

BIBLËN MUND TA KUPTOSH DHE TI!

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I DHATËS SË VJETËR

ZANAFILLA – MALAKIA

BOB UTLEY
PROFESOR I HERMENEUTIKËS
(INTERPRETIMIT BIBLIK)

PËRKTHEU: FLORENC MENE

BIBLE LESSONS INTERNATIONAL, MARSHALL, TEKSAS

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I DHIATËS SË VJETËR ZANAFILLA-MALAKIA

DR. BOB UTLEY
Bible Lessons International

PËRMBAJTJE

I.	UDHËZUES PËR LEXIMIN E MIRË BIBLIKE	4
II.	MËSIM HYRËS	
	A. PËRCAKTIM I TERMAVE MË TË PËRDORUR	10
	B. PSE TA STUDIOJMË DHIATËN E VJETËR	10
	C. SI TA STUDIOJMË DHIATËN E VJETËR	11
	D. HARTA BAZË	11
	E. GRAFIKU KOHOR THELBËSOR	13
III.	TORAHU	
	A. ZANAFILLA	20
	B. EKSODI	33
	C. LEVITIKU	43
	D. NUMRAT	58
	E. LIGJI I PËRTËRIRË	65
IV.	PROFETËT E HERSHËM	
	A. JOZUEU	74
	B. GJYQTARËT	82
	C. RUTHI (SHKRIMET)	89
	D. SAMUELI	94
	E. MBRETËRIT	103
V.	GRAFIK – MBRETËRIT E MBRETËRISË SË NDARË	
VI.	SHKRIMET	
	A. KRONIKAT	124
	B. EZRA	129
	C. NEHEMIA	135
	D. ESTERI	141
VII.	LETËRSIA E URTËSISË	147
	A. POEZIA HEBRAIKE	150
	B. LIBRAT	
	JOBI	152
	PSALMET	159
	FJALËT E URTA	167
	PREDIKUESI	173
	KËNGA E KËNGËVE	179

VIII.	PROFETËT E MËDHENJ	
	A. HYRJE PËR PROFECINË E DHIATËS SË VJETËR	186
	B. LIBRAT	
	ISAIA	190
	JEREMIA	208
	VAJTIMET	215
	EZEKIELI	220
	DANIELI	227
IX.	PROFETËT E VEGJËL	
	OSEA	233
	JOELI	239
	AMOSI	245
	ABDIA	253
	JONA	259
	MIKEA	264
	NAHUMI	270
	HABAKUKU	276
	SOFONIA	281
	HAGAI	286
	ZAKARIA	291
	MALAKIA	297

UDHËZUES PËR LEXIMIN E MIRË BIBLIK: KËRKIM PERSONAL PËR TË VËRTETËN E VERIFIKUESHME

A mund ta njohim të vërtetën? Ku gjendet? E verifikojmë dot logjikisht? A ekziston autoriteti absolut? A ka vlera absolute që mund të na udhëheqin jetën dhe botën tonë? A ka kuptim jeta? Pse jemi këtu? Ku po shkojmë? Këto pyetje (pyetje që përsiasin të gjithë njerëzit e logjikshëm) e kanë përndjekur mendjen njerëzore që nga agji i kohës (Pred. 1:13-18; 3:9-11). Më kujtohet kërkimi im vetjak për një qendër integruese në jetën time. Unë u bëra besimtar në Krishtin në moshë të re, kryesisht në bazë të dëshmisë së disa personave të rëndësishëm në familjen time. Me rritjen drejt pjekurisë, m'u rritën edhe pyetjet për veten dhe botën time. Klishetë e thjeshta kulturore dhe fetare nuk u jepnin kuptim përjetimeve për të cilat lexoja dhe me të cilat ndeshesha. Ishte një kohë pësjtjellimi, kërkimi, përmallimi dhe, shpesh, e një mungese shprese përballë botës së pandjeshme dhe të ashpër ku jetoja.

Shumë pretendonin se kishin përgjigje për këto pyetje absolute, por, pas hulumtimeve dhe përsiatjeve, vëreja se përgjigjet e tyre bazoheshin në (1) filozofi personale, (2) mite të lashta, (3) përjetime personale, ose (4) projeksione psikologjike. Kisha nevojë për njëfarë mase verifikimi, njëfarë lloj prove, një logjikë mbi të cilën të bazoja botëkuptimin tim, qendrën time integruese, arsyen për të jetuar.

Këto i gjeta në studimin e Biblës. Fillova të shqyrtoja për prova për vërtetësinë e saj, të cilat i gjeta në (1) besueshmërinë historike të Biblës, e vërtetuar nga arkeologjia, (2) saktësinë e profecive të Dhiatës së Vjetër, (3) unitetin e mesazhit të Biblës gjatë një mijë e gjashtëqind viteve të prodhimit të saj, dhe (4) dëshmitë personale të njerëzve të cilëve iu ndryshoi jeta një herë e përgjithmonë nga kontakti me Biblën. Krishterimi, si sistem i unifikuar besimi dhe bindjesh, ka aftësinë që të trajtojë pyetjet e koklavitura të jetës njerëzore. Kjo jo vetëm që më siguroi një kornizë logjike, por aspekti përjetues i besimit biblik më solli edhe gëzim e qëndrueshmëri emocionale.

Mendova se e gjeta qendrën integruese për jetën time: Krishtin, siç kuptohet përmes Shkrimeve. Ishte një përjetim ngazëllues, një çlirim emocional. Megjithatë, ende më kujtohet tronditja dhe dhimbja që pata kur fillova të kuptoja se sa shumë interpretime të ndryshme të këtij libri propagandoheshin, nganjëherë edhe brenda të njëjtave kisha dhe shkolla mendimi. Pohimi i frymëzimit dhe vërtetësisë së Biblës nuk ishte fundi, por vetëm fillimi. Si t'i vërtetoj ose mohoj interpretimet e larmishme dhe të kundërta të pasazheve të shumta e të vështira në Bibël, që ofroheshin nga ata që besonin në autoritetin dhe vërtetësinë e saj?

Kjo detyrë u bë synimi i jetës sime dhe shtegtimi i besimit tim. E dija se besimi në Krishtin (1) më kishte sjellë paqe dhe gëzim të madh. Mendja ime kërkonte me ngulm disa vlera absolute në mes të relativitetit të kulturës sime (postmodernizmit); (2) dogmatizmi i sistemeve të kundërta fetare (feve botërore); dhe (3) arroganca denominacionale. Në kërkimin tim për qasje të vlefshme për interpretimin e literaturës së lashtë, u habita kur zbulova dhe vetë anësitë e mia historike, kulturore, denominacionale dhe përjetuese. Shpesh, Biblën e kisha lexuar për të përforcuar pikëpamjet e mia. E përdorja si burim dogme për të sulmuar të tjerët dhe për të ripërkrahur vetë pasiguritë dhe mangësitë e mia. Sa të dhimbshëm e pata këtë ndërgjegjësim!

Ndonëse nuk mund të jem kurrë plotësisht objektiv, mund të bëhem lexues më i mirë i Biblës. Mund t'i kufizoj anësitë e mia duke i identifikuar dhe duke pranuar praninë e tyre. Ende nuk jam i çliruar prej tyre, por jam përballur me dobësitë e mia. Shpesh, interpretuesi është armiku më i keq i leximit të mirë biblik!

Më lejo të rendis disa nga presupozimet që sjell në studimin tim të Biblës në mënyrë që ti, si lexues, t'i shqyrtosh bashkë me mua:

- (1) Unë besoj se Bibla është e vetmja vetëzbulesë e frymëzuar e të vetmit Perëndi të vërtetë. Si rrjedhojë, duhet interpretuar në dritën e synimit të autorit fillestar hyjnor (Frymës) përmes shkrimtarit njerëzor në një sfond të veçantë historik.
- (2) Unë besoj se Bibla është shkruar për njeriun e zakonshëm – për të gjithë njerëzit! Perëndia na u përshtat për të na folur qartazi brenda një konteksti historik dhe kulturor. Perëndia nuk e fsheh të vërtetën – ai dëshiron të kuptojmë! Si rrjedhojë, Bibla duhet interpretuar në dritën e kohës së vet, jo sonës. Për ne, Bibla nuk duhet të ketë kurrë një kuptim të ndryshëm nga ajo që kuptuan ata që e lexuan dhe dëgjuan për herë të parë. Ajo është e kuptueshme nga mendja e zakonshme njerëzore dhe përdor forma e teknika normale të komunikimit njerëzor.
- (3) Unë besoj se Bibla ka një mesazh dhe synim të unifikuar. Ajo nuk bie në kundërshti me veten, ndonëse vërtet përmban pasazhe të vështira dhe paradoksale. Kështu, interpretuesi më i mirë i Biblës është vetë Bibla.

- (4) Unë besoj se çdo pasazh (përjashto profecitë) ka vetëm një kuptim, i bazuar në synimin e autorit të frymëzuar fillestar. Ndonëse s'mund të jemi kurrë absolutisht të sigurt se e njohim synimin e autorit fillestar, shumë tregues na dëftojnë në drejtimin e tij:
- Gjinia (lloji letrar) e zgjedhur për të shprehur mesazhin
 - Sfondi historik dhe/ose shkasi i veçantë që solli në ekzistencë shkrimin
 - Konteksti letrar i gjithë librit, si dhe i çdo njësie letrare
 - Modeli (përvijimi) tekstual i njësisve letrare në mënyrën si lidhen me gjithë mesazhin
 - Tiparet e veçanta gramatikore që janë përdorur për të komunikuar mesazhin
 - Fjalët e zgjedhura për të paraqitur mesazhin

Studimi i secilës prej këtyre zonave bëhet objekti i studimit tonë të pasazhit. Përpara se të shpjegoj metodologjinë time për leximin e mirë të Biblës, më lejon të përvijoj disa nga metodat e papërshtatshme që po përdoren sot, të cilat kanë shkaktuar kaq shumë larmi interpretimesh dhe që, si rrjedhojë, duhen shmangur:

- Anashkalimi i kontekstit letrar të librave të Biblës dhe përdorimi i çdo periudhe, fjalie, madje dhe fjalësh të veçanta si pohime të së vërtetës pa lidhje me synimin e autorit ose kontekstin më të gjerë. Shpesh, ky quhet “përdorim i teksteve si provë”.
- Anashkalimi i sfondit historik të librave duke e zëvendësuar me një sfond të hamendësuar historik që ka pak ose aspak mbështetje nga vetë teksti.
- Anashkalimi i sfondit historik të librave dhe leximi i tyre si gazetën lokale të mëngjesit, të shkruar kryesisht për të krishterët e sotëm si individë.
- Anashkalimi i sfondit historik të librave duke alegorizuar tekstin në një mesazh teologjiko-filozofik tërësisht pa lidhje me dëgjuesit e parë apo me synimin e autorit fillestar.
- Anashkalimi i mesazhit fillestar duke e zëvendësuar me sistemin tonë të teologjisë, ndonjë doktrinë që e kemi për zemër, apo me ndonjë çështje bashkëkohore pa lidhje me synimin dhe mesazhin e shprehur të autorit fillestar. Shpesh, ky fenomen vijon pas leximit fillestar të Biblës si mënyrë për të mbështetur autoritetin e folësit. Rëndom, ky quhet “reagim i lexuesit” (interpretim i llojit “çfarë më thotë teksti mua?”). Në çdo komunikim njerëzor me shkrim mund të gjenden tre përbërës të lidhur me njëri-tjetrin:



Në të shkuarën, teknikat e ndryshme të leximit janë fokusuar në njërin nga këta tre përbërës. Por, për të pohuar vërtet frymëzimin unik të Biblës, do të ishte më i përshtatshëm një diagram i ndryshuar:



Në të vërtetë, në procesin interpretues duhen përfshirë të tre këta përbërës. Për qëllime vërtetimi, interpretimi im fokusohet në dy përbërësit e parë: autori fillestar dhe teksti. Ndoshta, po reagoj ndaj keqpërdorimeve që kam përmendur: (1) alegorizimi ose shpirtërizimi i teksteve dhe (2) interpretimi i “reagimit të lexuesit” (ç’kuptim ka teksti për mua). Keqpërdorimi mund të ndodhë në secilën fazë. Duhet t’i kontrollojmë gjithmonë motivet, anësitë, teknikat dhe zbatimet tona. Por si t’i kontrollojmë nëse nuk ka asnjë kufi, cak, apo

kritere për interpretimet? Pikërisht këtu, synimi autorial dhe struktura e tekstit më sigurojnë disa kritere për t'ua kufizuar gamën interpretimeve të vlefshme të mundshme.

Në dritën e këtyre teknikave të përshtatshme leximore, cilat janë disa qasje të mundshme për leximin dhe interpretimin e mirë të Biblës, të cilat na ofrojnë një shkallë vërtetimi dhe konsistence?

Në këtë pikë, nuk po diskutoj për teknikat unike të interpretimit të gjinive të veçanta, por për parimet e përgjithshme hermeneutike që janë të vlefshme për të gjitha llojet e teksteve biblike. Një libër i mirë për qasjet sipas gjinive të ndryshme është *How To Read the Bible For All Its Worth (Si ta lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka)*, nga Gordon Fee dhe Douglas Stuart, botuar nga Zondervan.

Metodologjia ime fokusohet fillimisht te fakti se lexuesi duhet t'i lejojë Frymës së Shenjtë që të hedhë dritë mbi Biblën përmes katër ciklesh personale leximi. Kjo i jep Frymës, tekstit dhe lexuesit vend parësor, jo dytësor. Po kështu, kjo e mbron lexuesin që të mos ndikohet në mënyrë të panevojshme nga komentuesit. Kam dëgjuar se dikush ka thënë: "Bibla hedh shumë dritë mbi komentaret". Ky nuk synohet si koment zhvlerësues për ndihmat studimore, por si thirrje për përdorimin e tyre në kohën e duhur.

Duhet të jemi në gjendje që interpretimet t'i mbështesim me vetë tekstin. Gjashtë zona sigurojnë të paktën një vërtetim të kufizuar:

- (1) Sfondi historik
- (2) Konteksti letrar
- (3) Strukturat gramatikore (sintaksa)
- (4) Përdorimi i fjalëve në kohën kur u shkruan
- (5) Pasazhet e përshtatshme paralele

Duhet të jemi në gjendje të japim arsyet dhe logjikën e interpretimeve tona. Bibla është burimi ynë i vetëm për besimin dhe praktikën. Mjerisht, shpesh, të krishterët nuk bien dakord për ato që mëson ose pohon ajo. Është vetëkundërshtuese që ne besimtarët të pohojmë frymëzimin e Biblës dhe, pastaj, të mos jemi në gjendje të biem dakord se çfarë na mëson dhe kërkon ajo!

Katër ciklet e leximit synojnë të na sigurojnë të dhënat interpretuese të mëposhtme:

- (1) Cikli i parë i leximit
 - (a) Lexo gjithë librin njëherësh. Lexoje sërish me një përkthim tjetër, ndoshta me një teori të ndryshme përkthimi
 - i. fjalë për fjalë (NKJV, NASB, NRSV)
 - ii. ekuivalencë dinamike (TEV, JB)
 - iii. parafrazim (Living Bible, Amplified Bible)
 - (b) Kërko qëllimin qendror të gjithë shkrimit. Identifiko idenë e tij kryesore.
 - (c) Izolo (nëse është e mundur) një njësi letrare, kapitull, paragraf, apo fjali që shpreh qartë qëllimin ose idenë e tij qendrore.
 - (d) Identifiko gjininë mbizotëruese letrare
 - i. Dhiata e Vjetër
 - 1) Narrativa hebraike
 - 2) Poezia hebraike (letërsi urtësie, psalm)
 - 3) Profecia hebraike (prozë, poezi)
 - 4) Kodet e ligjit
 - ii. Dhiata e Re
 - 1) Narrativa (ungjijtë, Veprat)
 - 2) Shëmbëlltyra (ungjijtë)
 - 3) Letra
- (2) Cikli i dytë i leximit
 - (a) Lexo sërish gjithë librin, duke u përpjekur të identifikosh temat ose subjektet kryesore.
 - (b) Përvijoj temat madhore dhe shpreh shkurtimisht përmbajtjen e tyre me një pohim të thjeshtë.
 - (c) Kontrolllo pohimin e synimit dhe përvijimin tënd të përgjithshëm me anë të ndihmave studimore.
- (3) Cikli i tretë i leximit
 - (a) Lexo sërish gjithë librin, duke u përpjekur të identifikosh sfondin historik dhe shkasit e veçantë për shkrimin e tij, duke u bazuar në të dhënat e vetë këtij libri biblik.
 - (b) Rendit elementet historike që përmenden në librin biblik
 - i. Autori

- ii. Data
- iii. Marrësit
- iv. Arsyja e veçantë për shkrimin e tij
- v. Aspekte të sfondit kulturor që lidhen me qëllimin e shkrimit
- (c) Zgjerje përvijimit tënd në nivel paragrafi për atë pjesë të librit biblik që po interpreton. Gjithmonë identifikoj dhe përvijoj njësinë letrare. Kjo mund të përbëhet nga një sërë kapitujsh ose paragrafesh. Kjo gjë të mundëson të ndjekësh logjikën dhe modelin tekstual të autorit fillestar.
- (d) Kontrollon sfondin historik duke përdorur ndihma studimore.
- (4) Cikli i katërt i leximit
 - (a) Lexo sërish njësinë e veçantë letrare në disa përkthime
 - (b) Gjej strukturat letrare ose gramatikore
 - i. Frazë të përsëritura
 - ii. Struktura të përsëritura gramatikore
 - iii. Koncepte të kundërta
 - (c) Rendit elementet e mëposhtme
 - i. Terma të rëndësishëm
 - ii. Terma të pazakontë
 - iii. Struktura të rëndësishme gramatikore
 - iv. Fjalë, fjali dhe periudha tejet të vështira
 - (d) Gjej pasazhet e duhura paralele
 - i. Gjej pasazhin më të qartë mësimor për temën tënde duke përdorur
 - a) Libra “të teologjisë sistematike”
 - b) Bibla me referenca
 - c) Përkues biblikë
 - ii. Gjej një çift të mundshëm paradoksal brenda temës tënde. Shumë të vërteta biblike paraqiten në çifte dialektike; shumë konflikte denominacionale vijnë nga mbështetja e njëanshme të gjysmës dhe një tensioni biblik. Gjithë Bibla është e frymëzuar, ndaj duhet të përipiqemi të gjejmë mesazhin e saj të plotë në mënyrë që t’i sigurojmë një drejtpeshim biblik interpretimit tonë.
 - iii. Kërko për paralele brenda të njëjtit libër, të njëjtit autor, ose të njëjtës gjini letrare; Bibla është interpretuesja më e mirë e vetes, pasi ajo ka një autor të vetëm, Frymën.
 - (e) Përdor ndihmat studimore për të kontrolluar vëzhgimet e tua për sfondin dhe shkasit historik
 - i. Bibla studimore
 - ii. Enciklopedi, manualë dhe fjalorë biblikë
 - iii. Hyrje biblike
 - iv. Komentare biblike (në këtë pikë në studimin tënd, lejo komunitetin besimtar, të kaluar dhe të tashëm, që të të ndihmojë në studimin tënd personal dhe të ta korrigjojë).

Në këtë pikë, i kthehemi zbatimit. Ke kaluar kohë për të kuptuar tekstin në sfondin e vet fillestar; tani, duhet ta zbatosh në jetën dhe kulturën tënde. Unë e përcaktoj autoritetin biblik si “të kuptuarit e asaj që po i thoshte autori fillestar biblik kohës së vet dhe zbatimin e asaj të vërtete në kohën tonë”.

Zbatimi duhet të ndjekë interpretimin e synimit të autorit fillestar si nga ana kohore, ashtu dhe ajo logjike. Nuk mund ta zbatojmë pasazhin biblik në kohën tonë pa kuptuar se çfarë po thoshte ai në kohën e vet! Pasazhi biblik nuk duhet të ketë një kuptim që nuk e pati kurrë vetë!

Si udhërrëfyes do të kesh përvijimin tënd të detajuar në nivelin e paragrafit (cikli i tretë i leximit). Zbatimi duhet bërë në nivelin e paragrafit, jo fjalës. Fjalët kanë kuptim vetëm në kontekst; fjalitë kanë kuptim vetëm në kontekst; periudhat kanë kuptim vetëm në kontekst. I vetmi person i frymëzuar, që është i përfshirë në procesin interpretues, është autori fillestar. Në ndjekim vetëm udhëheqjen e tij me anë të përndritjes së Frymës së Shenjtë. Por përndritja nuk është frymëzim. Për të thënë, “kështu thotë Zoti”, duhet t’i qëndrojmë besnikë synimit të autorit fillestar. Zbatimi duhet të ketë lidhje të veçantë me synimin e përgjithshëm të gjithë shkrimit, me njësinë e veçantë letrare dhe me zhvillimin e mendimit në nivelin e paragrafit.

Mos lejo që problematikat e kohës sonë të interpretojnë Biblën; lër Biblën të flasë vetë! Kjo mund të na kërkojë që t'i nxjerrim parimet nga teksti. Kjo është e vlefshme nëse teksti mbështet një parim të caktuar. Fatkeqësisht, shumë herë, parimet tona janë thjesht të tilla, parime “tonat” – jo parime të tekstit.

Në zbatimin e Biblës, është e rëndësishme të kujtojmë se (përveçse në rastin e profecisë) vetëm një kuptim i vetëm është i vlefshëm për një tekst të caktuar biblik. Ai kuptim lidhet me synimin e autorit fillestar teksa trajtonte një krizë apo nevojës të kohës. Nga ky kuptim i vetëm mund të nxirren shumë zbatime të mundshme. Zbatimi do të bazohet në nevojat e marrësve, por duhet të ketë lidhje me kuptimin e autorit fillestar.

Deri tani, kam diskutuar për procesin logjik dhe tekstual që ka të bëjë me interpretimin dhe zbatimin. Tani, më lejoni të diskutoj shkurtimisht për aspektin shpirtëror të interpretimit. Lista e mëposhtme më ka rezultuar e dobishme:

- (1) Lutu për ndihmën e Frymës (shih 1 Kor. 1:26-2:16).
- (2) Lutu për falje dhe pastrim personal nga mëkatet e njohura (shih 1 Gjonit 1:9).
- (3) Lutu për një dëshirë më të madhe për të njohur Perëndinë (shih Psa. 19:7-14; 42:1 e më tej; 119:1 e më tej).
- (4) Çdo mësim të ri zbatoje menjëherë në jetë.
- (5) Vazhdo të jesh i përgjitur dhe i mësueshëm.

Është shumë e vështirë të ruash ekuilibrin mes procesit logjik dhe udhëheqjes shpirtërore të Frymës së Shenjtë. Citimet e mëposhtme më kanë ndihmuar t'i ekuilibroj këto të dyja:

- (1) nga James W. Sire, *Scripture Twisting (Shtrembërimi i Shkrimit)*, f. 17-18:

“Përndritja i vjen në mendje popullit të Perëndisë – jo vetëm elitës shpirtërore. Nuk ka asnjë klasë *guru*-sh në krishterimin biblik, asnjë *iluminati*, as njerëz përmes të cilëve duhet të vijë çdo interpretim i saktë. Prandaj, ndonëse Fryma e Shenjtë jep dhunti të veçanta urtësie, njohurie dhe mprehtësie shpirtërore, ai nuk i cakton këta të krishterë të dhuntishëm që të jenë të vetmit interpretues të autoritetshëm të Fjalës së tij. Është në dorën e secilit individ të popullit të tij që të mësojë, të gjykojë dhe të dallojë në lidhje me Biblën, e cila qëndron si autoritet edhe mbi ata të cilëve Perëndia u ka dhënë aftësi të veçanta. Si përmbledhje, supozimi që shpreh në gjithë këtë libër është se Bibla është zbulues e vërtetë e Perëndisë për gjithë njerëzimin, se ajo është autoriteti ynë absolut për të gjitha çështjet për të cilat flet, dhe se ajo nuk është mister i plotë, por mund të kuptohet mjaftueshëm nga njerëzit e zakonshëm në çdo kulturë”.

- (2) për Kirkegardin, gjetur në Bernard Ramm, *Protestant Biblical Interpretation (Interpretimi biblik protestant)*, f. 75:

Sipas Kirkegardit, studimi gramatikor, leksikor dhe historik i Biblës është hap i nevojshëm, por paraprak, drejt leximit të vërtetë të Biblës. “Për ta lexuar Biblën *si fjalë të Perëndisë*, njeriu duhet ta lexojë me emocion të madh, në majtë gishtave, me pritshmëri të madhe, në kuvendim me Perëndinë. Nëse Biblën e lexon shkel e shko, pa kujdes, apo në mënyrë akademike, apo profesionale, nuk po e lexon si Fjalë të Perëndisë. Kur njeriu e lexon Biblën siç lexon një letër dashurie, atëherë po e lexon si Fjalë të Perëndisë”.

- (3) H. H. Rowley në *The Relevance of the Bible (Natyra aktuale e Biblës)*, f. 19:

“Asnjë kuptim thjesht mendor i Biblës, sado i plotë, s'mund t'ia zotërojë dot të gjitha thesaret asaj. Ajo nuk e përçmon këtë lloj kuptimi, sepse ai është thelbësor për të shkuar drejt të kuptuarit të plotë. Por kjo duhet të të çojë në një të kuptuar shpirtëror të thesareve shpirtërore të këtij libri, në mënyrë që të plotësohet. Dhe, për këtë të kuptuar shpirtëror, është e nevojshme diçka më tepër sesa vigjilenca mendore. Gjërat shpirtërore dallohen shpirtërisht, ndaj studiuesit të Biblës i nevojitet një qëndrim shpirtëror pranues, një zell për të gjetur Perëndinë që t'i dorëzohet atij, në mënyrë që të kalojë, përtej studimit të tij shkencor, në trashëgiminë më të pasur të librit më madhështor në botë”.

Komentari studimor udhëzues synon të të ndihmojë në procedurat interpretuese në mënyrat vijuese

1. Një përvijim i shkurtër historik shërben si hyrje e çdo libri. Pasi të kesh kryer “ciklin tre të leximit”, kontrollo këtë informacion.
2. Mësimet kontekstuale gjenden në fillim të secilit kapitull. Kjo do të të ndihmojë të kuptosh sesi është strukturuar njësia letrare.
3. Në fillim të çdo kapitulli ose njësie letrare kryesore, kam dhënë ndarjet e paragrafëve dhe titujt e tyre përshkruar nga një sërë përkthimesh moderne:

- a. Teksti greqisht i United Bible Society, botimi i katërt i rishikuar (UBS⁴)
- b. The New American Standard Bible, përditësimi i vitit 1995 (NASB)
- c. The New King James Version (NKJV)
- d. The New Revised Standard Version (NRSV)
- e. Today's English Version (TEV)
- f. The Jerusalem Bible (JB)

Ndarjet sipas paragrafëve nuk janë të frymëzuara. Ato duhen vërtetuar nga konteksti. Duke krahasuar disa përkthime moderne që nisen nga teori të ndryshme përkthimi dhe pikëvështrime të ndryshme teologjike, jemi në gjendje të analizojmë strukturën e hamendësuar të mendimit të autorit fillestar. Secili paragraf përmban nga një të vërtetë kryesore. Kjo është quajtur “fjalë të mëdha”, ose “ideja qendrore e tekstit”. Ky mendim unifikues është çelësi për interpretimin e duhur historik dhe gramatikor. S’duhet kurrë të interpretojmë, të predikojmë, ose të japim mësim nga më pak se një paragraf! Gjithmonë kujto se çdo paragraf ka lidhje me paragrafët rrethues. Ja pse është kaq e rëndësishme të bësh një përvijim të të gjithë librit në nivelin e paragrafëve. Duhet të jemi në gjendje të ndjekim rrjedhën logjike të temës që po trajtohet nga autori i frymëzuar fillestar.

4. Shënimet e Bobit ndjekin një qasje interpretimi “varg për varg”. Kjo na shtrëngon të ndjekim mendimin e autorit fillestar. Shënimet sigurojnë informacion për pikat e mëposhtme:
 - a. kontekstin letrar
 - b. të dhënat historike dhe kulturore
 - c. informacione gramatikore
 - d. studime fjalësh
 - e. pasazhe paralele të rëndësishme
5. Në pika të ndryshme gjatë këtij komentari, tekstit të shtypur të New American Standard Version (përditësimi i vitit 1995) do t’i shtojmë edhe përkthimet e një sërë versionesh të tjera moderne:
 - a. The New King James Version (NKJV), i cili ndjek dorëshkrimet tekstuale të “Textus Receptus”.
 - b. The New Revised Standard Version (NRSV), i cili është një rishikim “fjalë për fjalë” i Revised Standard Version, i kryer nga Këshilli Kombëtar i Kishave (National Council of Churches).
 - c. The Today's English Version (TEV), i cili është një përkthim ekuivalent dinamik i Shoqërisë Biblike Amerikane.
 - d. The Jerusalem Bible (JB), i cili është një përkthim anglisht i bazuar në një përkthim ekuivalent dinamik nga ana e katolikëve francezë.
6. Për ata që s’lexojnë greqisht, krahasimi i përkthimeve anglisht mund t’i ndihmojë në identifikimin e problemeve në tekst:
 - a. variantet në dorëshkrime
 - b. kuptimet e ndryshme të fjalëve
 - c. tekstet dhe strukturat që janë të vështira nga ana gramatikore
 - d. tekstet e paqarta

Ndonëse përkthimet anglisht nuk i zgjidhin dot këto probleme, gjithsesi i shigjetojnë si pjesë që kanë nevojë për një studim më të thellë dhe më tërësor.

7. Në përmbyllje të çdo kapitulli, jepen pyetje të vlefshme diskutimi, të cilat përpiqen të shigjetojnë çështjet kryesore interpretuese të atij kapitulli.

MËSIM HYRËS

I. PËRCAKTIM I TERMAVE MË TË PËRDORUR

A. EMRAT E PERËNDISË

1. El
2. Elohim
3. JHVH
4. Adon
5. El Shadai

B. EMRAT E TEKSTEVE DHE PËRKTHIMEVE

1. Teksti Masoret (MT)
2. Septuaginta (LXX)
3. Vullgata
4. Midrash
 - a. Halakah – komentari i Torahut
 - b. Hagada – histori dhe shëmbëllyra për gjithë DHV
5. Talmud
 - a. Mishnah – tradita gojore për Torahun nga rabinët e vjetër dhe të famshëm
 - b. Gemara – komentari për Mishnën nga rabinët e mëvonshëm
6. Targumët
7. Pergamenat e Detit të Vdekur

II. PSE TA STUDIOJMË DHIATËN E VJETËR

A. Ishte i vetmi Shkrim që kishin Jezusit dhe apostujt. E citonin shpesh.

B. Është vetëzbuluesja e Perëndisë. Është e frymëzuar.

1. Mateu 5:17 e më tej
2. 2 Timoteut 3:15-17
3. 1 Korintasve 2:9-13
4. 1 Thesalonikasve 2:13
5. 1 Pjetrit 1:23-25
6. 2 Pjetrit 1:20-21
7. 2 Pjetrit 3:15-16

C. U shkrua për ne

1. Romakëve 4:23-24; 15:4
2. 1 Korintasve 9:9-10; 10:6, 11

D. Ç'qëndrim duhet të mbajnë të krishterët ndaj DHV?

1. Ka patur disa qasje historike
2. Ta zbatojnë plotësisht
3. Ta anashkalojnë plotësisht
4. Ta respektojnë si zbulësë, por jo si të detyrueshme
5. Nuk është mjet shpëtimi
 - a. Romakëve 4
 - b. Veprat 15; Galatasve 3
6. Hebrejve
7. Është zbulësia e Perëndisë për njeriutn. Ka një qëllim në jetën tonë. Përbën bazën e Dhiatës së Re (premtimi për përmbushje.)

III. SI TA STUDIOJMË DHIATËN E VJETËR (BIBLËN) Disa parime interpretuese bazë:

- A. Bibla është shkruar në gjuhë njerëzore normale:
 1. Perëndia nuk po mundohet ta fshehtë të vërtetën.
 2. Perëndia i është përshtatur aftësisë sonë për të kuptuar.
- B. Çelësi për interpretimin e saktë është qëllimi fillestar i autorit të frymëzuar. Kjo gjendet në kuptimin e qartë të termave, siç i përdorte autorit dhe siç i kuptonin dëgjuesit e parë. Prandaj, për ta interpretuar saktë një pasazh, duhet të marrim parasysh informacionet e mëposhtme:
 1. kontekstin historik;
 2. kontekstin letrar;
 3. gjininë letrare (llojin e letërsisë);
 4. gramatikën (sintaksën);
 5. kuptimin e fjalëve në atë kohë;
 6. formatin tekstual të autorit.
- C. Gjithë Bibla është e frymëzuar (2 Tim. 3:16); prandaj, interpretuesi më i mirë i Biblës është Bibla. Këtë e quajmë “analogjia e besimit”, ose pasazhet paralele:
 1. kërkojmë pasazhin më të qartë;
 2. kërkojmë qëllimin kryesor të Perëndisë;
 3. kërkojmë të vërtetën e paraqitur në dyshe paradoksale.
- D. Si ta dallojmë kulturoren dhe kalimtare nga e vërteta ndërkulturore dhe e përjetshme?
 1. A vërtetohet një e vërtetë e DHV nga një autor i DHR?
 2. A është uniforme Bibla në paraqitjen e kësaj të vërtete?
 3. A është e veshur kjo e vërtetë me fjalë që janë qartazi kulturore?

IV. HARTA BAZË E LINDJES SË AFËRT TË LASHTË, LIDHUR ME DHIATËN E VJETËR

- A. Ujëra (nga perëndimi në lindje)

1. Deti Mesdhe (Deti i Madh, ose i Sipërm)	7. Lumi Jordan
2. Lumi Nil	8. Lumi Jabok
3. Deti i Kuq	9. Lumi Arnon
4. Gjiri i Akabasë	10. Deti i Galilesë (Liqeni i Kineretit)
5. Lumi (ose përroi) i Egjiptit	11. Lumi Eufrat
6. Deti i Kripur (Deti i Vdekur)	12. Lumi Tigër
	13. Gjiri Persik (Deti i Ulët)
- B. Vende që lidhen me popullin e Perëndisë në DHV (nga perëndimi në lindje)

1. Romë
2. Greqi
3. Kaftor (Kretë)
4. Kitim (Qipro)
5. Egjipt
6. Filisti
7. Jude
8. Izrael
9. Edom
10. Moab
11. Amon
12. Feniki (Liban)
13. Siri
14. Hititët (Anatoli)
15. Arabi
16. Asiri
17. Babiloni
18. Persi
19. Medi
20. Elam

C. Kryeqytetet e vendeve kryesore [provimi i dytë]

1. Memfis (Egjipt)
2. Jerusalem (Jude)
3. Samari (Izrael)
4. Tir (Feniki)
5. Damask (Siri)
6. Ninive (Asiri)
7. Babiloni (Babiloni)
8. Suza (Persi)

D. Qytete të tjera të rëndësishme [provimi i tretë]

1. Ur
2. Haran
3. Megido
4. Shekem
5. Jeriko
6. Betlehem
7. Hebron
8. Beersheba
9. Avaris/Zoan/Tanis
10. Tebë

E. Male [provimi i tretë]



1. Ararat
2. Hermon
3. Tabor
4. Ebal, ose Gerizim (Shekem)
5. Karmel
6. Nebo/Pisga
7. Sion/Moriah (Jerusalem)
8. Sinai/Horeb

V. GRAFIKU KOHOR THELBËSOR I DHIATËS SË VJETËR


- A. Ngjarje të padatueshme (Zanafilla 1-11)
1. Krijimi (Zan. 1-2)
 2. Rënia e njeriut (Zan. 3)
 3. Përmbytja e Noeut (Zan. 6-9)
 4. Kulla e Babelit (Zan. 10-11)
- B. Dhjetë data dhe ngjarje:
- | | |
|--|-----------------------|
| 1. Periudha patriarkale (Zan. 12-50 dhe Jobi) | 2000 para K. |
| 2. Eksodi nga Egjipti (Eksodi) | 1445 pse 1290 para K. |
| 3. Pushtimi i Kananit (Jozueu) | 1440 ose 1250 para K. |
| 4. Monarkia e bashkuar (Sauli, Davidi, Solomoni) | 1000 para K. |
| 5. Monarkia e ndarë (Rehoboami-Jeroboami I) | 922 para K. |
| 6. Rënia e Samarisë (Izraelit) në duart e Asirisë | 722 para K. |
| 7. Rënia e Jerusalemit (Judës) në duart e Babilonisë | 586 para K. |
| 8. Dekreti i Kirit (Persi) për kthimin në Izrael | 538 para K. |
| 9. Rindërtimi i tempullit | 516 para K. |
| 10. Përmbyllja e periudhës së DHV (Malakia) | 430 para K. |
- C. Armiqtë kryesorë të popullit të Perëndisë:
1. Egjipt
 2. Kanan
 3. Filisti
 4. Siri
 5. Asiri
 6. Babiloni
 7. Persi
 8. Greqi
 9. Romë
- D. Mbretërit sipas vijës kohore:
1. Monarkia e bashkuar
 - a. Sauli
 - b. Davidi
 - c. Solomoni
 2. Izraeli
 - a. Jeroboami I
 - b. Ahabi
 - c. Jeroboami II
 - d. Hoshea
 3. Juda
 1. Rehoboami
 2. Uziahu
 3. Hezekia
 4. Manasi
 5. Jozia
 6. Jehoahazi (3 muaj)
 7. Jehoiakimi
 8. Jehoiakini (3 muaj)
 9. Zedekia
 10. Gedaliahu (gubernator i Persisë)
 4. Persia
 1. Kiri II (550-530 para K.)
 2. Kambisi II (530-522)
 3. Dari I (522-486)

4. Kserksi I (486-465)
5. Artakserksi I (465-424) Shih listën e plotë të mbretërve të Judës dhe Izraelit, si dhe mbretërve të Asirisë, Babilonisë, Persisë dhe Greqisë, në fund të 1 dhe 2 Mbretërve.

WATERWAYS



**ANCIENT
NEAR EAST**



NATIONS

HITTITE

KITTIM

EGYPT

MIDIAN

PHILISTIA

JUDAH

ISRAEL

AMMON

MOAB

EDOM

PHOENICIA

SYRIA


ARABIA

ASSYRIA

MEDIA-PERSIA

BABYLON


ELAM




**ANCIENT
NEAR EAST**




**ANCIENT
NEAR EAST**



OTHER CITIES ■



**ANCIENT
NEAR EAST**



HYRJE PËR ZANAFILLËN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Në hebraisht (pra, sipas Tekstit Masoretik), titulli është fjala e parë e librit, *Bereshith*, “në fillim”, ose “Fillimisht”.
- B. Në Biblën greqisht (pra, përkthimi i Septuagintës), titulli është *Zanafilla*, që do të thotë “fillimi” ose “origjina”, që është marrë nga Zan. 2:4a. Kjo mund të jetë fraza kyçe “përvijuese” e autorit, ose kolofoni i tij për të lidhur së bashku biografitë e ndryshme teologjike, njësoj siç bënin dhe shkruarit e pllakave me kuneiforme babilonase. Kjo frazë përvijuese kyçe funksionon si përmbledhje, jo si hyrje.

II. KANONIZIMI

- A. Ky është libri i parë i pjesës së parë të kanonit hebraik të titulluar “Torahu”, ose “mësimet”, ose “Ligji”.
- B. Në Septuagintë, kjo pjesë njihet me termin Pentatuk/Pesëlibërsh (pra, pesë rrotullat).
- C. Nganjëherë, në anglisht njihet me titullin “Pesë Librat e Moisiut”.
- D. Zanafilla-Ligji i Përtërirë është një rrëfim i vazhduar, i rrëfyer (ose i redaktuar) nga Moisiu në lidhje me krijimin; u përpilua gjatë jetës së Moisiut.

III. GJINIA LETRARE – Libri i Zanafillës është pikësëpari narrativë teologjike dhe historike, por përfshin dhe lloje të tjera gjinish letrare:

- A. Poezi – shembuj: 2:23; 4:2; 8:22
- B. Profeci – shembuj: 3:15; 49:1 e më tej (si dhe poetike)

IV. AUTORËSIA

- A. Vetë Bibla nuk e përmend autorin (siç ndodh dhe për shumë libra të DHV). Zanafilla nuk ka pjesë në vetën e parë njëjës si Ezra, Nehemia, apo pjesë në vetën e parë shumës si te Veprat. Gjithsesi, në fund të fundit, autori është Perëndia!
- B. Tradita judaike:
 - 1. Autorët e lashtë judenj thonë se e shkroi Moisiu:
 - a. *Ekleziastiku* i Ben Sirahut, 24:23, shkruar rreth 185 para K.
 - b. *Babba Bathra* 14b, një pjesë e Talmudit
 - c. Filoja i Aleksandrisë, në Egjipt, një filozof jude që jetoi rreth 20 para K. deri më 42 pas K.
 - d. Flavius Jozefusi, historian jude, që jetoi rreth 37-70 pas K.
 - 2. Ky libër ishte zbulesë që iu dha Moisiut
 - a. Thuhet se Moisiu e shkroi për popullin:
 - (1) Eksodi 17:14
 - (2) Eksodi 24:4, 7
 - (3) Eksodi 34:27-28
 - (4) Numrat 33:2
 - (5) Ligji i Përtërirë 31:9, 22, 24-26
 - b. Thuhet se Perëndia i foli popullit nëpërmjet Moisiut:
 - (1) Ligji i Përtërirë 5:4-5, 22
 - (2) Ligji i Përtërirë 6:1
 - (3) Ligji i Përtërirë 10:1

- c. Thuhet se Moisiu ia tha popullit fjalët e Torahut:
 - (1) Ligji i Përtërirë 1:1, 3
 - (2) Ligji i Përtërirë 5:1
 - (3) Ligji i Përtërirë 27:1
 - (4) Ligji i Përtërirë 29:2
 - (5) Ligji i Përtërirë 31:1, 30
 - (6) Ligji i Përtërirë 32:44
 - (7) Ligji i Përtërirë 33:1
 - 3. Autorët e DHV ia atribuojnë Moisiut:
 - a. Jozueu 8:31
 - b. 2 Mbretërve 14:6
 - c. Esdra 6:18
 - d. Nehemia 8:1; 13:1-2
 - e. 2 Kronikave 25:4; 34:12; 35:12
 - f. Danieli 9:11
 - g. Malakia 4:4
- C. Tradita e krishterë:
- 1. Jezusi ia atribuon Moisiut disa citime nga Torahu:
 - a. Mateu 8:4; 19:8
 - b. Marku 1:44; 7:10; 10:5; 12:26
 - c. Luka 5:14; 16:31; 20:37; 24:27, 44
 - d. Gjoni 5:46-47; 7:19, 23
 - 2. Autorë të tjerë të DHR ia atribuojnë Moisiut disa citime nga Torahu:
 - a. Luka 2:22;
 - b. Veprat 3:22; 13:39; 15:1, 15-21; 26:22; 28:23
 - c. Romakëve 10:5, 19
 - d. 1 Korintasve 9:9
 - e. 2 Korintasve 3:15
 - f. Hebrenjve 10:28
 - g. Zbulesa 15:3
 - 3. Shumica e Etërve të hershëm të kishës pranonin autorësinë e Moisiut. Nga ana tjetër, Ireneu, Klementi i Aleksandrisë, Origeni dhe Tertuliani shprehën dyshimin e tyre për marrëdhënien e Moisiut me formën e tanishme kanonike të Zanafillës (shih D. 2, më poshtë).
- D. Bota studimore moderne
- 1. Është e qartë se Torahut i janë bërë disa shtesa redaktoriale (me sa duket, për ta bërë këtë vepër të lashtë më të kuptueshme për lexuesit e kohës, gjë që ishte tipike për skribët egjiptianë):
 - a. Zanafilla 12:6; 13:7; 14:14; 21:34; 32:32; 36:31; 47:11
 - b. Eksodi 11:3; 16:36
 - c. Numrat 12:3; 13:22; 15:22-23; 21:14-15; 32:33 e më tej
 - d. Ligji i Përtërirë 3:14; 34:6
 - e. Skribët e lashtë ishin tejet të stërvitur e të arsimuar. Gjithsesi, teknikat e tyre ndryshonin nga njëri vend në tjetrin:
 - (1) Në Mesopotami, skribët kujdeseshin që të mos ndryshonin asgjë, madje dhe i kontrollonin punët e tyre nga ana e saktësisë. Ja një shënim i një skribi të lashtë sumerian: “Vepra është e plotë nga fillimi në fund, është kopjuar, rishikuar, krahasuar dhe vërtetuar shenjë për shenjë” (rreth 1400 para K.).
 - (2) Në Egjipt, ata i ripunonin lirisht tekstat e lashta për t’i përditësuar për lexuesit e kohës. Edhe skribët në Kumran (pra, Pergamenat e Detit të Vdekur) e ndoqën këtë qasje.
 - 2. Studiuesit e shekullit të 19-të nxorën teorinë se Torahu është një dokument i përbërë prej shumë burimesh gjatë një periudhe të gjatë kohore (Graff-Wellhausen). Kjo teori bazohet në:
 - a. Emrat e ndryshëm, që përdoren në Torah për Perëndinë
 - b. Ngjarjet që përmenden dy herë në tekst
 - c. Forma letrare e rrëfimeve

- d. Teologjia e rrëfimeve
- 3. Burimet dhe datat e hamendësuar:
 - a. Burimi “J” (përdorimi i emrit JHVH nga Izraeli jugor) – 950 para K.
 - b. Burimi “E” (përdorimi i emrit *Elohim* nga Izraeli verior) – 850 para K.
 - c. “J” dhe “E” në kombinim me njëri-tjetrin – 750 para K.
 - d. Burimi “D” (“Libri i Ligjit”, 2 Mbre. 22:8, zbuluar gjatë reformës së Josias teksa riparonte tempullin, mund të ketë qenë libri i Ligjit të Përtërirë, i shkruar nga një prift i panjohur i kohës së Josias për të mbështetur reformën e tij.) – 621 para K.
 - e. Burimi “P” (rishkrimi priftëror i DHV, sidomos i ritualeve dhe procedurave) – 400 para K.
 - f. Është e qartë se Torahut i janë bërë shtesa redaktoriale. Judenjtë thonë se këtë e kishte bërë
 - (1) Kryepriifti (ose ndonjë tjetër i familjes së tij) në kohën e shkrimit
 - (2) Profeti Jeremia
 - (3) Skribi Ezra – IV Ezra thotë se ai e rishkroi për shkak se dokumentet origjinale u shkatërruan gjatë rënies së Jerusalemit më 586 para K.
 - g. Gjithsesi, teoria e “J. E. D. P.” nxjerr në pah më tepër teoritë dhe kategoritë e sotme letrare sesa të dhënat nga vetë Torahu. Shih R. K. Harrison, *Introduction to the Old Testament [Hyrje në Dhiatën e Vjetër]*, f. 495-541, dhe *Tyndale’s Commentaries, “Leviticus” [Levitiku]*, f. 15-25).
 - h. Veçoritë e letërsisë hebraike
 - (1) Ngjarjet e rrëfyera dy herë, si Zan. 1 & 2, janë të zakonshme në hebraisht. Zakonisht, jepet një përshkrim i përgjithshëm, i ndjekur nga një rrëfim më i hollësishëm (p.sh., Dhjetë Urdhërimet dhe Kodi i Shenjtërisë). Ndoshta, me këtë mënyrë theksoheshin të vërtetat ose i vihej në ndihmë mësimi përmendësh me gojë.
 - (2) Rabinët e lashtë thoshin se dy emrat më të zakonshëm për Perëndinë kanë domethënie teologjike:
 - (a) JHVH – emri i Besëlidhjes për Perëndinë, që tregon marrëdhënien e tij me Izraelin si Shpëtimtar dhe Shpengues (shih Psa. 19:7-14; 103).
 - (b) *Elohim* – hyjnia si Krijues, Furnizues dhe Ruajtës i gjithës jetës në tokë (shih Psa. 19:1-6; 104).
 - (3) Në letërsinë jobiblrike të Lindjes së Afërt, është normale që brenda një vepre të unifikuar letrare të shfaqet një larmi stileshe dhe fjalorësh (shih *Hyrje në Dhiatën e Vjetër*, R. K. Harrison, f. 522-526).

E. Të dhënat nga literatura e lashtë e Lindjes së Mesme na lënë të kuptojmë se Moisiu përdori dokumente të shkruara kuneiforme, ose tradita gojore të stilit (patriarkal) mesopotamas, për të shkruar Zanafillën. Kjo s’do të thotë aspak se ia ulim vlerën frymëzimit hyjnor, por është një përpjekje për të shpjeguar fenomenet letrare të librit të Zanafillës (shih P. J. Wiseman, *New Discoveries in Babylonia about Genesis [Zbulime të reja në Babiloni për Zanafillën]*). Duke filluar nga Zan. 37, ndikimi i fortë egjiptian në lidhje me stilin, formën dhe fjalorin duket se na tregon që Moisiu përdori produkte letrare, ose tradita gojore nga koha e izraelitëve në Egjipt dhe në Mesopotami. Arsimin zyrtar Moisiu e kishte plotësisht egjiptian! Formulimi i saktë letrar i Pesëlibërshit është i paqartë. Unë besoj se Moisiu është përpiluesi dhe autori i shumicës dërrmuese të Pesëlibërshit, ndonëse mund të ketë përdorur skribë dhe/ose tradita (patriarkale) të shkruara dhe gojore. Historiciteti dhe besueshmëria e këtyre librave të parë të DHV është mbështetur nga arkeologjia e sotme.

V. DATA

- A. Zanafilla mbulon periudhën nga krijimi i kozmosit deri te familja e Abrahamit. Është e mundur që ta datojmë jetën e Abrahamit në bazë të literaturës shekulare të asaj periudhe. Data e përafërt është 2 000 para K., mijëvjeçari i dytë para K. Baza për këtë është si më poshtë:
 - 1. babai vepronte si prift i familjes (si Jobi)
 - 2. jeta ishte nomade, ndiqnin bagëtitë e trasha dhe të imta
 - 3. migrimi i popujve semitë gjatë kësaj periudhe

- B. Ngjarjet e hershme të Zanafillës 1-11 janë ngjarje të vërteta historike (ndoshta, dramë historike), por të padatueshme në bazë të njohurive që disponojmë deri më sot.
- C. Kur studiojmë Zanafillën, duhet të kemi parasysh se ngjarjet historike janë regjistruar nga Moisiu, i cili e udhëhoqi popullin e Perëndisë duke e nxjerrë nga Egjipti (1) më 1445 para K., në bazë të 1 Mbretërve 6:1; ose (2) më 1290 para K., bazuar në të dhënat e arkeologjisë së sotme. Prandaj, qoftë nëpërmjet traditës gojore, burimeve të shkruara që ne s'i njohim, apo nëpërmjet zbulësës së drejtpërdrejtë hyjnore, Moisiu regjistron "sesi nisi gjithçka" dhe "pse".

VI. BURIME QË MBËSHITESIN KONTEKSTIN HISTORIK

A. Librat e tjerë biblikë

1. Krijimi – Psalmet 8; 19; 50; 104
2. Koha e Abrahamit – Jobi

B. Burimet arkeologjike laike

1. Paraleli më i hershëm i njohur letrar me kontekstin kulturor të Zanafillës 1-11 gjendet në pllakat kuneiforme të Eblës, në Sirinë veriore, që datojnë rreth 2500 para K., shkruar në akadisht.
2. Krijimi
 - a. Rrëfimi më i afërt mesopotamas, që merret me krijimin, *Enuma Elish*, i cili daton sipas (1) NIV Study Bible, rreth 1900-1700 para K., ose sipas (2) John H. Walton, *Ancient Israelite Literature in Its Cultural Context [Literatura e lashtë izraelite në kontekstin e saj kulturor]*, f. 21, rreth 1000 para K. U gjet në bibliotekën e mbretit Ashurbanipal në Ninive; kopje të tjera të saj janë gjetur edhe në disa vende të tjera. Ekzistojnë shtatë pllaka kuneiforme, të shkruara në akadisht, që përshkruajnë krijimin nga perëndia Marduk.
 - (1) Perënditë *Apsu* (uji i ëmbël—mashkull) dhe *Tiamat* (uji i kripur—femër) lindën fëmijë të pabindur dhe poterexhinj. Këta dy perëndi u përpoqën t'u mbyllnin gojën perëndive më të reja.
 - (2) Një nga fëmijët e *Eas* dhe *Damkinës*, *Marduku* (perëndia i epërm i qytetit të ri të Babilonisë), e mposht *Tiamatin*. Ai e formoi tokën dhe qiellin me trupin e saj.
 - (3) *Marduku* e formoi njerëzimin nga një tjetër perëndi i mposhtur: *Kingu*, i cili ishte partneri mashkull i *Tiamatit* pas vdekjes së *Apsus*. Njerëzimi erdhi nga gjaku i *Kingut*.
 - (4) *Marduku* u bë i pari në panteonin e perëndive babilonase.
 - b. "Vula e krijimit" është një pllakë kuneiforme; ajo është vizatimi i një burri dhe i një gruaje të zhveshur përbri një peme frutore. Rreth trungut të pemës është mbështjellë një gjarpër, i cili është vendosur mbi shpatullën e gruas sikur po i flet.
3. Krijimi dhe Përmytja – *Epika e Atrahasisit* flet për kryengritjen e perëndive më të ulët për shkak të punës së tepërt dhe për krijimin e shtatë çifteve njerëzore (nga balta, gjaku dhe pështyma) që të kryenin detyrat e këtyre perëndive më të ulët. Njerëzit u shkatërruan për shkak të: (1) mbipopullimit dhe (2) zhurmës. Qeniet njerëzore u pakësuan me anë të një murtaje, dy zi buke dhe, më në fund, një përmytjeje, e planifikuar nga *Enlili*. *Atrahasi* ndërton një anije dhe fut kafshët në të që t'i shpëtojnë nga ujërat. Këto ngjarje madhore shihen në të njëjtin rend si te Zanafilla 1-8. Ky kompozim në kuneiform daton rreth së njëjtës kohë si *Enuma Elish* dhe *Epi i Gilgameshit*, rreth 1900-1700 para K. Të gjitha janë në akadisht.
4. Përmytja e Noeut
 - a. Një pllakë sumere nga Nipuri, e quajtur *Zanafilla e Eridut*, që daton rreth 1600 para K., flet për *Ziusudrën* dhe për një përmytje që po vjen.
 - (1) *Enka*, perëndia i ujit, e paralajmëron *Ziusudrën* për përmytjen që po vjen.
 - (2) *Ziusudra*, një mbret-prift, i beson kësaj zbulëse dhe ndërton një anije të stërmadhe katrore dhe e mbush me gjithfarëlloj farash.
 - (3) Përmytja zgjati shtatë ditë.
 - (4) *Ziusudra* hapi një dritare në anije dhe lëshoi disa zogj për të parë nëse ishte shfaqur toka e thatë apo jo.
 - (5) Po kështu, ofroi si flijim një dem dhe një dele kur doli nga anija.

- b. Një rrëfim i përbërë babilonas për përmbytjen, në katër pllaka sumere, që njihet si *Epi i Gilgameshit*, që daton fillimisht rreth 2500-2400 para K., ndonëse forma e shkruar dhe e përbërë në kuneiformen akadisht, është shumë më e vonët (rreth 1900-1700 para K.). Bën fjalë për një të mbijetuar nga përmbytja, *Utnapishtimi*, i cili i tregon *Gilgameshit*, mbretit të *Urukut*, sesi i mbijetoi përmbytjes së madhe dhe sesi iu dha jeta e përjetshme.
- (1) *Ea*, perëndia i ujit, e paralajmëron *Utnapishtimin* (forma babilonase e emrit *Ziusudra*) për një përmbytje që po vjen dhe i thotë të ndërtojë një anije.
 - (2) *Utnapishtimi* me gjithë familjen, bashkë me bimët e përzgjedhura shëruese, i mbijetoi përmbytjes.
 - (3) Përmbytja zgjati shtatë ditë.
 - (4) Anija ndaloi në Persinë veriore, në malin Nisir.
 - (5) Ai lëshoi 3 zogj të ndryshëm për të parë nëse ishte shfaqur toka e thatë.
5. Literatura mesopotamase, që përshkruan një përmbytje të lashtë, është bazuar e gjitha në të njëjtin burim. Shpesh, emrat ndryshojnë, por skenari është i njëjtë. Një shembull është se *Zivusudra*, *Atrahasi* dhe *Utnapishtimi* përfaqësojnë të njëjtin mbret njerëzor.
6. Paralelet historike të këtyre me ngjarjet e hershme të Zanafillës mund të shpjegohen në bazë të njohurisë së njerëzimit para shpërndarjes (Zanafilla 1-11), si dhe në bazë të përjetimit të Perëndisë. Këto kujtime thelbësore, të vërteta nga ana historike, janë detajuar dhe mitologjizuar në rrëfimet e ndryshme të përmbytjes, që gjenden në mbarë botën. E njëjta gjë mund të thuhet jo vetëm për krijimin (Zan. 1, 2) dhe për Përmbytjen (Zan. 6-9), por edhe për bashkimet e njerëzve me engjëjt (Zan. 6).
7. Koha e Patriarkëve (bronzi i mesëm)
- a. Pllakat e Marit – tekste ligjore (të kulturës amonit) dhe personale, të shkruara në kuneiform në akadisht, rreth 1700 para K.
 - b. Pllakat e Nuzit – arkiva në kuneiforme të disa familjeve (kultura horite, ose huriane), të shkruara në akadisht rreth 100 milje në juglindje të Ninivesë, rreth 1500-1300 para K. Bëjnë fjalë për procedura familjare dhe biznesi. Për shembuj të mëtejshëm të veçantë, shih John H. Walton, *Ancient Israelite Literature in Its Cultural Context [Literatura e lashtë izraelite në kontekstin e saj kulturor]*, f. 52-58.
 - c. Pllakat e Alalakut – tekste në kuneiform nga Siria veriore, rreth 2000 para K.
 - d. Disa nga emrat, që gjenden në Zanafillë, regjistrohen si emra vendesh në Pllakat e Marit: Serugu, Pelegu, Terahu dhe Nahori. Edhe emra të tjerë biblikë janë të njohur: Abrahami, Isaku, Jakobi, Labani dhe Jozefi. Kjo tregon se emrat biblikë përputhen me këtë vend dhe me këtë periudhë.
8. “Studimet historiografike krahasuese kanë treguar se, përkrah hititëve, hebrenjtë e lashtë ishin regjistruer më të saktë, më objektivë dhe më të përgjegjshëm të historisë së Lindjes së Afërt”. R. K. Harrison, *Biblical Criticism [Kritika biblike]*, f. 5.
9. Arkeologjia ka provuar se është tejet e dobishme për të vërtetuar historicitetin e Biblës. Megjithatë, është e domosdoshme të vëmë në dukje diçka. Arkeologjia nuk është një udhërrëfyes absolutisht i pagabueshëm, për shkak të
- a. teknikave të dobëta në gërmimet e hershme
 - b. interpretimeve të larmishme dhe tejet subjektive të artefakteve që janë zbuluar
 - c. mungesës së një kronologjie të dakordësuar për Lindjen e Afërt në lashtësi (ndonëse një e tillë po zhvillohet nga rrathët e trunqeve të pemëve dhe nga poçaria).
- C. Rrëfimet egjiptiane të krijimit mund t’i gjeni në librin e John H. Walton, *Literatura e lashtë izraelite në kontekstin e saj kulturor* (Grand Rapids, MI: Zondervan, 1990), f. 23-24, 32-34.
1. Në literaturën egjiptiane, krijimi nisi me ujin e pastruar dhe kaotik parak. Krijimi shihet si zhvillim i një strukture (kode) nga kaosi ujqor.
 2. Në literaturën egjiptiane të Memfisit, krijimi ndodhi me anë të fjalës së thënë nga Ptahu.
- D. Adresat e grupeve ungjillore për kozmologjinë:
1. Institute for Creation Research (mosha e re e tokës)
P.O. Box 2667
El Cajon, CA 92021-0667

2. Reasons to Believe (mosha e vjetër e tokës)
P.O. Box 5978
Pasadena, CA 91117

VII. NJËSITË LETRARE (KONTEKSTI)

- A. Përvijim i bazuar në përdorimin që i bën Moisiu frazës “breznitë/gjenealogjitë e” (*toledoth*):
1. Fillesat e qiejve dhe tokës, 1:1-2:3
 2. Fillesat e njerëzimit, 2:4-4:26
 3. Breznitë e Adamit, 5:1-6:8
 4. Breznitë e Noeut, 6:9-9:17
 5. Breznitë e bijve të Noeut, 10:1-11:9
 6. Breznitë e Shemit, 11:10-26
 7. Breznitë e Terahut (Abrahami), 11:27-25:11
 8. Breznitë e Ishmaelit, 25:12-18
 9. Breznitë e Isakut, 25:19-35:29
 10. Breznitë e Esaut, 36:1-8
 11. Breznitë e bijve të Esaut, 36:9-43
 12. Breznitë e Jakobit, 37:1-50:26 (#1-11 kanë një sfond letrar mesopotamas, por #12 ka një ngjyrim letrar egjiptian.).
- B. Përvijimi teologjik:
1. Krijimi për njerëzimin dhe i njerëzimit, 1-2
 2. Njerëzimi dhe krijimi bien, 3:1-11:26
 3. Një njeri për gjithë njerëzimin (3:15), 12-50
 - a. Abrahami (12:1-3), 11:27-23:20
 - b. Isaku, 24:1-26:35
 - c. Jakobi, 27:1-36:4
 - (1) Juda (prejardhja e Mesisë)
 - (2) Jozefi (trashëgimi e dyfishtë toke), 37:1-50:26

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Si filloi gjithçka?
1. Filloi me Perëndinë (Zanafilla 1-2). Botëkuptimi i Biblës nuk është politeizmi, por monoteizmi. Ajo nuk fokusohet te “si”-ja e krijimit, por te “cili”. Është plotësisht unike për kohën e vet.
 2. Perëndia donte shoqëri. Krijimi është vetëm një fazë e shoqërisë së Perëndisë me njeriun.
 3. S’është e mundur ta kuptosh pjesën tjetër të Biblës pa Zanafillën 1-3 dhe 12.
 4. Njerëzit duhet t’i përgjigjen me besim asaj që kuptojnë në lidhje me vullnetin e Perëndisë (Zan. 15:6 dhe Rom. 4).
- B. Pse është kaq e ligë dhe e padrejtë kjo botë? Ajo ishte “shumë e mirë” (1:31), por njeriu mëkatoi (shih Zan. 3). Rezultatet e tmerrshme janë të qarta:
1. Kaini vret Abelin (kap. 4)
 2. Hakmartja e Lamekut (4:23)
 3. Bashkimet e palejuara seksuale (6:1-4)
 4. Ligësia e njeriut (6:5, 11-12; 8:21)
 5. Dehja e Noeut (9)
 6. Kulla e Babelit (11)
 7. Politeizmi i Urit
- C. Si do ta ndreqë Perëndia?
1. Mesia do të vijë për të gjithë njerëzit (3:15)
 2. Perëndia thërret njërin për të thirrur gjithë njerëzit (Zan. 12:1-3 dhe Eks. 19:5-6)

3. Perëndia është i gatshëm të punojë me njerëzimin e rënë (Adami, Eva, Kaini, Noeu, Abrahami, judenjtë dhe johebrenjtë) dhe, me anë të hirit të vet, siguron
 - a. premtimet
 - b. besëlidhjet (të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara)
 - c. flijimet
 - d. adhurimin

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe fraza

1. “Perëndia tha...” 1:3, 6, 9, 14, 20, 24 (NASB & NIV)
2. “Le të bëjmë...” 1:26; 3:22 :11:7 (NASB & NIV)
3. “në shëmbëlltërinë tonë” 1:26, 27; 5:1, 3; 9:6 (NASB & NIV)
4. “Zotin Perëndi, që po ecte” (antropomorfizëm) 3:8 (NASB & NIV)
5. Nefilim 6:4 (NASB & NIV)
6. Besëlidhja 6:18; 9:9-17 (NASB & NIV)
7. “Abrahami besoi në ZOTIN; dhe ai ia llogariti si drejtësi” 15:6 (NIV, “Abrami i besoi Zotit, dhe ai ia llogariti si drejtësi”)
8. Dashamirësi (*hesed*) 24:12, 27; 32:10 (NIV, “mirësi”)
9. Idhujt shtëpiakë (*terafim*) 31:19, 30, 34 (NIV, “perënditë familjare”)
10. Falli 44:5 (NASB & NIV)

B. Persona që duhen identifikuar shkurtimisht

- | | |
|----------------------------|------------------------------------|
| 1. Sethi 4:25 | 11. Hagari, 16:1 |
| 2. Enoku, 5:21-24 | 12. Ishmaeli, 15:15; 25:12-19 |
| 3. Metuselahu, 5:22, 25-27 | 13. Isaku, 21:3 |
| 4. Shemi, 9:18; 10:27-31 | 14. Labani, 24:29 |
| 5. Kanani, 9:20-27 | 15. Keturahu, 25:1 |
| 6. Nimrodi, 10:8-10 | 16. Jakobi (Izraeli), 25:26; 32:28 |
| 7. Terahu, 11:24-32 | 17. Dina, 30:21 |
| 8. Loti, 11:31 | 18. Potifari, 37:36 |
| 9. Abrahami, 12:18 | 19. Tamara, 38 |
| 10. Melkicedeku, 14:18 | 20. Manasi dhe Efraimi, 41:51, 52 |

X. VENDNDODHJET NË HARTË

A. Harta e parë – Zanafilla 1-11 (sipas numrave)

1. Kopshti i Edenit, 2:8
2. Lumi Tigër, 2:14
3. Lumi Eufra, 2:14
4. Malet e Araratit, 8:4
5. Shinari, 10:10; 11:2
6. Babeli, 10:10; 11:9
7. Ninive, 10:10
8. Jebus, 10:16
9. Sodom, 10:19; 13:10
10. Uri i Kaldeasve, 11:28
11. Haran, 11:31-32

B. Harta e dytë – Zanafilla 12-150 (sipas numrave)

1. Shekem, 12:6; 33:18
2. Betel, 12:8; 13:3; 35:6
3. Negev, 12:9; 13:1
4. Lumi Jordan, 13:10-11
5. Hebron, 13:18; 23:2
6. Deti i Kripur, 14:3
7. Kadesh Barnea, 14:7; 16:14
8. Damask, 14:15
9. Salem, 14:18
10. Lumi i Egjiptit, 15:18
11. Shkretëtira e Shurit, 16:7
12. Moab, 19:37
13. Amon, 19:38
14. Beersheba, 21:14; 26:33
15. Zona e filistejve, 21:32
16. Shkretëtira e Paranit, 21:21
17. Toka e Moriahut, 22:22
18. Aram, 24:10
19. Edom, 25:30; 36:1:8-9, 19
20. Lumi Jabok, 32:22
21. Betlehem, 35:19
22. Toka e Goshenit, 45:10; 46:34

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

PYETJE PËR ZANAFILLËN 1-11

1. Si diskuton Bibla për origjinën e Perëndisë?
2. A bie ndesh Bibla me shkencën për krijimin?
3. Ç’lidhje ka Zanafilla 1 me rrëfimet e tjera të krijimit në Lindjen e Afërt të lashtë?
4. Përcakto fjalët *fiat* dhe *eks nihilo*.
5. Pse jepen dy emra të ndryshëm për Hyjninë në kapitujt 1 dhe 2?
6. A kemi të bëjmë me dy rrëfime të ndryshme për krijimin e njeriut?
7. Ç’do të thotë që burri dhe gruaja u krijuan në shëmbëllimin e Perëndisë?
8. Pse përdoret shumësi në lidhje me të Vetmin Perëndi? 1:26, 27; 3:22; 11:7
9. Pse është kyç kapitulli 3 për ta kuptuar gjithë pjesën tjetër të Biblës?
10. A provojnë kafshët që flasin (3:1) se ky rrëfim është mitologjik?
11. Pse është kaq i rëndësishëm 3:15?
12. Si lidhet 3:16 me jetën e sotme?
13. A ka dy pemë të veçanta, apo vetëm një të tillë, në Kopshtin e Edenit?
14. Rendit zhvillimet në shoqëri, që vijnë nga pasardhja e Kainit, 4:16-24.
15. Cili ishte qëllimi i Përmytjes?
16. Cili ishte qëllimi i ndërtimit të kullës së Babelit nga njerëzit?

PYETJE PËR ZANAFILLËN 12-50

1. Si ndryshon besëlidhja e Noeut nga ajo e Abrahamit?
2. Ç’lidhje ka besëlidhja e Abrahamit me johebrentjë?
3. Cilat janë dy shenja dobësie dhe mungese besimi, që shihen në Abramanin në kapitullin 12?
4. Kush është Melkicedeku, dhe pse i dha Abrahami të dhjetën?
5. Pse është kaq i rëndësishëm 15:12-21?
6. Kush janë tre burrat e kapitullit 18? (pse dhe ku)?
7. Pse gënjeu Abrahami që s’ ishte i martuar me Sarën? Kë gënjeu?


8. Pse e mashtruan Isakun Rebeka dhe Jakobi? (27)
9. Shpjego përse Rubeni Levi dhe Simoni u refuzuan si paraardhës të Mesisë? (34 & 49)
10. Përshkruaj me fjalët e tua ëndrrat e Jozefit (37).
11. Pse u shtir Jozefi sikur s'i njihte vëllezërit?
12. Pse djemtë e Jozefit trashëguan njësoj me fëmijët e tjerë të Jakobit?

Genesis 1-11




**ANCIENT
NEAR EAST**

Genesis 12-50




**ANCIENT
NEAR EAST**



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR EKSODIN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Në hebraisht (pra, sipas Tekstit Masoretik [MT]), është fjala e parë e librit: “dhe këto janë fjalët (emrat)”.
- B. Në përkthimin e LXX, titulli është “*ek ‘odos*”, që do të thotë “rrugëdalje”, “ose udhë jashtë”.
- C. Në Vullgatën latine të Jeronimit, titullohet “eksod”.

II. KANONIZIMI

- A. Është pjesë e pjesës së parë të Kanonit Hebraisht, që quhet “Torah”, ose “mësimet”, ose “Ligji”.
- B. Kjo pjesë njihet si Pentatuk (pesë rrotullat) në LXX.
- C. Nganjëherë, në gjuhën tonë quhet “Pesë Librat e Moisiut”.
- D. Përfshin një rrëfim të vazhdueshëm historik nga Moisiu, që nga krijimi deri në jetën e Moisiut: Zanafilla—Ligji i Përtërirë.

III. GJINIA LETRARE – Libri i Eksodit përfshin tre lloje gjinish letrare.

- A. Narrativë historike, Eks. 1-19; 32:34
- B. Poezi, Eks. 15
- C. Të dhëna të hollësishme për tabernakullin, Eks. 25-31, dhe ndërtimin e tij, 35-40

IV. AUTORËSIA

- A. Torahu është një rrëfim i unifikuar. Eksodi nis me parafjalën “dhe”. Shih diskutimin e zgjatur në përvijimin e Zanafillës.
- B. Në Eksod, ka disa pasazhe ku thuhet se Moisiu shkroi:
 - 1. 17:14;
 - 2. 24:4, 12
 - 3. 34:27, 28
- C. Jozueu 8:31 citon Eksodin 20:25 dhe ia atribuon Moisiut. Jezusi citon Eks. 20:12, 17 dhe ia atribuon Moisiut, Mk. 7:10.

V. DATA E EKSODIT

- A. Ka patur dy mendime ndër studiuesit për datën e Eksodit:
 - 1. nga 1 Mbret. 6:1, që thotë: “480 vjet, nga Eksodi në ndërtimin e tempullit të Solomonit”:
 - a. Solomoni e nisi mbretërimin më 970 para K. Kjo llogaritet duke përdorur betejën e Karkarit (853 para K.) si datë të sigurt fillestare.
 - b. Tempulli u ndërtua në vitin e tij të katërt (965 para K.), kështu që Eksodi ndodhi rreth 1445/6 para K.
 - 2. Kjo do ta vendoste ngjarjen e Eksodit në Dinastinë e 18-të egjiptiane.
 - a. Faraoni i shtypjes së izraelitëve i bie të ketë qenë *Tutmosi III* (1490-1436 para K.).
 - b. Faraoni i Eksodit i bie të ketë qenë *Amenhotepi II* (1436-1407 para K.).

- (1) Disa u besojnë të dhënave të Jerikos, nga fakti se mes Jerikos dhe Egjiptit nuk kishte asnjë korrespondencë diplomatike gjatë mbretërimit të *Amenhotepit III* (1413-1377 para K.).
 - (2) Tekstet e *Amarnës* përmbajnë korrespondenca diplomatike, të shkruara në pjesë poçarie, që flasin për *habirut*, të cilët pushtuan tokën e Kananit gjatë mbretërimit të *Amenhotepit III*. Prandaj, Eksodi ndodhi gjatë mbretërimit të *Amenhotepit II*.
 - (3) Periudha e Gjyqtarëve nuk është aq e gjatë sa duhet, nëse Eksodi datohet në shekullin e trembëdhjetë.
3. Problemet e mundshme të këtyre datimeve janë:
 - a. Septuaginta (LXX) përmend 440 vite, jo 480.
 - b. Ka gjasa që 480 vitet të përfaqësojnë 12 breza me nga 40 vite secili; prandaj, kjo mund të jetë shifër e figurshme.
 - c. Ka 12 breza priftërinjsh nga Aaroni te Solomoni (shih 1 Kro. 6), pastaj, 12 të tjerë nga Solomoni te Tempulli i Dytë. Judenjtë, si dhe grekët, brezin e llogarisnin sikur zgjaste dyzet vjet. Këshut kemi një periudhë 480-vjeçare para dhe pas (përdorimi simbolik i numrave) (shih Bimson, *Redating the Exodus and Conquest*).
 4. Ka dhe tre pasazhe të tjera që përmendin data:
 - a. Zanafilla 15:13, 16 (shih Veprat 7:6), 400 vjet robëri;
 - b. Eksodi 12:40-41 (shih Gal. 3:17);
 - (1) MT – 430 vjet qëndrim në Egjipt
 - (2) LXX – 215 vjet qëndrim në Egjipt
 - c. Gjyqtarëve 11:26: 300 vite, nga koha e Jeftës deri në pushtimin e Izraelit (mbështet datën 1445 para K.)
 - d. Veprat 13:19, eksodi, endjet në shkretëtirë dhe pushtimi i Izraelit – 450 vjet
 5. Autori i Mbretërve përdori referenca të veçanta historike, dhe nuk i rumbullakosi numrat (Edwin Thiele, *A Chronology of the Hebrew Kings*, f. 83-85)
- B. Të dhënat e mundshme nga arkeologjia duket se tregojnë për një datë rreth 1290 para K., ose gjatë Dinastisë së 19-të egjiptiane.
1. Jozefi arriti ta vizitonte të atin dhe të takohej me faraonin brenda të njëjtës ditë. Faraoni i parë vendas që filloi ta transferonte kryeqytetin e Egjiptit nga Teba në një vend në Deltën e Nilit, që quhej *Avaris/Zoan/Tansi*, që ishte kryeqyteti i vjetër i hiksove, ishte *Seti I* (1309-1290). Ai mund të ketë qenë faraoni i shtypjes në Egjipt.
 - a. Kjo duket se përputhet me dy të dhëna për mbretërmin e hiksove në Egjipt.
 - (1) Është gjetur një shtyllë nga koha e Ramzesit II, që përkujtton themelimin e Avarisit, katërqind vjet më herët (vitet 1700 para K., nga hiksot)
 - (2) Profecia e Zanafillës 15:13 flet për një shtypje 400-vjeçare
 - b. Kjo nënkupton se ngritja e Jozefit në pushtet u bë nën një faraon *hiksos* (semit). Dinastia e re egjiptiane përmendet në Eks. 1:8.
 2. *Hiksos*, një fjalë egjiptiane që do të thotë “sundimtarë nga toka të huaja”, që ishin një grup sundimtarësh semitë të Egjiptit, e mbajtën nën kontroll Egjiptin gjatë dinastive 15 dhe 16 (1720-1570 para K.). Disa duan t’i lidhin këta sundimtarë me ngritjen e Jozefit në pushtet. Nëse e zbresim shifrën prej 430 vitesh të Eks. 12:40 nga viti 1720 para K., marrim një datë rreth 1290 para K.
 3. Biri i Setit I ishte Ramzesi II (1290-1224). Ky emër përmendet si një nga qytetet-hambar, të ndërtuara nga skllevërit hebrej, Eks. 1:11. Gjithashtu, ky rajon në Egjipt, pranë Goshenit, quhet Ramzes, Zan. 47:11. *Avaris/Zoan/Tanis* njihet si “Shtëpia e Ramzesit” nga 1300-1100 para K.
 4. Tutmozes III njihet si ndërtues i madh; i tillë njihet dhe Ramzesi II.
 5. Ramzesi II kishte 47 bija, që jetonin secila në pallatin e saj.
 6. Arkeologjia ka treguar se shumica e qyteteve të mëdha me mur të Kananit (Hacor, Debir, Lakish) u shkatërruan dhe u rindërtuan shpejt rreth 1250 para K. Nëse lejojmë një periudhë endjeje 38-vjeçare në shkretëtirë, kjo përputhet me një datim prej 1290 para K.
 7. Arkeologjia ka zbuluar një përmendje të izraelitëve si banues në Kananin jugor në një shtyllë përkujtimore të pasardhësit të Ramzesit, *Merneptah* (1224-1214 para K. [shih, Shtylla e Merneptahut, datuar më 1220 para K.]).

8. Edomi dhe Moabi duket se kishin arritur një identitet të fortë kombëtar në fund të viteve 1300 para K. Këto vende nuk ishin të organizuara në shekullin e 15 (Glueck).
9. Libri me titull *Redating the Exodus and Conquest*, nga John J. Bimson, botuar nga universiteti i Shefildit, 1978, argumenton kundër të gjitha të dhënave arkeologjike për një datim më të hershëm.

VI. PASIGURI TË TJERA QË LIDHEN ME EKSODIN:

- A. Numri i personave që u larguan gjatë Eksodit është i paqartë
 1. Numrat 1:46; 26:51 përmendin se kishte 600,000 burra të moshës luftuese (20-50 vjeç; në moshë të pjekur, shih Eks. 38:26). Prandaj, nëse llogaritim gratë, fëmijët dhe pleqtë, është e mundshme një shifër prej 1.5 deri në 2.5 milion izraelitë.
 2. Mirëpo, fjala hebraisht që përkthehet “një mijë”, *Elef*, mund të ketë dhe këto kuptime:
 - a. Familje, ose njësi fisnore, Jozueu 22:14; Gjyq. 6:15; 1 Sam. 23:2; Zak. 9:7
 - b. Njësit ushtarak, Eks. 18:21, 25; LiP. 1:15
 - c. Një mijë (e fjalëpërfjalshme), Zan. 20:16; Eks. 32:28
 - d. E përdorur simbolikisht, Zan. 24:60; Eks. 20:6 (LiP. 7:9); 34:7; Jer. 32:18
 - e. Nga gjuha ugarite (gjuhë e të njëjtës familjes semite), të njëjtat bashkëgintëlloret lexohen *alluf*, që do të thotë “kryetar fisi” (shih Zan. 36:15). Kjo do të thotë, për shembull, se në Num. 1:39 kemi 60 kryetarë fisesh dhe 270 burra nga Dani. Problemi del kur teksti tregon qartë se ka një numër më të madh kryetarësh fisesh se ç’duhet për numrin e burrave të disa fiseve.
 - f. Për këtë gjë, ka një diskutim të dobishëm në NIV Study Bible, f. 186.
 3. Arkeologjia e ka llogaritur madhësinë e ushtrive të Egjiptit dhe Asirisë gjatë kësaj periudhe në dhjetra mijë ushtarë. Disa pasazhe të Jozueut duket se nënkuptojnë që Izraeli kishte një ushtri me rreth 40,000 burra (shih Joz. 4:13; 7:3; 8:3, 11, 12).
- B. Rruga e përshkuar gjatë Eksodit është në dyshim
 1. Vendndodhja e: (1) qyteteve egjiptiane; (2) masat ujore; dhe (3) vendet e kampeve të hebrejve janë të paqarta.
 2. Fjala “Det i Kuq” është *Jam Suf*, që:
 - a. do të thotë “det barishtesh”, ose “det xunkthesh”. Mund të nënkuptojë detin e kripur, Jona 2:5; 1 Mbre. 9:26, ose ujin e ëmbël, Eks. 2:3; Isa. 19:26. E para që e përktheu “Det i Kuq” ishte LXX, që më vonë u ndoq nga Vullgata dhe, pastaj, Versioni i Mbretit Xhejms.
 - b. Bënte fjalë për “detin e jugut”, ose “detin e fundit (të tokës)”. Mund të bëhet fjalë për Detin e Kuq të sotëm, Oqeanin Indian, ose Gjirin Persik.
 - c. Kishte disa përdorime të ndryshme në DHV (shih Num. 33:8, 10).
 3. Ka tre itinerare të mundshme, që përfshijnë masa të ndryshme ujore:
 - a. Një itinerar verior – kjo rrugë kalonte përbri bregdetit mesdhetar, duke ndjekur rrugën kryesore tregtare të njohur si “rruga e filistejve”. Kjo do të kishte qenë rruga më e shkurtër për në Tokën e Premtuar. Masa ujore me të cilën duhet të jenë përballur izraelitët ishte një nga cektinat kënetore të quajtura: Liqeni Sirbonis, ose Liqeni Menzalkh. Megjithatë, nëse kemi parasysh Eks. 13:17, kjo mundësi mohohet. Gjithashtu, prania e fortesave egjiptiane përgjatë kësaj rruge e rrëzon këtë mundësi.
 - b. Një itinerar i mesëm – këtu, bëhet fjalë për liqenet qendrore, që quhen: (1) “Liqenet e Hidhura”; (2) “Liqeni Balah”; (3) “Liqeni timsah”. Edhe ky itinerar ndiqet rrugën e karvanëve përmes shkretëtirës së Shurit.
 - c. Një itinerar jugor – këtu, bëhet fjalë për një masë të madhe uji të kripur, që sot e quajmë Deti i Kuq. Nga kjo zonë dilte dhe një rrugë karvanësh, që lidhej me “Rrugën e Mbretit” (rruga e Transjordanit për në Damask) në Ecion-Geber.
 - (1) Kjo mundësi kundërshtohet nga mungesa e xunktheve në këtë masë ujore.
 - (2) Një gjë që e mbështet është 1 Mbre. 9:26, që thotë se Ecion-Geberi ndodhej në Jam-Suf. Kjo duhet të ketë qenë Gjiri i Akabasë, ose pjesë e Detit të Kuq (shih Num. 21:4; LiP. 27; Gjyq. 11:16; Jer. 49:12).

- d. Numrat 33 e vë qartazi në dukje këtë problem. Në v.8a, hebrejntë “kalojnë përmes detit”, pastaj, në v. 10), ngrenë kampin përbri “Detit të Kuq”, një masë tjetër ujore.
 - e. Cilëndo masë ujore që të kenë kaluar izraelitët, kjo ishte mrekulli e Perëndisë. Izraeli siguroi armë nga ushtarët e vdekur egjiptianë, që pluskuan në anën e tyre të ujit; dhe kjo një tjetër mrekulli, Eks. 14:30; 15:4-5.
 - f. Nga shkrime të tjera, është e mundshme që “*jom suf*” të ketë qenë masa e mistershme dhe e palundruar ujore në jug. Në disa shkrime të vjetra, Oqeani Indian, ose gjiri i Bengelit, quhet “*jom suf*”.
4. Edhe vendndodhja e malit Sinai është në dyshim
- a. Nëse Moisiu po fliste realisht, dhe jo në mënyrë të figurshme, për një udhëtim treditor që ia kërkoi faraonit (3:18; 5:3; 8:27), kjo kohë nuk do të mjaftonte për të arritur në vendin tradicional të gadishullit jugor të Sinait. Prandaj, disa studiues e vendosin këtë mal pranë oazit të Kadesh-Barneas.
 - b. Vendi tradicional, që quhet “Xhebel Musa”, në Shkretëtirën e Sinit, ka një sërë elementesh në favor të vet:
 - (1) një pllajë të madhe përpara malit,
 - (2) LiP. 1:2 thotë se ishte udhëtim 11-ditor nga mali Sinai në Kadesh-Barnea,
 - (3) Fjala “Sinai” është johebraike. Mund të ketë lidhje me Shkretëtirën e Sinit, që bën fjalë për një shkurrish të vogël në shkretëtirë. Në hebraisht, emri i këtij mali është Horeb (shkretëtirë).
 - (4) Mali Sinai ka qenë vendi tradicional që nga shekulli i katërt pas K. Ndodhet në “vandin e Midianit”, që përfshinte një zonë të madh të gadishullit të Sinait dhe Arabisë.
 - (5) Me sa duket, arkeologjia ka vërtetuar vendndodhjen e disa qyteteve të përmendura në rrëfimin e Eksodit (*Elim, Dofakh, Refidim*) në anën perëndimore të Gadishullit të Sinait.

VII. BURIME QË MBËSHITESIN KONTEKSTIN HISTORIK

- A. Nga Egjipti nuk ka asnjë të dhënë me shkrim për Eksodin. Kjo s’është e pazakontë, kur kemi parasysh disfatën e plotë të perëndive egjiptiane përpara JHVH.
- B. Ka disa shembuj kulturorë ligjesh të ngjashme me *Dekalogun* (Dhjetë Urdhërimet):
 - 1. *Ligjet e Lipit-Ishtar* (sumere), nga mbreti i Isinit (1934-1924 para K.)
 - 2. *Ligjet e Eshnunës* (babilonase), që datojnë nga 1800 para K. nga mbretërimi i Dadushës, mbretit të Ashnunës
 - 3. *Kodi i Hamurabit* (Babilonia e lashtë), nga një mbret i Babilonisë, Hamurabi (1728-1686 para K.).
 - 4. Kodet e ligjeve të mbretërve hiditë Mupsilis I ose Hatusilis I, nga rreth 1650 para K.
 - 5. Kodet e ligjeve mesopotamase fokusohen kryesisht në ligjet civile, ndërsa ligjet biblike fokusohen kryesisht në ligjet fetare/kultike. “... Mund të flasim për një prirje civile në të gjitha ligjet kuneiforme, dhe një prirje kultike në ligjin izraelit.... Në Mesopotami, shkelja shihet e lidhur me shoqërinë; ndërsa, në Izrael, çdo shkelje, në fund fare, është kundër Perëndisë”. Walton, f. 80.
 - 6. Albrecht Alt, në *Essays on Old Testament History and Religion*, Oxford, 1966, f. 81-132, ka identifikuar dy lloje ligjesh:
 - a. Kazuistike, që përdorin fjali kushtore. Karakterizohet nga struktura “nëse... atëherë”. Nuk bën fjalë për normat fetare apo shoqërore, por shpreh një ndalesë dhe një pasojë.
 - b. Apodiktike, që nuk përdor fjali kushtore.
 - (1) Eks. 21 dhe LiP. 27:15-26 përdorin vetë ne tretë dhe bëjnë fjalë për raste të veçanta individuale
 - (2) Lev. 18:7-17 dhe Eks. 20/LiP. 5 përdorin vetën e dytë dhe kanë gamë më të përgjithshme.
 - c. Ligji mesopotamas është kryesisht kazuistik, ndërsa ligji izraelit është kryesisht apodiktik.

- C. Sa për argumentin e vjetër liberal se Moisiu nuk mund të ketë ditur të shkruante, arkeologjika ka vërtetuar ekzistencën e një alfabeti të hershëm kananit, që përdorej në Egjipt në kohën e Moisiut.
1. Është gjetur korrespondencë e vitit 1400 para K. në lidhje me skllëverit semitë në minierat egjiptiane të Sinait (shih Albright, BASOR, #110 [1948], f. 12-13).
 2. Në Tebë janë gjetur copa të shkruara poçarie (poçari të thyera, që përdoren për të shkruar) në Luginën e Mbretëreshave (shih Albright, BASOR, #110 [1948], f. 12).

VIII. NJËSITË LETRARE (KONTEKSTI)

A. Përvijim i shkurtër

1. Izraeli në Egjipt, 1-11
2. Izraeli largohet nga Egjipti, 12-18
3. Izraeli në malin Sinai, 19-40
 - a. Ligjet e jetës në malin Sinai, 19-24
 - b. Ligjet e adhurimit në malin Sinai, 25-40
 - (1) Planimetria e tabernakullit, 25-31
 - (2) Rebelimi dhe ripërtëritja e besëlidhjes, 32-34
 - (3) Ndërtimi i tabernakullit, 35-40

B. Fatkeqësitë

1. Tregojnë gjykimin e Perëndisë ndaj perëndive të Egjiptit. Duket se ndodhën gjatë një periudhë 18-mujore. Bëhet fjalë për ngjarje të natyrshme, por me:
 - a. kohë të mbinatyrshme
 - b. intensitet të mbinatyrshëm
 - c. vendodhje të mbinatyrshme
2. Përvijim i shkurtër i dhjetë fatkeqësive
 - a. Nili kthehet në gjak, 7:14-25
 - b. Bretkosat,
 - c. Morrat, mushkonjat, 8:16-19
 - d. Mizat, 8:20-32
 - e. Sëmundja e bagëtive 9:1-7
 - f. Ulcerat, 9:8-12
 - g. Breshëri 9:13-35
 - h. Karkalecat, 10:1-20
 - i. Errësira, 10:21-29
 - j. Engjëlli i vdekjes, vdekja e të parëlindurve, 11:1-8

C. Lista e festave/ditëve të agjërimit në kapitullin 23:

- a. Shabati i përjavshëm, 23:3
- b. Pashka (14 Nisan), 23:5; Eks. 12
- c. Buka e Ndorme (15-21 Nisan), 23:6-8; LiP. 16:1-8
- d. Frytet e para (22 Nisan), 23:9-14
- e. Rrëshajët, ose Festa e Javëve (50 ditë pas 21 Nisanit, 6 Sivan), 23:15-21; LiP. 16:9-12
- f. Dita e Shlyerjes (10 Tishri), 23:26-32; Num. 29:7-11
- g. Festa e Kasolleve (15 Tishri), 23:33-44; Num. 29:12-40; LiP. 16:13-17

D. Përvijim i hollësishëm

1. shih R. K. Harrison, *Introduction to the OT*, f. 560-562
2. shih E. J. Young, *An Introduction to the OT*, f. 63-72
3. shih NIV Study Bible, f. 85-87

IX. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Eksodi vazhdon historinë e nisur te libri i Zanafillës. Dokumenton zhvillimin e familjes së zgjedhur për t'u bërë komb i zgjedhur. Ndonëse u skllavëruan në Egjipt, do të zotërojnë Vendlindjen e Premtuar (Zan. 12:1-3; 15:16).
- B. Përmend ligjet e besëlidhjes në malin Sinai (Horeb)
1. Si duhet të jetojmë! (Dekalogu dhe shtojcat)
 2. Si duhet të adhurojmë! (Tabernakulli, priftërinjtë, procedurat, koha dhe ritualet)
 3. Është manual përdorimi për Tabernakullin (Levitiku)
- C. Dokumenton veprat madhështore të mëshirës dhe dashurisë së Perëndisë për Izraelin, që iu profetizuan Abrahamit, Zan. 15:16.
- D. Marrëdhënia e Perëndisë me faraonin tregon drejtpeshimin e sovranitetit të Perëndisë me vullnetin e lirë njerëzor:
1. Perëndia ia ngurtësoi zemrën faraonit
 - a. 7:3 13
 - b. 9:12
 - c. 10:1, 20, 27
 - d. 11:10
 - e. 14:4, 8
 2. Faraoni e ngurtësoi vetë zemrën
 - a. 8:15, 32
 - b. 9:34

X. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

- A. Fjalë dhe fraza
1. ndenjësja e lindjes, 1:16 (NIV, stoli i lindjes)
 2. hiq sandalet, 3:5 (NASB & NIV)
 3. “udhëtim treditor”, 3:18; 5:3; 8:27 (NASB & NIV)
 4. “do t'ia ngurtësoj zemrën”, 4:21; 7:3, 13; 9:12, 35; 10:1, 20, 27 (NASB & NIV)
 5. magjistarët, 7:11, 22 (NASB & NIV)
 6. i panjollë, 12:5 (NIV, pa defekte)
 7. shtylla e resë, 13:21-22 (NASB & NIV)
 8. profeteshë, 15:20 (NASB & NIV)
 9. bukë (mana), 16:4, 8, 14-15, 31 (NASB & NIV)
 10. mbretëri priftërinjsh, 19:4-6 (NASB & NIV)
 11. shkatërroj plotësisht (*herem*), 22:20 (NIV, shkatërroi)
 12. shtyllat e shenjta, 23:24 (NIV, gurët e shenjtë)
 13. efodi, 25:7 (NASB & NIV)
 14. pajtuesi, 25:17 (NIV, kapaku i shlyerjes)
 15. *Urim* dhe *Thumim*, 28:30 (NASB & NIV)
 16. libri, 32:32-33 (NASB & NIV)
 17. buka e Pranisë, 35:13 (NASB & NIV)
- B. Persona që duhen identifikuar shkurtimisht
1. Hiksot, 1:8
 2. Engjëlli i ZOTIT, 3:1, 4
 3. Unë Jam (JHVH)
 4. Reueli, 2:18; Jethro, 3:1; 18:11-12
 5. Fineasi, 6:25
 6. Shkatërruesi, 12:23
 7. Nadabi dhe Abihu, 24:1
 8. Amaleku, 17:8-16
 9. Kerubin, 25:19




XI. VENDNDODHJET NË HARTË (sipas numrave)

1. Pitom, 1:11
2. Ramzes, 1:11
3. Midian, 2:15
4. Mali Horeb, 3:1
5. Goshen, 8:22
6. Jam Suf, 10:19 (NIV, Deti i Kuq)
7. Shkretëtira e Shurit
8. Shkretëtira e Sinit
9. Shkretëtira e Paranit
10. Rruga e Detit (filistinët), 13:17
11. Gjiri i Agabas

XII. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Pse u druhej faraoni hebrejve? 1:7-10
2. Pse u hodhën në Nil djemtë? Pse lahej në Nil familja e faraonit? Pse ishte shumë domethënës kthimi i Nilit në gjak?
3. Pse u arratis në Midian Moisiu?
4. Pse ishte kaq i rëndësishëm fakti që Perëndia po ia zbulonte emrin e vet Moisiut? (3:13-16)
5. Çfarë thotë 3:22 për konfliktin mes JHVH-së dhe perëndive të Egjiptit?
6. Si ta shpjegojmë Eks. 6:3, kur kemi parasysh shfaqjen e JHVH-së në Zanafilla 4:26?
7. Si ndikojnë fatkeqësitë në fenë e Egjiptit?
8. A ia heq zgjedhjen e lire faraonit fakti se Perëndia ia ngurtësoi zemrën?
9. Cila është domethënia e vdekjes së të parëlindurve?
10. Ku i gjetën hebrejtë armët e luftës?
11. Në ç'mënyra nënkupton veprimi i Moisiut ndaj Jethros në kap. 18 se është besimtar i JHVH?
12. Ç' domethënie ka fakti se Izraeli është mbretëri priftërinjsh?
13. Rendit Dhjetë Fjalët.
14. Rendit ditët e festave të kapitullit 23.
15. Bëj një vizatim të Tabernakullit dhe mobilieve të tij.
16. Çfarë simbolizonte Viçi i Artë në kapitullin 32?

EXODUS



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR LEVITIKUN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Në tekstin hebraisht (MT), emri i këtij libri është fjala e parë e tij, “dhe ai (JHVH) thirri”.
- B. Talmudi (Mishna) e quan “ligji i priftërinjve”.
- C. Në përkthimin LXX, quhet “Libri Levitik”.
- D. Vullgata latinisht e Jeronimit e titullon “Leviticu”.

II. KANONIZIMI

- A. Është pjesë e ndarjes së parë të kanonit hebraik që quhet “Torah”, ose “mësimet”, ose “Ligji”.
- B. Kjo ndarje njihet me emrin Pentatuk (pesë rrotullat) në LXX.
- C. Nganjëherë, në gjuhën tonë quhet “Pesë Librat e Moisiut”.
- D. Përfshin një tregim të vazhdueshëm të Moisiut, nga krijimi deri në jetën e Moisiut, Zanafilla—Ligji i Peërtërirë.

III. GJINIA LETRARE – Ky libër është kryesisht legjislacion, me përjashtim të narrativës historike të kapitujve 8-10.

IV. AUTORËSIA – Kapitulli 1:1 përmend motivin e përsëritur shpesh (35 herë): “JHVH i tha Moisiut”. Shih diskutimin e hollësishëm në përvijimin e Zanafillës.

V. DATA – Krahaso Eks. 40:2, 17 me Num. 1:1. Kjo tregon se Perëndia ia dha Moisiut në muajin e parë të vitit të dytë pas Eksodit. Shih diskutimin e hollësishëm në përvijimin e Eksodit.

VI. BURIME QË MBËSHTESIN KONTEKSTIN HISTORIK

A. Ligjet e ritualeve në Mesopotami

- 1. Flijimi ishte, kryesisht, një vakt që i ofrohej një perëndie të caktuar. Altari ishte tryeza e perëndisë, ku vendosej ushqimi i vaktit. Përmbri altarit ishte mangalli i temjanit, që synonte t’i tërhiqte vëmendjen perëndisë. Gjaku nuk kishte ndonjë domethënie për ritualin. Ai që mbante shpatën ia priste fytin kafshës. Ushqimi ndahej mes perëndive, priftit-mbret dhe pjesëmarrësve. Ofruesi nuk merrte asgjë.
- 2. Nuk kishte flijime shlyese.
- 3. Sëmundja ose dhimbja ishin ndëshkim nga perënditë. Sillej një kafshë dhe vritej; kjo shërbente si zëvendësim për ofruesin.
- 4. Ritualit i Izraelit ishte i ndryshëm dhe i veçantë. Duket se zanafilla e tij ishte ideja se njeriu i kthente Perëndisë një pjesë të punës së vet për ushqimin e nevojshëm (shih Zan. 4:1-4; 8:20-22).

B. Ligjet rituale të Kananit (shumë të ngjashme me ato të Izraelit)

- 1. Burimet
 - a. Rrëfimet biblike
 - b. Literatura fenikase
 - c. Pllakat e Ras Shamrës nga Ugariti në lidhje me hyjnitë dhe mitologjinë kananite nga rreth 1400 para K.
 - d. Flijimet e Izraelit ngjasojnë së tepërmi me ato të Kananit. Megjiahtë, në flijimet kananite nuk vihej theksi te gjaku i viktimës.

- C. Ligjet rituale në Egjipt
1. Ofroheshin flijime, por nuk theksoheshin
 2. Fljimi nuk ishte i rëndësishëm; rëndësi kishte qëndrimi i fljuesit
 3. Fljimet bëheshin për të ndalur zemërimin e perëndive
 4. Ofruesi shpresonte për çlirim, ose falje
- D. Sistemi fljues i Izraelit – fljimet e Izraelit ishin më të ngjashme me ato të Kananit, ndonëse jo domosdoshmërisht të lidhura me to.
1. Fraza përshkruese
 - a. Fljimi ishte shprehje spontane e nevojës së njerëzimit për Perëndinë
 - b. Ligjet e DHV, që përcaktojnë fljimet, nuk mund të thuhet se ishin të parat që kërkuan bërjen e fljimeve (shih Zan. 7:8; 8:20)
 - c. Fljimi ishte ofrim (i një kafshe, ose i një bime)
 - d. Duhet të ishte një ofrim që shkatërrohej plotësisht ose pjesërisht mbi një altar, si nderim ndaj Perëndisë
 - e. Altari ishte vendi i fljimit dhe simbolizonte praninë hyjnore
 - f. Fljimi ishte akt i jashtëm adhurimi (lutje e shprehur me veprime)
 - g. Përcaktimi i fljimit është “lutje të shprehura me veprime”, ose “lutje të ritualizuara”. Domethënia e këtij rituali dhe anësia jonë kulturore kundër tij na shpjegohet nga Gordon J. Wenham (Tyndale, *Numbers*, f. 25-39). Levitiku dhe Numrat përmbajnë sasi të mëdha të këtij lloj materiali, gjë që tregon rëndësinë e tij për Moisiun dhe Izraelin.
 2. Fljimet që kërkoheshin
 - a. Dhurata për Perëndinë
 - (1) Tregojnë se gjithë toak është e Zotit
 - (2) Gjithçka që ka, njeriu ia detyron Perëndisë
 - (3) Prandaj, është e drejtë që njeriu t’i sjellë homazh Perëndisë
 - (4) Ky ishte një lloj i veçantë homazhi, ose dhurate. Ishte diçka që njeriut i nevojitej për të mbajtur veten në jetë. Ishte më tepër sesa thjesht të jepje diçka; kjo ishte diçka që njeriut i nevojitej. Ishte si t’i jepte Perëndisë një pjesë të vetvetes.
 - (5) Për shkak të shkatërrohej, dhurata nuk mund të merrej mbrapsht
 - (6) Një ofertë e djegur bëhet e padukshme dhe ngjitet në sferën e Perëndisë
 - (7) Altaret më të hershëm ngriheshin në vende ku ishte shfaqur Perëndia. Altari filloi të shihej si vend i shenjtë; prandaj, oferta sillej aty.
 - b. Shprehja e dedikimit të gjithë jetës së besimtarit ndaj Perëndisë
 - (1) Oferta e djegur ishte një nga tre fljimet vullnetare.
 - (2) Gjithë kafsha digej, për t’i shprehur Perëndisë nderimin e thellë të njeriut.
 - (3) Kjo ishte dhuratë shumë shprehëse për Perëndinë.
 - c. Bashkësia me Perëndinë
 - (1) Aspekti bashkësor i fljimit
 - (2) Një shembull ishte oferta e paqes, që simbolizonte miqësinë e Perëndisë me njeriun
 - (3) Fljimi bëhej për ta siguruar, ose rikthyer, këtë miqësi
 - d. Shlyerja për mëkat
 - (1) Kur njeriu mëkatonte, duhet t’i kërkonte Perëndisë që ta rimëkëmbte marrëdhënien (besëlidhjen), që e kishte thyer njeriu
 - (2) Në rastin e ofertës për mëkat, nuk shtrohej vakt bashkësor, për shkak të marrëdhënies së prishur
 - (3) Domethënia e gjakut
 - (a) Vendosej në altar për njeriun
 - (b) Vendosej mbi perden për priftin
 - (c) Vendosej mbi pajtuesin e Arkës së Besëlidhejs për kryepriftin dhe kombin (Lev. 16)
 - (4) Kishte dy lloje ofrimesh për mëkat. E dyta quhej oferta e fajit, ose oferta e shkeljes. Në të, shkelësi duhet t’i rikthente një bashkëizraeliti atë që ia kishte marrë ose dëmtuar, së bashku me një fljim kafshe.

- (5) Nuk kishte flijim për mëkatet e qëllimshme, ose me paramendim, 4:1, 22, 27; 5:15-18; 22:14

E. PROCEDURAT PËR FLIJIMET E NDRYSHME

1. KAPITULLI 1

- a. Formula hyrëse, “Zoti i foli Moisiut”, 1:1-2; 4:1; 5:14; 6:1, 19; 7:22, 28
- (1) Nga tufa e bagëtive ose gjedhëve
 - (2) “Kur”, v. 2, tregon se kjo nuk ishte e detyrueshme, por vullnetare
- b. Oferta e djegur, vgj. 3-17 (6:8-13)
- (1) Altari
 - (a) Altari prej bronzi, që quhej dhe altari i ofertave të djegura, altari përbri hyrjes së Tabernakullit, ose altari prej druri shitim, i mbuluar me bronz (shih Eks. 27)
 - (b) Kjo e dallonte nga altari i temjanit (altari i artë) në Vendin e Shenjtë (shih Eks. 30)
 - (c) Thëngjijtë e altarit të bronzit çoheshin te altari i temjanit
 - (d) Altari i bronzit ishte në mes të hyrjes së Tabernakullit
 - (e) Altari kishte brirë, që ishin pjesa e tij më e shenjtë. Gjaku spërkatej mbi brirët (shih Eks. 30:10)
 - (f) Ndoshta, brirët kishin këtë kuptim:
 - i. Simbol i duarve që ngrenë ofertën lart
 - ii. Simbol i forcës ose fuqisë ngadhënjyese (LiP. 33:17; 2 Sam. 22:3)
 - iii. Më vonë, kushdo që kapte brirët e altarit ishte i sigurti derisa çështja e tij vendosej nga gjykata (1 Mbre. 1:50-51; 2:28)
 - (2) Oferta
 - (a) Një dem i vogël dhe i panjollë, që përmendet i pari për shkak të rëndësisë dhe çmimit të tij, v. 3
 - (b) Cjap, ose dele, v. 10
 - (c) Turtuj ose pëllumba të rinj, v. 14 (oferta e të varfërve)
 - (3) Vendi i Ofertës së Djegur ishte te hyrja e Çadrës së Mbledhjes
 - (4) Vënia e duarve – kjo bëhej vetëm për demat, jo për dhitë, delet apo zogjtë, v. 4
 - (a) Ofruesi e bënte vetë këtë (nuk e bënte prifti)
 - (b) Shumë mendojnë se ky ishte veprim simbolik i transferimit të fajit
 - (c) Disa besojnë se nënkuptonte se:
 - i. kjo kafshë vjen nga ky individ
 - ii. flijimi duhet të bëhej në emrin e ofruesit
 - iii. fryti i këtij flijimi i përket atij që vinte duart mbi kafshën
 - (5) Therja
 - (a) Demi – “përpara Zotit”, nga ai që bënte ofrimin. Ofruesi duhet ta vriste, rripte dhe copëtonte kafshën. Roli i priftit (përveç rastit të flijimeve publike) niste kur ofruesi e sillte kafshën te altari.
 - (b) Delja, ose cjapi, v. 11 – “në anën veriore të altarit, përpara Zotit”. Kjo nënkuptonte një vend të veçantë për këto kafshë më të vogla.
 - (c) Zogjtë – prifti e vriste dhe e ofronte këtë flijim. Ofruesi duhet t’ia hiqte puplat zogut.
 - (6) Përdorimi i gjakut
 - (a) Kafshët
 - i. Prifti e hidhte gjakun mbi altar, dhe e spërkaste rreth e rrotull altarit.
 - ii. Jeta e kafshës ishte në gjak (shih Zan. 9:4; Lev. 17:11). Jeta i përkiste që më parë Perëndisë; prandaj, gjaku nuk ishte pjesë e dhuratës së njeriut.
 - iii. Gjaku i zogut kullohej në anë të altarit dhe nuk digej në zjarr.
 - (7) Përdorimi i mishit
 - (a) Demi, v. 6
 - i. Ofruesi e rripte ofertën. Prifti e mbante atë lëkurë (shih 7:8)
 - ii. Ofruesi e copëtonte
 - iii. Prifti e vendoste ofertën mbi altar, duke i bashkuar copat në të njëjtën formë si kur ishte gjallë
 - iv. Këmbët dhe të brendshme laheshin me ujë nga legeni

- v. Prifti e digjte të gjithë kafshën mbi altar
- c. Rastet kur bëheshin ofertat e djegura
- (1) Festa e Çadrave, Kasolleve
 - (2) Dita e Shlyerjes
 - (3) Festa e Javëve, Fryteve të Para, ose Rrëshajëve
 - (4) Festa e Borive
 - (5) Duajt e Tundur (Lev. 23)
 - (6) Festa e Bukëve të Ndorme, Pashka
 - (7) Fillimi i muajve, Hëna e Re
 - (8) Shabati
- d. Domethënia e Ofertës së Djegur
- (1) Dhuratë për Perëndinë
 - (2) Shihej si flijimi më i vyer.
 - (3) Duket se trajtonte konceptin e mëkatit në përgjithësi, ose me falënderimin.
 - (4) Simbolizimi më i përsosur i idesë së flijimit.
 - (5) Ofrimi simbolik i jetës së vetë ofruesit
 - (6) Përfaqëson dedikimin e plotë të jetës së individit në shërbim të Perëndisë
 - (7) Vlera e shkallëzuar e ofrimit
 - (a) Demi
 - (b) Delja – cjapi
 - (c) Zogjtë
 - (8) Kjo tregon se çdokush që ishte i vetëdijshëm për nevojat shpirtërore mund t'i afrohej Perëndisë. Perëndia siguron për gjithë njerëzit.
- e. Udhëzimet e veçanta për priftin, 6:8-12
- (1) Oferta e djegur lihej gjithë natën në vatrën e altarit
 - (2) Zjarri duhej mbajtur gjallë vazhdimisht nën ofertën e djegur
 - (3) Udhëzime për veshjen e priftit
 - (4) Udhëzime për heqjen e hirit
2. KAPITULLI 2:1-16 (6:14-23)
- a. Hyrje
- (1) Ky kapitull trajton blatin e grurit
 - (2) Blatimi i grurit vjen nga rrënja e fjalës “dhuratë”. Më vonë, u bë fjalë teknike për dhuratat joshtazore, ose ato bimore.
 - (3) Pas Dëbimit, blatimi i grurit shfaqet si shtesë e ofrimit të djegur dhe ofrimit të paqes, dhe rabinët thonë se mund të ofrohej vetëm nga më të varfrit.
 - (4) Besëlidhja e kripës përmendet dhe në Num. 18:19 dhe 2 Kron. 13:5. Kripa ishte e kundërta e majasë. Përdorej si simbol i besëlidhjes së Perëndisë për shkak se ishte e paprishme dhe zgjaste.
- b. Blatimi i grurit nënkuptonte që ofruesi ia jepte punën e vet Perëndisë.
- (1) Ishte dhuratë për Perëndinë nga ushqimi i përditshëm i popullit.
 - (2) Në përgjithësi, ishte suplement (sidomos në kohën pas Dëbimit) i ofrimit të djegur ose të paqes.
 - (3) Flijimi ishte diçka që Perëndia ia siguronte priftit. Vetëm një pjesë e vogël digjej si përkujtimore e të tërës.
 - (4) Fjala “përkujtimore” përshkruan pjesën e ofruar, ose atë pjesë që sjell tërësinë e dhuratës para Zotit.
 - (5) Koncepti i Dhiatës së Re për Darkën e Zotit si “përkujtimore” shpreh këtë koncept të Dhiatës së Vjetër.
 - (6) Dallimet mes fjalëve “i shenjtë” dhe “shumë i shenjtë” janë:
 - (a) “i shenjtë” – prifti dhe familja mund ta hanin ofertën në çdo vend të pastër
 - (b) “shumë i shenjtë” – mun të hahej vetëm nga priftërinjtë, dhe vetëm në oborrin e Çadrës së Mbledhjes
- c. Llojet
- (1) Miell i papjekur (për të pasurit), 2:1-3

- (2) Bukë ose kulaçë të pjekur, 2:4-11
- (3) Veshë të gjelbër misri ose gruri (për të varfrit), 2:12-16
 - (a) Mielli i papjekur ishte oferta më e lartë. Ishte pjesa më e mirë e miellit të grurit.
 - (b) Kulaçët e pjekur
 - i. Një përbërës ishte vaji
 - ii. Përgatitej në furrë, v. 4.
 - iii. Mbi një skarë hekuri, v. 5.
 - iv. Në një tigan dheu, v. 7.
 - (c) Veshë të gjelbër misri ose gruri
 - i. Duhet të jetë i tharë
 - ii. Të ndahej në pjesë
 - iii. Të vendosej si vakt ushqimi para të ftuarve.
- d. Përbërësit
 - (1) Maja e miellit përkonte me kafshën pa të meta
 - (2) Vaji ishte simbol begati dhe, si rrjedhojë, simbol i pranisë së Perëndisë
 - (a) Përdorej për ushqim, flijime, ilaç dhe vajosje
 - (b) Ndoshta, vaji përdorej për të zëvendësuar ofrimin e vajit
 - (3) Temjani vinte nga India ose Arabi
 - (a) Shihej si diçka shumë e pastër me aromë të mahnitshme
 - (b) Simbolizonte lutjen dhe lavdërimin
 - (4) Kripa
 - (a) Cilësi jetëdhënëse dhe ruajtëse
 - (b) Ndoshta, përdorej më tepër për miqësi tryeze sesa për të ruajtur ushqimin
 - (5) Elementet që përjashtoheshin
 - (a) Majaja përjashtoheshin, v. 11
 - i. Ndoshta, për shkak të fermentimit
 - ii. Majaja shoqërohej me prishjen
 - iii. Mund të ofrohej me frytet e para dhe t'i jepej priftit
 - (b) Mjalti përjashtoheshin
 - i. Shurupi bëhej nga frytet, jo nga bletët
 - ii. Ndoshta, për shkak të përdorimit të tij në ritualet kananite
- e. Rituali i ofrimit
 - (1) Sillej te prifti. Ai kryente gjithë ceremoninë (2:2, 9, 16)
 - (2) Një pjesë e ofrimit duhej të hahej nga prifti në shenjtërore. Ishte gjëja më e shenjtë.
- f. Domethënia
 - (1) Dhuratë që më i ulëti ia jepte më të lartit
 - (2) Djegja e një pjese të saj përfaqësonte dedikimin e një pjese të punës Perëndisë
 - (3) Kuptimi në dukje
 - (a) Ofrimi i djegur – dedikimi i jetës ndaj Perëndisë
 - (b) Ofrimi i vaktit – dedikimi i punës së përditshme
- g. Udhëzime të veçanta për blatimin e grurit, 6:14-23
 - (1) Ofrimi përpara altarit
 - (2) Puna ia ofronte dhuratën Perëndisë dhe, në të vërtetë, mbështeste priftërinë

3. KAPITULLI 3:1-17 (7:13-34) OFRIMI I PAQES

- a. Hyrje
 - (1) Pse
 - (a) Ofrimi i bashkësisë
 - (b) Flijimi i besëlidhjes
 - (c) Ofrimi kolektiv
 - (d) Flijimi përmyllës
 - (2) Shprehet falënderim ndaj Perëndisë për shkak të bashkësisë me Perëndinë, familjen dhe miqtë.
 - (3) Zakonisht, ishte akti i fundit në një seri flijimesh, ku kryhej pajtimi.

- (4) Ofrimi i djegur shprehte çmimin e lartë të bindjes, ndërsa ofrimi i paqes shprehet gëzimin dhe lumturinë e bashkësisë me Perëndinë.
- (5) Mashkull, ose femër, por pa të meta
- (6) Larmitë e ofrimit
 - (a) nga bagëtitë; mashkull ose femër
 - (b) bëhej dallim mes deleve dhe dhive për shkak të dhjavit në bishtin e dhenve
 - i. qengji i tufës – mashkull ose femër
 - ii. dhia e tufës – mashkull ose femër
- b. Rituali
 - (1) Paraqitja e ofrimit
 - (a) Vendoseshin duart mbi ofrimin
 - (b) Vritej te hyrja e Çadrës së mbledhjes
 - (c) Identifikimi i flijimit ishte njësoj me atë të ofrimit të djegur
 - (d) Spërkatej gjaku rreth altarit
 - (e) Pjesët më të mira digjeshin mbi altar para Perëndisë
 - i. Sdhjami (bishti i dhjamosur i deles) simbolizonte begati
 - ii. Veshkat, pjesa e mëlçisë simbolizonin vatrën e vullnetit dhe ndjenjave
 - iii. Pjesat e dhjemosura vendoeshin mb ofrimin e djegur të ofruesit, ose mbi ofrimin e qengjit në mëngjes
 - (2) Ofrimi i falenderimit përfshinte (7:11-14)
 - (a) Kulaç pa maja, i përzier me vaj
 - (b) Biskota pa maja, të përhapura me vaj
 - (c) Miell i përzier me vaj
- c. Pjesa e priftit, 7:29-34
 - (1) Gjoksi i përkiste priftit si ofertë tundjeje
 - (2) Tundja nënkuptonte vendosjen e ofrimit në duart e ofruesit dhe të priftit. Tregonte ofrimin që ofruesi ia jepte Perëndisë, dhe pastaj i kthehej sërish priftit.
 - (3) Kofsha e djathtë i përkiste priftit që kryente ritualin
 - (4) Ofrimi i tundur ngrihej para Perëndisë dhe i kthehej priftit
- d. Pjesa e ofruesit, 7:15-18
 - (1) Ofrimi i falenderimit duhet ngrënë ditën që ofrohet, v. 15
 - (2) Ofrimi i betimit, ose vullnetar, do të hahet ditën e ofrimit, ose të nesërmen, v. 16
 - (3) Kjo pjesë ishte gjithçka që nuk i jepej Perëndisë, dhe nga Perëndia, priftit
 - (4) Në mënyrë simbolike, Perëndia ha me ofruesit, familjen dhe miqtë e tij në këtë ofrim
 - (5) Ky ofrim thekson se marrëdhëniet e miqësisë me Perëndinë janë rimëkëmbur

4. KAPITULLI 4:1-5:13 (6:24-30) OFRIMI I MËKATIT

- a. Hyrje
 - (1) Ky është ofrimi i parë, ku elementi mbizotërues është shlyerja.
 - (2) Ky flijim rivendos besëlidhjen mes njeriut dhe Perëndisë. Kjo gjë ripërtërin këtë bashkësi.
 - (3) Ky ofrim përfshin:
 - (a) Mëkatet e padijes
 - (b) Mëkatet e pakujdesisë
 - (c) Mëkatet e pasionit
 - (d) Mëkatet e moskryerjes
 - (e) Nuk kryente shlyrje për mëkatet e kryera qëllimisht në rebelim kryeneç kundër Perëndisë. Nuk kishte fljime për mëkatet e qëllimshëm, arrogant dhe të paramenduar (shih Num. 15:27-31).
- b. Kuptimi
 - (1) Ky ofrim shlyente fajin dhe ndëshkimin për mëkatet.
 - (2) Kjo gjë përfshinte hiriin e Perëndisë dhe besimin e njeriut.
 - (3) Asnjë flijim nuk kryente diçka thjesht nga ofrimi ritual. Pas këtij akti qëndronte besimi i ofruesit.

- (4) Mirëpo, ky fljirim ishte më tepër sesa thjesht shprehje e ofruesit. Ofrimi kryente diçka për të. Rimëkëmbte marrëdhënien e tij me Perëndinë.
- (5) Ky ritual ishte mënyra që kishte caktuar Perëndia për dëmshpërblim; nuk ishte zëvendësues i besimit personal.
- (6) Perëndia urren çdo veprim fetar që nuk shoqërohet nga besimi (Isa. 1:10-20; Amos 5:21-24; Mikea 6:6-8).

c. Rituali

(1) Për kryepriiftin, v. 3-12

(a) Kryepriifti – priifti i vajosur

- i. Mëkati, për shkak se mund ta drejtojë popullin keqaz
- ii. Mëkati, në mënyrë personale
- iii. Kryepriifti, meqë është përfaqësuesi shpirtëror i komunitetit. Nëse ai mëkaton, të gjithë mëkatojnë në të. Kështu e kuptonin judenjtë kolektivin (shih Jozueu 7; Rom. 5:12 e më tej).

(b) Procedurat

- i. Kryepriifti sillte një dem të ri e të panjollë te altari.
- ii. Ia vinte duart mbi kokë
- iii. Kryepriifti therrte kafshën
- iv. Kryepriifti e spërkate gjakun përpara perdes 7 herë
 - a) Kjo e pastronte tabernakullin
 - b) Simbolikisht, i hapte rrugën Perëndisë
 - c) Gjaku vendosej mbi brirët e altarit të temjanit
 - d) Gjaku që mbetej derdhej në këmbë të altarit të ofertave të djegura
- v. E vendoste gjithë dhjamin të digjej mbi altar
- vi. Gjithë pjesa tjetër e kafshësh çohet jashtë kampit në një vend të pastër, v. 12, ndërsa hiri i altarit derdhej. Aty digjej pjesa e mbetur e kafshës.

(2) Për Kombin, v. 13-21

(a) Ata mëkatonin kur nuk përmbusheshin kërkesat e ligjit, v. 12-31

(b) Procedurat

- i. Pleqtë sillnin tek altari një dem të ri e të panjollë.
- ii. Pleqtë ia vinin duart mbi kokë.
- iii. Pleqtë e therrnin kafshën.
- iv. Kryepriifti e spërkaste gjakun para perdes 7 herë.
 - a) Kjo e pastronte tabernakullin
 - b) Simbolikisht, i hapte rrugën Perëndisë
 - c) Gjaku vendosej mbi brirët e altarit të temjanit
 - d) Gjaku që mbetej derdhej në këmbë të altarit të fljimeve
- v. E gjithë kafsha ofrohej në altar
- vi. Gjithë pjesa e mbetur e kafshës nxirrej jashtë kampit në një vend të pastër, v. 12, ku hiri i altarit derdhej. Aty digjej pjesa e mbetur e kafshës.

(3) Për kreun, v. 22-26

(a) Kreu (udhëheqësi), v. 22-26

- i. Kreu i fisit
- ii. Personi përgjegjës në komunitet
- iii. Plaku

(b) Procedurat

- i. Kreu sillte një cjamin (cjamin të plakur dhe leshatak) te altari.
- ii. Kreu ia vendoste duart mbi kokë.
- iii. Kreu e therrte kafshën.
- iv. Kryepriifti vendoste gjak mbi brirët e altarit të ofertave të djegura—pjesa e mbetur e gjakut derdhej në këmbë të altarit të fljimeve.
- v. Gjithë dhjami digjej mbi altar.
- vi. Priiftërinjtë hanin pjesën tjetër të mishit.

(4) Për individin, v. 27-35

(a) Për individin – kjo mësonte se kishte mëkatur, duhet të bënte këtë ofrim

- (b) Procedurat
 - i. Individu sillte një dhi ose një qengj femër.
 - ii. Individu ia vinte duart mbi kokë.
 - iii. Individu e therte kafshën.
 - iv. Prifti vendost gjak mbi brirët e altarit të flijimeve—pjesa tjetër derdhej në këmbë të altarit.
 - v. Gjithë dhjami vendosej mbi altar dhe digjej.
 - vi. Priftërinjtë hanin pjesën tjetër të mishit.
- (5) Raste të veçanta për ofrimet për mëkatën, 5:1-13 (Këto duket se kanë të bëjnë me mëkatë të qëllimshme kundër një partneri të besëlidhjes)
 - (a) Nëse nuk del të dëshmojë një dëshmitar (mospasja e të dhënave), 5:1
 - (b) Prekja e një kafshe të papastër, 5:2
 - (c) Prekja e një njeriu të papastër, 5:3
 - (d) Kur dikush fliste pa menduar dhe bëtohej, 5:4
 - (e) Ofrimi për mëkatet e sipërme:
 - i. Dhi ose dele
 - ii. Dy turtuj ose dy pëllumba
 - iii. 1/10 e efës miell të pastër
- (6) Rituali i ofrimit për mëkatën, 6:24-30
 - (a) Atë që mbetet mund ta hante prifti.
 - (b) Nëse binte gjak në rroba, veshja duhej larë.
 - (c) Nëse gjaku binte mbi një enë balte, ena duhej thyer.
 - (d) Nëse gjaku binte mbi një enë metali, ena duhej larë.
 - (e) Nëse gjaku i ofrimit të djegur sillej në Vendin e Shenjtë, mishi duhej djegur dhe nuk duhej ngrënë nga prifti.
- (7) Domethënia e këtij ofrimi për mëkatën
 - (a) Nuk ka ofrim për mëkatën me paramendim—vetëm për mëkatën pa paramendim, ose mëkatet e mosdijes, 5:15, 18.
 - (b) Çfarë kërkon falja:
 - i. Pjesa e njeriut është besimi
 - ii. Pjesa e Perëndisë është mëshira

5. KAPITULLI 5:14-19 OFERTA E FAJIT OSE SHKELJES

a. Hyrje

- (1) Ndërsa Ofrimi i Mëkatit vlente për mëkatën e kryer, ofrimi i shkeljes/fajit kishte të bënte me dëmin që i shkactohej një partneri të besëlidhjes dhe me dëmshpërblimin që ishte i mundur.
- (2) Ofrimet e mëkatit dhe shkeljes ishin shumë të ngjashëm.
- (3) Të drejtat e individit shpreheshin në Dhjetë Urdhërimet (Eks. 20; LiP. 5).
 - (a) Shtëpi
 - (b) Grumbullim të mirash materiale
 - (c) Jetë
- (4) Ky ofrim thekson dëmin që i shkactohej vëllait kur mëkaton ndaj tij dhe dëmshpërblimin e asaj që dëmtohej plus 1/5 më tepër.

b. Mëkatet që kërkonin ofrim

- (1) Kundër Perëndisë ose asaj që i përkiste atij
 - (a) Frytet e para
 - (b) I parëlinduri, 14-16
 - (c) Të dhjetat
 - (d) Ofrimi që jepej gabim
 - (e) Dhurata me vlera inferiore
- (2) “Nëse dikush mëkaton dhe bën ndonjë nga gjërat që ZOTI ka urdhëruar të mos bëhen, edhe sikur ta ketë bërë me padije, është fajtor dhe do të marrë ndëshkimin e tij”.

- F. Flijimet e lashta ofroheshin për disa arsye:
- për të fashitur zemërimin e hyjnisë
 - për të ushqyer perëndinë
 - për të patur bashkësi me perëndinë
 - akt lavdërimi
 - ndjesia e nevojës për falje ose pajtim

VII. NJËSITË LETRARE (KONTEKSTI)

A. PËRVIJIM I SHKURTËR:

- Kapitujt 1-16: Si t'i afrohem Perëndisë së Shenjtë?
- Kapitujt 17-26: Si mund ta vazhdojmë bashkësinë me Perëndinë e Shenjtë?

B. Përdorimi që i bën autori formulës hyrëse: “Dhe ZOTI i foli Moisiut (ose Aronit) duke thënë...”.

- Kjo mund të nënkuptojë se ky material zbulëse u dha gjatë një periudhe kohore.
- Vendet ku përdoret kjo formulë: 1:1-3:17; 4:1-5:13; 5:14-19; 5:20-26; 6:1-11; 6:12-16; 6:17-7:21; 7:22-38; 8:1-10:20; 11:1-47; 12:1-8; 13:1-59; 14:1-32; 14:33-57; 15:1-33; 16:1-34; 17:1-16; 18:1-3; 19:1-37; 20:1-27; 21:1-24; 22:1-16; 22:17-25; 22:26-33; 23:1-8; 23:9-22; 23:26-32; 23:33-44; 24:1-23; 25:1-26:46; 27:1-34

C. PËRVIJIM I ZGJERUAR:

- Largimi i papastërtisë, kap. 1-16
 - Ligjet e flijimit, 1:1-7:38
 - Ofrimi i djegur, kap. 1:3-17 & 6:8-13
 - Ofrimi i vaktit, kap. 2:11-7 & 6:14-23
 - Ofrimi i paqes, kap. 3:1-17; 7:33 & 7:11-21
 - Ofrimi i mëkatit, kap. 4:1; 5:13 & 6:24-30
 - Ofrimi i fajit/shkeljes, kap. 5:14-6:7; 7:1-10
 - Mëkati pa dashje kundër besëlidhjes së JHVH, 4:1-35; 5:14-19
 - Mëkati me dashje ndaj një partneri të besëlidhjes, 5:1-13; 6:1-7 (Kapitujt 1-6:7 për popullin; kapitujt 6:8-7:36 për priftërinjtë)
 - Shenjtërimi i priftërinjve, 8:1-10:20
 - Përgatitja për vajosje, 8:1-5
 - Larja, veshjet dhe vajosja, 8:6-18
 - Flijimi i vajosjes, 8:14-32
 - Moisiu i jep udhëzime Aronit, 9:1-7
 - Aroni dhe bijtë fillojnë, 9:8-21
 - Aroni bekon popullin dhe JHVH
 - Mëkati i Nadabit dhe Abihut, 10:1-3
 - Fundi dhe largimi i tyre, 10:4-7
 - Mospirja e verës gjatë turnit, 10:8-11
 - Pjesa e flijimeve të priftit, 10:12-20
 - E pastra dhe e papastra, kapitujt 11-15
 - Kafshët, kap. 11 (shih LiP. 14:6-20)
 - Lindja e fëmijëve, kapitulli 12
 - Sëmundjet e lëkurës, kapitujt 13-14
 - Te njeriu, 13:1-46
 - Te rrobat, 13:47-59
 - Pastrimi, 14:1-32
 - Në shtëpi, 14:33-53
 - Përmbledhje, 14:54
 - Pastrimi nga rrjedhjet e lëngut të trupit (burrat dhe gratë), kapitulli 15
 - Dita e Shlyerjes (Jom Kipur), një ditë pastrimi në vit, kapitulli 16 (ky duket se është kulmimi i kapitujve 1-16)

- (1) Përgatitja priftërore, 16:1-4
- (2) Ofrimi i mëkatit për Kryepriftin, 16:5-10
- (3) Rituali, 16:23-28
- (4) Procedura vjetore, 16:29-34
2. Rimëkëmbja e shenjtërisë dhe bashkësisë me Perëndinë, kap. 17-26
 - a. Gjaku i flijimit, 17:1-16
 - b. Standardet fetare dhe morale, 18:1-20:27
 - (1) Incesti
 - (2) Mëkatet seksuale
 - (3) Ndëshkimet, kapitulli 20
 - c. Shenjtëria e priftërinjve, 21:1-22:33
 - d. Shenjtëria e ditëve të festave vjetore, 23:1-24:23
 - (1) Shabati, 23:1-3
 - (2) Pashka dhe Buka e Ndorme, 23:5-8
 - (3) Frytet e para, 23:9-14
 - (4) Korra, 23:15-24
 - (5) Rrëshajët, 23:23-25
 - (6) Dita e Shlyerjes, 23:26-32 (vetëm ditë agjërimi)
 - (7) Çadrat (Kasollet), 23:33-43
 - e. Vitet e veçanta, 25:1-55
 - (1) Vitet e shabatit, vgj. 2-7
 - (2) Jubileu, vgj. 8-55
 - (a) Zbatimi, vgj. 8-12
 - (b) Efektet, vgj. 13-34
 - (c) Vlera dhe liri e secilit individ të besëlidhjes, vgj. 35-55
 - f. Bekimet dhe mallkimet e besëlidhjes, 26:1-46
3. Shtojcë (betimet), 27:1-34
 - a. Personat, vgj. 1-8
 - b. Kafshët, vgj. 9-13
 - c. Banesat, vgj. 14-15
 - d. Toka, vgj. 16-25
 - e. Të parëlindurat, vgj. 26-27
 - f. Gjëja e përkushtuar Zotit, vgj. 28-39
 - g. Të dhjetat, vgj. 30-34

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Libri i Levitikut merret me bazën ligjore të jetës civile dhe fetare për kombin e Izraelit dhe me rolin e priftërisë. Jep udhëzime për përdorimin e Tabernakullit, që përshkruhet në Eks. 25-40.
- B. Përshkruan sesi njeriu mëkatar mund t'i afrohet Perëndisë së shenjtë dhe sesi ta mbajë bashkësinë me të. "Shenjtëria" është çelësi i këtij libri (shih 11:44 [Mat. 5:48]).
- C. Mrekullia e mrekullive është se Perëndia dëshiron që njeriu mëkatar t'i afrohet; prandaj, Zoti ka siguruar një mënyrë, një sistem flijimesh.
- D. Karakteri i JHVH zbulohet:
 1. Në sigurimin e një sistemi flijimesh, kapitujt 1-7 (hiri0)
 2. Në veprat historike, kapitujt 8-10 (drejtësia)
 3. Në praninë e tij të vazhdueshme në popull (besnikëria)

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

- A. Fjalë dhe fraza
 1. Shlyerje, 1:4; 4:26 (NASB & NIV)

2. Aromë qetësuese, 1:9, 13 (NIV, aromë e këndshme)
3. Pa dashje, 4:1, 22, 27; 5:15-18; 22:14 (NASB & NIV)
4. Zhdëmtimi, 6:5 (NASB & NIV)
5. Ofrimi i tundjes, 7:30 (NIV, tundje)
6. I shenjtë (*kadosh*), 11:44 (NASB & NIV)
7. Lebroza, 13:1 e më tej (NIV, sëmundje infektive e lëkurës)
8. Cjapi i fajit, 16:8 (NASB & NIV)
9. Demonët cjepë, 17:7 (NIV, idhujt cjepë)
10. Shortaria, 19:26 (NIV, magjia)
11. Jublieu, 25:30 (NASB & NIV)

B. Persona që duhen identifikuar shkurtimisht

1. Nadabi dhe Abihu, 10:1
2. Azazeli, 16:8, 10 (NIV, për cjapin e fajit)
3. Moleku, 18:21; 20:2


X. VENDNDODHJET NË HARTË – S’KA

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT



1. Çfarë përfaqëson sistemi i flijimeve? Pse përmendet kaq shpesh “gjaku” (3:17; 7:26; 17:11)?
2. Si mund ta falë mëkatin njerëzor vdekja e një kafshe?
3. Pse janë vullnetare tre nga pesë llojet e flijimeve?
4. Pse ka dallim mes kafshëve të pastra dhe atyre të papastra?
5. Çfarë ka unike Dita e Shlyerjes nga gjithë festat e caktuara për Izraelin?
6. Cila është e vërteta që qëndron pas Vitit të Shabatit dhe Vitit të Jubileut?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



HYRJE PËR NUMRAT

I. EMRI I LIBRIT

- A. Në hebraisht (TM), titulli është “Në shkretëtirë”. Kjo nuk është fjala e parë, por gjendet në fjalinë e parë, fjala e pestë.
- B. Në LXX titullohet “Numrat”, për shkak se regjistrimi i popullsisë jepet dy herë në kapitujt 1-4 & 26.

II. KANONIZIMI

- A. Bën pjesë në pjesën e parë të kanonit hebraik, që quhet “Torah”, ose “mësimet”, ose “Ligji”.
- B. Kjo pjesë njihet si Pentatuku (pesë rrotullat) në LXX.
- C. Nganjëherë, quhet “Pesë librat e Moisiut” në anglisht.
- D. Përfshin rrëfimin e vazhdueshëm të Moisiut që nga koha e krijimit deri në jetën e Moisiut, Zanafilla-Ligji i Përtërirë.

III. GJINIA LETRARE - Ky libër është shumë i ngjashëm me Eksodin. Është kombinim i narrativës historike me literaturën ligjore, si dhe me orakujt e lashtë poetikë të Balaamit (shih Num. 23-24).

IV. AUTORËSIA

- A. Ky është libri i parë i Torahut që përmend një burim të shkruar, “Libri i luftave të JHVH”, 21:14-15. Kjo tregon qartazi se Moisiu përdori dhe dokumente të tjera të shkruara.
- B. Ky libër pohon se Moisiu ishte në gjendje të mbante shënim ngjarjet e Periudhës së Endjes në Shkretëtirë.
- C. Numrat siguron dhe disa shembuj shtesash të qarta redaktoriale (ndoshta, Jozueu ose Samueli):
 - 1. 12:1, 3
 - 2. 13:22
 - 3. 15:22-23
 - 4. 21:14-15
 - 5. 32:33 e më tej
 - 6. 32:33 e më tej
- D. Në shumicën e rasteve, Moisiu përmendet në vetën e tretë, me përjashtim të citimeve të drejtpërdrejta. Kjo nënkupton se Moisiu përdori ndihmën e kopjuesve për përpilimin e këtyre materialeve.
- E. Është interesante të vërejmë se Numrat përfshin dy produkte letrare joizraelite: (1) poezinë thumbuese amorite në 21:27-30 (v. 30 mund të jetë shtesë izraelite); dhe (2) bisedat e Balaamit me Balakun, mbretin e Moabit, në 23-24. Këto tregojnë përdorimin e materialeve të shkruara ose gojore, të përfshira në përpilimin e librit (p.sh. “Libri i luftave të Zotit”).

V. DATA

- A. Datën na e jep libri vetë:
 - 1. 1:1; 10:10, thotë se ishte muaji i dytë i vitit të dytë pas Eksodit. Pas kësaj, kemi një periudhë 38-vjeçare endjeje në shkretëtirë.
 - 2. 9:1 thotë se ishte muaji i parë i vitit të dytë pas Eksodit.

B. Koha e Eksodit është e paqartë. Ishte ose 1445 para K., ose 1290 para K.

VI. BURIME QË MBËSHITESIN KONTEKSTIN HISTORIK

A. Katër elemente të librit të Numrave pasqyrojnë në mënyrë unike kulturën egjiptiane:

1. Vendosja e kampit të hebrejve sipas fiseve (Num. 2:1-31; 10:11-33) dhe vendosja marshuese e fiseve (Num. 1-7). Kjo përputhet saktësisht me rendin e përdorur nga Ramzesi II në fushatën e tij sirane, për të cilën mësojmë nga tekstet e Amarnës. Këto dokumente kananite, nga periudha 1300 para K., përshkruajnë ndërveprimet shoqërore, politike dhe fetare mes Kananit dhe Egjiptit. Po kështu, është domethënëse që kjo vendosje dhe renditje egjiptiane ndryshoi, siç mësojmë nga basorelievet asiriane të mijëvjeçarit të parë para K. Asirianët fushonin në formë rrethi.
2. Trumbetat e argjendta të Numrave 10 pasqyrojnë një burim egjiptian. Arkeologjia i ka gjetur të përmendura në mbretërimin e Tutankamenit, rreth 1350 para K. Po kështu, këto trumbeta të argjendta, që përdoren për qëllime fetare dhe civile, përmenden rëndom në tekstet e Amarnës.
3. Karrocet e ngara nga kuajt u prezantuan në Egjipt nga *Hiksot*, sundues semitë të dinastive 15 dhe 16. Qerret e ngara me qe ishin, po kështu, unike për Egjiptin. Ato shihen në fushatën asiriane të Tutmozit III, 1470 para K. Popujt e Kananit nuk i njihnin këto karroca, ndoshta për shkak se Kanani ishte tejet i thepisur dhe kodrinor. Këto karroca u përdorn për të marrë Jakobin (Zan. 45:19, 21, 27). Ato u përdorën dhe nga hebrejtë gjatë Eksodit (Num. 7:3, 6, 7).
4. Një element i fundit, që ishte unik për egjiptianët dhe u kopjua nga hebrejtë, ishin priftërinjtë plotësisht të rruar (8:7).

B. Dy regjistrimet, që gjenden në kapitujt 1-4 dhe 26, kanë paralelet e tyre në:

1. Pllakat Mari, nga 1700 para K.
2. Një dokument i periudhës së mbretërimit të vjetër të Egjiptit, 2900-2300 para K.

VII. NJËSITË LETRARE (konteksti)

A. Përvijim i shkurtër, i bazuar në kontekstin gjeografik:

1. Përgatitjet në malin Sinai për udhëtimin në Vendin e Premtuar, 1:1-10:10.
2. Udhëtimi në Vendin e Premtuar, 10:11 – 21:35
 - a. për në Kadesh, 10:11-12:16
 - b. në Kadesh, 13:1-20:13
 - c. nga Kadeshi, 20:14-21:35
3. ngjarjet në Pllajat e Moabit, 22:1-36:13

B. Përvijim i hollësishëm

1. R. K. Harrison, *Introduction to the Old Testament*, f. 614-615.
2. E. J. Young, *An Introduction to the Old Testament*, f. 84-90.
3. NIV Study Bible, f. 187-188.

C. Një nga vështirësitë e analizimit të Numrave është organizimi tejet i pazakontë i materialit: pra, përzierja e ligjit me narrativën, dhe përfshirja e materialeve të ndryshme në të. Disa teori për strukturën e këtij libri janë:

1. Qartazi, përkrahësit e “hipotezës dokumentare” (ose J.E.D.P.) e përdorën këtë gjë për ta ndarë librin në shumë burime johistorike dhe jomozaike.
2. J. S. Wright propozon një përpilim materialesh nga ana e Moisiut në fund të jetës së tij në konsultim me kopjuesit. Karakteri i copëzuar i Numrave pranohet, por caktohet brenda periudhës kohore të Moisiut.
3. Gordon J. Wenham (*Tyndale Commentary on Numbers*, f. 14-18) propozon një model triadik, duke përdorur materiale biblike nga Eksodi, Levitiku dhe Numrat, dhe duke i lidhur me tre udhëtimet: (1) nga Deti i Kuq në Sinai; (2) nga Sinai në Kadesh; dhe (3) nga Kadeshi në Moab. Duke vepruar kështu, si për materialin e “udhëtimeve”, ashtu dhe atë të “ndalesave”, del në pah një paralelizim i mahnitshëm. Më tej, ai e lidh këtë paralelizëm triadik me Zan. 1-11; Zan. 12-150 dhe LiP. Kjo duket shumë premtuese. Kjo strukturë na tregon se autorët e lashtë të Lindjes së

Afërt kishin struktura ose motive letrare që përcaktonin format e tyre letrare, por që janë të paqarta për ne si njerëz perëndimorë.

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Është vazhdimi i narrativës historike, që nisi në Zanafillë. Por duhet patur parasysh se kjo nuk është “histori perëndimore”, por histori teologjike e Lindjes së Afërt. Ngjarjet nuk regjistrohen në mënyrë shteruese apo në rend kronologjik, por përzgjidhen për të zbuluar karakterin e Perëndisë dhe të Izraelit.
- B. Kjo tregon karakterin e Perëndisë:
1. Prania e tij shihet në renë;
 - a. Reja qëndroi mbi “Vendin më të Shenjtë” të tabernakullit, 9:15. Perëndia e pranoi tabernakullin dhe procedurat e tij si udha dhe vendi ku Perëndia do të takohej me njeriun!
 - b. Reja i priu popullit, 9:17-23. Perëndia ishte me ta dhe i drejtoi me anë të vetë pranisë së tij.
 - c. Reja mishëronte praninë e Perëndisë, që ia zbulonte veten Moisiut, 11:17, 25; 16:42-43.
 - d. Reja u bë simbol i pranisë së Perëndisë në gjykim, si dhe në zbulesë, 12:1-8; 14:10.
 - e. Reja ishte simboli i dukshëm i pranisë së Perëndisë, jo vetëm para Izraelit, por edhe para kombeve përreth, 14:14; 23:21.
 - f. Prania e Perëndisë, e simbolizuar nga reja gjatë Eksodit dhe Periudhës së Endjes në Shkretëtirë, nuk u shfaq më e tillë pasi izraelitët hynë në Vendin e Premtuar; gjithsesi, Perëndia ishte simbolikisht mes tyre me anë të Arkës së Besëlidhjes, 35:34.
 2. Hiri dhe mëshira e tij shfaqen në:
 - a. Pranimë e tij të vazhdueshme mes tyre, pavarësisht ankesave dhe refuzimit që ata iu bënë drejtuesve të tyre, 11:1; 14:2, 27, 29, 36; 16:11, 42; 17:5; 20:2; 21:5.
 - b. Furnizimi i tij për ta në shkretëtirë:
 - (1) Ujë
 - (2) Ushqim
 - (a) Mana (përditë, përveçse në shabat)
 - (b) Shkurtat (dy herë)
 - (3) Veshje që nuk vjetëroheshin
 - (4) Reja;
 - (a) Hija
 - (b) Drita
 - (c) Udhërrëfimi
 - (d) Zbulesa
 - c. Fakti se Perëndia e dëgjoi ndërmjetësimin e Moisiut:
 - (1) 11:2
 - (2) 12:13
 - (3) 14:13-20
 - (4) 16:20-24
 - (5) 21:7
 3. Drejtësia (shenjtëria) e tij shfaqet si më poshtë:
 - a. ndëshkimi i Izraelit me një periudhë 38-vjeçare endjeje në shkretëtirë (14).
 - b. ndëshkimi i Moisiut, duke mos e lejuar që të hynte në Vendin e Premtuar (20:1-13; 27:14; LiP. 3:23-29).
 - c. vdekja e Korahut dhe krerëve të Rubenit (16:1-40).
 - d. murtaja që iu ra atyre që refuzuan udhëheqjen e Moisiut dhe Aronit (16:41-50).
 - e. idhujtaria në Shitim u gjykua nga Perëndia me vdekjen e shkelësve me anë të levitëve (25).
- C. Me pranimin e marrëveshjes së Besëlidhjes nga Izraeli në malin Sinai, besimi në JHVH dhe bindja e rreptë ndaj Fjalës së tij u bënë çështje thelbësore.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe fraza (NASB):

1. Çadra e takimeve, 1:1 (NASB & NIV)
2. Shpengimi, 3:46 (NIV, shpengoj)
3. Nazaritët, 6:2 (NASB & NIV)
4. i huaji banon ndër ju, 9:14 (NIV, i huaji)
5. Reja, 9:15 (NASB & NIV)
6. “turma e përzier që ishte ndër ta”, 11:4 (NASB & NIV)
7. “shqyen rrobat”, 14:6 (NASB & NIV)
8. Thekët, 15:38 (NASB & NIV)
9. *Sheol*, 16:30 (NIV, varri)
10. Mëshqerra e kuqe, 19:2 (NASB & NIV)
11. Gjarpërinjtë e zjarrtë, 21:6 (NIV, gjarpërinj helmues)
12. Qytet strehimi, 35:6 (NASB & NIV)
13. Gjakmarrësi, 35:19, 21 (NASB & NIV)

B. Persona që duhen identifikuar shkurtimisht


1. Gruaja kushite, 12:1 (NIV, “gruaja e tij kushite”)
2. Anaku, 13:28, 33
3. Jebusitët, 13:29
4. Korahu 16:1 (NIV, “Korathi”)
5. Balaami, 22:5
6. Baali, 22:41

X. VENDNDODHJET NË HARTË (sipas numrave)


1. Lugina e Eshkolit, 13:23 (veri të Hebronit)
2. Rruga e Mbretërve, 20:17
3. Mali Pisga, 21:20
4. Lumi i Arnonit, 21:24
5. Lumi i Jabokut, 21:24
6. Ashur, 24:22
7. Shitim, 25:1
8. Deti i Kineretit, 34:11 (NIV, “Deti i Kineretit”)

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Pse nuk u numërua dhe Levi me fiset e tjera, 1:49?
2. Ç’lidhje kanë levitët me të parëlindurit, 3:12-13?
3. Përshkruaj provën e kurorëshkeljes, 5:16 e më tej.
4. Rendit kërkesat e zotimit nazarit, 6:1 e më tej.
5. Si e shpjegon kapitullin 4:3 në krahasim me 8:24?
6. A e shkroi Moisiu vargun 12:3?
7. Pse caktoi Perëndia një periudhë 40-vjeçare endjeje në shkretëtirë?
8. Ç’kuptim ka fjala “pa dashje” në lidhje me mëkatin dhe flijimin, siç na shpjegohet në kapitullin 15?
9. Cili ishte mëkati i Moisiut në kapitullin 20? Cilat ishte pasoja e tij?
10. A foli vërtet gomari i Balaamit (22:28)? Si i sugjeroi Balaami Balakut që ta mposhte Izraelin?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



HYRJE PËR LIGJIN E PËRTËRIRË

I. RËNDËSIA

- A. Është një nga katër librat më të cituar të DHV në Dhiatën e Re (Zanafilla, Ligji i Përtërirë, Psalmet dhe Isaia). LiP. Citohet 83 herë.
- B. Duhet të ketë qenë një nga librat e preferuar të Jezusit nga DHV:
1. e citoi shpesh gjatë tundimit nga Satani në shkretëtirë (Mat. 4:1-16; Luka 4:1-13)
 2. ndoshta, është burimi i përvijimit të Predikimit në Mal, Mat. 5-7.
 3. Jezusi e citoi LiP. 6:5 si urdhërimin më të madh, Mat. 22:34-40; Mk. 12:28-34; Lk. 10:25-28.
 4. Jezusi e citoi këtë pjesë të DHV (Zan.-LiP.) më shpesh për shkak se judenjtë e kohës së tij e konsideronin si pjesën më të autoritetshme të kanonit.
- C. Përbën shembullin madhor në Bibël të riinterpretimit të një zbuluese të mëparshme nga Perëndia për t'ia përshtatur një situatë të re. Një shembull i kësaj është dallimi disi mes Dhjetë Urdhërimeve të Eks. 20 dhe atyre në LiP. 5. Eksodi 20 u dha gjatë Periudhës së Endjes në Shkretëtirë, ndërsa LiP. 5 u dha kur populli po përgatitej të zinte vend në Kanan.
- D. Ligji i Përtërirë është, sipas pohimit të vet, një sërë mesazhesh të Moisiut:
1. Për të rrefyer veprat besnike të Perëndisë ndaj Izraelit;
 2. Për të ritheksuar Ligjin, që u dha në malin Sinai;
 3. Për të riinterpretuar rrjedhojat e tij për jetën bujqësore në Kanan;
 4. Për t'u përgatitur për ceremoninë e ripërtëritjes së Besëlidhjes në Vendin e Premtuar (Jozueu);
 5. Për të dokumentuar vdekjen e Moisiut dhe kalimin e drejtimit në dorë të Jozueut
- E. Ligji i Përtërirë është edhe sot vatër dialogu mes teologëve në lidhje me formimin letrar të librit. Studiuesit e sotëm janë të ndarë për sa u përket teorive për formulimin e librave të Pentatukut.

II. EMRI I LIBRIT

- A. Në hebraisht, titujt e librave të Pentatukut janë një nga dhjetë fjalët e para të secilit libër, zakonisht fjala e parë:
1. Zanafilla, “Në fillim”
 2. Eksodi, “Dhe këta janë emrat”
 3. Levitiku, “Dhe ai thirri”
 4. Numrat, “Në shkretëtirë”
 5. Ligji i Përtërirë, “Dhe këto janë fjalët”
- B. Në Talmud (Mishnah Hattorah për 17:18) quhet “përsëritja e ligjit”.
- C. Në përkthimin grek të DHV, që quhet Septuagintë (LXX) dhe që u shkruar rreth 250 para K., quhet “ligji i dytë” për shkak të një keqpërkthimi të 17:18.
- D. Titullin në anglisht (Deuteronomy) e marrim nga Vullgata latinisht e Jeronimit, ku quhet “ligji i dytë” (Deutero-nomian).

III. KANONIZIMI – Ky është libri përmbyllës i Torahut, që përbën të parën e tre ndarjeve të kanonit hebre

A. Torahu, ose Ligji – Zanafilla-Ligji i Përtërirë

B. Profetët:

1. Profetët e hershëm – Jozueu-Mbretërit (përveç Ruthit)
2. Profetët e mëvonshëm – Isaia-Malakia (përveç Danielit dhe Vajtimeve)

C. Shkrimet:

1. Megiloti (5 rrotullat):
 - a. Kënga e Këngëve
 - b. Predikuesi
 - c. Ruthi
 - d. Vajtimet
 - e. Esteri
2. Danieli
3. Literatura e Urtësisë:
 - a. Jobi
 - b. Psalmet
 - c. Fjalët e Urta
 - d. I & II Kronikat

IV. GJINIA LETRARE

- A. Ligji i Përtërirë është një seri mesazhesh, me një hyrje të përgjithshme dhe përshkrim përmbyllës të vdekjes së Moisiut, të cilat Moisiu i dha në anën lindore të lumit Jordan përpara se Izraeli të hynte në Vendin e Premtuar.
- B. Ky libër përmban dhe një këngë/psalm të lashtë të Moisiut, kapitujt 31:30-32:43
- C. Ashtu si Zan. 49, edhe LiP. 33 është profeci për fëmijët e Jakobit.
- D. Ky libër përmban dhe një rrëfim të vdekjes së Moisiut, kapitulli 34.

V. AUTORËSIA

- A. Tradita judaike:
 1. Tradita e lashtë është unanime se autori ishte Moisiu.
 2. Kjo shprehet në:
 - a. Talmud – Baba Bathra 14b
 - b. Mishnah
 - c. *Ekleziastiku* i Ben Siras 24:23 (shkruar rreth 185 para K.)
 - d. Filo i Aleksandrisë
 - e. Flavius Jozefus
 3. Vetë Shkrimi:
 - a. Gjyqtarët 3:4; Jozueu 8:31
 - b. “Moisiu foli”:
 - (1) LiP. 1:1, 3
 - (2) LiP. 5:1
 - (3) LiP. 27:1
 - (4) LiP. 29:2
 - (5) LiP. 31:1, 30
 - (6) LiP. 32:44
 - (7) LiP. 33:1
 - c. “JHVH i foli Moisiut”:
 - (1) LiP. 5:4-5, 22
 - (2) LiP. 6:1
 - (3) LiP. 10:1
 - d. “Moisiu shkroi”:
 - (1) LiP. 31:9, 22, 24
 - (2) Eksodi 17:14
 - (3) Eksodi 24:4, 12
 - (4) Eksodi 34:27-28

- (5) Numrat 33:2
- e. Jezusi citon ose aludon nga Ligji i Përtërirë dhe thotë “Moisiu tha”/“Moisiu shkroi”:
 - (1) Mateu 19:7-9; Marku 10:4-5 – LiP. 24:1-4
 - (2) Marku 7:10 – LiP. 5:16
 - (3) Luka 16:31; 24:27, 44; Gjoni 5:46-47; 7:19, 23
- f. Pali pohon se autori ishte Moisiu:
 - (1) Romakëve 10:19 – LiP. 32:21
 - (2) 1 Kor. 9:9 – LiP. 25:4
 - (3) Gal. 3:10 – LiP. 27:26
 - (4) Veprat 26:22; 28:23
- g. Pjetri pohon si autor Moisiun gjatë predikimit të tij në ditën e Rrëshajëve – Veprat 3:22
- h. Autori i Hebrenjve thotë se autori i LiP. ishte Moisiu – Hebrenjve 10:28; LiP. 17:2-6

B. Studiuesit e sotëm

1. Shumë nga teologët e shekujve 18 dhe 19, duke ndjekur teorinë e Graf-Uellhausen për autorësinë e shumëfishtë (J.E.D.P.), shprehen se Ligji i Përtërirë u shkrua nga një prift/profet gjatë mbretërimit të Josias në Judë me qëllim që të mbështeste reformat e tij shpirtërore. Kjo do të thotë se libri u shkrua në emër të Moisiut rreth 621 para K.
2. Këtë mendim ata e bazojnë në:
 - a. 2 Mbretërve 22:8; 2 Kron. 34:14-15. “E gjeta librin e ligjit në shtëpinë e ZOTIT”.
 - b. Kapitulli 12 diskuton për një vend të vetëm për tabernakullin dhe, pastaj, tempullin;
 - c. Kapitulli 17 diskuton për një mbret të mëvonshëm;
 - d. Është e vërtetë se shkrimi i një libri në emër të një njeriu të famshëm nga e kaluara ishte diçka e përhapur në Lindjen e Afërt të lashtë dhe në qarqet judaike;
 - e. Ka ngjashmëri stili, fjalori dhe gramatike mes LiP. dhe Jozueut, Mbretërve dhe Jeremisë;
 - f. Ligji i Përtërirë përmban dhe vdekjen e Moisiut, kapitulli 34;
 - g. Në Pentatuk gjenden qartazi shtesa të mëvonshme redaktoriale:
 - (1) Ligji i Përtërirë 3:14
 - (2) Ligji i Përtërirë 34:6
 - h. Larmia ndonjëherë e pashpjegueshme e përdorimit të emrave të Perëndisë: El, El Shadai, Elohim, JHVH, në kontekste dhe periudha historike që, në dukje, janë të unifikuara.

VI. DATA

A. Nëse u shkrua nga Moisiu, mbeten gjithsesi dy mundësi në lidhje me kohën dhe kohëzgjatjen e eksodit (daljes) nga Egjipti:

1. Nëse 1 Mbretërve 6:1 duhet marrë në mënyrë të fjalëpërfjalshme, kjo ndodhi rreth 1445 para K. (dinastia e 18-të e Tutmozit III dhe Amenhotepit II):
 - a. LXX shkruan 440 vite, jo 480 vite.
 - b. Kjo shifër mund të reflektojë brezni, jo vite (pra, simbolike).
2. Provat arkeologjike për vitin 1290 para K. për daljen (dinastia e 19-të egjiptiane):
 - a. Seti I (1390-1290) e transferoi kryeqytetin egjiptian nga Teba në rajonin e deltës – Zoan/Tanis.
 - b. Ramzesi II (1290-1224):
 - (1) Emri i tij shfaqet në një qytet të ndërtuar nga skllëvër hebrej, Zan. 47:11; Eks. 1:11;
 - (2) Kishte 47 bija;
 - (3) Nuk u pasua nga biri i tij i madh.
 - c. Të gjitha qytetet kryesore me mur të Palestinës u shkatërruan dhe u rindërtuan me shpejtësi rreth vitit 1250 para K.

B. Teoria e studiuesve modernë për autorësinë e shumëfishtë të Pentatukut:

1. J (JHVH) 950 para K.
2. E (Elohim) 850 para K.
3. JE (kombinim) 750 para K.
4. D (Ligji i Përtërirë) 621 para K.

5. P (priftërinjtë) 400 para K.

VII. BURIME QË MBËSHITESIN KONTEKSTIN HISTORIK

- A. Traktatet hitite të mijëvjeçarit të dytë para K. na ofrojnë një paralelizëm të lashtë, historik dhe bashkëkohor për strukturën e Ligjit të Përtërirë (si dhe Eks.-Lev, Joz. 24). Ky model traktati u ndryshua rreth mijëvjeçarit të parë para K. Kjo na jep një provë për vërtetësinë historike të Ligjit të Përtërirë. Për lexim të mëtejshëm në këtë fushë, shih G. E. Mendenhall, *Law and Covenants in Israel and the Ancient Near East*.
- B. Modeli hitit dhe paralelet e tij në LiP.:
1. Parathënia (LiP. 1:1-5; prezantimi i folësit, JHVH)
 2. Përsëritja e veprave të kaluara të Mbretit (LiP. 1:6-4:49, veprat e Perëndisë për Izraelin në të kaluarën)
 3. Kushtet e traktatit (LiP. 5-26):
 - a. Të përgjithshme (LiP. 5-11)
 - b. Të veçanta (LiP. 12-26)
 4. Rezultatet e traktatit (LiP. 27-29):
 - a. Dobitë (LiP. 28)
 - b. Rrjedhjet (LiP. 27)
 5. Hyjnia si dëshmitar (LiP. 30:19; 31:19; si dhe 32; kënga e Moisiut funksionon si dëshmitare):
 - a. Një kopje në tempullin e perëndisë;
 - b. Një kopje i jepej vasalit, që ta lexonte çdo vit;
 - c. Natyra unike e traktateve hitite, në dallim nga traktatet e mëvonshme asiriane dhe siriane, ishin:
 - (1) Përsëritja historike e veprave të kaluara të mbretit;
 - (2) Pjesa e mallkimeve ishte më pak e theksuar.

VIII. NJËSITË LETRARE (konteksti)

- A. Hyrja e librit, 1:1-5
- B. Predikimi i parë, 1:6-4:43 (veprat e kaluara të JHVH për sot):
- C. Predikimi i dytë, 4:44-26:19 (ligji i JHVH për sot dhe për gjithë kohën):
1. të përgjithshme – Dhjetë Urdhërimet (5-11)
 2. shembuj dhe zbatime të veçanta (12-26)
- D. Predikimi i tretë, 27-30 (ligji i JHVH për të ardhmen, 27-29):
1. Mallkimet (27)
 2. Bekimet (28)
 3. Ripërtëritja e besëlidhjes (29-30)
- E. Fjalët e fundit të Moisiut, 31-33:
1. Predikimi i “lamtumirës”, 31:1-29
 2. Kënga e Moisiut, 31:30-32:52
 3. Bekimet e Moisiut 33:1-29
- F. Vdekja e Moisiut, 34

IX. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Përgatitjet përfundimtare përpara hyrjes në Vendin e Premtuar. Besëlidhja e Perëndisë me Abrahamin (Zan. 12:1-3) premtoi një vend dhe një farë. DHV përqendrohet te vendi.

- B. Moisiu e përgatiti popullin për një jetë të sistemuar bujqësore, në dallim nga jeta nomade. Ai e përshtat besëlidhjen e Sinait për t' u zbatuar në Vendin e Premtuar.
- C. Libri thekson besnikërinë e Perëndisë në të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen. Mirëpo besëlidhja është e kushtëzuar! Izraeli duhet të përgjigjet dhe të vazhdojë me besim, pendim dhe bindje. Nëse s' vepron kështu, mallkimet e kapitujve 27-29 do të bëhen realitet.

X. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe fraza:

1. “Do të thërras si dëshmitarë qiellin dhe tokën”, 4:26 (NASB & NIV)
2. “vizitohet shkeljen e etërve të femijët...”, 5:9 (NIV, “ndëshkohet femijët për mëkatet e etërve deri në brezin e tretë dhe të katërt”)
3. “... por dashamirësi për mijëra...”, 5:10 (NIV, “por u tregoj dashuri një mijë brezave”)
4. “dëgjoj” (Shema) 6:4 (NASB & NIV)
5. “shirita mbi ballë”, (filakteri) 6:8 (NIV, “si simbole mbi...”)
6. “shkruajini mbi pragun e derës” (*mezuzah*) 6:9 (NIV, “pragjet e dyerve”)
7. “të ndaluara” *herem*, 13:17 (NIV, “ato gjërat e dënuara”)
8. “ushtria qiellore”, 17:3 (NIV, “yjet e qiellit”)
9. “kalojnë përmes zjarrit”, 18:10 (NIV, “flijimet”)
10. yshtësi, 18:11 (NASB & NIV)
11. të shpenguarit, 21:8 (NASB & NIV)
12. “të padashurit”, 21:15 (NIV, “jo për të tjerët”)
13. “varet në pemë”, 21:23 (NASB & NIV)
14. “rroga e qenit” (23:18 (NIV, “fitimet e një... prostitute mashkull”)
15. “certifikatë divorci” 21:4 (NASB & NIV)
16. “vajosuni me vaj”, 28:40 (NIV, “përdorni vajin”)

B. Persona që duhen identifikuar shkurtimisht:

1. Anakim, 1:28 (NIV, “anakitët”)
2. Refaim, 3:11 (NIV, “refaitët”)
3. Hititët, 7:1
4. Asherim, 7:5 (NIV, “shtyllat e asherahut”)
5. Profeti, 18:15-22
6. Jeshurun, 32:15; 33:5, 26


XI. VENDNDODHJET NË HARTË (sipas numrave)

1. Mali Horeb, 1:2, 6, 19; 4:10, 15
2. Mali Seir, 1:2, 4; 2:1, 4, 5, 8, 12, 22 (vargmal)
3. Kadesh Barnea, 1:46; 32:51 (NIV, “Kadesh”)
4. Bashan, 1:4; 3:1, 3, 4, 10, 11, 13; 4:43, 47
5. Elat, 2:8 (Ecion-Geber)
6. Mali Hermon, 3:8, 9; 4:48
7. Mali Ebal, 11:29; 27:4, 13
8. Mali Gerizim, 11:29; 27:12
9. Mali Hor, 32:50 (Xhebel Harun)


XII. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Si ndryshon Ligji i Përtërirë nga Eksodi dhe Numrat (gjinia letrare)?
2. Pse e përsërit Moisiu historinë e Eksodit?
3. Pse përmendet kaq shpesh fakti se duhet t' i mësojmë femijët (4:9; 6:7, 20-25; 11:19; 32:46)?
4. Si dallon versioni i Dhjetë Urdhërimeve të Ligji i Përtërirë 5 nga Eksodi 20?

5. Pse u urdhërua populli që t'i shkatërronte shtyllat e shenjta dhe Asherimët e tyre (7:5)?
6. Si e karakterizon 10:12-21 Ligjin e Përtërirë?
7. Pse janë kaq të rëndësishëm kapitujt 27-29 për interpretimin e gjithë Dhiatës së Vjetër?
8. Kush e shkroi vdekjen e Moisiut (34)?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



HYRJJE PËR JOZUEUN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Emri i këtij libri është ai i pasuesit të Moisiut dhe protagonistit të librit.
- B. Emri i tij përbëhet nga dy fjalë hebraisht:
 - 1. JHVH (J plus një zanore)
 - 2. Shpëtim (Hoshea)
- C. Ky është i njëjti emër hebraisht si ai i Jezusit (Mat. 1:21).

II. KANONIZIMI

- A. Jozueu është libri i parë i asaj pjese të kanonit hebraik, të njohur si “Profetët”.
- B. Kjo pjesë ndahet në dy nënpjesë:
 - 1. Profetët e hershëm, që përfshin Jozueu-Mbretërve (përveç Ruthit).
 - 2. Profetët e mëvonshëm, që përfshin Isaia-Malakia (përveç Danielit dhe Vajtimeve).

III. GJINIA LETRARE

- A. Këta libra historikë vijojnë historinë e popullit të Perëndisë, e cila filloi në librin e Zanafillës. Nuk bëhet fjalë për histori kronologjike perëndimore, por për histori të përzgjedhur teologjike. Kjo nuk do të thotë se s’është e vërtetë ose e saktë, por do të thotë se autorët përzgjedhën disa ngjarje për të mësuar disa të vërteta teologjike për Perëndinë, njeriun, mëkatin, shpëtimin, etj. Në këtë kuptim, kjo është e ngjashme me ungjijtë dhe Veprat e Apostujve në Dhiatën e Re.
- B. Për judenjtë, historia nuk ishte ciklike si në rastin e fqinjëve të tyre, që e bazonin historinë në ciklet e natyrës, por ishte “teleologjike”. Pra, kishte një qëllim, një synim. Perëndia po lëvizte drejt synimit të paracaktuar, pra, shpëngimit të botës së rënë (Zan. 3:15).

IV. AUTORËSIA

- A. Tradicionalisht, autori është Jozueu:
 - 1. Në fillim, e kishte emrin Hoshea (Shpëtim), Num. 13:8.
 - 2. Moisiu ia ndryshoi emrin në Jozue (JHVH “është” shpëtim), Num. 13:16.
 - 3. për arsye të panjohura, emri i tij shqiptohet në katër mënyra të ndryshme:
 - a. *jeshoshu’a* (përdoret shpesh) Joz. 1:1
 - b. *jehoshu’a*, LiP. 3:21
 - c. *hoshe’a*, LiP. 32:44
 - d. *jeshu’a*, Neh. 8:17
- B. Baba Bathra 14B thotë se Jozueu e shkroi gjithë librin, me përjashtim të rrëfimit të vdekjes së tij, të cilin e shkroi prifti Eleazar, 24:29-30; biri i tij, Fineas (Num. 25:7-13; 31:6-8; Joz. 22:10-34) e përfundoi librin duke përmendur vdekjen e Eleazarit, 24:31-33.
- C. Kush ishte Jozueu:
 - 1. lindi gjatë skllavërisë në Egjipt
 - 2. një nga dymbëdhjetë spiunët; vetëm ai dhe Kalebi sollën raportim me besim (Num. 14:26-34)
 - 3. ndihmësi besnik i Moisiut gjatë gjithë kohës së Eksodit. Ishte vetmi që ungjit në malin Sinai bashkë me Moisiun (deri në gjysmë të malit – Eks. 24:13-14).
 - 4. Komandanti i ushtrisë së Izraelit (Eks. 17:8-13)
 - 5. I priu Pushtimit të Kananit si pasuesi i Moisiut (LiP. 31:23)

D. Disa fakte për autorësinë e Jozueut:

1. Libri pohon se Jozueu shkroi besëlidhjen e Perëndisë me popullin, 24:26; prandaj, e dimë që ishte në gjendje të shkruante.
2. Këtu kemi, pa dyshim, materiale prej dëshmitari okular:
 - a. “ne”, 5:1 (ka variante në dorëshkrime)
 - b. “Jozueu i rrethpreu”, 5:7-8
 - c. Takimi personal i Jozueut me Engjëllin e ZOTIT, 5:13-15
 - d. “ajo (Rahabi) ka jetuar në mes të Izraelit deri më sot”, 6:25 (ky s’është redaktor i mëvonshëm, por bashkëkohës dhe dëshmitar okular)
3. Ai përdori disa burime të shkruara:
 - a. Libri i Jasharit, 10:13 (2 Sam. 1:18)
 - b. “në një libër”, 18:9
4. Renditja e saktë e emrave të qyteteve të lashta, gjë që përputhet me një autor bashkëkohor, por jo me një redaktor të mëvonshëm:
 - a. Jerusalemi quhej Jebus, 15:8; 18:16, 28
 - b. Hebroni quhet Kiriath-arba, 14:15, 15:13, 54: 20:7; 21:11
 - c. Kiriath-jearimi quhet Baalah – 15:9, 10
 - d. Sidoni quhet qyteti kryesor i fenikasve, dhe jo Tiri (11:8; 19:28), i cili u bë më vonë qyteti kryesor.
5. Jozueu, ashtu si dhe Pentatuku, përmban disa shtesa redaktoriale:
 - a. Vdekja e Jozueut
 - b. Pushtimi i mëvonshëm i Hebronit, 14:6-15; 15:13-14
 - c. Pushtimi i mëvonshëm i Debirit, 15:15, 49
 - d. Migrimi i Danit në veri, 19:47
 - e. Frazja “deri më sot” shfaqet shumë herë, gjë që tregon një redaktim të mëvonshëm, 4:9; 5:9; (6:25); 7:26 (dy herë); 8:28-29; 9:27; 10:27; 13:13; 14:14; 15:63; 16:10; 22:3

E. Studiuesit e sotëm:

1. Vënë në dukje ngjashmëritë mes Pentatukut dhe Jozueut:
 - a. stili
 - b. fjalori
2. Hipotezat Dokumentare të J. E. D. P. shprehen se libri u shkrua gjatë një periudhe të gjatë kohore dhe nga shumë shkruarës të ndryshëm:
 - a. Burimi J shkroi disa pjesë të kapitujve 1-12, që fokusohen te betejat individuale (950-850 para K.)
 - b. Burimi E shkroi disa pjesë të kapitujve 1-12, që përqendrohen te fushata e bashkuara ushtarake (750 para K.)
 - c. Një kombinim i J & E u shkrua rreth 650 para K, ku shumica e J u përjashtua
 - d. Libri u riredaktua nga prifti/profeti i kohës së Josias, i cili shkroi dhe Ligjin e Përtërirë. Ky person ose grup quhet “burimi deuteronomist”. Ky burim shkroi dhe LiP. për të përforcuar reformën e Josias më 621 para K., duke u përqendruar te Jerusalemi si shenjtërorja e vetme e vërtetë.
 - e. Burimi P ishte një grup priftërinjsh, të cilët shkruan kapitujt 13-21 në periudhën 400 para K.
 - f. Shtesa të tjera mund të jenë bërë në shekullin e tretë para K.
3. Vini re presupozimin e kësaj teorie! Vini re sesi e shkëput tekstin nga konteksti historik dhe autori. Kjo është përpjekje moderne për t’i analizuar tekstet në dritën e teorive letrare moderne. Gjithsesi, duhet thënë:
 - a. Autorësia e librit të Jozueut nuk na jepet.
 - b. Vdekja e Jozueut, ashtu si ajo e Moisiut, përmendet në libër.
 - c. Librat e DHV janë redaktuar në mënyrë të vazhdueshme.
 - d. Ne e pranojmë procesin e formimit, që prodhoi një DHV të frymëzuar.
 - e. Të dhënat kundër një Heksatuku (Zan.-Joz.):
 - (1) Në traditën judaike bëhet një dallim i qartë mes pesë librave të Moisiut (Pentatuku) dhe Jozueut, i cili shërben si fillimi i pjesës së “Profetëve” në kanonin hebraik:

- (a) Ben Sira, autori i *Ekleziastit*, i shkruar rreth 185 para K., e bën këtë dallim në 45:22-48:12.
- (b) Edhe Flavius Jozefus, në librin e tij *Kundër Apionit* 1:7 e më tej, e bën këtë dallim.
- (c) Këtë dallim e bën dhe shënimi përmbyllës kopjues i Tekstit Masoret (TM) të Pentatukut.
- (d) Edhe leximet e përjavshme biblike në sinagoga, që quhen “*Haftarot*”, e bëjnë këtë dallim.
- (e) Samaritanët e quanin Pentatukun Shkrim, por jo librin e Jozueut.
- (2) Të dhënat e brendshme (Young, f. 158):
 - (a) Jozueu përdor në mënyrë të veçantë përemrin pronor, që nuk ndodh te Pentatuku.
 - (b) Qyteti i Jerikos shqiptohet ndryshe.
 - (c) Titulli i Hyjnisë, “Perëndia i Izraelit”, shfaqet 14 herë te Jozueu, por asnjëherë në pentatuk.
- f. Duhet pranuar se ka shumëçka që nuk dimë në lidhje me formimin e këtyre librave të DHV në gjendjen e tyre përfunditmare.

V. DATA

- A. Ky libër trajton pushtimin e Vendit të Premtuar. Meqë jemi të pasigurt për datën e Eksodit dhe Periudhës së Endjes në Shkretëtirë, jemi të paqartë për datimin e Pushtimit:
 - 1. 1445-40 – rreth 1400 para K. (1 Mbre. 6:1)
 - 2. 1290-40 – rreth 1250 para K. (arkeologjia)
- B. Jozueu u shkrua, ose u redaktua, në periudhën e Gjyqtarëve; një sërë qytetesh iu ndryshua emri pas pushtimit izraelit. Një shembull është qyteti kananit i Zefatit, që më vonë u ndryshua në Horma, Gjyqtarëve 1:16-17. Megjithatë, emri i mëvonshëm përdoret më herët te Jozueu 12:14; 15:30; 19:4.
- C. R. K. Harrison hamendëson se libri u shkrua nga Samueli gjatë mbretërimit të Davidit, dhe se Samueli mund të ketë qenë burimi i traditave nga Shilohu (shih *Introduction to the Old Testament*, f. 673).

VI. BURIME QË MBËSHTESIN KONTEKSTIN HISTORIK

- A. Arkeologjia ka treguar se shumica e qyteteve të mëdha e të fortifikuara të Kananit u shkatërruan dhe u rindërtuan me shpejtësi rreth vitit 1250 para K.:
 - 1. Hacori
 - 2. Lakishi
 - 3. Beteli
 - 4. Debiri (më herët, quhej Kerioth Sefer, ose Kirath Sefer, 15:15)
- B. Arkeologjia s’ka qenë në gjendje të pohojë ose kundërshtojë rrëfimin biblik për rënien e Jerikos. Kjo ndodh për shkak se vendi aty është në gjendje shumë të keqe:
 - 1. moti/vendndodhja
 - 2. rindërtimet e mëvonshme mbi vendet e mëparshme, duke përdorur materiale të mëparshme
 - 3. paqartësi për datimin e shtresave arkeologjike
- C. Arkeologët kanë gjetur një altar mbi malin Ebal, që ndoshta lidhet me Jozueu 8:30-31 (LiP. 27:2-9). Është shumë i ngjashëm me një përshkrim të gjetur në *Mishnah* (Talmud).
- D. Tekstet e Ras Shamrës, të gjetura në Ugarit, tregojnë jetën dhe fenë kananite të viteve 1400 para K.:
 - 1. natyra politeiste e adhurimit (kulti i pjellorisë)
 - 2. Eli ishte perëndia kryesor
 - 3. Bashkëshortja e Elit ishte Asherahu (më vonë, u bë bashkëshortja e Ba’alit)
 - 4. Biri i tyre ishte Ba’ali (Hadadi), perëndia i furtunës
 - 5. Ba’ali u bë “perëndia i lartë” i panteonit kananit. Bashkëshortja e tij ishte Anati.
 - 6. Ceremoni të ngjashme me Isin dhe Osirin e Egjiptit

7. Adhurimi i Ba'alit përqendrohej në “vendet e shenjta” lokal, ose në platformat prej guri (prostitucioni ritual).
 8. Ba'ali simbolizohej nga një shtyllë e ngritur prej guri (simboli i penisit), ndërsa Asherahu, ose Astartja, simbolizohej nga një hu i gdhendur prej druri, ose pemë ulliri, që simbolizonte “pemën e jetës”.
- E. Arkeologjia ka vërtetuar se perandoritë kryesore të rajonit (hititët, egjiptianët dhe mesopotamasit) nuk ishin në gjendje të ushtronin ndikim në Palestinë gjatë kësaj periudhe të njohur si Epoka e Bronzit të Vonët (1550-1200 para K.).
- F. Renditja e saktë e emrave të qyteteve të lashta përputhet me një autor të kohës, jo me një redaktor të mëvonshëm:
1. Jerusalemi quhej Jebus, 15:8; 18:16, 28 (15:28 thotë se jebusitët kishin mbetur ende në një pjesë të Jerusalemit)
 2. Hebroni quhej Kiriath-arba, 14:15; 15:13, 54; 20:7; 21:11
 3. Kiriath-jearimi quhej Baalah, 15:9,10
 4. Debiri quhej Kiriath-sana, 15:49
 5. Sidoni përmendet si qyteti kryesor i fenikasve, në dallim nga Tiri (11:8; 13:6; 19:28), që më vonë u bë qyteti kryesor.
- G. Jozueu 24 përputhet plotësisht me modelin e traktatit hitit (si Ligji i Përtërirë) të mijëvjeçarit të dytë para K.

VII. NJËSITË LETRARE (konteksti)

- A. Lëvizjet gjeografike përbëjnë një përvijim të këtij libri:
1. Nis me Pllajat e Moabit, 1-2
 2. Kalimi i lumit Jordan në Gilgal, pranë Jerikos, 3-4
 3. Fushata qendrore ushtarake në Kanan, 5:1-10:15
 4. Fushata jugore ushtarake në Kanan, 10:16-43
 5. Fushata veriore ushtarake në Kanan, 11:1-23
 6. Ndarja gjeografike e vendit mes fiseve, 12-21
- B. Një përvijim i shkurtër:
1. Pushtimi i Kananit, 1-11
 2. Ndarja e Vendit të Premtuar mes fiseve, 12-21
 3. Fjalët e fundit dhe vdekja e Jozueut, 22-24

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Demonstrimi i aftësisë dhe besnikërisë së Perëndia ndaj premtimit të tij për Abrahamin (Zan. 12:1-3) në lidhje me vendin e premtuar (Zan. 15:16).
- B. Vijon historinë, që nisi në Zanafillë, dhe e sjell në një periudhë të re. Gjatë kësaj kohe, shoqërimet vullnetare fisnore ishin faktori qendror përbashkues. Nuk kishte qeverisje qendrore.
- C. Koncepti i “Luftës së Shenjtë” (*herem* – “e ndaluar”) na duket shumë mizor, por Perëndia i paralajmëroi izraelitët për mëkatet e kananitëve. Ashtu si Perëndia i hoqi kananitët nga vendi për shkak të mëkateve, kështu do të heqë dhe judenjtë për të njëjtat mëkate (Robëria, nga Asiria dhe Babilonia).

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

- A. Fjalë dhe/ose fraza:
1. vau 2:7 (NASB & NIV)

2. thika prej stralli, 5:2 (NASB & NIV)
3. “një vend, ku rrjedh qumështi dhe mjalti” 5:6 (NASB & NIV)
4. “hiqni sandalet”, 5:15 (NIV, “zbathi sandalet”)
5. “i shenjtë” (*kadosh*), 5:15
6. “nën ndalim” (*herem*), 6:17 (NIV, “i përkushtuar”)
7. Dielli qëndron pa lëvizur në Gibeon, 10:12 (NASB & NIV)
8. “vendosni këmbët mbi qafat e këtyre mbretërve”, 10:24 (NASB & NIV)
9. (qytetet levitike), 21:1-3 (NIV, “Moisiu urdhëroi që të na jepni qytete ku të jetojmë”)
10. “shërbëtori i Zotit”, 24:29 (NASB & NIV)

B. Persona që duhen identifikuar shkurtimisht:


1. Rahabi, 2:1
2. “kapiteni i ushtrive të Zotit”, 5:14 (NIV, “komandanti i ushtrisë së ZOTIT”)
3. Akani, 7:1
4. Zelofehadi, 17:3
5. Fineasi, 22:12

X. VENDNDODHJET NË HARTË (sipas numrave)


1. Deti i Madh, 1:4
2. Shitimi, 2:1
3. Adami, 3:16
4. Ai, 7:2
5. Gibeoni, 9:3
6. Negevi, 11:16
7. Arabahu, 11:16
8. Heshboni, 12:5
9. Përroi i Egjiptit (*uadi al 'arish*), 15:4 (NIV, “vau i Egjiptit”)
10. Lugina e Hinomit, 15:8 (NIV, “lugina e Ben Hinomit”)
11. Shekemi, 17:7

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Si e inkurajon Perëndia Jozueun, siç kishte bërë me Moisiun (1:1 e më tej; 5:13-15)?
2. Shpjego sesi izraelitët duhet ta kalonin Jordanin me besim (3).
3. Pse pushoi mana?
4. Pse u mposht ushtria e Izraelit në Ai?
5. Si e mashtroi Gibeoni Jozueun?
6. A është e sigurt se kapitulli 10 është mrekulli? Pse/pse jo?
7. Shpjego marrëdhënien mes qyteteve levitike dhe qyteteve të strehimit.
8. Çfarë është problemi që ndodh në kapitullin 22?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



HYRJE PËR GJYQTARËT

I. EMRI I LIBRIT

- A. Titulli vjen nga fjala hebraisht “shofetim”, që do të thotë “ai që zgjidh një mosmarrëveshje”. Kjo fjalë hebraisht është e ngjashme me:
1. fjalën fenikase “regjent”
 2. fjalën akadishit “sundimtar”
 3. fjalën kartagjenase “kryemagjistrat”
- B. Në LXX përkthehet si “*kritai*”, ose Gjyqtarët.
- C. Fjala jonë anglisht vjen nga përkthimi i Vullgatës “*judicum*”.
- D. Titulli anglisht është disi ngatërrues, për shkak se këta persona nuk veprojnë si gjykatës, por janë krerë vendorë dinamikë, që i ngrinte Perëndia dhe i fuqizonte Fryma e Shenjtë (3:10; 6:34; 11:29; 14:6, 19; 15:14) për të përmbushur qëllimin e veçantë të çlirimit të popullit nga një pushtues i huaj (shih 2:16). Një titull më i saktë do të ishte “Çliruesit”.

II. KANONIZIMI

- A. Ky është libri i dytë i pjesës së dytë të kanonit hebraik, që quhet “Profetët”.
- B. Ndarja e dytë ka dy nëndarje:
1. Profetët e hershëm, ku përfshijmë librat historikë: Jozueu – Mbretërve (përveç Ruthit)
 2. Profetët e mëvonshëm, ku përfshijmë profetët: Isa. – Mal. (përveç Dan. dhe Vaj.)

III. GJINIA LETRARE – është kryesisht narrative historike

IV. AUTORËSIA

- A. Bibla vetë është e heshtur
- B. Baba Bathra 14b thotë se Samueli shkroi librat që mbajnë emrin e tij, Gjyqtarët dhe Ruthin
- C. Libri mbulon një periudhë prej shumë vitesh; prandaj, autori nuk mund të ketë qenë dëshmitar okular
- D. Libri mund të jetë përpiluar prej burimeve të mëposhtme:
1. një sërë burimesh të panjohura me shkrim, si:
 - a. “Libri i Luftrave të Zotit”, që është një burim historik i përmendur në Num. 21:14
 - b. “Libri i Jasharit”, që është një tjetër burim historik i përmendur në Joz. 10:13 dhe 2 Sam. 1:18
 2. Ndoshta, burime të ndryshme gojore. Historitë e sakta gojore ishin të përhapura në Lindjen e Afërt të lashtë, ku materialet e shkrimit ishin shumë të shtrenjta dhe të vështira për t’u transportuar. Një shembull i tillë do të ishte:
 - a. “Kronikat e Samuel profetit,... Natan profetit,... Gad profetit” në 1 Kro. 29:29
- E. Me sa duket, përpiluesi fillestar shkroi gjatë fillimit të Monarkisë së Bashkuar:
1. Betlehemi përmendet shpesh, gjë që ndoshta reflekton kohën e Davidit (shih 17:7, 8, 9; 19:1, 2, 18 [dy herë]).
 2. Disa pasazhe reflektojnë një periudhë monarkike, kur përdorin frazën “në atë kohë, nuk kishte mbret në Izrael” (shih 17:6; 18:1; 19:1; 21:25). Të gjitha kombet përreth kishin mbretër, ndërsa Izraeli, jo.

- F. Ekzistojnë të dhëna për një redaktor të mëvonshëm:
1. 18:30 reflekton:
 - a. robërinë asiriane të dhjetë fiseve veriore më 722 para K.
 - b. ndoshta, kapjen e Arkës nga filistinët e kohës së Elit, 1 Sam. 1-7.
 2. Tradita judaike shprehet se Jeremia dhe/ose skribi Ezra redaktuan disa pjesë të DHV. Formimi i DHV në formën e tanishme nuk dihet si ka ndodhur. Megjithatë, kjo nuk e ul aspak frymëzimin hyjnor të këtyre librave të DHV.

V. DATA

- A. Ndonëse u shkrua nga një përpilues, ndoshta gjatë mbretërimit të Davidit, kjo nuk do të thotë se materialet historike nuk vijnë nga burime okulare. Ka dy shembuj të qartë të kësaj:
1. Në 1:21, jebusitët mbajnë ende fortesën e brendshme të Jebusit (më vonë, Jerusalemit). Davidi nuk e pushtoi dot këtë fortesë deri në 2 Sam. 5:6 e më tej.
 2. Në 3:3, Sidoni, dhe jo Tiri, renditet si qyteti kryesor i Fenikisë.
- B. Libri mbulon periudhën kohore menjëherë pas Pushtimit të Jozueut deri në lindjen e Samuelit. Data e fillimit varet nga datimi i Eksodit (1445 para K., ose 1290 para K.), 1350 para K., ose 1200 para K. Data përfundimtare i bie të jetë rreth 1020 para K., që ishte fillimi i mbretërimit të Saulit (Bright).
- C. Nëse i mbledhim të gjitha datat që jepen në Gjyqtarët, bëhet fjalë për një periudhë 390-410 vite. Kjo s' duhet marrë si përvijim kronologjik, pasi nga 1 Mbre. 6:1, Bibla thotë se kaluan 480 vjet nga Eksodi deri në ndërtimin e tempullit të Solomonit, më 965 para K. Kjo do të thotë se Gjyqtarët duhet të kenë qenë, pikësepari, krerë vendorë dhe se datat e tyre mbivendosen me njëra-tjetrën.

VI. KONTEKSTI HISTORIK

- A. Kapitujt e parë të Gjyqtarëve na tregojnë sesa i kufizuar kishte qenë pushtimi i Jozueut. Në thelb, Jozueu mposhti qytetet kryesore të fortifikuara të kananitëve, bashkë me potencialin e tyre ushtarak. Perëndia ia la detyrën e vështirë të pushtimit secilit fis sipas zonës së tyre të caktuar, 2:6. Kjo strategji kishte për qëllim të sprovonte brezin e ri të izraelitëve, të cilët nuk i kishin parë mrekullitë e Perëndisë gjatë Eksodit dhe Pushtimit, 2:1-10; 3:1.
- B. Brezi i ri dështoi në këtë sprovë, 2:11 e më tej; 3:7, 12; 4:1; 6:1; 10:6; 13:1. Perëndia iu përgjigj mëkatit të tyre duke dërguar pushtues të huaj që të ndëshkonin popullin e tij. Populli pendohej dhe i bërtiste Perëndisë për ndihmë. Perëndia u dërgonte “një çlirues”. Pastaj, për një periudhë kohore disavjetore, vendi gëzonte paqe. Ky është, në thelb, modeli që përshkruan librin e Gjyqtarëve 2:6-16:31 (“Mëkat, Trishtim, Përgjyrim, Shpëtim”).

VII. NJËSITË LETRARE

- A. Duket se koha e Gjyqtarëve përshkruhet teologjikisht në tre mënyra të ndryshme. Këto tre pikëvështrime përbëjnë dhe përvijimin e librit:
1. rezultatet e pushtimit të Jozueut
 2. nevoja për çlirimtarë
 3. shembuj femohimi
- B. Përvijim i shkurtër i librit:
1. një rrëfim i shkurtër i Pushtimit, 1:1-2:5
 2. mëkati, gjykimi dhe çlirimi i popullit të Perëndisë, 2:6-16:31
 3. tre shembuj mëkatesh të popullit të Perëndisë, që zbulojnë klimën morale të kohës:
 - a. idhujtaria e Mikesë, 17
 - b. migrimi i Danit, 18
 - c. mëkati seksual i Gibeahut, 19-21

C. Gjyqtarët kryesorë dhe armiqtë e tyre:

EMRI	PASAZHI	ARMIKU	KOHA E PAQES (1) ose KOHA E GJYKIMIT (2)
1. Othnieli	3:7-11	Mesopotamia (Kushan-Rishathaimi)	40 vite (1)
2. Ehudi	3:12-30	Moabi (Egloni)	80 vite (1)
3. Debora (Baraku)	4:1-24 (prozë) 5:1-31 (poezi)	Kananitët (Jabini dhe Sisera)	40 vite (1)
4. Gideoni	6-8	Midianitët & amalekitët	40 vite (1)
5. Jeftahu	10:17-2:7	Amonitët (& Efraimi)	6 vite (2)
6. Samsoni	13-16	Filistinët	20 vite (2)

D. Gjyqtarët dytësorë:

Emri	Pasazhi	Armiku	Koha e gjykimit
1. Shamgari	3:31	Filistinët	?
2. Tola	10:1-2	?	23 vjet
3. Jaini	10:3-5	?	22 vjet
4. Ibzani	12:8-10	?	7 vjet
5. Eloni	12:11-12	?	10 vjet
6. Abdoni	12:13-15	?	8 vjet

E. Abimeleku, 9:1-57:

- ky ishte i biri i Gideonit me një konkubinë
- ndkoi vetëm te një qytet: Shekemi
- ishte i ndryshëm nga gjyqtarët e tjerë

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

A. Ky libër vijon qartazi rezultatet e vazhdueshme të Rënies:

- Secili brez i mëtejshëm shkeli Besëlidhjen dhe shkoi pas perëndive kananite të pjellorisë.
- Edhe në Vendin e Premtuar, pavarësisht tokës që i caktoi Perëndia, fisi i Danit zgjodhi të zhvendosej në cepin verior në vend që t'i besonte Perëndisë për mposhtjen e filistinëve.

B. Perëndia zgjodhi popuj paganë për të gjykuar popullin e tij (më vonë, zgjodhi Sirinë, Asirinë dhe Babiloniinë). Kjo reflekton pjesët mallkuese të LiP. 27-29.

C. Ky libër tregon nevojën që një Mbret i drejtë t'u printe fiseve të bashkuara.

D. Ky libër vijon historinë e popullit jude, që nisi në Zanafillë.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjala dhe fraza:

- prerja e gishtave të mëdhenj të dorës dhe të këmbës, 1:7 (NASB & NIV)
- i fryu bririt, 3:27 (NIV, "... trumbetës")
- hosteni, 3:31 (NASB & NIV)
- profeteshja, 4:4 (NASB & NIV)
- mbjellja e kallinjve, 8:2 (NASB & NIV)
- "ahu i orakullit" (*terebinth*), 9:37 (NIV, "pema e magjistarëve")
- Shibolet, 12:6 (NASB & NIV)
- "çdo njeri bënte siç i dukej e drejtë në sytë e vet" 17:6; 18:1; 19:1; 21:25 (NIV, "gjithkush bënte si t'i vinte për mbarë")
- "idhujt e shtëpisë" (*terafim*), 18:17 (NIV, "perënditë shtëpiake")

10. “njerëz të pavlerë” (*belial*), 19:22 (NIV, “njerëz të ligj”)

B. Persona që duhen identifikuar shkurtimisht:


1. Sisera 4:2
2. Baraku 4:6
3. Jalie 4:17
4. Jerubbaali 6:32 (NIV, “Jerub-baali”)
5. Abimeleku 9:1
6. Kemoshi 11:24
7. Dagoni 16:23

X. VENDNDODHJET NË HARTË (sipas numrave)


1. Qyteti i Palmave, 1:16; 3:13
2. Arad, 1:16
3. Betel, 1:22
4. Megido, 1:27
5. Gezer, 1:29
6. Ako, 1:31
7. Hacor, 4:2
8. Rama, 4:5
9. Mali Tabor, 4:6
10. Lumi Kishon, 4:7
11. Lugina e Jezreelit, 6:33
12. Shekem, 9:1
13. Micpa, 10:17
14. Lumi i Aronit, 11:13
15. Lumi i Jabokut, 11:13
16. Timna, 14:1
17. Ashkelon, 14:19
18. Gaza, 16:1
19. Shiloh, 18:31
20. Jebus, 19:10
21. Gibeai, 19:12

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT


1. Pse ndryshojnë kaq shumë rrëfimet e Pushtimeve në Joz. 1-12 nga Gjyqtarët 1-2?
2. Pse duhet t’i vrisnin fiset e Izraelit gjithë kananitët dhe të mos bënin besëlidhje me ta?
3. Pse disa Gjyqtarë i quajmë Kryesorë, ndërsa disa të tjerë, Dytësorë?
4. Çfarë na thonë kapitujt 4-5 për përdorimin e femrave nga Perëndia si drejtuese?
5. Pse donte Perëndia që Gideoni ta ulte numrin e ushtarëve në kapitullin 7?
6. A ia flijoi Perëndisë Jeftahu të bijën (11:30-40)?
7. Si mund ta përdorë Perëndia një njeri kaq epshor sa Samsoni?
8. Pse ishte mëkat i madh fakti që fisi i Danit u zhvendos diku tjetër?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



HYRJE PËR RUTHIN

I. RËNDËSIA

Libri titullohet sipas emrit të njëres prej protagonistëve, Ruth moabiteshës, paraardhëse e Davidit dhe Jezusit, Mat. 1:5.

II. KANONIZIMI

- A. Ky libër është pjesë e ndarjes së tretë të kanonit hebraik, që quhet “Shkrimet”.
- B. Gjithashtu, ai bën pjesë në një grup të veçantë prej pesë libërthash, që quhet Megilot, ose “Pesë Rrotullat”. Secili prej këtyre pesë libërthave (Ruthi, Esteri, Predikuesi, Kënga e Këngëve dhe Vajtimet) lexohet në një ditë feste të veçantë. Ruthi lexohet në ditën e Rrëshajëve, ose në Festën e Javëve.
- C. LXX e vendos Ruthin pas Gjyqtarëve. Jozefusi, në *Kundër Apionit* 1:8, thotë se DHV kishte vetëm 22 libra. Kjo tregon se Gjyqtarët dhe Ruthi llogariteshin si një libër i vetëm. Prandaj, përfshirja e këtij libri në pjesën e “Shkrimeve” duhet të ketë ndodhur më vonë (Jeronimi).

III. GJINIA LETRARE

- A. Ky libër është qartazi narrativë historike, e rrëfyer përmes dialogut. Libri përbëhet nga 85 vargje; 50 prej tyre janë dialog. Ky autor është tregimtar i shkëlqyer.
- B. Disa studiues mendojnë se ky libër është dramë, jo histori, për shkak të:
 - 1. kuptimit simbolik të emrave të karaktereve
 - a. Mahlon = sëmundje
 - b. Kilion = harxhim
 - c. Orpah = qafëfortë
 - d. Naomi = ëmbëlsia ime
 - 2. faktit jokarakteristik se të gjithë karakteret janë shumë fisnikë
 - 3. besimit të fortë fetar të shprehur nga karakteret në periudhën e Gjyqtarëve, 1:1

IV. AUTORËSIA

- A. Si shumë libra të tjerë të DHV, edhe ky bështë anonim.
- B. Baba Bathra 14b thotë se Samueli shkroi librin e vet, Gjyqtarët dhe Ruthin. Meqë Ruthi 4:17, 22 nënkupton se Davidi ishte i mirënjohur, kjo gjë duket e pagjasë, por jo e pamundur.
- C. Ruthi 4:7 tregon një autor ose redaktor të mëvonshëm me anë të frazës: “ky ishte zakoni i kohëve të dikurshme”.

V. DATA

- A. Ngjarjet e kësaj historie ndodhin gjatë Periudhës së Gjyqtarëve, 1:1 (1350 ose 120 para K., deri në 1020 para K.). Kjo mund të jetë arsyeja pse LXX e vendos këtë libër pas Gjyqtarëve.
- B. Duhet të ketë ndodhur gjatë një periudhe paqeje mes Izraelit dhe Moabit:
 - 1. Kjo është e habitshme nëse kemi parasysh Gjyqtarëve 3:12-30
 - 2. Sidoqoftë, duhet të ketë patur paqe në periudha të ndryshme, 1 Sam. 22:3-4 (pra, Sauli).
- C. Kur u shkrua libri?

1. Data e shkrimit është, qartazi, gjatë sundimit të Davidit, 4:17, 22. Vërtetësia historike e këtyre ngjarjeve mbështetet nga fakti se një paraardhëse moabite në rastin e Davidit nuk ishte kompliment për të! (shih LiP. 23:3)
2. Stili dhe fjalori i Ruthit ngjan me atë të Samuelit, por jo me Kronikat

VI. BURIME QË MBËSHTESIN KONTEKSTIN HISTORIK – i vetmi aspekt i këtij libri që është gjetur në zbulimet arkeologjike është transferimi i sandales si shenjë ligjore e transferimit të të drejtave të trashëgimisë. Një zakon i ngjashëm është gjetur dhe në pllakat e Nuzit. Këto janë pllaka kuneiforme akadiane nga mijëvjeçari i dytë para K., që e quajmë Periudhën Patriarkale.

VII. NJËSITË LETRARE (konteksti)

- A. Familja e Naomit largohet nga gjykimi hyjnor i Izraelit dhe transferohet në Moab, ku i vdesin të gjithë burrat, 1:1-5
- B. Naomi kthehet në Betlehem bashkë me nusen e saj moabite, 1:6-22
- C. Ruthi takohet me Boazin gjatë korrjes së elbit. Ai tregohet i njerëzishëm me të, 2:1-23
- D. Naomi dhe Ruthi bëjnë plan si ta joshin Boazin dhe ia dalin, 3:1-18
- E. Boazi merr nismën që të bëhet *go 'el* për nusen e Naomit, Ruthin, 4:1-22

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Karakteri i perëndishëm i një besimtareje johebreje, 1:16-17;
- B. Karakteri i perëndishëm i grave, izraelite apo johebraike;
- C. Prejardhja e mbretit David dhe mbretit Mesi përman gra të huaja, Mat. 1:5; Luka 3:32, dhe ky ishte plani i Perëndisë.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

- A. Fjalë dhe fraza:
 1. Efratitët, 1:2; 4:11 (NASB & NIV)
 2. Mara, 1:20 (NASB & NIV)
 3. I Plotfuqishmi (*El Shadai*), 1:20 (NASB & NIV)
 4. “nën krahët e të cilit ke ardhur të kërkosh strehim”, 2:12 (NASB & NIV)
 5. efa, 2:17 (NASB & NIV)
 6. kushëriri më i afërt (*go 'el*), 2:20; 3:9; 4:14 (NIV, “kushëriri i ngushtë”)
 7. (martesa levirate), LiP. 25:5-10
 8. “zbuloja këmbët”, 3:4, 7-8, 14 (NASB & NIV)
 9. Një burrë heq sandalen dhe ia jep tjetrit, 4:7 (NASB & NIV)
- B. Persona që duhen identifikuar shkurtimisht:
 1. Elimeleku, 1:2
 2. Jeseu, 4:22

X. VENDNDODHJET NË HARTË (sipas numrave)


1. Moabi 1:1
2. Betlehemi, 1:2

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Cili është qëllimi i këtij libri në kanonin hebraik?
2. Pse u largua kjo familje nga Izraeli?
3. Shpjego lidhjen e fjalës *go'el* me zakonet e martesës levirate.
4. Pse ishte i sikletshëm ky libër për Davidin?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR I & II SAMUELIN

I. EMRI I LIBRIT

A. Thirret sipas protagonistit të tij, Samuelit. Emri i tij do të thotë:

1. “Emri i tij është El”, që kthehet pas në kohën e Shemit,
2. “i kërkoi Elit” (shih 1 Sam. 1:20)

B. Ai ishte:

1. gjyqtar – 1 Sam. 7:6, 15-17
2. profet – 1 Sam. 3:20 (profetët, në fillim, quheshin “shikues”, 1 Sam. 9:9; 1 Kron. 29:29)
3. prift – 1 Sam. 10:8; 16:5

II. KANONIZIMI

A. Kjo është pjesë e ndarjes së dytë të kanonit hebraik, që quhet “Profetët”. Kjo pjesë ndahet në dy nënpjesë:

1. Profetët e hershëm, ku përfshihen Jozueu-Mbretërit (përveç Ruthit)
2. Profetët e mëvonshëm, ku përfshihen Isaia-Malakia (përveç Danielit dhe Vajttimeve)

B. Në fillim, I & II Samueli ishin një libër i vetëm në kanonin hebraik:

1. Baba Bathra 14b (shënimi përmyllës i MT jepet vetëm në fund të 2 Samuelit)
2. Euzebi, *Historia kishtare*, VII:25:2

C. Septuaginta (LXX) e ndau librin në dy pjesë, ndoshta për shkak të gjatësisë. LXX i quajti dhe librat historikë si më poshtë:

1. 1 Samueli – 1 Mbretërive (në Vullgatë, 1 Mbretërve)
2. 2 Samueli – 2 Mbretërive (në Vullgatë, 2 Mbretërve)
3. 1 Mbretërve – 3 Mbretërive (në Vullgatë, 3 Mbretërve)
4. 2 Mbretërve – 4 Mbretërive (në Vullgatë, 4 Mbretërve)

III. GJINIA LETRARE

A. Është kryesisht narrativë historike, me fokus biografik.

B. Kjo do të thotë se regjistron zakone dhe ngjarje historike, që nuk vlejné medoemos për gjithë besimtarët!

C. Nuk është histori perëndimore moderne, por histori e lashtë e Lindjes së Mesme. Fokusohet në ngjarje të përzgjedhura për të komunikuar të vërteta teologjike. Prandaj, është e ngjashme me ungjijtë dhe veprat e DHR. Duhet interpretuar në dritën e: (1) përzgjedhjes; (2) përshtatjes; (3) renditjes dhe (4) frymëzimit.

Gjithsesi, duhet thënë se hebrenjtë dhe hititët ishin historianë tejet të saktë. Popujt e tjerë të lashtë prireshin t’i ekzagjeronin fitoret dhe të linin pa përmendur humbjet.

D. Pasuria e literaturës së Lindjes së Afërt, që tani është e disponueshme për studiuesit për shkak të arkeologjisë moderne, na ka dhënë shumë informacione për gjininë letrare të Samuelit, sidomos për 1 Sam. 15 – 2 Sam. 8. Në veçanti, dokumenti hitit i 1200 para K., i quajtur “Apologji ae Halusitisit”, ka shumë ngjashmëri me Samuelin. Në thelb, ajo është mbrojtje e dinastisë së re, në mënyrë që sundimtari i ri të mos akuzohet se ka uzurpuar fronin e ligjshëm të dikujt tjetër (*Zondervan Pictorial Encyclopedia*, vëll. 5, f. 259-260):

1. thekson ngjarje që çuan te mbreti i ri
2. shpesh, përmban përmbledhje ngjarjesh, jo kronologji strikte
3. tregon qartazi skualifikimin e sundimtarëve të mëparshëm
4. tregon fitoret ushtarake të sundimtarit të ri

5. zbulon popullaritetin në rritje të sundimtarit të ri
6. dokumenton martesat e rëndësishme politike të sundimtarit të ri
7. thekson zellin fetar dhe vetëdijen kombëtare të sundimtarit të ri
8. përmbledh sundimin e mbretit të ri, bashkë me bekimet hyjnore dhe sukseset e tij administrative

IV. AUTORËSIA

- A. Tradita judaike ka pohuar gjithmonë se autori është Samueli:
1. Baba Bathra 14b thotë se Samueli shkroi librin që mban emrin e tij, si dhe Gjyqtarët dhe Ruthin.
 2. Vetë libri pohon se e shkroi Samueli (shih 1 Sam. 10:25 [zakonisht, mendohet se bëhet fjalë për 12-15 kapitujt e parë]).
 3. Studiuesit e mëvonshëm judaikë kanë pranuar se, ashtu si Ligji i Përtërirë dhe Jozueu, edhe ky libër përmend vdekjen e protagonistit të vet, 1 Sam. 25:1; 28:3, dhe përmend ngjarje që ndodhin shumë kohë pas vdekjes së tij. Për këtë arsye, ata sugjerojnë se:
 - a. Ndoshta, librin e përfundoi skribi Seraja, 2 Sam. 8:17
 - b. Ndoshta, librin e përfundoi prifti Abiathar
 - c. Ndoshta, librin e përpiloi Zabudi, biri i profetit Natan (NIV; shih 1 Mbre. 4:5)
- B. Studiuesit e sotëm:
1. pranojnë se përmbajtja e librit vjen nga dëshmitarë okularë të ngjarjeve (Bright).
 2. Pranohet, gjithashtu, se u përdorën këto burime:
 - a. “libri i Jasharit”, 2 Sam. 1:18
 - b. Kronikat e Samuelit, 1 Sam. 10:25; 1 Kron. 29:29
 - c. Kronikat e profetëve Natan dhe Gad, 1 Kron. 29:29
 - d. Kronika të tjera të kohës, 1 Kron. 27:24
 - e. Shumë studiues modernë preferojnë të supozojnë se Samueli, Natani dhe Gadi (1 Kron. 29:29) ishin autorët e tre narrativave, që u kombinuan nga Zabudi, biri i Natanit (1 Mbre. 4:5), i cili kishte dhe leje për të lexuar dokumentat e oborrit mbretëror.
 3. Gjithashtu, ka të dhëna për redaktorë të mëvonshëm pas kohës së Samuelit; këtë e tregon, për shembull, fraza “deri më sot” (shih 1 Sam. 5:5; 6:18; 27:6; 30:25; 2 Sam. 4:3; 6:8; 18:18).
 4. Ka të dhëna që ky redaktor (ose këta redaktorë) jetoi dhe veproi gjatë Monarkisë së Bashkuar, që u nda më 922 para K. (Bright) ose 930 para K. (Harrison & NIV) ose 933 para K. (Young) në dhjetë fiset veriore, që quhej Izrael, Efraim, ose Samari, dhe tre fiset jugore, që quheshin Jude (shih 1 Sam. 11:8; 17:52; 18:16; 27:6; 2 Sam. 5:5; 24:1).
 5. Samueli është shembull i qartë i asaj që studiuesit e sotëm kritikë e konsiderojnë si shenjë të një literature të përbërë:
 - a. Fundi i famljes së Elit si priftërinj:
 - (1) 1 Samuelit 2:31 e më tej
 - (2) 1 Samuelit 3:1 e më tej
 - b. Vajosja e Saulit:
 - (1) E fshehtë, 1 Samuelit 9:26-10:1
 - (2) Publike (dy herë), 1 Samuelit 13:14; 15:23
 - c. Prezantimi i Davidit te Sauli:
 - (1) 1 Samuelit 16:21
 - (2) 1 Samuelit 17:58
 - d. Davidi arratiset nga oborri i Saulit:
 - (1) 1 Samuelit 24:3
 - (2) 1 Samuelit 26:5
 - e. Besëlidhjet e Davidit me Jonathanin:
 - (1) 1 Samuelit 18:3
 - (2) 1 Samuelit 20:16, 42
 - (3) 1 Samuelit 23:18
 - f. Davidi në Gath:
 - (1) 1 Samuelit 21:10
 - (2) 1 Samuelit 27:1

- g. Vrasësi i Goliatit:
 - (1) Davidi - 1 Samuelit 17:51
 - (2) Elhanani – 2 Samuelit 21:19
 - (3) 1 Kron. 20:5 duket se tregon që Goliati dhe i vëllai (Lahmi) përmenden në të njëjtën kohë
 - h. Kursimi i jetës së Saulit:
 - (1) 1 Samuelit 24:3 e më tej
 - (2) 1 Samuelit 26:5 e më tej
 - i. Sa për paralelizmat dhe/ose ngjarjet e dyfishta të supozuara, R. K. Harrison thotë: “Duhet vërejtur sërish se shumë prej mospërputhjeve të supozuara në narrativat biblike janë rezultat i drejtpërdrejtë i leximit të pakujdesshëm, ose, ndonjëherë, i keqinterpretimit të qëllimshëm të tekstit hebraisht... që, në fakt, ekziston vetëm në imagjinatën e kritikut”, *Introduction to the Old Testament*, f. 703.
6. Duhet pranuar se autorësia është e panjohur (E. J. Young); i panjohur është dhe procesi i përpilimit të këtyre librave nga DHV. Gjithsesi, duhet të themi se:
- a. ky proces u udhëhoq nga Perëndia;
 - b. ngjarjet janë vërtet historike, jo të shpikura;
 - c. ngjarjet kanë bosht teologjik.

V. DATA

A. Kur ndodhën ngjarjet

1. 1 Samueli mbulon periudhën kohore nga lindja e Samuelit, 1105 para K. (NIV), deri te vdekja e Saulit, rreth 1011/10 (Harrison & NIV), ose 1013 (Young), ose 1000 (Bright).
2. 2 Samuelit mbulon periudhën kohore, nga vdekja e Saulit (rreth 1011 para K.) deri në fund të mbretërimit të Davidit (971/70 Harrison; 973 Young; 961 Bright). Solomoni e nisi mbretërimin rreth vitit 969 para K.

B. Kur u shkrua libri

1. 1 Samuelit 11:8; 27:6 tregon se të paktën një pjesë e librit, në formën e tanishme, u shkrua pas ndarjes së Monarkisë së Bashkuar më 922 para K., ose 930 para K.
2. Fraza e përsëritur, “deri më sot”, tregon se:
 - a. Një pjesë e librit u shkrua shumë kohë pas ngjarjeve: 1 Sam. 5:5; 6:18; 27:6; 30:25; 2 Sam. 4:3; 6:8; 18:18.
 - b. Burimet që u përdorën e përfshinin tashmë këtë frazë.
3. Një nga problemet datuese për këtë periudhë është teksti i 1 Sam. 13:1, që na jep datat e mbretërimit të Saulit, por që është dëmtuar gjatë transmetimit. Është e qartë se ky numër mungon.

VI. KONTEKSTI HISTORIK

A. 1 Samuelit vazhdon historinë e anarkisë dhe shthurjes morale të periudhës së Gjyqtarëve:

1. mëkati, pushtimi, lutja për falje dhe çlirimtari i Perëndisë karakterizon Gjyq. 1-17
2. tre shembuj shthurjeje morale renditen në Gjyq. 18-21

B. Ishte një kohë kur perandoritë e mëdha të Mesopotamisë dhe Egjiptit nuk ishin ekspansioniste:

1. Egjipti:
 - a. mbreti i fundit etnik egjiptian i Dinastisë XX (1180-1065 para K., Bright) ishte Ramzesi XI
 - b. Dinastia XXI (joegjiptiane), e quajtur “tanite”, ndodhi rreth 1065-935 para K. (Bright)
 - c. Asiria ishte në rënie pas Tiglath-Pileserit I (1118-1078 para K., Bright)

C. Filistinët, në numra të mëdha (popujt e detit Egje), u përpoqën ta pushtonin Egjiptin rreth 1300 para K., por u mposhtën. U vendosën në cepin jugperëndimor të Palestinës rreth 1250 para K. Ata e kishin zhvilluar teknologjinë e epokës së hekurit nga hititët dhe ia dolën që të vendoseshin në një rreth prej pesë qytetesh: Ashkelon, Ashdod, Ekron, Gath dhe Gaza. Organizoheshin si qytet-shtetet greke, secili me mbretin e vet. U bënë armiku kryesor i izraelitëve në kohën e hershme të mbretërisë.

VII. NJËSITË LETRARE (kontekstet)

A. Përvijim i shkurtër i karaktereve kryesore:

1. Eli dhe Samueli, 1 Sam. 1-7
2. Samueli dhe Sauli, 1 Sam. 8-15
3. Sauli dhe Davidi, 1 Sam. 16 – 2 Sam. 1
4. Mbretërimi i Davidit, 2 Sam. 2-12
5. Davidi dhe pasardhësit, 2 Sam. 13-20
6. Çështje të ndryshme për Davidin dhe mbretërimin e tij, 2 Sam. 21-24

B. I & II Samuelit duket se është përvijuar nga autori/redaktori me anë të disa pohimeve përmbledhëse:

1. I Samuelit 7:15-17
2. I Samuelit 14:49-51
3. II Samuelit 8:15-18
4. II Samuelit 20:23-26

C. Përvijim i hollësishëm:

1. Shih R. K. Harrison, *Introduction to the Old Testament*, f. 695-696
2. Shih E. J. Young, *An Introduction to the Old Testament*, f. 180-187
3. Shih NIV Study Bible, f. 373 dhe 422

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

A. Samueli përgatit skenën për formimin e monarkisë, ashtu si Moisiu përgatiti skenën për formimin e kombit:

1. Moisiu paratha se Izraeli do të kishte një mbret në LiP. 17:14-20, ku përshkruan se çfarë duhet, ose s' duhet, të bëjë mbreti i drejtë.
2. Ka një tension në 1 Samueli për mbretin:
 - a. aspektet negative:
 - (1) kombi refuzoi JHVH-në si mbret, 1 Sam. 8:7; 10:19
 - (2) kërkuan një mbret “si kombet përreth”, 1 Sam. 8:5; 12:19-20
 - (3) kjo gjë e mërziti Samuelin; u ndie personalisht i refuzuar, 1 Sam. 8:6
 - b. aspektet pozitive:
 - (1) JHVH përbushi profecinë e tij në Ligjin e Përtërirë duke u dhënë mbret, 1 Sam. 8:7, 9, 22, “dëgjo zërin e popullit”
 - (2) tregoji mbretit të ri udhëzimet e perëndishme, 1 Sam. 8:9 (LiP. 17:14-20)
 - (3) mbreti do ta çlirojë popullin, 1 Sam. 9:16 (ashtu si gjyqtarët, kur erdhën si përgjigje e lutjeve të popullit, shih 1 Sam. 12:13)

B. Samueli tregon kalimin e fuqisë shpirtërore nga kryepriifti dhe tabernakulli te folësi i ri profetik. Kjo, ndoshta, vjen si përgjigje e:

1. gjykimin të Perëndisë mbi Elin dhe familjen e tij, 1 Sam. 2:22-3:18
2. nevojë për një drejtpeshim mes formës dhe ritualit të priftërinjve dhe fokusit të profetëve tek besimi i ndier personal
3. si priftërinjtë, ashtu dhe profetët, janë ndërmjetës të besëlidhjes për popullin në tërësi
4. Samueli dëgjonte Samuelin, ndërsa Davidi dëgjonte Natanin dhe Gadin, për të vërtetuar vullnetin e Perëndisë

C. II Samuelit tregon:

1. mirësinë e Perëndisë ndaj Davidit
2. forcat dhe dobësitë e Davidit
3. gjykimin e Perëndisë mbi Davidin për shkak të mëkatit të tij dhe efektet e atij mëkati mbi:
 - a. kombin
 - b. familjen e Uriahut
 - c. fëmijën e Bathshebës

d. fëmijët e Davidit

D. I & II Samuelit vijon historinë e popullit të Perëndisë, që nisi në Zanafillë.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe fraza:

1. I Samuelit:

- a. efod liri, 2:18, 28 (NASB & NIV)
- b. “briri im është lartësuar”, 2:1, 10 (NASB & NIV)
- c. “nga Dani në Beershebë”, 3:20 (NASB & NIV)
- d. “ZOTI i ushtrive, që rri ulur mbi kerubimët”, 4:4 (NIV, “ZOTI i plotfuqishëm, që e ka fronin mes kerubinëve”)
- e. “secili burrë në çadrën e vet”, 4:10 (NASB & NIV)
- f. Hemorroide të florinjta, 6:4 (NIV, “ulcera të arta”)
- g. Ebenezer, 7:12 (NASB & NIV)
- h. “njeri sipas zemrës së Perëndisë”, 13:14 (NASB & NIV)
- i. “nuk gjendej asnjë kovaç në gjithë vendin e Izraelit”, 13:19 (NASB & NIV)
- j. “bindja është më mirë se flijimi”, 15:22 (NASB & NIV)
- k. “ZOTI u pendua...” 15:35 (NIV, “... u hidhërua”)
- l. “një frymë e ligë nga ZOTI e tmerronte”, 16:14 (NIV, “torturonte”)
- m. “pështyma e tij le t’i zbresë te mjekra” 21:13 (NASB & NIV)

2. II Samuelit:

- a. libri i Jasharit, 1:18 (NASB & NIV)
- b. Milo, 5:9 (NIV, “nga tarracat mbështetëse”)
- c. ua preu leqet e këmbëve, 8:4 (NASB & NIV)

B. Persona që duhen identifikuar shkurtimisht:

1. I Samuelit:

- a. Hana, 1:1
- b. Hofni & Finaes, 1:3
- c. Ikabod, 4:21
- d. Kish, 9:1
- e. Jonathan, 14:1; 19:1
- f. Mikal, 14:49
- g. Abner, 14:50
- h. Goliath, 17:4
- i. Doeg, 21:7
- j. Abiathar, 22:20
- k. Shtirga e En-dorit, 28:7 (NIV, “magjistarja... në Endor”)
- l. Abigail, 30:5

2. II Samuelit:

- a. Ish-bosheth, 2:8
- b. Joab, 2:13
- c. Amnon, 3:2
- d. Absalom, 3:3
- e. Adonija, 3:4
- f. Mefibosheth, 4:4
- g. Uza, 6:3
- h. Uriah, 11:3
- i. Tamara, 13:5
- j. Cadok, 15:24
- k. Shimei, 16:5

X. VENDNDODHJET NË HARTË (sipas numrave)

A. 1 Samuelit:

1. Kiriath-jearim, 6:21
2. Rama, 7:17
3. Beersheba, 8:2
4. Jabesh-gilead, 11:1
5. Shpella e Adulamit, 22:1
6. Nob, 21:1
7. Engedi, 23:29
8. Ciklag, 30:1
9. Mali Gilboa, 31:8

B. 2 Samuelit:

1. Ashkelon, 1:20
2. Hebron, 2:3
3. Jezreel, 2:9
4. Gezer, 5:25
5. Damask, 8:5
6. Raba, 12:27
7. Tekoa, 14:2
8. Lëmi i shirjes së Araunah jebusitit, 24:16 (Jerusalem)

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

A. I SAMUELIT:


1. Pse regjistrohet lindja e Samuelit, dhe jo ajo e Saulit ose Davidit?
2. Pse e refuzoi Perëndia Elin dhe familjen e tij?
3. Pse e çuan arkën në betejë Finea dhe Hofni?
4. Pse u zemërua Samueli që populli i kërkoi mbret?
5. Pse u hodh poshtë Sauli si mbret?
6. Shpjego “frymë e ligë nga ZOTI”.
7. Pse u përpoq Sauli ta vriste Davidin?
8. Pse e vizitoi Sauli shtrigën e En-Dorit?
9. Si vdiq Sauli?

B. II SAMUELIT:

1. Pse u zemërua Davidi nga vdekja e Ish-boshethit?
2. Pse u zemërua Davidi nga vdekja e Abnerit?
3. Pse e ndihmoi Davidi Mefiboshethin?
4. Pse e vrau Perëndia Uzën?
5. Pse janë kaq të rëndësishme premtimet e Perëndisë ndaj Davidit në kapitullin 7?
6. Si ndikoi mëkati i Davidit me Bathshebën në familjen e tij?
7. Shpjego dallimin mes Cadokut dhe Abiatharit.
8. Pse ishte i zemëruar Perëndia nga fakti që Davidi numëroi popullin?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



HYRJE PËR I & II MBRETËRVE

I. EMRI I LIBRIT

- A. Ashtu si I & II Samuelit dhe I & II Kronikave, I & II Mbretërve, në fillim, ishte një libër i vetëm në hebraisht. Quhej “*Malekim*”, ose Mbretërit. Këtë titull e mori nga fakti se mbulon historinë e mbretërve të Judës dhe Izraelit.
- B. Ashtu si I & II Samuelit dhe I & II Kronikave, I & II Mbretërve u nda së pari në dy libra nga LXX. Me sa duket, kjo u bë për shkak të gjatësisë së këtyre librave. Nuk përmbaheshin dot brenda një rrotulle të vetme pergameni për shkak të peshës dhe madhësisë së lëkurës. Teksti i parë hebraisht që e ndan këtë libër në dy shfaqet vetëm pas vitit 1448 pas K.
- C. Titulli i këtyre dy librave ishte:
1. në hebraisht – “Mbretërve”
 2. në LXX – III & IV Mbretërive
 3. në Vullgatë – III & IV Mbretërve (I & II Samuelit ishte I & II Mbretërive ose Mbretërve)

II. KANONIZIMI

- A. Këta libra janë pjesë e ndarjes së dytë të kanonit hebraik, që quhet “Profetët”.
- B. Kjo pjesë ndahet në dy nënpjesë:
1. Profetët e hershem, që përfshin Jozueu-Mbretërve, përveç Ruthi,
 2. Profetët e mëvonshëm, që përfshin Isaia-Malakia, përveç Danielit dhe Vajtimeve.
- C. Lista e librave në DHV hebraisht mund të jetë ndikuar nga misticizmi hebraik. Alfabeti hebraisht ka 22 shkronja. Kur librat kombinohen me njëri-tjetrin, bëhen 22 të tillë:
1. Gjyqtarëve dhe Ruthi
 2. Samueli
 3. Mbretërve
 4. Kronikat
 5. Ezra-Nehemia
 6. Jeremia dhe Vajtimet
 7. Dymbëdhjetë Profetët e Vegjël.

III. GJINIA LETRARE

- A. Këta libra, në thelb, janë narrativë historike me citime të shpeshta nga:
1. dokumentet e oborrit mbretëror
 2. profetët
- B. Kur i krahasojmë librat e Samuelit, Mbretërve dhe Kronikave me njëri-tjetrin, shfaqen lloj të ndryshme narrativash historike:
1. Samueli ka thelb biografik. Përqendrohet në personazhet kryesore të:
 - a. Samuelit
 - b. Saulit
 - c. Davidit
 2. Në thelb, Mbretërve është përpilim:
 - a. i dokumentave të oborrit mbretëror:
 - (1) “libri i Kronikave të Solomonit”, 1 Mbre. 11:41
 - (2) “libri i kronikave të mbretërve të Judës”, 1 Mbre. 14:29; 15:7, 23
 - (3) “libri i kronikave të mbretërve të Izraelit”, 1 Mbre. 14:19; 15:31.
 - b. i materialeve profetike:
 - (1) Elia

- (2) Elizeu
- (3) Isaia (kap. 36-39)
- (4) Shenjat e burimeve profetike dhe historike mund të shihen qartazi në Kronikat:
 - (a) 1 Kronikat 29:29
 - (b) 2 Kronikat 9:29
 - (c) 2 Kronikat 12:15
 - (d) 2 Kronikat 13:22
 - (e) 2 Kronikat 26:22
- 3. Kronikat, në thelb, është paraqitje e përzgjedhur dhe teologjikisht pozitive e mbretërve të:
 - a. Monarkisë së Bashkuar.
 - b. Mbretërve të Judës.

IV. AUTORËSIA

- A. Bibla është e heshtur për autorësinë e I & II Mbretërve, si dhe për shumicën e librave që bëjnë pjesë në Profetët e hershëm.
- B. Baba Bathra 15a thotë se Jeremia shkroi këtë libër, si dhe Mbretërve dhe Vajtimet:
 - 1. Kjo është e mundshme për shkak të fundit të 2 Mbretërve 24:18-25:30, që në hebraisht është shumë i ngjashëm me Jeremian 52.
 - 2. Është e qartë se autori ishte dëshmitar okular i rënies së Jerusalemit.
- C. Në të vërtetë, këta libra janë vepër e një përpiluesi, jo e një autori.
- D. Po kështu, duhet thënë se përpiluesi përdori disa burime:
 - 1. Burimi i parë ishte Shkrimi. Ai citon ose aludon shpesh për Ligjin e Përtërirë dhe disa nga profetët.
 - 2. Përmenden shkoqur një sërë burimesh me shkrim:
 - a. “Libri i Veprave të Solomonit”, 1 Mbre. 11:41
 - b. “Libri i Kronikave të Mbretërve të Judës”, 1 Mbre. 14:29; 15:7, 23
 - c. “Libri i Kronikave të Mbretërve të Izraelit”, 1 Mbre. 14:19; 15:31
 - d. Te 1 Kron. 29:29 përmenden dhe shkrimet e profetëve Samuel, Natan dhe Gad. Kjo tregon se traditat gojore po hidheshin me shkrim.
- E. 1 & 2 Mbretërve përmban disa shtesa redaktoriale, ose përpiluesi citon frazën “deri më sot” nga burimet e tij:
 - 1. 1 Mbre. 8:8
 - 2. 1 Mbre. 9:21
 - 3. 1 Mbre. 12:19
 - 4. 2 Mbre. 8:22

V. DATA

- A. Ngjarjet e librit mbulojnë një periudhë kohore:
 - 1. Nga vdekja e Davidit deri në fillimin e mbretërimit të Solomonit:
 - a. Bright – 961 para K.
 - b. Harrison – 971/970 para K.
 - c. Young – 973 para K.
 - d. NIV – 970 para K.
 - 2. Deri në mbretërimin e mbretit babilonas Evil-Merodak, i njohur edhe si Amel-Marduk, 562-560 para K. (Bright)
 - 3. Por libri i 2 Mbretërve nuk e përmend mbretin medo-pers Kirin “e Madh”, ushtria e të cilit shkatërroi qytetin e Babilonisë më 539 para K.
- B. Libri u shkrua, ose u përpilua dikur gjatë (ose pak kohë pas) Robërisë Babilonase.

- C. Kohëzgjatja e viteve të mbretërimeve të Mbretërve, nëse i bëhet shuma, del tepër e gjatë për t'iu përputhur kornizës kohore të këtyre librave. Janë dhënë disa zgjidhje të hamendësuar:
1. Numrat e renditur nuk marrin parasysh periudhat e bashkëmbretërimeve.
 2. Përdoren dy kalendarë:
 - a. Kalendar i shenjtë fillonte në vjeshtë.
 - b. Kalendar fetar fillonte në pranverë.
 3. Kur krahasohen me njëra-tjetrën shifrat e Mbretërve me ato të Kronikave, është e qartë se kemi të bëjmë dhe me disa gabime të kopjuesve të dorëshkrimeve.

VI. BURIME QË MBËSHTESIN KONTEKSTIN HISTORIK

- A. Të dhënat arkeologjike:
1. Shtylla e Meshës, e njohur edhe si Guri Moabit, përmend kryengritjen e Meshës, mbretit të Moabit, kundër Izraelit pak kohë pas mbretit Omri (876-869 para K., Bright; 874/3 para K., Harrison [shih 2 Mbre. 3:4]).
 2. Obelisku i Zi i mbretit asirian, Shalmaneser III (859-824 para K., Bright & Harrison):
 - a. Beteja e Karkarit më 853 para K. ndodhi në lumin Oront. Të dhënat e marra nga Obelisku i Zi i Shalmaneserit III përmendin Ahab izraelitin dhe thonë se ai kishte një forcë të fuqishme ushtarake (bashkë me Sirinë, shih 1 Mbre. 22:1). Kjo betejë nuk përmendet në DHV.
 - b. Obelisku tregon mbretin tjetër të Izraelit, Jehun (842-815 para K., Bright [shih 2 Mbre. 9-10]), duke i sjellë haraçin Asirisë dhe duke i shprehur vasalitetin e vet. Edhe kjo nuk përmendet në DHV.
 3. Një vulë jasperi, e gjetur në Megido dhe që daton nga koha e Jeroboamit II (786-746 para K., Bright; 782-753 para K., Harrison), përmend Jeroboamin.
 4. Kronikat e Korsabadit përshkruajnë mbretërimin dhe rënien e Samarisë në dorë të Sargonit II (722-705 para K.) më 722 para K. (shih 2 Mbre. 17).
 5. Rrëfimi që i bën Senakeribi rrethimit të Jerusalemit më 701 para K. gjatë mbretërimit të Hezekisë (715-687 para K., Bright [shih 2 Mbre. 18:13-19:17, Isa. 36-39]).
 6. Duke përdorur datat e përkruara (dokumentet asiriane dhe DHV) të (1) betejës së Karkarit (Shalmaneseri III kundër Izraelit dhe Sirisë) 853 para K.; dhe (2) eklipsit diellor (lista e eponimeve asiriane, Ishdi-Sagale, 763 para K.); (3) pagimin e heraçit që Jehu ia dha Shalmaneserit III (841 para K.); mund të vërtetohen datat e ngjarjeve në librin e Mbretërve.
- B. Një vështrim i shkurtër historik i fuqive kryesore në Mesopotami (duke përdorur datat që, kryesisht, bazohen në librin e John Bright, *A History of Israel*, f. 462 e më tej):
1. Perandoria asiriane (Zan. 10:11):
 - a. Feja dhe kultura u ndikuan së tepërmi nga perandoria sumere/babilonase.
 - b. Lista e përafërt e sundimtarëve dhe datave të përafërta:
 - (1) 1354-1318, Ashur-Ubaliti I:
 - (a) Pushtoi qytetin hitit të Karkemishit
 - (b) Filloi ta largonte ndikimin hitit dhe lejoi zhvillimin e Asirisë
 - (c) 1297-1266 Ada-Nirari I (mbret i fuqishëm)
 - (d) 1265-1235 Shalmaneseri I (mbret i fuqishëm)
 - (e) 1234-1197 Tukulti-Ninurta I
 - Fushata e parë pushtuese e perandorisë babilonase në jug
 - (5) 1118-1078 Tiglath-Pileser I
 - Asiria bëhet fuqi e madhe në Mesopotami
 - (6) 1012-972 Ashur-Rabi II
 - (7) 972-967 Ashur-Resh-Isui II
 - (8) 966-934 Tiglath-Pileseri II
 - (9) 934- 912 Ashur-Dan II
 - (10) 912- 890 Adad-Nirari II
 - (11) 890- 884 Tukulti-Ninurta II
 - (12) 883- 859 Asshur-Nasir-Apal II

- (13) 859- 824 Shalmaneser III (beteja e Karkarit më 853)
- (14) 824-811 Shamashi-Adad V
- (15) 811-783 Adad-Nirari III
- (16) 781-772 Shalmaneser IV
- (17) 772-754 Ashur-Dan III
- (18) 754-745 Ashur-Nirari V
- (19) 745-727 Tiglath-Pileser III
 - (a) i thirrur me emrin e fronit babilonas, Pul, në 2 Mbre. 15:19
 - (b) mbret shumë i fuqishëm
 - (c) nisi politikën e deportimit të popujve të pushtuar
 - (d) më 735 para K., u bë formimi i “Lidhjes siro-efraimite”, që ishte përpjekje për të bashkuar të gjitha burimet e disponueshme ushtarake të kombeve përtej Jordanit, nga burimet e lumit Euftrat deri në Egjipt, më qëllim që të asgjësonin fuqinë ushtarake në rritje të Asirisë. Mbreti Ahaz i Judës nuk pranoi që t’i bashkohej kësaj aleance, ndaj Izraeli dhe Siria e pushtuan. Ai i shkroi për Tiglath-Pileserit III për ndihmë, kundër këshillës së Isaisë (shih 2 Mbre. 16; Isa. 7-12).
 - (e) Më 732, Tiglath-Pileseri III pushton Sirinë dhe Izraelin, dhe vendos një mbret vasal në fronin e Izraeli, Hozean (732-722). Mijëra judenj nga Mbretëria Veriore dërgohën robër në Medi (shih 2 Mbre. 15).
- (20) 727-722 Shalmaneseri V
 - (a) Hozea bën aleancë me Egjiptin dhe pushtohet nga Asiria (2 Mbre. 17)
 - (b) Rrethoi Samarinë më 724 para K.
- (21) 722-705 Sargoni II:
 - (a) Pas një rrethimi trevjeçar, që nisi nga Shalmaneseri V, pasuesi i tij, Sargoni II, pushton kryeqytetin e Izraelit, Samarinë. Mbi 27,000 izraelitë deportohen në Medi.
 - (b) Pushtohet dhe perandoria hitite.
 - (c) Më 714-711, një tjetër koalicion mes kombeve të përtej-Jordanit dhe Egjiptit bën kryengritje kundër Asirisë. Ky koalicion njihet si “Kryengritja e Ashdadit”. Edhe Hezekia i Judës u përfshi në fillim në të. Asiria i pushtoi dhe shkatërroi një sërë qytetesh filistinase.
- (22) 705-681, Senakeribi:
 - (a) Më 705, bëri kryengritje një tjetër koalicion i kombeve të përtej-Jordanit dhe Egjiptit pas vdekjes së Sargonit II. Hezekia e mbështeti plotësisht kryengritjen. Senakeribi i pushtoi më 701. Kryengritja u shtyp, por Jerusalemi u kursye nga një akt hyjnor (shih Isa. 36-39, dhe 2 Mbre. 18-19).
 - (b) Senakeribi shtypi dhe kryengritjet në Elam dhe Babiloni.
- (23) 681-669, Esarhadoni:
 - (a) Sundimtari i parë asirian që sulmoi dhe pushtoi Egjipin
 - (b) E pëlqente së tepërmi Babiloninë dhe ia rindërtoi kryeqytetin
- (24) 669-663, Ashurbanipali:
 - (a) i quajtur dhe Osnapar, në Ezra 4:10
 - (b) vëllai i tij, Shamash-shum-ukin u bë mbret i Babilonisë. Kjo solli disa vite paqeje mes Asirisë dhe Babilonisë, por pati një lloj përpjekjeje të fshehtë pavarësia, që shpërtheu hapur më 652, dhe që e udhëhiqte vëllai i tij.
 - (c) Rënia e Tebës, 663 para K.
 - (d) Mposhti Elamin, 653, 645 para K.
- (25) 633-629 Ashur-Etil-Ilani
- (26) 629-612 Sin-Shar-Ishkun
- (27) 612-609 Ashur-Ubaliti II:
 - u shpall mbret në syrgjyn, në Haran, pas rënies së Asherit më 614 para K. dhe Ninivesë më 612 para K.

2. Perandoria neobabilonase:

- a. 703-? Merodak-Baladani
 - nisi një sërë kryengritjesh kundër sundimit asirian
- b. 652, Shamash-shum-ukin:

- (1) I biri i Esarhadonit dhe vëllai i Ashurbanipalit
 (2) Nisi një kryengritje kundër Asirisë, por u mposht
- c. 626-605 Nabopolasari:
- (1) Ishte monarku i parë i perandorisë neobabilonase
 (2) Sulmoi Asirinë nga jugu, ndërsa Kiaksari i Medisë e sulmoi nga verilindja
 (3) Kryeqyteti i vjetër asirian i Ashurit ra më 614, ndërsa kryeqyteti i ri dhe i fuqishëm i Ninivesë ra më 612 para K.
 (4) Pjesa e mbetur e ushtrisë asiriane u tërhoq në Haran. Madje, caktuan dhe një mbret.
 (5) Më 608, faraoni Neko II (shih 2 Mbre. 23:29) marshoi për në veri për t'i ardhur në ndihmë pjesës së mbetur të ushtrisë asiriane me qëllim që të formonte një zonë sigurie kundër fuqisë në rritje të Babilonisë. Josia, mbreti i perëndishëm i Judës (shih 2 Mbre. 23), iu kundërvu lëvizjes së ushtrisë egjiptiane përmes Palestinës. U krye një ndërluftim i shkurtër në Megido. Josia u plagos dhe vdiq (2 Mbre. 23:29-30). Biri i tij, Jehoahazi, u bë mbret. Faraoni Neko II mbërriti tepër vonë për ta ndaluar shfarosjen e forcave asiriane në Haran. U ndesh me forcat babilonase, të komanduara nga princi i kurorës Nebukadnecari II, dhe pësoi humbje të rëndë më 605 para K. në Karkemish, në lumin Euftrat.
 Gjatë kthimit në Egjipt, ndaloi në Jerusalem dhe plaçkiti qytetin. E zëvendësoi dhe e deportoi Jehoahazin pas vetëm tre muajsh. Vendosi një tjetër bir të Josias, Jehoiakimi, në fron (shih 2 Mbre. 23:31-35).
- (6) Nebukadnecari II e ndoqi ushtrinë egjiptiane në jug mespërmes Palestinës, por i çuan fjalë për vdekjen e të atit dhe u kthye në Babiloni.
 Më vonë, atë vit, u kthye sërish në Palestinë. La Jehoiakimin në fronin e Judës, por çoi në robëri mijëra krerë të Izraelit dhe shumë anëtarë të familjes mbretërore. Danieli dhe shokët e tij ishin pjesë e këtyre të deportuarve.
- d. 605-562 Nebukadnecari II:
- (1) Nga 597-538, Babilonia kishte plotësisht nën kontroll Palestinën.
 (2) Më 597 ndodhi një tjetër dëbim nga Jerusalemi për shkak të aleancës së Jehoiakimit me Egjiptin (2 Mbre. 24). Ai vdiq përpara mbërritjes së Nebukadnecarit II. I biri i tij, Jehoiakini, qëndroi mbret vetëm për tre muaj, pastaj u dërgua rob në Babiloni. Dhjetë mijë shtetas, përfshi Ezekielin, u rivendosën pranë qytetit të Babilonisë përbri kanalit të Kebarit.
 (3) Më 586, pas flirtimeve të vazhdueshme me Egjiptin, qyteti i Jerusalemit u shkatërrua plotësisht (2 Mbre. 25) dhe ndodhi një tjetër deportim masiv. Zedekia, që zëvendësoi Jehoiakinin, u çua në robëri dhe guvernator u caktua Gedaliahu.
 (4) Gedaliahu u vra nga forcat ushtarake rebele të judenjve. Këto forca u arratisan në Egjipt dhe detyruan Jeremian që të shkonte me ta. Nebukadnecari i pushtoi për herë të katërt (605, 596, 586, 582) dhe deportoi gjithë judenjtë e mbetur që mundi të gjente.
- e. 562-560 Evil-Merodak, i njohur dhe si Amel-marduk
 - Liroi Jehoiakimin nga burgun, por u detyrua të qëndronte në Babiloni (shih 2 Mbre. 25:27-30; Jer. 52:31)
- f. 560-556 Neriglisari
 - Ishte gjenerali i Nebukadnecarit që shkatërroi Jerusalemin.
- g. 556-? Labaski Marduk
 - Ishte biri i Neriglisarit, por e vranë pas nëntë muajsh.
- h. 556-539 Nabonidi:
- (1) Nabonidi nuk kishte lidhje gjaku me familjen mbretërore, kështu që u martua me një bijë të Nebukadnecarit II.
 (2) Shumicën e kohës e kaloi duke ndërtuar një tempull kushtuar perëndisë së hënës, "Sin", në Temë. Ishte biri i kryepriftëresësh së kësaj perëndeshe. Kjo bëri që priftërinjtë e Mardukut, perëndisë kryesore të Babilonisë, ta urrenin.
 (3) Ai e kaloi shumicën e kohës së vet në përpjekje për të shtypur kryengritjet dhe për të stabilizuar mbretërinë e vet.
 (4) U transferua në Temë dhe ia la punët në dorë të birit, Belshacarit, në kryeqytet, Babiloni (shih Dan. 5).
- i. ? – 539 Belshacar (bashkë-mbretërues)

- Qyteti i Babilonisë ra shumë shpejt në dorë të ushtrisë perse nën Gobrjasin e Gutiumit, i cili ia zhvendosi shtratin uji të Eufratit dhe hyri në qytet pa rezistencë. Priftërinjtë dhe populli i qytetit i panë persët si çlirimtarë dhe si rimëkëmbës të Mardukut. Gobrjasi u bë guvernator i Babilonisë nga Kiri II. Gobrjasi mund të ketë qenë medi Dar i Dan. 5:31; 6:1; “Dar” do të thotë “mbretërori”.
- 3. Perandoria medo-perse: vështrim i shpejtë i ngritjes së Kirit II (Isa. 44:28; 45:1-7):
 - a. 625-585 Kiaksari ishte mbreti i Medisë që ndihmoi Babiloninë të mposhte Asirinë.
 - b. 585-550 Astjagi ishte mbreti i Medisë. Kiri ishte nipi i tij nga Mandani.
 - c. 550-530 Kiri II i Anshamit ishte një mbret vasal, që ngriti krye:
 - (1) Nabonidi, mbreti babilonas, mbështeti Kirin.
 - (2) Kiri II hoqi nga fronti Astjagin.
 - (3) me qëllim që të rikthente ekuilibrin e pushtetit, Nabonidi bëri aleancë me:
 - (a) Egjiptin
 - (b) Kroesin, mbretin e Lidisë (Azia e Vogël)
 - (4) 547 – Kiri II marshoi kundër Sardit (kryeqyteti i Lidisë)
 - (5) 539- më 2 nëntor, Gobrjasi i Gutiumit, bashkë me ushtrinë e Kirit, e mori Babiloninë pa rezistencë. Gobrjasi u bë guvernator i Babilonisë.
 - (6) 539 – në tetor, Kiri II “i Madh” hyri personalisht si çlirimtar. Politika mirëdashëse e tij ndaj grup-kombeve u dha fund viteve të deportimit si politikë kombëtare.
 - (7) 538 – judenjtë dhe të tjerët u lejuan të ktheheshin në vendet e tyre dhe të rindërtonin tempujt e tyre.
 - (8) 530 – biri i Kirit, Kambisi II, trashëgoi fronin e të atit.
 - d. 530-522 mbretërimi i Kambisit II
 - (1) I shtoi perëndorisë medo-perse perandorinë egjiptiane më 525 para K.;
 - (2) Patë mbretërim të shkurtër;
 - (a) Disa thonë se kreu vetëvrasje;
 - (b) Herodoti thotë se preu veten me shpatë ndërsa kalëronte dhe vdiq nga infeksioni.
 - (3) Mbretërimi i shkurtër i Pseudo-Smerdit – 522
 - e. 522-486 erdhi në pushtet Dari I (Histapi)
 - (1) Nuk kishte prejardhje mbretërore, por qe gjeneral ushtarak.
 - (2) E organizoi perandorinë perse duke përdorur planet e Kirit për satrapët (shih Ezra 1-6; Hagai; Zakaria).
 - (3) Bëri monedha të reja, si ato për Lidiën.
 - f. 486-465 mbretërimi i Kserksit I:
 - (1) Shtypi kryengritjen egjiptiane
 - (2) Synonte të pushtonte Greqinë dhe të përmbushte ëndrrën perse, por u mposht në betejën e Termopileve më 480 para K., dhe në Salaminë më 479 para K.
 - (3) Burri i Esterit, që në Bibël quhet Ahasuer, u vra më 465 para K.
 - g. 465-424 mbretërimi i Artakserksit I (Longimanus) (shih Ezra 7-10; Nehemia; Malakia):
 - (1) Grektë vijuan përparimin dërsa u përballën me luftrat civile të Peloponezitet
 - (2) Greqia ndahet (athenase – peloponeziane)
 - (3) Luftrat civile greke zgjatën rreth 20 vjet
 - (4) Gjatë kësaj periudhe, komuniteti judaik u përforcua
 - (5) Mbretërimi i shkurtër i Kserksit II dhe Sekidianit – 423
 - h. 423-404 mbretërimi i Darit II (Nothos)
 - i. 404-358 mbretërimi i Artakserksit II (Mnemon)
 - j. 358-338 mbretërimi i Artakserksit III (Okos)
 - k. 338-336 mbretërimi i Arsit
 - l. 336-331 mbretërimi i Darit III (Kodomanus)
- 4. Vështrim i përgjithshëm i Egjiptit:
 - a. Hiksos (mbretërit-barinj – sundimtarë semitë) – 1720/10-1550
 - b. Dinastia e 18-52 (1570-1310):
 - (1) 1570-1546 Amosis
 - (a) Bëri kryeqytet Tebën
 - (b) Pushtoi Kananin jugor

- (2) 1546-1525 Amenofis I (Amenhotep I)
- (3) 1525-1494 Tutmozi I
- (4) 1494-1490 Tutmozi II – u martua me të bijën e Tutmozit I, Hatshepsutin
- (5) 1490-1435 Tutmozi III (nipi i Hatshepsutit)
- (6) 1435-1414 Amenofisi II (Amenhotepi II)
- (7) 1414-1406 Tutmozi IV
- (8) 1406-1370 Amenofisi III (Amenhotepi III)
- (9) 1370-1353 Amenofisi IV (Akhenaten)
 - (a) Adhuronte Diellin, Aten
 - (b) Urdhëroi një formë adhurimi të perëndisë së lartë (monoteizëm)
 - (c) Letrat e Tel-El-Amarnës vijnë nga kjo periudhë
- (10) ? Smenkhare
- (11) ? Tutankhamuni (Tutankhaten)
- (12) ? Aj (Aj-Aj)
- (13) 1340-1310 Haremhabi
- c. Dinastia e 19-të (1310-1200):
 - (1) ? Ramzesi I (Ramzesi)
 - (2) 1309-1290 Seti I (Sethos)
 - (3) 1290-1224 Ramzesi II (Ramzi II)
 - (a) Nga të dhënat arkeologjike, ka shumë gjasa që ky të jetë faraoni i Eksodit
 - (b) Ndërtoi qytetet e Avarit, Pitomit dhe Ramzit me anë të skllëvërve habaru (ndoshta, semitë ose hebrej)
 - (4) 1224-1216 Marnipta (Merenpta)
 - (5) ? Amenmeses
 - (6) ? Seti II
 - (7) ? Sipta
 - (8) Tevosret
- d. Dinastia e 20-të (1180-1065):
 - (1) 1175-1144 Ramzesi III
 - (2) 1144-1065 Ramzesi IV-XI
- e. Dinastia e 21-të (1065-935):
 - (1) ? Smendi
 - (2) ? Herihori
- f. Dinastia e 22-të (935-725 – libiane):
 - (1) 935-914 Shishak (Shosenk I ose Sheshong I)
 - (a) Mbrojti Jeroboamin I deri në vdekjen e Solomonit
 - (b) Pushtoi Palestinën rreth 925 para K. (shih 1 Mbre. 14-25; 2 Kro. 12)
 - (2) 914-874 Osorkon I
 - (3) ? Osorkon II
 - (4) ? Shoshenk II
- g. Dinastia e 23-të (759-715 – libiane)
- h. Dinastia e 24-të (725-709)
- i. Dinastia e 25-të (716/15-66 – etiopian/nubiane):
 - (1) 710/09-696/95 Shabako (Shabaku)
 - (2) 696/95-685/84 Shebtkeo (Shebitku)
 - (3) 690/689, 865/84-664 Tirhaka (Taharka)
 - (4) ? Tantamun
- j. Dinastia e 26-të (663-525 – saitike):
 - (1) 663-609 Psametiku I (Psamtiku)
 - (2) 609-593 Neko II (Neko)
 - (3) 593-588 Psametiku II (Psamtiku)
 - (4) 588-569 Apries (Hofra)
 - (5) 569-525 Amasi
 - (6) ? Psametiku III (Psamtiku)
- k. Dinastia e 27-të (525-401 – perse):

- (1) 530-522 Kambisi II (biri i Kirit II)
- (2) 522-486 Dari I
- (3) 486-465 Kserksi I
- (4) 465-424 Artakserksi I
- (5) 423-404 Dari II

* për një kronologji ndryshe, shih *Zondervan's Pictorial Bible Encyclopedia*, vëll. 2, f. 231.

5. Vështrim i përgjithshëm i Greqisë:
 - a. 359-336 Filipi II i Maqedonisë:
 - (1) Ndërtoi Greqinë
 - (2) U vra më 336 para K.
 - b. 336-323 Aleksandri II “i Madh” (biri i Filipit):
 - (1) Mposhti Darin II, mbretin pers, në betejën e Isusit
 - (2) Vdiq nga ethet më 323 para K. në Babiloni; ishte 32/33 vjeç
 - (3) Gjeneralët e Aleksandrit e ndanë perandorinë e tij pas vdekjes:
 - (a) Kasandri – Maqedoni dhe Greqi
 - (b) Lisiniku – Thrakë
 - (c) Seleuku I – Siri dhe Palestinë
 - (d) Antigoni – Azi e Vogël (nuk zgjati shumë)
 - c. Seleukët kundër ptolemejve për kontrollin e Palestinës:
 - (1) Siri (sundimtarët seleukë):
 - (a) 312-280 Seleuku I
 - (b) 280-261 Antioku I Soter
 - (c) 261-146 Antioku II Teus
 - (d) 246-226 Seleuku II Kalinik
 - (e) 226-223 Seleuku III Keraun
 - (f) 223-187 Antioku III i Madh
 - (g) 187-175 Seleuku IV Filopator
 - (h) 145-163 Antioku IV Epifan
 - (i) 163-162 Antioku V
 - (j) 162-150 Demetri I
 - (2) Egjiptian (sundimtarët ptolemej):
 - (a) 327-285 Ptolemi I Soter
 - (b) 285-246 Ptolemi II Filadelf
 - (c) 246-221 Ptolemi III Evegjet
 - (d) 221-203 Ptolemi IV Filopator
 - (e) 203-181 Ptolemi V Epifan
 - (f) 181-146 Ptolemi VI Filometor
 - (3) Vështrim i shkurtër:
 - (a) 301 – Palestina, nën sundimin e ptolemejve për 181 vite.
 - (b) 175-163 Antioku IV Epifan, sundimtari i tetë seleuk, donte t’i helenizonte judenjtë forcërisht, po të ishte e nevojshme:
 - (i) Ndërtoi gjimnaze
 - (ii) Ndërtoi altarë paganë për Zeun e Olimpët në tempullin e Jerusalemit
 - (c) 168 – 13 dhjetor – u ther një derr në altarin e Jerusalemit me urdhër të Antiokut IV Epifan. Disa mendojnë se kjo ishte “neveria e shkatërrimit” në Danieli 8.
 - (d) 167 – Matatia, prift në Modin, bën kryengritje me djemtë e tij. Biri i tij më i njohur ishte Juda Makabeasi, “Juda Çekiçi”.
 - (e) 165 – 25 dhjetor – ripërkushtimi i tempullit. Quhet *Hanuka*, ose “festa e Dritave”.
6. Për një diskutim të dobishëm për problemet, procedurat dhe presupozimet e datimeve, shih *The Expositor's Bible Commentary*, vëll. 4, f. 10-17.

VII. NJËSITË LETRARE (konteksti)

- A. Ka një model të qartë informacioni që autori jep për çdo mbret të veriut dhe jugut. Zakonisht, informacionet për mbretërit e judës janë më të plota (marrë nga shënimet e kursit të Dr Huey-t në SWBTS):
1. data e mbretërimit të një mbreti kombinohet me kolegun e tij në veri ose jug
 2. emri i mbretit
 3. emri i të atit
 4. mosha e ngjitjes në fron
 5. kohëzgjatja e mbretërimit
 6. vendi ku jetonte
 7. emri i nënës
 8. disa të dhëna për mbretërimin e tij
 9. shprehje përmbledhëse për jetën e tij
 10. rrëfim për vdekjen dhe varrosjen e tij
 11. shpesh #4 dhe #7 nuk përmenden për disa mbretër të Izraelit
- B. Ka disa mënyra të ndryshme për të përvijuar shkurtimisht këtë material të zgjatur historik:
1. Me anë të personazheve kryesore:
 - a. Davidi/Solomoni
 - b. Rehoboami/Jeroboami I
 - c. Ahabi (Jezebela)/Elia
 - d. Elia/Elizeu
 - e. Hezekia/Isaia
 - f. Josia/faraoni Neko
 - g. Jehoiakimi/Jehoiakini/Nebukadnecari
 2. Me anë të kombeve të përfshira:
 - a. Monarkia e Bashkuar
 - b. Izraeli/Juda
 - c. Siria
 - d. Asiria
 - e. Babilonia.
- C. Për disa përvijime të hollësishme, shih:
1. E. J. Young, *An Introduction to the Old Testament*, f. 190-200
 2. R. K. Harrison, *Introduciton to the Old Testament*, f. 720-721
 3. NIV Study Bible, f. 468-469

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Kjo nuk është histori perëndimore, por histori teologjike e Lindjes së Afërt në lashtësi:
1. Të gjithë mbretërit e veriut dënohen për shkak të viçave të artë që ngriti Jeroboami I për të përfaqësuar JHVH-në.
 2. Dy krerët më të fortë të veriut, Omri dhe Jeroboami II, përmenden shkurt, dhe nuk përmendet asnjëra nga arritjet e tyre politike dhe ushtarake.
 3. Dy mbretërit jugorë që trajtohen në mënyrën më të hollësishme janë Hezekia dhe Josia. Ata lavdërohen për shkak të besnikërisë së tyre ndaj besëlidhjes së Moisiut dhe përpjekjeve për reforma shpirtërore.
 4. I vetmi mbret tjetër që trajtohet në mënyrë të hollësishme është Manasi, i biri i Hezekias. Por kjo ndodh për shkak se ai është komplet e kundërta e të atit, dhe e çon kombin në mëkat të rëndë.
- B. Mbretërve vijon motivin e Samuelit. Mbretërit përbëjnë një histori të vetme të kësaj periudhe. Ngritja e profetizmit në krahasim me priftërinë vijon. Profetët që nuk shkruan libra, Elia dhe Elizeu, zënë plot një të tretën e I & II Mbretërve!
- C. Libri i Mbretërve tregon shmangien e përshkallëzuar të popullit të Perëndisë nga besëlidhja e Moisiut. Në fund, kjo çon në rënien e Samarisë (722 para K.) dhe në rënien e Jerusalemit (586 para

K.). Kjo nuk ndodhi për shkak të dobësisë së JHVH, por për shkak të mëkatit të popullit dhe krerëve! Besnikëria ndaj besëlidhjes ishte çështja thelbësore. JHVH ishte besnik! Kurse Solomoni, Juda dhe Izraeli, jo!

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. 1 MBRETËRVE

1. Fjalë dhe fraza:
 - a. “ashtu si ZOTI jeton”, 1:29 (NASB & NIV)
 - b. “ngas mushkën time”, 1:33 (NASB & NIV)
 - c. “u kap pas brirëve të altarit”, 1:50; 2:28 (NASB & NIV)
 - d. Jakini dhe Boazi, 7:21 (NASB & NIV)
 - e. “hapi krahët”, 8:22 (NASB & NIV)
 - f. “gishti im i vogël është më i trashë se ijët e atit tim” 12:10 (NIV, “... më i trashë se brezi i atit tim”)
 - g. viçat e artë, 12:28 (NASB & NIV)
 - h. “kërcenin rreth altarit... prisnin veten” 18:26, 28 (NIV, “vallëzonin... dhe pritëshin...”)
 - i. “ora e flijimit të darkës”, 18:36 (NIV, “në orën e flijimit”)
 - j. Një tingull ere e lehtë” (19:12, NIV, “një pëshpërimë e butë”)
2. Persona që duhen identifikuar shkurtimisht:
 - a. Abishagu, 1:3
 - b. Shimei, 2:8
 - c. Hiram, 5:1, 7:13
 - d. Mbretëresha e Shebës, 10:10
 - e. Ahstorethi, 11:5
 - f. Moleku, 11:7
 - g. Shishaku, 11:40
 - h. Omri, 16:16
 - i. Naboti, 21:1
 - j. Mikajahu, 22:24

B. 2 MBRETËRVE

1. Fjalë dhe fraza:
 - a. “karroca dhe kuaj të zjarrtë”, 2:11; 6:17 (NASB & NIV)
 - b. “bëri të keqen në sytë e ZOTIT”, 3:2 (NIV, “... sytë e...”)
 - c. “mblidh ijët” 4:29 (NIV, “ngjishe mantelin në brez”)
 - d. “kabi glasash pëllumbi” 6:25 (NIV, “një kab farash”)
 - e. “gjarpri i bronzit që kishte bërë Moisiu”, (*nehshatan*) 18:4 (NASB & NIV)
 - f. “ai bëri rezervuarin dhe tunelin” 20:20 (NIV, “... tunel”)
 - g. “ushtria e qiellit” 21:3 (NIV, “ushtria e yjeve”)
 - h. “Libri i Ligjit”, 22:8 (NASB & NIV)
 - i. Tofeti, 23:10 (NASB & NIV)
 - j. “deti i bronzit”, 25:13 (NASB & NIV)
2. Persona që duhen identifikuar shkurtimisht:
 - a. Gehazi, 4:11
 - b. Naamani, 5:1
 - c. Atalia, 11:1, 3
 - d. Puli, 15:19
 - e. Senakeribi, 18:13
 - f. Manasi, 21:1
 - g. Hulda, 22:14
 - h. Neko, 23:29
 - i. Jehoiakini, 24:8

- j. Seraiahu, 25:18
- k. Gedaliahu, 25:22

X. VENDNDODHJET NË HARTË (sipas numrave)

A. 1 Mbretërve:

- 1. En-rogel, 1:9 (Jerusalem)
- 2. Gihon, 1:33 (Jerusalem)
- 3. Anathoth, 2:26
- 4. Përroi i Egjiptit, 8:65 (NIV, “vau i Egjiptit”)
- 5. Megido, 9:15
- 6. Ecion-geber, 9:26
- 7. Shekem, 12:1
- 8. Penuel, 12:25
- 9. Përroi i Kidronit, 15:13 (NIV, “Lugina e Kidronit”)
- 10. Kineroti, 15:20 (NIV, “Kineret”)
- 11. Samaria, 16:24
- 12. Mali Karmel, 18:20
- 13. Përroi i Kishonit, 18:40 (NIV, “Lugina e Kishonit”)
- 14. Jezreeli, 18:45

B. 2 Mbretërve:

- 1. Ekron, 1:2
- 2. Lumenjtë e Abanës dhe Farparit, 5:12
- 3. Dotan, 6:13
- 4. Sela, 14:7
- 5. Elat, 14:22
- 6. Lakish, 18:14
- 7. Lugina e bijve të Hinomit, 23:10 (NIV, “... e Ben Hinomit”)
- 8. Megido, 23:30
- 9. Ribla, 25:6


XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

A. 1 MBRETËRVE:


- 1. Rendit disa arsye pse kishte qaq probleme në familjen e Davidit.
- 2. Pse u martua me qaq shumë gra Solomoni? Si ndikuan ato tek ai kur ishte plak?
- 3. Pse i jepet qaq shumë hapësirë dhe hollësi tempullit?
- 4. Pse u thye Monarkia e Bashkuar?
- 5. Përshkruaj adhurimin e Baalit/Asherahut.
- 6. Cilat janë rrjedhojat teologjike të 22:18-23?

B. 2 MBRETËRVE:

- 1. Shpjego kuptimin e 5:15-18.
- 2. Shpjego kuptimin e 19:19.
- 3. Rendit pikat e forta të Hezekias dhe mëkatet e Manasit.
- 4. Për çfarë bën fjalë fraza (22:8): “kam gjetur librin e Ligjit”?
- 5. Si ishte besëlidhja e JHVH: e kushtëzuar, apo e pakushtëzuar?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



MBRETËRIT E MBRETËRISË SË NDARË

MBRETËRIT E JUDËS (1 Kro. 3:1-16; Mat. 1:6-11)					MBRETËRIT E IZRAELIT				
EMRAT & DATAT	BRIGHT	YOUNG	HARRISON	TEKSTET BIBLIKE	EMRAT & DATAT	BRIGHT	YOUNG	HARRISON	TEKSTET BIBLIKE
Rehoboami	922-915	933-917	931/30-13	1 Mbre. 11:43-12:27; 41:21-31 2 Kro. 9:31-12:16	Jeroboami I	922-901	933-912	931/30-910/09	1 Mbre. 11:26-40; 12:12-14:20
Abijahu/Abijami	915-914	916-914	913-911/10	1 Mbre. 14:31-15:8 2 Kro. 11:20, 22					
Asa	913-873	913-873	911/10-870/69	1 Mbre. 15:8-30; 16:8, 10, 23, 29; 22:41, 43, 46 Jer. 41:9	Nadabi	901-900	912-911	910/09-909/08	1 Mbre. 14:20; 15:25-31
					Baasha	900-877	911-888	909/08-886/85	1 Mbre.15:16-16:7; 2 Mbre..9:9 2 Kro. 16:1-6 Jer. 41:9
Jehoshafati	873-849	873-849	870/69-848	1 Mbre. 15:24; 22:1-51 2 Mbre. 3:1-12; 8:16-19 1 Kro. 3:10 2 Kro. 17:1-21:1	Elahu	877-876	888-887	886/85-885/84	1 Mbre. 16:8-14
(Jehorami, bashkëmbretërues)	-	-	853-848	1 Mbre. 22:50 2 Mbre. 1:17; 8:16; 12:18	Zimri (general ushtrie)	876	887	885/84	1 Mbre. 16:9-20 2 Mbre. 9:31 1 Mbre. 16:15-28
Jehorami (Jorami)	849-842	849-842	848-841	1 Kro. 22:1-20 Mateu 1:8	Omri (general ushtrie)	876-869	887-877	885/84-874/73	2 Mbre. 8:26 Mikea 6:16
Ahazia	842	842	-	2 Mbre. 8:24-9:29 2 Kro. 22:1-9	Ahabi	869-850	876-854	874/73-853	1 Mbre. 16:29-22:40
					Ahazia	8540-849	854-853	853-852	1 Mbre. 22:40, 41, 49, 51- 53 2 Kro. 18:1-3, 19
Atalia (mbretëreshë)	842-337	842-836	841-835	2 Mbre. 8:26; 11:1-20 2 Kro. 22:2-23:21	Jehorami (Jorami)	849-842	853-842	852-841	2 Mbre. 1:17; 3:1-27; 8:16-9:29
Joashi (Jehoashi)	837-800	836-797	835-796	2 Mbre. 11:2-3; 12:1-21 2 Kro. 22:11-12; 24:1- 27	Jehu (general ushtrie)	842-815	842-815	841-814/3	1 Mbre. 19:16-17 2 Mbre. 9:1-10:36; 15:12 2 Kro. 22:7-9 Osea 1:4
Amaciahu	800-783	797-779	796-767	2 Mbre. 12:21; 14:1-22 2 Kro. 25:1-28					
(Uziah, bashkëmbretërues)	-----	-----	791/90-767	2 Mbre. 14:21; 15:1-7	Jehoahazi	815-801	814-798	814/13-798	2 Mbre. 10:35; 13:1-9
Uziah (Azaria)	783-742	779-740	767-740/39	2 Kro. 26:1-23 Osea 1:1; Amos 1:1	Jehosahu	810-786	798-783	798-782/81	2 Mbre. 13:9-13, 25 2 Kro. 25:17-25


				Zakaria 14:5					Osea 1:1; Amosi 1:1
(Jotami bashkëmbretërues)	750-742	-----	750-740/39	2 Mbre. 15:7, 32-38	(Jer. II, bashkëmbretërues)	-----	-----	793/92-782/81	2 Mbre. 13:13; 14:16, 23-29 Osea 1:1
Jotami	742-735	740-736	740/39-732/31	1 Kro. 5:17 2 Kro. 26:23-27:9 Isa. 1:1; 7:1 Osea 1:1; Mikea 1:1	Jeroboami II	786-746	783-743	782/81-753	Amos 1:1; 7:9-11
					Zakaria	746-745	743	753-752	2 Mbre. 15:8-12
(Ahazi, bashkëmbret)	-----	-----	744/43-732/31	2 Mbre. 15:30-16:20 2 Kro. 27:9-28:27	Shalum	745	743	752	2 Mbre. 15:10, 13-15
Ahazi	735-715	736-728	732/31-716/15	Isa. 1:1; 7:1 e më tej; 14:28; 38:8; Osea 1:1; Mikea 1:1	Menahemi	745-738	743-737	752-742/41	2 Mbre. 15:14, 16-22
(Hezekia bashkëmbret)	-----	-----	729-716/15	2 Mbre. 16:20; 18:1-20, 21 2 Kro. 28:27-33:33 Fja. 25:1	Pekahia	738-737	737-736	742/41-740/39	2 Mbre. 15:23-26
Hezekia	715-687	727-699	716/15-687/86	Isa. 1:1; 36:1-39:8 Osea 1:1; Mikea 1:1 Mat. 1:9-10	Peka	737-732	736-730	740/39-732/31	2 Mbre. 15:27-31; 16:5 2 Kro. 28:6; Isa. 7:1
(Manasi bashkëmbret)	-----	-----	696/95-687/86	2 Mbre. 20:21-21:18; 23:12, 26; 24:2	Hoshea	732-724	730-722	732/31-723/22	2 Mbre. 17:1-18
Manasi	687/86-642	698-643	687/86-642/41	2 Kro. 32:33-33:20 Jer. 15:4 e më tej; 2 Mbre. 21:18-26	Rënia e Samarisë në dorë të Asirisë	724 para K.	722 para K.	722 para K.	
Amni	642-640	643-641	642/41-640/39	2 Kro. 33:20-25 Jer. 1:2; Sof. 1:1 1 Mbre. 13:2-3					
Josia	610-609	640-609	640/39-609	2 Mbre. 21:24; 22:1-23:30 2 Kro. 33:25-35:27 Jer. 1:2; Sof. 1:1 Mat. 1:10-11					
Jehoahazi	609 (3 muaj)	609	609	2 Mbre. 23:30-34 2 Kro. 36:1-4					
Jehoiakimi	609-598	609-598	609-597	2 Mbre. 23:34-24:6, 19 2 Kro. 36:4-8 Jer. 1:3; 22:18-23; 25:1 e më tej; 26:1 e më tej; 27:1 e më tej; 35:1 e më tej; 36:1 e më tej Dan. 1:1-2					
Jehoiakimi	598/97 (3 muaj)	598	597	2 Mbre. 24:6, 8-17; 25:27-30 2 Kro. 36:8-9 Jer. 52:31; Ezek. 1:2					

Sedekia	597-586	598-587	597-587	2 Mbre. 24:17-25:7 2 Kro. 36:10-11 Jer. 1:3; 21:1-7; 24:8-10; 27:1 e më tej; 32:4-5; 34:1-22; 37:1-39:7; 52:1-11					
Rënia e Jerusalemit në dorë të Babilonisë	586 para K.	587 para K.	587 para K.	Vajtimit					

Për një diskutim të dobishëm për problemet e datimeve, shih E. R. Thiele, *The Mysterious Numbers of the Hebrew Kings*.



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



HYRJE PËR I & II KRONIKAVE

I. EMRI I LIBRIT

- A. Emri i këtij libri në hebraisht është: “fjalët (ngjarjet) e ditëve (viteve)”. Kjo duket se përdoret në kuptimin e një kronike për vitet. Të njëjtat fjalë shfaqen dhe në titullin e disa librave që përmenden si burime të shkruara në 1 Mbre. 14:19, 29; 15:7, 23, 31; 16:5, 14, 20, 27; 22:46. Vetë kjo frazë përdoret mbi tridhjetë herë në I & II Mbretërve dhe, zakonisht, përkthehet “kronikat”.
- B. LXX e titullon: “Gjërat e papërmendura (në lidhje me mbretërit e Judës)”. Kjo nënkupton se Kronikat është për Samuelin dhe Mbretërve ajo që ungjilli i Gjonit është për ungjijtë sinoptikë.
- C. Jeronimi, në përkthimin e tij latinisht, Vullgata, e titullon: “Kronika e gjithë historisë së shenjtë”, pasi gjenealogjia e saj kthehet tek Adami, ndërsa librat shoqërues të Ezrës/Nehemias kanë të bëjnë me periudhën pas kthimit nga robëria.
- D. Në fillim, I & II Kronikave ishte një libër i vetëm në hebraisht, por LXX e ndan në dy libra, njësoj si në rastin e Samuelit dhe Mbretërve.

II. KANONIZIMI

- A. Ky është libri i fundit i “Shkrimeve”, një pjesë e kanonit hebraik. Kjo do të thotë se është libri i fundit i Biblës hebraisht.
- B. Pozicioni i tij në kanonin hebraisht nënkupton:
 - 1. kompozimin e vonët të tij;
 - 2. natyrën përmbledhëse të librit;
 - 3. shihet si shtojcë;
 - 4. u pranua vonë në kanon.
- C. LXX e vendosi pas Mbretërve dhe përpara Ezrës. Është e habitshme që Ezra/Nehemia vendoset para Kronikave, ndoshta për shkak të natyrës përmbledhëse të Kronikave, ose për shkak se përfundon në mënyrë pozitive.

III. GJINIA LETRARE

- A. Ky libër është narrativë historike, por në një kuptim të veçantë e të përzgjedhur teologjik.
- B. Lë pa përmendur shumicën e aspekteve negative të mbretërimeve të:
 - 1. Davidit
 - 2. Solomonit
 - 3. Mbretërve “të perëndishëm” judeas:
 - a. Asa
 - b. Jehoshafati
 - c. Uzia
 - d. Hezekia
 - e. Josia

IV. AUTORËSIA

- A. Bibla është e heshtur për autorësinë e këtij libri.
- B. Baba Bathra 15a thotë se Ezra e shkroi gjenealogjinë e Kronikave deri tek ai vetë. Kjo është interpretuar në dy mënyra:

1. Ezra shkroi Kronikat
 2. Ezra e përfundoi historinë e nisur në Kronikat deri në ditën e tij
- C. Ezra 1:1-4 dhe 2 Kronikave 36:22-23 janë shumë të ngjashme në hebraisht. Young dhe Harrison thonë se i pari u shkrua libri i Kronikave. Kjo vërtetohet pjesërisht nga një teknikë kopjuesish që përdorej nga skribët babilonas, të cilët i lidhnin këto dy vepra me njëra-tjetrën me anë të një “rreshti lidhës”, ose kolofoni. Kjo teknikë nuk shihet në shkrimet rabinike. Kjo nënkupton se Ezra i përdori Kronikat si hyrje historike për veprën e tij, që vijoi më tej historinë e popullit jude.
- D. Autori (ose autorët) i Kronikave dhe Ezra/Nehemias kanë të njëjtin interes dhe pikëvështrim teologjik:
1. përqendrohen te tempulli dhe priftëria (sidomos te listat e levitëve)
 2. përdorin shumë dokumenta statistikore dhe gjenealogji
 3. ngjasojnë nga fjalori dhe nga stili letrar
 4. por duhet thënë se edhe ndryshojnë:
 - a. i shqiptojnë ndryshet emrat
 - b. Kronikat përqendrohet në pasardhjen mbretërore të Davidit, ndërsa Ezra/Nehemia përqendrohet në besëlidhjen e Moisiut
- E. William Albright ia atribuon autorësinë Ezerës, mes viteve 428 dhe 397 para K. Reforma e Ezerës, që gjendet në Ezra 7-10, ndodhi rreth 458-457 para K., në kohën e Artakserksit I.
- F. Kronikat përdor shumë burime:
1. Shkrime të shkruara më parë:
 - a. Kronikat përdor rreth gjysmën e Samuelit dhe Mbretërve, ose të paktën të njëjtat burime si to.
 - b. 1 Kronikave duket se i nje disa tekste të DHV në mënyrë të veçantë:
 - (1) Zan. 35:22 – 5:1
 - (2) Zan. 38:7 – 2:3
 - (3) Zan. 38:30 – 2:4, 6
 - (4) Zan. 46:10 – 24:24
 - (5) Zan. 46:11 – 6:16
 - (6) Zan. 46:13 – 7:1
 - (7) Zan. 46:21 – 7:6, 12
 - (8) Zan. 46:24 – 7:13
 - (9) Ruthi 4:18-21 – 2:11-13
 - (10) 1 Sam. 27:10 – 2:9, 25-26
 - (11) 1 Sam. 31:1-6 – 10:1-12
 - c. Hyrja e NIV Study Bible për Kronikat përfshin si burime:
 - (1) Pentatukun
 - (2) Gjyqtarët
 - (3) Ruthin
 - (4) 1 Samuelin
 - (5) Mbretërit
 - (6) Psalmet
 - (7) Isaian
 - (8) Jeremian
 - (9) Vajtimet
 - (10) Zakarian
 2. dokumenta të shkruara historike nga mbretëria e ndarë.
 - a. ndoshta, dokumenta zyrtarë të oborrit mbretëror:
 - (1) kronikat e mbretit David, 1 Kron. 27:24
 - (2) libri i mbretërve të Judës dhe Izraelit, 2 Kron. 16:11; 25:26; 28:26; 32:32
 - (3) libri i mbretërve të Izraelit dhe Judës, 2 Kron. 27:7; 35:27; 36:8
 - (4) libri i mbretërve të Izraelit, 1 Kron. 9:1; 2 Kron. 20:34

- (5) fjalët e mbretërve të Izraelit, 2 Kron. 24:27; 33:18
- b. profetët:
- (1) veprat e mbretit David, 1 Kron. 29:29:
 - (a) kronikat e shikuesit Samuel
 - (b) kronikat e profetit Natan
 - (c) Kronikat e shikuesit Gad
 - (2) dokumentet e profetit Natan
 - (3) profecia e Ahijah shilonitit
 - (4) veprat e Jeroboamit I në vegimet e shikuesit Ido, 2 Kron. 9:29
 - (5) veprat e Rehoboamit në 2 Kron. 12:15:
 - (a) dokumentet e profetit Shemaia
 - (b) shikuesi Ido
 - (c) veprat e Abijahut në 2 Kron. 13:22 nga profeti Ido
 - (d) veprat e Jehut në 2 Kron. 20:34 nga i biri i Hananit
 - (e) veprat e Manasit në 2 Kron. 33:19 nga Hozai (LXX “shikuesi”)
- c. dokumentet gjenealogjike të fiseve:
- (1) Simeoni, 1 Kron. 4:33
 - (2) Gadi, 1 Kron. 5:17
 - (3) Benjamini, 7:9
 - (4) Asheri, 7:40
 - (5) Gjithë Izraeli, 9:1
 - (6) Derëtarët levitë, 9:22 (ideja është se çdo degë e levitëve kishte të dhëna me shkrim [shih 1 Kron. 23:1; e më tej; 28:13; 2 Kron. 35:4]).
- d. burime të huaja:
- (1) letrat e Senakeribit, 2 Kron. 32:17-70
 - (2) dekreti i Kirit, 2 Kron. 36:22-23

- G. Ashtu si Ezra-Nehemia, edhe Kronikat rendit gjenealogjitë e një sërë personave. Disa nga këto shtrihen deri në katër ose gjashtë breza në të ardhmen. Ka patur dy mënyra si është interpretuar kjo:
1. janë shtesa redaktoriale:
 2. janë familje të kohës, jo brezni.

V. DATA

- A. Dy pasazhe të Kronikave nënkuptojnë një periudhë pas kthimit nga robëria për shkrimin e Kronikave:
1. 1 Kronikave 3:19-21. Kjo është një listë e pasardhësve të Zerubabelit:
 - a. disa thonë deri në brezin e gjashtë
 - b. të tjerë thonë vetëm deri në brezin e dytë, e vijuar nga një listë e katër familjeve davidike që ishin bashkëkohëse të dy pasardhësve të Zerubabelit – Pelatiah dhe Jeshaiahu (Young & Harrison)
 - c. LXX e zgjeron listën e pasardhësve të Zerubabelit deri në brezin e njëmbëdhjetë (kjo tregon përditësim redaktorial)
 2. 1 Kronikave 3:22-24 – kjo është një listë e pasardhësve të Shekaniahut, që përmendet në v. 21:
 - a. disa thonë se lista shkon deri në katër breza (NIV Study Bible)
 - b. nëse është e vërtetë, atëherë datimi i autorit (redaktorit) shtyhet më tej nga brezania e Zerubabelit në 3:19-21
 3. 2 Kron. 36:22-23:
 - a. kjo përmend Kirin II dhe dekretin e tij, që u lejoi gjithë popujve të pushtuar që të kthehen në vendet e tyre, përfshi dhe judenjtë
 - b. Kiri II e lëshoi këtë dekret më 538 para K. Kthimi i parë u krye menjëherë nga një princ judeas, që ishte caktuar guvernator: Sheshbacari. Ai nisi rindërtimin e tempullit në Jerusalem, por nuk e përfundoi. Më vonë, nën mbretin pers, Dari I, të tjerë filluan të kthehen nën Zerubabelin (që ishte pasardhës i Davidit) dhe nën Jozueun, një pasardhës i kryepriiftit. Ata e përfunduan rindërtimin e tempullit më 516 para K. me inkurajimin e Hagait dhe Zakarisë.

- B. Nga gjenealogjitë e librit, datimi i përpiluesit të tij duket se është diku mes 500-423 para K. Kjo datë përfundimtare përfshihet për shkak se duket që këtu bëhet aludimi më i fundit historik në Dhiatën e Vjetër. Dari II u kurorëzua mbret rreth 428 para K. Ai përmendet në Nehemia 12:22. Po kështu, tradita judaike thotë se kanoni i Dhiatës së Vjetër u përmbyll rreth kësaj periudhe.
- C. 1 Kronikave mbulon të njëjtën periudhë si I & II Samueli; sidoqoftë, gjenealogjitë e tij kthehen deri në kohën e Adamit. 2 Kronikat mbulon të njëjtën periudhë si I & II Mbretërve, por e zgjeron më tej, pothuajse deri në kohën e Kirit II.

VI. BURIME QË MBËSHTESIN KONTEKSTIN HISTORIK

- A. Ka disa dallime të vërteta mes paraqitjes historike të Samuelit-Mbretërve dhe asaj të Kronikave:
 - 1. Numrat në Kronikat janë më të mëdha (Young, f. 394-400)
 - a. Kjo është përgjithësisht e vërtetë: krahaso 1 Kron. 21:5 me 2 Sam. 24:9
 - b. Shpesh, Kronikat kanë numra më të vegjël, krahaso 1 Mbre. 4:26 me 2 Kron. 9:29
 - c. Shumica e problemeve me numrat gjenden dhe në përkthimin e LXX, që do të thotë se ishin të pranishëm përpara vitit 250 para K. (kur u shkrua LXX).
 - d. E. R. Thiele, në librin e tij të shkëlqyer, *The Mysterious Numbers of the Hebrew Kings* (1956, 1965), i shpjegon dallimet me anë të:
 - (1) dy sistemeve për datimin e mbretërimeve:
 - (a) viti i ngjitjes në fron;
 - (b) viti jo i ngjitjes në fron
 - (c) bashkëmbretërimet
 - 2. Kronikat thekson aspektet pozitive të mbretërve judenj të prejardhjes së Davidit
 - 3. Kronikat lë pa përmenduar shumë gjëra negative për Davidin dhe Solomonin. Gjithsesi, siç vë në dukje Young (f. 395-398), ajo lë pa përmendur pothuajse gjithçka nga jeta e tyre private, jo thjesht aspektet negative, por edhe disa nga aspektet pozitive.
 - 4. Po kështu, Kronikat s'përmend asnjë gjë në lidhje me mbretërinë veriore. Arsyeja është e paqartë. Disa mendojnë se kjo ndodh për shkak se gjithë mbretërit veriorë dënohen për shkak të viçave të artë që u ngritën në Dan dhe Betel. Jugu konsiderohej si e vetmja brezni e vërtetë dhe besnike davidike (mesianike).
- B. Vlefshmëria e historisë së Kronikave duket se mbështetet:
 - 1. në materialet gjenealogjike, që paralelizohen nga:
 - a. Samueli
 - b. Pergamenat e Detit të Vdekur
 - c. LXX
 - 2. kur materialet gjenealogjike të Kronikave paralelizohen nga Zanafilla dhe Numrat në tekstin masoret dhe në Pentatukun Samaritan, vlefshmëria e tyre historike duket se mbështetet prej tyre.

VII. NJËSITË LETRARE (konteksti)

- A. Përvijim i shkurtër:
 - 1. Material gjenealogjik nga Adami te Sauli, 1 Kron. 1:1-9:44
 - 2. Mbretërimi i Davidit, 1 Kron. 10:1-29:30
 - 3. Mbretërimi i Solomonit, 2 Kron. 1:1-9:31
 - 4. Mbretërimi i mbretërve të tjerë judeas nga robëria te Kiri, 2 Kron. 10:1-36:23
- B. Për një përvijim të hollësishëm, shih:
 - 1. E. J. Young, *An Introduction to the Old Testament*, f. 401-402
 - 2. R. K. Harrison, *Introduction to the Old Testament*, f. 1152-1153
 - 3. NIV Study Bible, f. 581-582

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Kjo është një histori e përzgjedhur teologjike e Judës, që përdor dhe zgjeron rrëfimet paralele në 1 & 2 Samuelit dhe 1 & 2 Mbretërve.
- B. U shkrua për një komunitet pas robërisë, që kishte nevojë të dëshpërueshme të dinte se Perëndia i Besëlidhjes ishte ende Perëndia i tyre Tempulli (meqë s'kishte më mbret) ishte fokusi i Besëlidhjes së përtërirë të Perëndisë. Besëlidhja ishte ende e kushtëzuar në bazë të bindjes ndaj urdhërimeve të Moisiut.
- C. Libri përqendrohet, pikësëpari, në premtimet e Perëndisë për Davidin dhe bijtë e tij, që gjendet në 2 Sam. 7:
1. Merret vetëm me bijtë e Davidit, prej të cilit në fund do të vijë Mbreti Mesi
 2. Rrëfen në mënyre pozitive mbretërimin e Davidit, Solomonit dhe mbretërve të “perëndishëm” të Judës
 3. Përmend kthimet e hebrenjve në Jerusalem nga Kiri II, 36:22-23
 4. Thekson një mbret të ardhshëm davidik (Mesia). Një mënyrë sesi kryhet kjo është nëpërmjet përmendjes së mbretërimeve “të perëndishme” të Davidit, Solomonit dhe mbretërve të tjerë të perëndishëm të Judës. Kjo shpresë mesianike shprehet dhe te Zakaria dhe Malakia.
- D. Theksohet dhe uniteti i gjithë popullit të Perëndisë. Kjo shihet nga përdorimi i termit kolektiv “gjithë Izraeli” (1 Kron. 9:1; 11:1-3,4; 12:38; 16:3; 18:14; 21:1-5; 28:1-8; 29:21,23,25; 2 Kron. 1:2; 2:8; 9:30; 10:1,16; 12:1; 18:16; 28:23; 29:24; 30:1,6,25-26; 34:7,9,33).
- E. Përdoren gjenealogji:
1. si ajo tek Ezra dhe Nehemia, për të treguar se Izraeli i rimëkëmbur është vërtet Izraeli i dikurshëm
 2. për të përmbledhur historinë e hebrenjve, duke u kthyer pas deri tek Adami

* Për shkak se 1 & 2 Kronikave, në thelb, përmend të njëjtat ngjarje si 1 & 2 Samuelit dhe 1 & 2 Mbreterve, nuk do të kemi harta ose pyetje për këto dy libra!

HYRJE PËR EZRËN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Ezra dhe Nehemia janë një libër i vetëm në kanonin hebre (MT). Baba Bathra 15a, e quajti “Ezra”.
1. Kjo është e pazakontë, pasi është e qartë se të dy librat përmbajnë të njëjtën listë gjenealogjie: Ezra 2:1 e më tej, dhe Nehemia 7:6-20.
 2. Për shkak të listave, që ndonëse paksa të ndryshme, janë në thelb të njëjta, mendimi është se, në fillim, këto përbënin dy libra.
 3. Kjo vërtetohet nga përdorimi i pjesëve që flasin në vetën e parë (“unë”) tek Ezra 7-10 dhe Nehemia.
- B. Më vonë, këto dy libra mund të jenë kombinuar në një të vetëm për shkak se shërbesa e Ezrës (Ezra 7-10) vazhdohet në Nehemia 8-10.
- C. Titujt e Ezrës dhe Nehemias ndryshojnë sipas përkthimeve të lashta:

LXX	Vullgata	Wycliffe & Coverdale (anglisht)	Anglishtja e sotme
Esdra B (Beta)	Esdras I	I Ezra	Ezra
Esdra C (Gama)	Esdras II	II Ezra	Nehemia
Esdra A (Alfa)	Esdras II	-	I Esdras (jokanonike)
-	Esdras IV	-	II Esdras (jokanonike)

- D. Teksti i parë hebraisht që i ndau këta libra ishte botimi i MT në vitin 1448 pas K.

II. KANONIZIMI

- A. Libri i Ezrës është pjesë e ndarjes së tretë të kanonit hebre, që quhet “Shkrimet”.
- B. Në tekstin masoret (MT) vendoset para Kronikave. Kjo është renditje e pazakontë. Rendi kronologjik duhet të jetë Kronikat, pastaj Ezra/Nehemia. Ka disa teori për këtë (shih Nehemia, II. B).

III. GJINIA LETRARE

- A. Narrativë historike në prozë të drejtpërdrejtë
- B. Përfshin shumë citime nga dokumente të tjera:
1. Perse
 2. Judaikë

IV. AUTORËSIA

- A. Baba Bathra 15a thotë se këtë libër e shkroi Ezra, por kjo nuk do të thotë se ai shkroi dhe Nehemian. Madje, disa burime të tjera judaike (Gemara) thonë se librin e përfundoi Nehemia (Ezra-Nehemia). Shënimet e fundit të librit në MT gjenden vetëm në fund të Nehemisë.
- B. Jozefusi, në librin e tij *Kundër Apionit*, 1:8, dhe Melito i Sardit, i cituar nga Euzebi (*Historia kishtare* IV:26), shprehen për autorësinë e Ezrës.
- C. Ajo pjesë e Ezrës që trajton jetën e skribit Ezra (kapitujt 7-10) u shkrua në vetën e parë, 7:27-28; 8:1-34; 9:1 e më tej. Ezra ishte prift sipas pasardhjes së Cadokut, dhe ishte skrib në oborrin pers të Artakserksit I (465-424 para K.).

- D. Ka shumë ngjashmëri mes Ezra/Nehemisë dhe Kronikave:
1. Përmbyllja e 2 Kron. 36:22-23 është pothuajse njësoj si Ezra 1:1-4 në hebraisht
 2. Të dyja kanë të njëjtin pikëvështrim teologjik:
 - a. përqendrohen te tempulli dhe priftëria (sidomos listat e levitëve)
 - b. përdorin shumë të dhëna statistikore dhe gjenealogji
 - c. kanë fjalor dhe stil letrar të ngjashëm
 - d. të dyja përdorin hebraishten e vonët
 - e. megjithatë, duhet thënë se kanë dhe dallime të qarta:
 - a. në shqiptimin e emrave mbretërorë:
 - b. Ezra dhe Nehemia fokusohen te besëlidhja me Moisiun, ndërsa I & II Kronikave fokusohen në besëlidhjen me Davidin.
- E. Origeni (185-253 pas K.), studiuesi i krishterë i Aleksandrisë, ishte i pari që e ndau librin në dy libra: Ezra dhe Nehemia. Jeronimi bëri të njëjtën gjë në Vullgatën e tij latinisht.
- F. Dorëshkrimi i parë hebraisht që e ndau këtë libër u botua më 1448 pas K. Me sa duket, në këtë periudhë, judenjve u kishte ikur dëshira që të kishin vetëm 22 libra në DHV, në mënyrë që të përputhej me 22 shkronjat e alfabetit hebraisht.
- G. Autori/përpiluesi i librit përdori shumë burime:
1. Dokumente perse
 2. Të dhëna judaike:
 - a. një listë e enëve në tempullin e JHVH, që tani ishin në Babiloni, 1:9-11; 7:19-20
 - b. një listë e robërve të kthyer në Izrael, 2:1-70; 8:1-20
 - c. gjenealogjia e Ezrës, 7:1-5
 - d. lista e atyre që ishin përfshirë në martesën të përziera, 10:18-43

V. DATA

- A. Ezra ishte prift sipas pasardhjes së Cadokut (7:2) dhe skrib në mbretërimin e Artakserksit I (465-424 para K.):
1. Ezra erdhi në Jerusalem në vitin e shtatë të Artakserksit I, 458 para K., si guvernator pers.
 2. Nehemia erdhi në Jerusalem në vitin e njëzetë të Artakserksit I, 445 para K. si guvernator pers.
- B. Duket se gjenealogjia e Ezrës/Nehemisë e vendosin autorin ose përpiluesin e librit në fund të shekullit të pestë para K.:
1. nëse supozojmë se 1 Kron. 3:15-24 rendit katër breza pas Zerubabelit, jo gjashtë;
 2. nëse supozojmë se Jada i Neh. 12:10-11 ishte:
 - a. jo i njëjti Jada, që Jozefusi e vendos në kohën e Aleksandrit të Madh (336-323 para K.):
 - b. ose se kjo gjenealogji u shtua nga një redaktor i mëvonshëm, pas shkrimit të origjinalit, për ta përditësuar si informacion:
 - c. ose se ai ishte shumë i vogël në kohën e Nehemias dhe jetoi në moshë shumë të thyer deri në kohën e Aleksandrit.
- C. Kjo do ta vendoste autorësinë e këtyre ngjarjeve të lidhura me njëra tjetër në vitin:
1. 440 para K. për Ezrën
 2. 430 para K. për Neheminë
 3. 400 para K. për Kronikat

VI. BURIME QË MBËSHTESIN KONTEKSTIN HISTORIK

- A. Forma e dokumentave në librin e Ezrës ndjek modelin dhe stilin e dokumenteve zyrtare të periudhës perse:

1. dekreti i Kirit (përkthimi hebraisht), 1:2-4 (për kthimin në Jerusalem dhe për tempullin)
 2. letrën akuzuese që Rehumi i dërgoi Artakserksit I, 4:7-16 (për muret e Jerusalemit)
 3. përgjigjja e Artakserksit I, 4:17-22
 4. akuzat ligjore nga Tatenai drejtuar Darit I, 5:6-17
 5. përgjigjja e Darit I (për tempullin):
 - a. citon dekretin e Kirit, 6:2-5
 - b. përgjigjja personale e Darit për Tatenain, 6:6-12, 13
 - c. dekreti i Artakserksit I për Ezrën, 7:12=26
- B. Papiruset elefantine (408 para K.) mbështesin vërtetësinë historike të Ezra/Nehemias pasi përmendin Sanbalatin (Sin-Ubalit në babilonisht), Neh. 2:10, 19; 4:1. Po kështu, shfaq dhe stilin e aramaishtes perandorake.
- C. Në Sukot janë gjetur disa tasa të argjendtë, ku është shkruar: “për Kainun, birin e Geshemit”, gjë që vërteton egzistencën e arabit Geshim ën Ezra/Nehemia, i cili sundoi në mbretërinë e Kedarit (shih Neh. 2:19; 6:1, 6).

VII. NJËSITË LETRARE (konteksti)

- A. Kthimet e para në Jerusalem, 1:1-2:70
1. Në mbretërimin e Kirit (550-530 para K.), Sheshbacari u caktua guvernator, 5:14. Ai ishte princ nga Juda ,1:8, ndoshta i biri i i Jehoiakinit. U kthye në Jerusalem me thesaret e tempullit, 1:1-11. Shtroi themelet e tempullit, por nuk e përfundoi, 5:13-17.
 2. Në mbretërimin e Kirit dhe Darit I (4:5, 522-486 para K.), Zerubabeli, pasardhës i Davidit, u caktua guvernator. Ai u kthye në Jerusalem bashkë me Jozueun (ose Jeshuan), pasardhës i kryepriutit të fundit, 2:1-70.
- B. Rivendosja e adhurimit mozaik të JHVH-së në Jerusalem nga Zerubabeli dhe Jozueu, 3:1-6:22
1. Fillon festa e kasolleve dhe flijimet e rregullta, 3:1-13
 2. Probleme politike për përfundimin e projekteve të ndërtimit, 4:1-24:
 - a. Tempulli, 1-5, 24
 - b. Muret e Jerusalemit, 6-23
 3. Profetët nxisin punën e rindërtimit, por duhet të presin për të marrë miratimin zyrtar pers, 5:1-17
 4. Gjetendet dekreti i Kirit dhe jepet leja zyrtare për rindërtimin e tempullit, 6:1-22
- C. Kthimi i tretë nën skribin Ezra, 7:1-10:44
1. Gjenealogjia e Ezrës dhe kthimi në Jerusalem, 7:1-10
 2. Letra e Artakserksit I drejtuar Ezrës, 7:11-26, dhe lutja e tij falenderuese, 7:27-28
 3. Kthimi, 8:1-36
 4. Problemi i martesave të përziera, 9:1-10:44

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Ezra/Nehemia vazhdon historinë e periudhës perse pas kthimit nga robëria, aty ku përfundon 2 Kronikave
- B. Tregon vlefshmërinë racore të robërve të kthyer me anë të:
 1. gjenealogjive të gjata fisnore;
 2. ndarjeve të hollësishme levitike;
 3. veçimit fetar të të kthyerve në lidhje me kombet përreth.
- C. Perëndia ka rivendosur besëlidhjen me pasardhësit e Jakobit

- D. Tregon zhvillimin e një modeli të ri adhurimi, që përqendrohet te sinagoga lokale dhe te skribët. Sigurisht, kjo nuk e përjashtonte adhurimin në tempullin e Jerusalemit.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe/ose fraza:

1. “për të përmbushur fjalën e Zotit me anë të gojës së Jeremias”, 1:1 (NIV: “e folur nga...”)
2. “Perëndia i qiellit”, 1:2 (NASB & NIV)
3. “kushdo, të cilit ia kishte nxitur shpirtin Perëndia”, 1:5 (NIV, “...që ia kishte nxitur zemrën Perëndia”)
4. “objektet e shtëpisë së Zotit”, 1:7 (NIV, “... që i përkisnin tempullit...”)
5. Urimi dhe Thumimi, 2:63 (NASB & NIV)
6. “provinca përtej Lumit”, 4:16 (NIV, “trans-Eufrati”)
7. Kubit, 6:3 (NIV, “këmbë”)
8. Libri i Moisiut, 6:18 (NASB & NIV)
9. Skrib, 7:6 (NIV, “mësues”)
10. Nethinim, 7:24 (NIV, “shërbëtorët e tempullit”)

B. Persona që duhen identifikuar shkurtimisht:


1. Kiri, 1:1
2. Mithredathi, 1:8; 4:17
3. Sheshbacari, 1:8, 11; 5:14
4. Zerubabeli, 2:2
5. Jeshua, 2:2
6. Ahasueri, 4:6 (NIV, Kserksi)
7. Osnapari, 4:10 (NIV, Ashurbanipali)

X. VENDNDODHJET NË HARTË (sipas numrave)


1. Lumi Eufrat
2. Jerusalemi
3. Samaria
4. Ekbatana, 6:2

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Ç’lidhje ka Sheshbacari me Zerubabelin?
2. A i kundërvihet vargu 3:6 vargut 5:16?
3. Pse lista e Ezrës 2 rishfaqet në Neh. 7?
4. Cili është titulli karakteristik pers për Perëndinë, që përdoret shumë shpesh në librat e pas-robërisë për JHVH-në?
5. Për çfarë e nxitën popullin profetët Hagai dhe Zakaria (5:1)?
6. Pse ishte kaq i rëndësishëm dekreti i Kirit për judenjtë?
7. Çfarë ishin “martesat e përziera”? Pse ishin kaq të rëndësishme për Ezrën dhe Nehemian?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR NEHEMIAN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Ezra-Nehemia janë një libër në MT; titullohen “Era”. Shënimet e fundit të çdo libri në MT jepen vetëm në fund të Nehemias.
- B. Për një diskutim të plotë të emrave të ndryshëm me të cilët është quajtur ky libër në LXX dhe në Vullgatë, shih Hyrjen e Ezrës, I.
- C. Emri “Nehemia” do të thotë “JHVH ka dhënë ngushëllim”.

II. KANONIZIMI

- A. Libri Ezra-Nehemia është pjesë e ndarjes së tretë të kanonit hebraik, që quhet “Shkrimet”.
- B. Vendoset para Kronikave, gjë që është e habitshme, pasi nga ana historike/kronologjike, Ezra-Nehemia vjen pas rrëfimit historik të Kronikave. Disa janë përpjekur ta shpjegojnë në këtë mënyrë:
 - 1. Kronikat është përmbledhje nga Adami te Kiri.
 - 2. Ezra-Nehemia u pranua i pari si libër kanonik.
 - 3. Kronikat vendoset në fund për shkak se judenjtë donin që kanoni të përfundonte në mënyrë pozitive (me dekretin e Kirit).
 - 4. Askush nuk i di vërtet kriteret ose logjikën e formimit të pjesës së “Shkrimeve” në kanonin hebre.
- C. Botimi i parë hebraisht i MT, që i ndan këta libra, është në vitin 1448 pas K.
- D. Sidoqoftë, nga të dhënat e brendshme është e qartë se Ezra dhe Nehemia, në fillim, ishin dy libra të veçuar:
 - 1. lista e hollësishme gjenealogjike e Ezrës 2 përsëritet në Neh. 7:6-70. Emrat shqiptohen disi ndryshe;
 - 2. ka pjesë të shkruara në vetën e parë (“unë”) te Ezra 7:27-28; 8:1-34; 9:1 e më tej; pjesë të tilla gjenden dhe te Nehemia.
- E. Pse u kombinuan në një libër të vetëm?
 - 1. Formojnë një histori të vetme.
 - 2. Është thënë se arsyeja pse Ezra-Nehemia u kombinuan në një libër në kanonin hebre ishte që numri i librave të DHV të përputhej me numrin e bashkëtingëlloreve në alfabetin hebraisht. Kjo do të thotë se librat u kombinuan si më poshtë:
 - a. Gjyqtarët dhe Ruthi
 - b. Samueli
 - c. Mbretërve
 - d. Kronikave
 - e. Ezra-Nehemia
 - f. Jeremia-Vajtimet
 - g. Dymbëdhjetë Profetët e Vegjël
 - 3. Shërbesa e Ezrës, që nis në Ezra 7-10, vazhdohet në Neh. 8-10.
- F. Botimi i parë hebraisht i MT që i ndan në dy libra daton në vitin 1448 pas K.
- G. Është interesante se kanoni i hershëm sirian dhe Teodori i Mopsuestias (drejtues i shkollës së interpretimit antiokas) nuk i përmbajnë librat e Kronikave, Ezrën dhe Nehemian në listën e librave të tyre të frymëzuar.

III. GJINIA LETRARE

- A. Shih Ezra IV, D (ngjashmëria mes Ezerës, Nehemias dhe Kronikave)
- B. Shih Ezra IV, G (përdorimi i dokumenteve)

IV. AUTORËSIA

- A. Baba Bathra 15a thotë se Ezra-Nehemia është një libër i vetëm, i shkruar nga Ezra.
- B. Gemara thotë se Nehemia ndihmoi në shkrimin e libri (Ezra/Nehemia).

V. DATA

- A. Studiuesit e shekujve të 19-të dhe 20-të besojnë se librat e Ezra-Nehemias dhe Kronikave mund të jenë shkruar në shekullin e katërt para K., për shkak të arsyeve të mëposhtme:
 - 1. Një pasardhës i kryepriut Jozue, që shoqëroi Zerubabelin në kthimin e dytë (nën Kirin) ishte Jada; ai përmendet në Nehemia 12:10-11, 22.
 - 2. Ata thonë se ky Jada përmendet dhe nga Jozefusi (*Lashtësitë*, XI:30-27) si kryepri (351-331 para K.) në kohën e pushtimit të Palestinës nga Aleksandri i Madh më 333-332 para K.;
 - 3. Kjo lidhet me g jashtë brezat e Zerubabelit, të renditur në listën e 1 Kronikave 3:19-24;
 - 4. Shumica e këtyre studiuesve kanë përkrahur dhe mendimin se Ezra u kthye gjatë mbretërimit të Artakserksit II (404-358 para K.), ndërsa Nehemia u kthye gjatë mbretërimit të Artakserksit I (465-424 para K.);
 - 5. Neh. 12:26, 47 tregon një redaktor/përpilues të mëvonshëm.
- B. Studiuesit e mëvonshëm dhe konservatorë të shekullit të 20-të shprehen se data e këtyre tre librave është diku në shekullin e pestë para K., për shkak se:
 - 1. Jada i Neh. 12:10-11,22 ndoshta ishte:
 - a. Shumë i ri kur përmendet, dhe jetoi në moshë shumë të thyer. Ai nuk përmendet si kryepriut te Nehemia;
 - b. S'është i njëjti Jada, por është nipi me të njëjtin emër (shih *The Expositor's Bible Commentary*, vëll. 4, f. 596-586);
 - c. Jozefusi e ka shkurtuar gabimisht periudhën perse, për shkak se emrat e sundimtarëve persë përsëriten në shekullin e pestë dhe të katërt para K.:
 - i. Artakserksi
 - ii. Dari
 - 2. Gjenealogjia e Zerubabelit në 1 Kron. 3:19-24 shkon vetëm në:
 - a. Dy breza (Young & Harrison)
 - b. Katër breza
 - 3. Nuk aludohen ngjarjet madhore që prekën Palestinën në shekullin e katërt para K.:
 - a. Pushtimi i Aleksandrit të Madh (333-332 para K.)
 - b. Kryengritja që u shtyp nga Artakserksi III (358-338 para K.)
 - 4. Ka gjasa që, edhe sikur Jada të kishte jetuar në kohën e Aleksandrit të Madh, kjo listë e levitëve u shtua nga një redaktor i mëvonshëm i librit, që u përpoq ta përditësonte (Young). Mund të ketë të dhëna për një redaktor në frazën "në ditët e Nehemias", Neh. 12:26, 47.
 - 5. Ezra dhe Nehemia paraqiten sikur janë së bashku në Jerusalem, jo të ndarë nga monarkë të ndryshëm:
 - a. Leximi i ligjit, Neh. 8:9;
 - b. Kushtimi i murit të Jerusalemit, Neh. 12:26, 36.

VI. BURIME QË MBËSHTESIN KONTEKSTIN HISTORIK

- A. Papiruset elefantin (408 para K.) rendisin emrat e disa njerëzve të përmendur te Ezra/Nehemia:

1. Sanballati, guvernatori i Samarisë, Neh. 2:10, 19; 4:1;
2. Johanani, nipi i kryepriftit Eliashib, Nehemia 12:10-11, 22, 23;
3. Përmendja e veçantë e këtyre njerëzve vërteton se Ezra dhe Nehemia jetuan dhe vepruan gjatë mbretërimit të Artakserksit I (464-424 para K.)

- B. Papiruset samaritane na japin një listë të guvernatorëve të Sirisë nga Sanballat Horovici deri në shkatërrimin e qytetit nga Aleksandri i Madh më 332 para K. Ato tregojnë, gjithashtu, se ngjarjet e Nehemias 13:28 dhe ngjarjet e ngjashme të përmendura nga Jozefusi gjatë kohës së Sanballatit III nuk janë të njëjta.

VII. NJËSITË LETRARE (konteksti)

- A. Nehemia rindërton muret e Jerusalemit (e bëri qytetin më të vogël), 1:1-7:73:
1. Prezantimi në vetën e parë, 1:1-2:20;
 2. Muri u rindërtua brenda 52 ditëve, 3:1-6:19;
 3. Vëllai i Nehemias, Hanani, vihet në krye të qytetit, 7:1-73.
- B. Reformat shpirtërore të Ezrës (vijim i Ezrës 7-10), 8:1-10:39:
1. Ezra lexon Ligjin dhe populli përgjigjet, 8:1-9:4;
 2. Rishikim i veprave të JHVH-së në dobi të judenjve, 9:5-31;
 3. Populli lidhet me betim për të adhuruar JHVH-në dhe për të mbështetur tepullin e tij (ripërtëritja e besëlidhjes), 9:32-10:39.
- C. Reformat administrative të Nehemias, 11-13:
1. Kthimi i parë i Nehemias në Jerusalem, 11-12:
 - a. Vendosja e popullatës së Jerusalemit në qytet, 11:1-36;
 - b. Listat e priftërinjve dhe levitëve, 12:1-26, 44-47;
 - c. Kushtimi i mureve të Jerusalemit, 12:27-43.
 2. Kthimi i dytë i Nehemias në Jerusalem, 13:1-31
 - a. Shkeljet e besëlidhjes, 13:1-5
 - b. Reformat, 13:6-31:
 - (1) Tobia dëbohet nga dhomat e tempullit, 13:4-5, 8-9;
 - (2) Ofertat e tempullit, 13:10-14;
 - (3) Martesat e përziera, 13:1-3, 23-29;
 - (4) Nozullimet për tempullin, 13:30-31.

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Ky libër vijon historinë, që kishte nisur te Ezra. Të dy librat dokumentojnë rithemelimin e komunitetit të besëlidhjes në Vendin e Premtuar.
- B. Ezra merret me jetën shpirtërore të komunitetit të ri të besëlidhjes, ndërsa Nehemia merret me:
1. murin mbrojtës rreth qytetit;
 2. aspektin administrues të qytetit.
- C. Edhe Ezra, edhe Nehemia, merren me besnikërinë ndaj besëlidhjes (së Moisiut). Mëkatet e popullit të Perëndisë, përveç idhujtarisë, vijnë edhe në komunitetin e kthyer nga robëria.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

- A. Fjalë dhe fraza:
1. Kupëmbajtësi, 1:11 (NASB & NIV)
 2. Nisan, 2:1

3. “edhe dhelpira po të hipë mbi të, do ta rrëzojë murin përtokë”, 4:3 (NIV, “edhe sikur një dhelpër të ngjitej mbi të, do ta rrëzonte murin e tyre prej guri”)
4. “bijat tona detyrohen nën zgjedhë”, 5:5 (NIV, “... janë skllavëruar tashmë”)
5. “shkunda pjesën e përparme të rrobës”, 5:13 (NIV, “... palët e mantelit tim”)
6. një shtyllë reje, 9:12 (NASB & NIV)
7. buka e paraqitjes, 10:33 (NIV, “buka e shtruar në tryezë”)
8. e vazhdueshme..., 10:33 (NIV, “e rregullt”)
9. frytet e para, 10:35 (NIV, “frytet e para”)
10. hodhën short për të sjellë një në dhjetë vetë në Jerusalem, 11:1 (NASB & NIV)
11. “libri i Moisiut”, 13:1 (NASB & NIV)

B. Persona që duhen identifikuar shkurtimisht:


1. Hanani, 1:2
2. Amoniti Tobia, 2:10, 19
3. Huroniti Sanballat, 2:10, 19
4. Arabi Geshem, 2:19
5. Asafi, 11:17
6. Jeduthuni, 11:17
7. Artakserksi I, 13:6

X. VENDNDODHJET NË HARTË


1. Suza, 1:1
2. Ashdod, 4:7
3. “Kefirimi, në luginën e Onos”, 6:2 (NIV, “fshatrat në luginën e Onos”)

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Pse ishte kaq i trishtuar Nehemia?
2. Si e shprehu trishtimin e vet?
3. Pse Nehemia mori me vete ushtarë persë (2:9), ndërsa Ezra, jo?
4. Cila ishte detyra parësore e Nehemias?
5. Pse ishin kaq të zemëruar judenjtë e varfër me judenjtë e pasur (kap. 5)?
6. Përvijoj kapitullin 9 në lidhje me veprat e Perëndisë për popullin jude.
7. Rendit tiparet e Perëndisë në 9:17 dhe shpjegoji shkurtimisht.
8. Pse nuk donte askush të jetonte në Jerusalem (kap. 11)?
9. Pse ishte kaq i zemëruar Nehemia për shkak të martesave të përziera?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJJE PËR ESTERIN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Ka emrin e mbretëreshës perse.
- B. Emri i saj në hebraisht është Hadasa, që do të thotë shqipë (2:7). Kjo fjalë simbolizon gëzimin në popullin hebre (Zak. 1:8).
- C. Emri i saj në persisht do të thotë “yll”.

II. KANONIZIMI

- A. Ky libër e pati të vështirë të përfshihej në kanonin hebre:
 - 1. ndoshta, për shkak se nuk përmend:
 - a. asnjë emër të Perëndisë;
 - b. tempullin;
 - c. ligjin e Moisiut;
 - d. flijimet;
 - e. Jerusalemin;
 - f. lutjen (ndonëse kjo nënkuptohet)
 - 2. Pergamenat e gjetura në Detin e Vdekur më 1947 përmbajnë kopje (të pjesshme ose të plota) të çdo libri të DHV përveç Esterit
 - 3. Si Ruthi, ashtu dhe Asteri, nuk citohen në DHR
 - 4. Ka marrë vlerësime të ndryshme nga komentuesit:
 - a. Talmudi i Jerusalemit (Megila 7a) thotë se pjesa e “Profetëve” në kanonin hebre dhe pjesa e “Shkrimeve” mund të përfundojnë një ditë, kurse Torahu dhe Esteri, jo. Ato s’do të shkatërohen kurrë (marrë nga E. J. Young);
 - b. Maimonidi, komentuesi jude i mesjetës (1204 pas K.) tha se Esteri ishte e dyta pas Ligjit të Moisiut për nga rëndësia;
 - c. Martin Luteri, reformatori protestant, tha se duhej përjashtuar nga kanoni pasi ishte libër tepër judaizues (këtë mendim kishte dhe për Jakobin dhe Zbulesën).
 - 5. Ishte një nga librat e polemizuar, që u diskutuan në Javne nga farisenjtë pas vitit 70 pas K.
 - 6. Autori i “Ekleziastikut”, i quajtur dhe “Urtësia e Ben Sirahut”, që e shkroi librin rreth 180 para K., nuk e përmend kurrë Esterin.
 - 7. Duket se Esteri u përfshi në kanonin jude për të shpjeguar origjinën e festës jo-mozaike të Purimit (9:28-31). Në 2 Makabejeve 15:36, Purimi quhet “Dita e Mordekait”.
- B. Libri i Esterit bën pjesë në një listë të veçantë me pesë rrotulla/pergamena, të quajtur *Megilot*. Këta pesë libra të shkurtër: Ruthi, Predikuesi, Kënga e Këngëve, Vajtimit dhe Esteri, janë pjesë e “Shkrimeve”, një nënpjesë e kanonit hebre. Secili prej tyre lexohet në ditë të veçanta feste gjatë vitit. Esteri lexohet në Purim.
- C. Libri i Esterit ka dallime të konsiderueshme në versione MT dhe LXX. LXX është shumë më i gjatë dhe përfshin lutjet e Mordekait dhe Esterit. Këto mund të jenë shtuar si ndihmë që libri të pranohej në kanonin hebre.
- D. Këshillat e kishave në Hipo (393 pas K.) dhe Kartagjenë (397 pas K.) e ripohuan vendin e Esterit në Biblën e krishterë.

III. GJINIA LETRARE

- A. Është narrative historike (në 10:2, lexuesi nxitet që ta lexojë vetë historinë e Mordekait në dokumentet e oborrit pers.)

- B. Disa mendojnë se është fantazi historike (roman) për të zbuluar disa të vërteta shpirtërore
 1. përdor ironinë
 2. ka skenar të kujdesshëm
 3. protagonistët kryesorë nuk njihen në histori

IV. AUTORËSIA

- A. Ka patur shumë teori për autorësinë e këtij libri pa emër:
 1. Rabini Azaria thotë se e shkroi Joiakimi, kryepifti gjatë mbretërimit të Darit I, në fundin e shekullit të gjashtë para K.;
 2. Talmudi, Baba Bathra 15a, thonë se librin e Esterit e shkruan burrat e Sinagogës së Madhe. Me sa duket, këta ishin një grup drejtuesish në Jerusalem, i krijuar nga Ezra, që më vonë formuan Sinedrin. Ndonëse përdoret fjala “shkruan”, duket se ka kuptimin: “redaktuan”, “përpiluan”, ose “mblodhën”;
 3. Ibn Ezra, Klementi i Aleksandrisë dhe Jozefusi (*Lashtësitë*, 11:6:1) thonë se e shkroi Mordekai, por Esteri 10:3 duket se e kundërshton këtë gjë (përveçse nëse ky varg u shkrua nga një redaktor i mëvonshëm);
 4. Isidori dhe Augustini thonë se e shkroi Ezra.
- B. Është e qartë se askush s’e di. Duket e sigurt se u shkrua nga një jude në robëri në Persi, që e njihnte oborrin mbretëror pers.
- C. Ky autor i panjohur përdori disa burime:
 1. Kujtimet e Mordekait, 9:20;
 2. Dokumente historike perse, 2:23; 3:14; 4:8; 6:1; 8:13; 10:2;
 3. Ndoshta dhe tradita gojore, sidomos për atë që ndodhi nëpër provincat përreth;
 4. Nuk dihet për çfarë bën fjalë “libri” tek 9:32.

V. DATA

- A. Ky libër përmend një mbret pers, të quajtur Ahasuer, që në persisht do të thotë “burrë i fuqishëm”. Shumica e studiuesve bien dakord se ky është mbreti që, në histori, njihet me titullin grek Kserksi I (486-465 para K.)
- B. Mirëpo LXX dhe Jozefusi e quajnë “Artakserks”, që është titulli i pasardhësit të Kserksit, Artakserksi I (465-424 para K.)
- C. Esteri, kapitulli 1, ndoshta një sesion planifikues pers për pushtimin e Greqisë. Nga historiani i lashtë, Herodoti (2:8) dimë se Persia e pushtoi Greqinë dhe, pastaj, u shpor prej aty më 480 para K. Ai thotë se mbreti pers u kthye në vendin e vet, ku kalonte shumë më tepër kohë me haremin (9:108).
- D. Nga ana e kronologjisë biblike, ky libër e ka vendin mes kapitujve 6 dhe 7 të Ezrës. Në këtë pikë, në rrëfimin e Ezrës ekziston një hapësirë kohore prej 57 vitesh. Ezra, si person, nuk prezantohet para kapitullit 7.
- E. Esteri 10:1-3 nënkupton një kohë pas vdekjes së Kserksit I. Ai u vra më 465 para K.
- F. Një datë në fundshekullin e pestë para K. duket bindëse, për shkak të:
 1. formës së gjuhës hebraike të Esterit, që ngjason me gjuhën e Kronikave, Ezrës dhe Nehemias;
 2. praninë të fjalëve të huazuara nga persishtja;
 3. njohurisë së autorit për zakonet dhe jetën e oborrit pers. Një shembull i till është 1:6-8, 10.

VI. BURIME QË MBËSHTESIN KONTEKSTIN HISTORIK

- A. Pllakat kuneiforme nga Nipuri, të shkruara gjatë mbretërimit të Artakserksit I (465-424 para K.) vërtetojnë praninë e një popullsie të madhe judaike në Mesopotami pas kthimit të lejuar nga Kiri II më 538 para K.
- B. Historia e Herodotit:
 - 1. Historia e Herodotit për Kserksin I duket se përputhet me skenarin e Esterit:
 - a. Mblodhi asamblenë për të planifikuar pushtimin e Greqisë;
 - b. Pas disfatës, kaloi shumë më tepër kohë me haremin;
 - c. Kserksi përshkruhet si tekanjuz, despot dhe i dhënë pas pasioneve.
 - 2. Megjithatë, kjo është thikë me dy presa. Herodoti përmend dhe përshkruan edhe gruan e Kserksit I. Emrin e kishte Amestri, dhe vinte nga “familja e të shtatëve”. Mbreti pers kishte shtatë këshilltarë të ngushtë (1:14). Herodoti përmend faktin se Amestri e shoqëroi Kserksin I në fushatën greke.
- C. Pllakat elamite të Persepolit (gjatë mbretërimeve të Darit I dhe Kserksit I) përmendin emrin e Mordekait si zyrtar të portës.

VII. NJËSITË LETRARE (konteksti)

- A. NIV Study Bible jep një përvijim shumë të dobishëm. I përdor tri festat e Esterit si strukturë për të ndjekur rrëfimin e librit:
 - 1. Festa e Mbretit, 1:1-2:18;
 - 2. Festa e Esterit, 2:19-7:10;
 - 3. Festa e Purimit, 8-10.
- B. Për një përvijim të hollësishëm:
 - 1. NIV Study Bible, f. 719
 - 2. *Expositor's Bible Commentary*, vëll. 4, f. 796

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Me sa duket, libri shpjegon fillesat e festës së përvitshme (jo-mozaike) të Purimit (9:28-32). E vetmja festë tjetër e përvitshme jo-mozaike për judenjtë është Hanuka. Në f. 176 të NIV Study Bible gjendet një tabelë e dobishme.
- B. Ky libër ishte inkurajim për të qenë besnikë ndaj Perëndisë gjatë periudhave me përndjekje (sidomos për ata që ishin ende në robëri jashtë Izraelit).
- C. Tregon qartë dorën udhërrëfyese të Perëndisë në histori, jo vetëm në lidhje me Izraelin, por edhe me Persinë. Mospërmendja e emrit të Perëndisë apo e praktikave normale shpirtërore të judenjve (me përjashtim të agjërimit) është mjet letrar për të theksuar ndikimin dhe udhëheqjen e mistershme të Perëndisë në gjithë historinë njerëzore (4:14).
- D. Disa e shohin këtë libër si një tjetër përpjekje e Satanit për të shkatërruar komunitetin e Besëlidhjes dhe, në këtë mënyrë, Mesinë!
 - 1. Rënia e Adamit;
 - 2. Engjëjt përzihen me njerëzit (Zanafilla 6);
 - 3. Abrahami dhe Isaku mohojnë gratë e tyre;
 - 4. Shkatërrimi i popullit të judenjve në librin e Esterit.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

- A. Fjalë dhe fraza:

1. “shtatë eunukët”, 1:10 (NASB & NIV)
2. “shtatë princat e Persisë dhe Medisë”, 1:14 (NIV, “shtatë fisnikët...”)
3. “ligjet e Persisë dhe Medisë, ndaj nuk mund të anulohet”, 1:19 (NASB & NIV)
4. Konkubinat, 2:14 (NASB & NIV)
5. Agagit, 3:1, 10; 8:5 (NASB & NIV)
6. Pur, 3:7; 9:24 (NASB & NIV)
7. Unaza e vulës, 3:10; 8:2 (NASB & NIV)
8. Satrap, 3:12 (NASB & NIV)
9. “skeptri i artë”, 4:11; 5:2 (NASB & NIV)
10. “një trekëmbësh pesëdhjetë kubit i lartë”, 5:14; 7:9-10 (NIV, “shtatëdhjetë e pesë këmbë i lartë”)
11. “këto ditë të Purimit”, 9:28-32 (NASB & NIV)

B. Persona që duhen identifikuar shkurtimisht:

1. Ahasueri, 1:1 (NIV, “Kserksi”)
2. Vashti, 1:9
3. Mordekai, 2:5
4. Haman agigiti, 3:1


X. VENDNDODHJET NË HARTË – s’ka hartë

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Pse ishin kaq të zemëruar këshilltarët e mbretit nga refuzimi i Vashtit (1:16-22)?
2. Pse nuk u përkul para Hamanit Mordekai?
3. Pse donte Hamani që t’i shfaroste gjithë judenjtë për shkak se një jude i vetëm nuk u përkul para tij?
4. Çfarë arsyes i jep Hamani mbretit për shfarosjen e judenjve (kap. 3)?
5. Rendit ritet karakteristike të vajtimin të judenjve, që përmenden në 4:1-3.
6. Si lidhet doktrina teologjike e providencës me 4:14?
7. Si mund të lidhet 8:17 me qëllimin e librit?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR LETËRSINË E URTËSISË

I. GJINIA LETRARE

A. Lloji i përhapur letrar në Lindjen e Afërt të lashtë

1. Mesopotami (1 Mbre. 4:30; Isa. 47:10; Dan. 2:2)
 - a. Sumeria kishte një traditë të zhvilluar urtësie, si proverbiale, ashtu dhe epike (NIPPUR).
 - b. Urtësia proverbiale (pra, me fjalë të urta) e Babilonisë lidhej me priftin/magjistarin. Nuk kishte fokus moral. Nuk ishte gjini e zhvilluar letrare si në Izrael.
 - c. Edhe Asiria kishte traditë urtësie, mësimet e Ahikarit. Ai ishte këshilltar i Senakeribit (704-681 para K.).
2. Egjipti (1 Mbre. 4:30)
 - a. “Mësimet e Vezirit Ptah-hotep”, shkruar rreth 2450 para K. Mësimet e tij ishin në formë paragrafi, jo proverbi. Strukturoheshin si këshilla të atit për birin; e njëjta gjë vlen dhe për “Mësimet e Mbretit Meri-ka-re”, rreth 2200 para K.
 - b. Urtësia e Amen-em-opetit, shkruar rreth 1200 para K., është shumë e ngjashme me Fja. 22:17-24:22.
3. Fenikia
 - a. Zbulimet në Ugarit kanë treguar lidhjen e ngushtë mes urtësisë fenikase dhe asaj hebraike, sidomos në lidhje me metrikën. Shumë nga format e pazakonta dhe fjalët e rralla në letërsinë biblike të Urtësisë tani marrin kuptim nga zbulimet arkeologjike në Ras Shamra (Ugarit).
 - b. Kënga e Këngëve ngjason së tepërmi me këngët e dasmave fenikase, të quajtura *uasps*, të shkruara rreth 600 para K.
4. Kanan (Jer. 49:7; Abd. 8) – Albright ka zbuluar ngjashmërinë mes letërsisë së urtësisë hebraike dhe asaj kananease, sidomos me tekstet e Ras Shamrës në Ugarit, të shkruara rreth shekullit 15 para K.
 - a. shpesh, shfaqen të njëjtat çifte fjalësh
 - b. prania e kiazmës
 - c. kanë tituj hyrës
 - d. kanë shënime muzikore
5. Letërsia e urtësisë biblike përfshin shkrimet të disa joizraelitëve:
 - a. Jobi nga Edomi
 - b. Agri nga Masa (një mbretëri izraelite në Arabinë Sauditë [shih Zan. 25:14; dhe 1 Kron. 1:30])
 - c. Lemueli nga Masa

B. Tiparet letrare

1. Kryesisht dy lloje të veçanta
 - a. Proverbiale (fillimisht, gojore)
 - (1) Të shkurtra
 - (2) Kuptoheshin lehtësisht nga ana kulturore (përjetime të përbashkëta)
 - (3) Nxisnin mendimin – shprehje goditëse të së vërtetës
 - (4) Zakonisht, përdorin kontrastin
 - (5) Përgjithësisht të vërteta, por jo gjithmonë të zbatueshme në mënyrë të veçantë
 - b. Temë të veçantë, të zhvilluar në mënyrë më të zgjatur; veprat letrare (zakonisht, me shkrim) si Jobi, Predikuesi dhe Jona.
 - (1) Monologë
 - (2) Dialogë
 - (3) Ese
 - (4) Trajtojnë pyetjet madhore dhe misteret e jetës
 - (5) Të urtët ishin të gatshëm të sfidonin gjendjen teologjike “në vend numëro”!
 - c. Personifikimi i urtësisë (zakonisht, femërore). Fjala urtësi ishte në gjininë femërore.
 - (1) Shpesh, në Fjalët e Urta, urtësia përshkruhet si grua
 - (a) Pozitivisht:
 - 1) 1:20-33

2) 8:1-36

3) 9:1-6

(b) Negativisht:

1) 7:6-27

2) 9:13-18

(2) Në Fjalët e Urta 8:22-31, urtësia personifikohet si e parëlindura e krijimit, me anë të së cilës Perëndia krijoi gjithçka tjetër (3:19-20). Ky duket se ishte dhe sfondi i përdorimit të fjalës “logos” nga ana e Gjonit në Gjoni 1:1 për t’iu referuar Jezus Mesisë.

(3) Kjo mund të shihet dhe në librin e *Ekleziastikut* 24.

2. Kjo letërsi është e ndryshme nga Ligji dhe Profetët, pasi i flet individit, jo kombit. Nuk ka aludime historike apo kultike. Në radhë të parë, ajo përqendrohet në jetesën e përditshme, të suksesshme, të gëzueshme dhe morale.
3. Letërsia e urtësisë biblike ngjason me atë të kombeve fqinj për nga struktura, por jo nga përmbajtja. Perëndia i vetëm dhe i vërtetë është themeli mbi të cilin bazohet gjithë urtësia biblike (shih Jobi 12:13; 28:28; Fja. 1:7; 9:10; Psa. 111:10). (Në Babiloni, ishte Apsu, Ea ose Marduku. Në Egjipt, ishte Toti.)
4. Urtësia hebraike ishte shumë praktike. Bazohej te pervoja, jo te zbulesa e veçantë. Përqendrohej te suksesi i individit në jetë (gjithë jeta: e shenjtja dhe laikja). Këto janë këshilla të urta hyjnore.
5. Për shkak se letërsia e urtësisë përdorte arsyen, përvojën dhe vëzhgimet njerëzore, ishte ndërkombëtare, ndërkulturore. Ishte botëkuptimi fetar monoteist që, shpesh, nuk shprehet, ai që i dha vlerë zbuluese urtësisë së Izraelit.

II. FILLESAT E MUNDSHME

A. Letërsia e Urtësisë u zhvillua në Izrael si alternativë ose drejtpeshim i formave të tjera të zbulësës.

(Jer. 18:18; Ezek. 7:26)

1. Prifti – ligji – forma (kolektive)
2. Profeti – orakulli – motivi (kolektive)
3. I urti – urtësia – jeta e përditshme, praktike dhe e suksesshme (individ)
4. Ashtu si kishte profetesha në Izrael, kështu kishte dhe gra të urta (shih 2 Sam. 14:1-21; 20:14-22).

B. Kjo lloj letërsie duket se u zhvillua:

1. si histori popullore, që tregoheshin rreth zjarreve të kampit
2. si tradita familjare, që u transmetoheshin fëmijëve meshkuj
3. të shkruara dhe të mbështetura nga Pallati Mbretëror:
 - a. Davidi lidhet me Psalmet
 - b. Solomoni lidhet me Fjalët e Urta (1 Mbre. 4:29-34; Psa. 72 & 127)
 - c. Hezekia lidhet me redaktimin e letërsisë së urtësisë.

III. QËLLIMI

A. Në thelb, është “doracak” për lumturinë dhe suksesin. Në thelb, ka fokus individin. Bazohet në:

1. Përvojën e brezave të kaluar,
2. Marrëdhënien e shkakut dhe pasojës në jetë.

B. Ishte mënyra sesi shoqëria përçonte të vërtetën dhe përgatiste brezin e ardhshëm të krerëve dhe shtetasve.

C. Urtësia e DHV e sheh Perëndinë e Besëlidhjes pas gjithçkaje në jetë, ndonëse nuk e shpreh gjithmonë hapur.

D. Ishte një mënyrë për të sfiduar dhe drejtpeshuar teologjinë tradicionale. Të urtët ishin menditmarë të lirë, të palidhur nga të vërtetat e librave të traditës. Ata guxonin të pyesnin: “Pse?”, “Si?”, dhe “Po sikur?”

IV. ÇELËSA INTERPRETIMI

A. Shprehjet e shkurtra proverbiale

1. kërkohet elementet e zakonshme të jetës që shprehin të vërtetën.
2. shprehje të vërtetën qendrore me një fjali të thjeshtë shpallëse.
3. meqë konteksti nuk të ndihmon dot, kërkohet pasazhe paralele në Bibël për të njëjtën temë.

B. Pjesët më të gjata letrare

1. përpiku të shprehësh të vërtetën qendrore të gjithë pjesës.
2. mos i nxirr vargjet nga konteksti.
3. përpiku të gjesh rastin historik, ose arsyen e këtij shkrimi.

C. Disa keqinterpretime të zakonshme (Fee & Stuart, *How to Read the Bible for All Its Worth*, f. 207)

1. Disa nuk lexojnë gjithë librin e Urtësisë (p.sh., Jobin, ose Pred.), ose nuk kërkojnë të vërtetën qendrore të librit, por shkëpusin pjesë të librit nga konteksti dhe i zbatojnë në mënyrë të fjalëpërfjalshme në jetën e sotme.
2. Shumë njerëz nuk e kuptojnë natyrën unike të gjinisë letrare të urtësisë. Ajo ishte një urtësi tejet kompakte dhe e figurshme e Lindjes së Afërt në lashtësi.
3. Fjalët e urta janë shprehje të të vërtetave të përgjithshme. Janë përgjithësime; nuk janë shprehje të vërteta në çdo rast dhe çdo kohë.

V. SHEMBUJ BIBLIKË

A. Dhiata e Vjetër

1. Jobi
2. Psalmi 1, 19, 32, 34, 37, 49, 73, 104, 107, 110, 112, 127-128, 133, 147, 148
3. Fjalët e Urta
4. Predikuesi
5. Kënga e Këngëve
6. Vajtimet
7. Jona

B. Librat jashtëkanonikë

1. Tobiti
2. Urtësia e Ben Sirahut (Ekleziastiku)
3. Urtësia e Solomonit (Libri i Urtësisë)
4. IV Makabejve

C. Dhiata e Re

1. Fjalët e urta dhe shëmbëlltyrat e Jezusit
2. Libri i Jakobit

HYRJE PËR POEZINË HEBRAIKE

I. GJINIA LETRARE

- A. Kjo lloj letërsie përbën 1/3 e Dhiatës së Vjetër. Është tejet e përdorur në “Profetët” dhe “Shkrimet”, dy pjesë të kanonit hebre.
- B. Është shumë e ndryshme nga poezia anglisht. Poezia anglisht u zhvillua nga poezia greke dhe latine. Poezia hebraike ka shumë të përbashkëta me poezinë kanonite. Poezia e Lindjes së Lashtë nuk ka vargje të theksuara, metrikë apo rimë.
- C. Zbulimet arkeologjike në veri të Izraelit në Ugarit (Ras Shamra) i kanë ndihmuar studiuesit që ta kuptojnë poezinë e DHV. Kjo poezi, nga shekulli i 15-të para K., ka lidhje të qarta letrare me poezinë biblike.

II. TIPARET E PËRGJITHSHME TË POEZISË

- A. Është shumë e ngjeshur.
- B. Përpiqet t’i shprehë të vërtetat, ndjenjat, ose përvojat me figura letrare.
- C. Është kryesisht e shkruar, jo gojore. Është tejet e strukturuar. Kjo strukturë shprehet me:
 - 1. Vargje të drejtpeshuara (paralelizëm)
 - 2. Lojëra fjalësh

III. STRUKTURA

- A. Peshkopi Robert Lowth, në librin e tij, *Lectures on the Sacred Poetry of the Hebrews* (1753), ishte i pari që e karakterizoi poezinë biblike si vargje të drejtpeshuara mendimi. Shumica e përkthimeve të Biblës në anglisht formatohej për të treguar rreshtat e poezisë.
 - 1. Sinonimike – vargjet shprehin të njëjtin mendim, por me fjalë të ndryshme:
 - a. Psalmi 3:1; 49:1; 83:14; 103:3
 - b. Fjalët e Urta 20:1
 - c. Isaia 1:3
 - d. Amosi 5:24
 - 2. Antitetike – vargjet shprehin mendime të kundërta me anë të kontrastit, ose duke shprehur pozitiven dhe negativen:
 - a. Psalmi 1:6; 90:6
 - b. Fjalët e Urta 1:6, 29; 10:1, 12; 15:1; 19:4
 - 3. Sintetike – dy ose tre vargjet e mëtejshme zhvillojnë mendimin e të parit – Psa. 1:1-2; 19:7-9; 29:1-2
- B. A. Brigg, në librin e vet, *General Introduction to the Study of Holy Scripture* (1899) zhvilloi fazën tjetër të analizës së poezisë hebraike:
 - 1. Emblematiske – një rresht i fjalëpërfjalshëm, ndërsa tjetri, metaforik, Psa. 42:1; 103:3.
 - 2. Kulmore, ose në formë shkallësh – rreshtat e zbulojnë një të vërtetë në mënyrë të shkallëzuar ngjitëse, Psa. 19:7-14; 29:1-2; 103:20-22.
 - 3. Introverte, ose kiastike – një sërë rreshtash, zakonisht të paktën katër të tillë, lidhen me anë të strukturës së brendshme; rreshti 1 lidhet me 4, 2 me 3 – Psa. 30:8-10a
- C. G. B. Gray, në librin e vet, *The Forms of Hebrew Poetry* (1915) e zhvilloi më tej konceptin e rreshtave të drejtpeshuara si më poshtë:
 - 1. Drejtpeshimi i plotë – ku çdo fjalë e rreshtit të parë përsëritet ose drejtpeshohet nga një fjalë në rreshtin e dytë – Psami 83:14 dhe Isaia 1:3

2. Drejtpeshimi i paplotë – ku rreshtat nuk kanë të njëjtën gjatësi – Psa. 59:16; 75:6

D. Lloji i modeleve të tingujve

1. Loja me alfabetin (akrostik)
2. Loja me bashkëtingëlloret (aliteracion)
3. Loja me zanoret (asonancë)
4. Loja me përsëritjen e fjalëve (paranomasi)
5. Loja me fjalët që tingëllojnë ngjashëm (onomatopi)
6. Hapja dhe përmbyllja e veçantë (përfshirëse)

E. Ka një sërë llojesh poezie në Dhiatën e Vjetër. Disa lidhen me temat, ndërsa disa të tjera, me formën:

1. këngë kushtimi – Num. 21:17-18
2. këngë pune – (aludohen, por nuk shkruhen në Gjyq. 9:27); Isa. 16:10; Jer. 25:30; 48:33
3. balada – Num. 21:27-30; Isa. 23:16
4. këngë pijeje – negative, Isa. 5:11-13; Amosi 6:4-7; pozitive, Isa. 22:13
5. poema dashurie – Kënga e Këngëve, gjëagjzë dasme – Gjyq. 14:10-18, këngë dasme – Psa. 45
6. vaje – (aludohet, por nuk shkruhet në 2 Sam. 1:17 dhe 2 Kro. 35:25) 2 Sam. 3:33; Psa. 27, 28; Jer. 9:17-22; Vaj.; Ezek. 19:1-14; 26:17-18; Nah. 3:15-19
7. këngë lufte – Zan. 4:23-24; Eks. 15:1-18; Num. 16:35-36; Joz. 10:13; Gjyq. 5:1-31; 11:34; 1 Sam. 18:6; 2 Sam. 1:18; Isa. 47:1-15; 37:21
8. urata të veçanta, ose bekimi i drejtuesit – Zan. 49; Num. 6:24-26; LiP. 32; 2 Sam. 23:1-7
9. pasazhe magjike – Balami, Num. 24:3-9
10. poezi të shenjta – Psalmet
11. poezi akrostike – Psa. 9, 34, 37, 119; Fja. 31:10 e më tej, dhe Vajtimet 1-4
12. mallkime – Num. 21:22-30
13. bejthe qesëndisëse – Isa. 14:1-22; 47:1-15; Ezek. 28:1-23

IV. UDHËZIME PËR INTERPRETIMIN E POEZISË HEBRAIKE

- A. Gjej të vërtetën qendrore të strofës (i ngjason paragrafit të prozës.). RSV ishte përkthimi i parë modern që e identifikoi poezinë hebraike me anë të strofave; krahaso përkthimet moderne për të mësuar gjëra të dobishme.
- B. Identifiko gjuhën e figurshme dhe shprehe në formë proze. Mos harro se kjo lloj letërsie është tejet e ngjeshur; një pjesë e mirë i lihet lexuesit që ta mbushë.
- C. Sigurohu t'i lidhësh poezitë e gjata, që orientohen nga temat, me kontekstin e tyre letrare dhe historik.
- D. Gjyqtarët 4 & 5 është shumë i dobishëm për të parë sesi e shpreh poezia historinë. Gjyqtarët 4 është prozë, ndërsa Gjyqtarët 5 është poezi për të njëjtën ngjarje.
- E. Përpiqu të identifikosh llojin e paralelizmit, qoftë ky sinonimik, antitetik, apo sintetik. Kjo është tejet e rëndësishme.

HYRJE PËR JOBIN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Ky libër titullohet sipas protagonistit të vet. Jobi është emër shumë i përhapur. Kuptimi i tij është interpretuar kështu:
1. “ku është Ati”
 2. “armik”
 3. “ai që pendohet”
- B. Ky është një libër i fuqishëm, artistik dhe kuptimplotë:
1. Luteri tha se është “madhështor dhe sublim si asnjë libër tjetër i Shkrimit”.
 2. Tenisoni tha se është “poema më madhështore, e lashtë apo e sotme”.
 3. Karlajl tha: “Asgjë e shkruar në Bibël apo jashtë saj nuk barabitet dot me meritat e Jobit”.

II. KANONIZIMI

- A. Futet në pjesën e “Shkrimeve” të kanonit hebre.
- B. Në disa dorëshkrimet hebraisht vendoset pas librit të Ligjit të Përtërirë, për shkak se Jobi dhe Abrahami bëjnë pjesë në të njëjtën periudhë historike.
- C. Vendosja e tanishme e Jobit ndër librat poetikë të Biblës u bë për herë të parë nga Vullgata dhe u aprovua nga Këshilli i Trentit.

III. GJINIA LETRARE

- A. Jobi është pjesë e një gjinie letrare shumë të përhapur në Lindjen e Afërt të lashtë, e quajtur “letërsia e urtësisë”.
- B. Për shkak se libri është kryesisht poezi, me një hyrje (1-2) dhe përmbyllje (42) proze, ka patur shumë debat mes studiuesve për gjininë e tij letrare:
1. Narrativë historike
 2. Paraqitje dramatike e një tematike filozofiko-teologjike
 3. Shëmbëlltje
- C. Jobi ka njëfarë ngjashmërie letrare (por jo teologjike) me:
1. Një shkrim sumer, i quajtur “Jobi sumer”, që daton rreth 2000 para K.
 - a. Ankesë në vetën e parë
 - b. Për vuajtjen e pamerituar
 - c. I braktisur nga hyjnia
 - d. Kërkon dëgjim në gjyq
 - e. Zbulohet mëkati
 2. Një shkrim babilonas, i quajtur “Unë do të përlehtëj Zotin e urtësisë”. Nganjëherë, quhet “Jobi babilonas”, dhe daton rreth 1300-1100 para K.
 - a. Monolog në vetën e parë
 - b. I braktisur nga perënditë dhe nga miqtë
 - c. Rikthimi, në fund, i shëndetit dhe pasurisë
 3. Një shkrim babilonas, i quajtur “Dekalogu për mjerimin njerëzor”. Nganjëherë, quhet “Teodisia babilonase”, daton rreth 1000 para K.
 - a. Dekalog akrostik për vuajtjen
 - b. Midis vuajtësit dhe mikut
 - c. Miku mbron pikëpamjet tradicionale, ndërsa vuajtësi vë në dukje problemet e kësaj, si, për shembull, begatia e të ligjve

- d. Të gjitha problemet rrjedhin nga dështimi njerëzor në njëfarë pike
- 4. Një shkrim egjiptian, i quajtur “Protestat e një fshatari gojëtar”.
- 5. Një shkrim egjiptian, i quajtur “Polemikë me shpirtin, nga një njeri i lodhur nga jeta”. Quhet dhe “Polemikë për vetëvrasjen”.

D. Libri përmban disa lloje gjinish letrare. Nuk futet në një kategori të vetme.

- 1. monolog
- 2. dialog
 - a. me miqtë
 - b. me JHVH
- 3. prozë (në fillim dhe në përmbyllje)

IV. AUTORËSIA

A. Libri është anonim.

B. Baba Bathra 14b thotë se librin e shkroi Moisiu. Disa dorëshkrime hebraisht dhe përkthimi siriak, Peshita, e vendosin pas Ligjit të Përtërirë.

C. Ka mundësi që një filozof jude, mori jetën historike të Jobit dhe e modifikoi për të na mësuar një të vërtetë filozofike dhe teologjike.

D. Disa studiues mendojnë se poema, kapitujt 3-41, u shkrua nga një autor i lashtë, ndërsa prologu (1-2) dhe epilogu (42) në prozë u shtuan nga një redaktor i mëvonshëm.

Mirëpo, duhet patur parasysh se, për shkak të kulturës sonë perëndimore, ne nuk i kuptojmë plotësisht modelet dhe teknikat e shkrimit në Lindjen e Afërt të lashtë. Kodi i Hamurabit hapet dhe mbyllet me poezi, ndërsa në mes ka prozë.

E. Jobi si person

- 1. Jobi ishte person i hershëm historik, sepse:
 - a. Përmendet në Ezekieli 14:14, 20 dhe Jakobi 5:1
 - b. Emri i tij, ndonëse jo i njëjti njeri, shfaqet dhe në tekstet e Amarnës; tekstet e Mallkimeve Egjiptiane; tekstet e Marit dhe tekstet Ugarite
 - c. Njësia monetare e gjendur në 42:11, *kesita*, shfaqet vetëm në Zan. 33:19 & Joz. 24:32
- 2. Me sa duket, Jobi nuk ishte jude
 - a. Përdorimi i emrave të përgjithshëm për Perëndinë nga Jobi dhe miqtë e tij në bisedë
 - 1. *Elohim* (Perëndi), kapitujt 1-2 dhe 20, 28, 32, 34, 38
 - 2. *El* (Perëndi), shumë herë
 - 3. *Shadai* (i Plotfuqishmi), shumë herë
 - b. Duket se ishte njeri i mençur nga Edomi
 - 1. Uzi (Zan. 36:28; Jer. 25:20; Vaj. 4:21)
 - 2. Temani (Zan. 36:11)
 - 3. Krahasohet me “njeriun e lindjes” (Jobi 1:3; Jud. 6:3, 33; Isa. 11:14; Ezek. 25:4, 10)

V. DATA

A. Konteksti historik i librit përputhet me periudhën patriarkale të mijëvjeçarit të dytë para K. Disa shembuj janë:

- 1. Jobi vepron si prift i familjes (1:5)
- 2. Jeta e gjatë e Jobit – 140+ vjeç (42:16)
- 3. Stili gjysmënomad i jetesës, ku njerëzit mbarështonin kafshët shtëpiake.
- 4. Bandat shëtitëse të plaçkitësve sabeas dhe kaldeas (1:15, 17)
- 5. Jobi jetonte në qytet një pjesë të vitit, ndërsa pjesën tjetër të vitit rrinte me bagëtitë.

- B. Gjinia letrare e daton librin gjatë periudhës së prodhimit të letërsisë së urtësisë. Kjo i bie të ketë qenë nga koha e Davidit deri në mbretërit e Judës, në veçanti Hezekia.
- C. R. K. Harrison beson se datimi i shkrimit të këtij libri jo më vonë se fundi i shekullit të pestë para K. përputhet më së miri me të dhënat.

VI. KONTEKSTI HISTORIK

- A. Vendndodhja e Uzit është e paqartë. Ka patur dy teori kryesore:
 - 1. Në vendin e Edomit
 - a. i njohur për burrat e mençur, Jer. 49:7
 - b. një nga tre miqtë e tij është nga Temani, një qytet në Edom. Emrin e kishte marrë nga një pasardhës i Esaut, Zan. 36:15.
 - c. Uzi përmendet si pasardhës i Seit horitit, shih Zan. 36:20-30. Këta njerëz lidhen me zonën e Edomit.
 - d. Uzi identifikohet me Edomin në Vaj. 4:21.
 - 2. Në zonën e Aramit
 - a. stili letrar dhe fjalët aramaisht mbizotërojnë në librin e Jobit
 - b. prania e plaçkitësve kaldeas (1:17)
 - c. Zan. 10:23 e lidh Uzin me Aramin, shih Zan. 22:20-22
 - 3. Ka gjasa që emri “Uz” të ketë përfshirë disa fise në lindje të Palestinës, nga Arami në veri deri tek Edomi në jug.

VII. NJËSITË LETRARE

- A. Prologu në prozë (këshilli qiellor), 1-2
- B. Miqtë e Jobit, 3-37
 - 1. Vajtimi i Jobit, 3
 - 2. Tre ciklet e dialogut, 4-31
 - a. Cikli i parë, 4-14
 - (1) Elifazi, 4-5
 - (2) Jobi, 6-7
 - (3) Bildadi, 8
 - (4) Jobi, 9-10
 - (5) Zofari, 11
 - (6) Job, 12-14
 - b. Cikli i dytë, 15-21
 - (1) Elifazi, 15
 - (2) Jobi, 16-17
 - (3) Bildadi, 18
 - (4) Jobi, 19
 - (5) Zofari, 20
 - (6) Jobi, 21
 - c. Cikli i tretë, 22-31
 - (1) Elifazi, 22
 - (2) Jobi, 23-24
 - (3) Bildadi, 25
 - (4) Jobi, 26
 - (5) Përmbyllja e Jobit, 27
 - (6) Komentit i autorit (lavdërimi dhe misteri i urtësisë), 28
 - (7) Monologët e Jobit, 29-31
 - 3. Komentet e Elihut, 32-37
 - a. Prozë, 32:1-5

b. Poezi, 32:6-37:24

C. Perëndia i përgjigjet Jobit, 38:1-42:6

1. Perëndia i përgjigjet si krijues, 38-39
2. Perëndia i përgjigjet si Gjykatës, 40:1-2, 6—41:34
3. Jobi pendohet, 40:3-5 dhe 42:1-6

D. Epilogu në prozë, 42:7-17

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

A. Ky libër u shkrua për të drejtpeshuar teologjinë tradicionale të besëlidhjes (LiP. 27-29) se të drejtët janë të bekuar në këtë jetë, ndërsa të ligjtë ndëshkohen në këtë jetë. Kjo teologji tradicionale judaike komunikohet me anë të fjalimeve të tre miqve të Jobit. Është interesante, gjithashtu, të vërejmë se sfida e veçantë ndaj traditaes erdhi nga një djalë i ri, si Elihu, i cili kundërshtoi dhe qortoi publikisht edhe Jobin, edhe tre miqtë e tij më të vjetër.

B. Ky libër thotë se Perëndia është i drejtë dhe se, në fund, do ta vëjë gjithçka në vijë, ose në këtë jetë (rimëkëmbja e Jobit, 42:10-17), ose në tjetrën (14:7-17; 19:23-27).

C. Jo çdo vuajtje është rezultat i mëkatit personal, megjithëse këtë gjë e pohonin tre miqtë (shih 4:7-11; 8:3-7; 11:13-15; 15:12-16; 22:21-30). Kjo është botë e padrejtë dhe e rënë në mëkat. Nganjëherë të ligjtë begatohen (Psa. 73). Shpesh, të drejtët vuajnë. Satani e akuzon Jobin se ka besim te Perëndia për të patur përfitime prej tij.

D. Ky libër na bën të kuptojmë disa gjëra për sferën shpirtërore. Ekziston një akuzues, një kundërshtar i përcaktuar i njeriut. Satani është shërbëtor i Perëndisë, engjëll prokuror në DHV (shih A. B. Davidson, *An Old Testament Theology*, botuar nga T & T Clark, f. 300-306). Është e vështirë të kuptojmë pse fjala “Satan” ka një nyjë shquese. Ndoshta, tregon funksion, jo emër. Disa engjëj të ndryshëm përshkruhen si “kundërshtar”.

1. person njerëzor
 - a. 1 Sam. 29:4
 - b. 2 Sam. 19:22
 - c. 1 Mbre. 5:4
 - d. 1 Mbre. 11:14-22, 23-25
 - e. Psa. 71:13
 - f. Psa. 109:6, 20, 29
2. engjëllor
 - a. engjëlli i Zotit – Num. 22:21
 - b. Satani – Jobi 1-2, 1 Kro. 21:13; Zak. 3:1-2

E. Perëndia kurrë nuk ia zbulon Jobit arsyen e vuajtjeve të tij. Jeta është mister. Besimi në Perëndinë është më i rëndësishëm sesa informacioni!

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT (NASB)

A. Fjala dhe/ose fraza:

1. i panjollë, 1:1; 2:3 (NASB & NIV)
2. bijtë e Perëndisë, 1:6; 2:1 (NIV, “engjëjt”)
3. copë poçi, 2:8 (NIV, “copë poçi i thyer”)
4. Sheoli, 7:9; 11:8 (NIV, “varri”)
5. papirus, 8:11 (NASB & NIV)
6. Rahab, 9:13; 26:12-13 (NASB & NIV)
7. Abadon, 26:6; 28:22; 31:12 (NIV, “Shkatërrimi”)

8. shpengim, 33:24; 36:18 (NASB & NIV)
9. leviathan, 3:8; 41:1 (NASB & NIV)
10. behemoth, 40:15 (NASB & NIV)
11. teodisia

B. Persona:


1. “burrat e lindjes”, NASB (NIV, “gjithë populli i lindjes”) 1:3
2. Satani, 1:6
3. Sabeanët, 1:15
4. Kaldeasit, 1:17
5. I Plotfuqishmi (*Shadai*), 6:4, 14; 13:3; 22:3, 26
6. Elihu, 32:2

X. VENDNDODHJET NË HARTË


1. Uz, 1:1
2. Teman, 4:1
3. Edom

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Ç’do të thotë t’i druhesh Perëndisë? 1:1, 9; 28:28
2. A ishte i pamëkatë (i pafajshëm) Jobi? 1:1, 8, 22
3. Kush janë “burrat e lindjes”? 1:1
4. Në ç’periudhë e daton librin fakti se Jobi vepronte si prift i familjes së vet? 1:5
5. Ç’domethënie ka fakti se Satani është në qiell para Perëndisë? 1:6-12
6. Në ç’mënyra e akuzon Satani Jobin para Perëndisë? 1:6-12; 2:1-6
7. A na mësojnë pasazhet 14:7-17 dhe 19:23-29 ringjalljen fizike? Pse, ose pse jo?
8. A u përgjigjet Perëndia ndonjëherë pyetjeve të Jobit?
9. A e pranon Jobi, më në fund, se ka mëkatuar? 40:3-5; 42:1-6
10. Çfarë u thotë Perëndia që të bëjnë tre miqtë e Jobit? (42)
11. Ç’mesazh jep këmbëngulja e Jobit për pafajësinë e vet në lidhje me karakterin e Perëndisë? 40:8



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



HYRJE PËR PSALMET

I. EMRI I LIBRIT

- A. Në hebraisht, titulli është “Këngë Lavdërimi”, ose “Lavdet”, (*Tehillim*). Kjo është e habitshme, pasi shumë prej Psalmeve janë vajtime ose ankesa.
- B. Në LXX, titulli është “*psalmos*”, që do të thotë “nduk”. Kjo fjalë greke përdoret për psalmet në Luka 20:42; 24:44 dhe Veprat 1:20. Jo të gjitha psalmet synoheshin që të këndoheshin me vegla muzikore, por ky u bë titulli i gjithë librit në LXX.

II. KANONIZIMI

- A. Psalmet janë pjesë e ndarjes së tretë të kanonit hebraik, që quhet “Shkrimet”. Kjo pjesë e kanonit hebraik përbëhet nga:
 - 1. Letërsia e urtësisë
 - a. Jobi
 - b. Psalmet
 - c. Fjalët e Urta
 - 2. Librat e festave (*Megilot*)
 - a. Ruthi
 - b. Predikuesi
 - c. Vajtimet
 - d. Esteri
 - 3. Librat historikë
 - a. Danieli
 - b. Ezra
 - c. Nehemia
 - d. Kronikat
- B. Psalmet si koleksion gjenden në LXX dhe në Pergamenat e Detit të Vdekur.
- C. Psalmet citohen në DHR më shpesh se çdo libër tjetër i DHV.

III. GJINIA LETRARE

- A. Kjo formë letrare është e përhapur në Lindjen e Afërt të lashtë. Psalmet biblike kanë formën e himneve të Babilonisë, Egjiptit dhe Kananit. Studiuesit kanë parë një lidhje të ngushtë mes:
 - 1. Psalmi 104:20-30 dhe Himnit Egjiptian për Atonin (shekulli i 14 para K.)
 - 2. Psalmi 29 është pothuajse i njëjtë me një poezi ugarite kushtuar Baalit, me përjashtim të emrit të perëndisë.
- B. Zbulimi arkeologjik i teksteve të Ras Shamrës nga qyteti i Ugaritit tregojnë ngjashëmrinë mes poezisë kananite dhe Psalmeve.
- C. Forma letrare e Psalmeve është një gjini e lashtë letrare brenda Izraelit:
 - 1. Kënga e Moisiut, Eks. 15:1-17
 - 2. Kënga e Miriamit, Eks. 15:21
 - 3. Kënga e Izraelit, Num. 21:17-18
 - 4. Kënga e Deborahës, Gjyq. 5
 - 5. Kënga e Hanës, 1 Sam. 2:1-10
 - 6. Kënga e harkut, nga libri i Jasharit, 2 Sam. 1:17-27
- D. Tre forma kryesore:

1. psalmet e lavdërimit – zakonisht, fillojnë me një urdhër, si “Lavdëroni Zotin”, “këndojini Zotit”, etj.
2. psalmet e vajtimit – zakonisht, fillojnë me një thirrje si, “o Zot!”, e ndjekur nga një vajtim ose kërkesë
3. psalmet e urtësisë – të ngjashme me kategoritë e letërsisë së urtësisë

IV. AUTORËSIA

- A. Autorësia tradicionale e shumë prej Psalmeve jepet në titujt ose mbishkrimet e tyre. Ka dy mënyra si duhen konsideruar këta tituj:
1. janë pjesë e tekstit hebraisht dhe, si rrjedhojë, janë kanonikë. Mirëpo, Psalmet e gjetura në Pergamenat e Detit të Vdekur nuk i kanë këto tituj ose mbishkrime.
 2. nuk i vendosën autorët e frymëzuar, kështu që duhen parë si tradita të lashta, por jo si të vërteta të frymëzuara. Duket se të paktën dy prej tyre bien ndesh me pasazhe të tjera kanonike:
 - a. Titulli i Psa. 34 me 1 Sam. 21:10 e më tej
 - b. Titulli i Psa. 56 me 1 Sam. 21:10
 3. një tjetër problem është ai i parafjalës hebraisht “i”, që mund të kuptohet në mënyra të ndryshme:
 - a. “shkruar nga”
 - b. “shkruar për”
 - c. “shkruar [filanit]”
 - d. “i përket kohët së”
 - e. “nën drejtimin e”
- B. Përcaktimi që i bën MT autorëve të Psalmeve:
1. Davidi, (1 Sam. 16:16-18), (MT) autor i 73; (LXX) autor i 84; (Vullgata) autor i 53 psalmeve
 2. Anonim – 50 psalme: 1, 2, 10, 33, 43, 71, 91, 93-97, 104-107, 118-119, 135, 137, 146-150
 3. Asafi, drejtuesi i korit të Davidit (1 Kron. 15:16-17; 16:5) 12 psalme: 50, 73-83
 4. Bijtë e Korahut, familje muzikantësh levitë (1 Kron. 9:19; 15:17) 11 psalme: 42-49, përveç 43, 84-88 përveç 86
 5. Jeduthuni, drejtues kori levit, (1 Kron. 16:41-42; 25:1-3; 2 Kron. 5:12) 3 psalme: 36, 62, 77
 6. Solomoni, 2 psalme: 72, 127. “Shkruar nga”, “shkruar për”, “shkruar [filanit]”, “i përket”, “në kohën e”, ose “nën drejtimin e”.
 7. Moisiu, 1 psalm: 90
 8. Ezrahitët (1 Kron. 6:33; 15:17)
 - a. Etani, Psami 89 (disa mendojnë se ishte Abrahami) 1 Kron. 15:17, 19
 - b. Hemani, Psalmi 88 (gjithashtu, bir i Korahut) 1 Mbre. 4:31; 1 Kron. 4:31; 15:19
- C. Traditat e autorësisë sipas shkrimeve judaike
1. Baba Bathra 14b – “Davidi e shkroi librin e Psalmeve me ndihmën e dhjetë pleqve, me ndihmën e Adamit, të parin, dhe Melkicedekut, Abrahami, Moisiut, Hemanit, Jeduthutni, Asafit dhe tre bijve të Korahut”
 2. Sanhedrin 38b (Talmud) ia atribuon Psa. 139 Adamit dhe Psa. 110 Melkicedekut
- D. LXX ia atribuon disa Psalme Jeremias, Ezekielit, Hagait dhe Zakarisë (112, 126, 127, 137, 146-149).

V. DATA

- A. Datimi i Psalmeve është i vështirë për dy arsye:
1. Secili nga psalmet mori shkas shkriim nga një rast i veçantë
 2. Psalmet u mblodhën përmes një procesi redaktorial në pesë libra
- B. Psalmet përfshijnë poezi nga të gjitha periudhat e jetës së Izraelit:
1. Tradita judaike thotë:
 - a. Adami shkroi Psa. 139

- b. Melkicedeku shkroi Psa. 110
 - c. Abrahami shkroi Psa. 89
 - d. Moisiu shkroi Psa. 90
2. Bota studimore moderne i ka ndarë psalmet në tre periudha kryesore:
- a. Pararobërisë (librat I, II & IV)
 - b. Gjatë robërisë (libri III)
 - c. Pas robërisë (libri V)
- C. Është e qartë se shumë prej Psalmeve i atribuohen Davidit:
- 1. Davidi ishte kompozitor, muzikant dhe këngëtar, 1 Sam. 16:16-18
 - 2. Filloi dhe organizoi grupet muzikore të levitëve, ose këngëtarët e tempullit ,1 Kro. 15:1-16:43, 25:1-31; 2 Kro. 29:25-30
 - 3. Dy librat e parë të Psalmeve i atribuohen atij, Psa. 72:20
 - 4. Psalmet e tij gjenden në të pestë librat e Psalmeve

VI. STRUKTURA E LIBRIT TË PSALMEVE

- A. Nuk ka një tematikë ose motiv të përgjithshëm. Ka:
- 1. një hyrje të përgjithshme (tiparet e njeriut të drejtë) – Psa. 1 dhe ndoshta Psa. 2
 - 2. secili nga pesë ndarjet e librave përfundon me doksologji, 41:13; 72:18-19; 89:52; 106:48
 - 3. një përmbyllje e përgjithshme (doksologji) – Psalmi 150
- B. Tiparet e Pesë Librave
- 1. Libri 1 – Psalmet 1-41
 - a. Të gjithë, me përjashtim të katër psalmeve, i atribuohen Davidit (1, 2, 10, 33)
 - b. Mbizotëron JHVH si titull për Perëndinë, JHVH 273 herë, në dallim nga Elohim 15 herë
 - c. Ndoshta, koha e konfliktit të Davidit me Saulin
 - 2. Libri 2 – Psalmet 42-72 (72:20 tregon dorën e një redaktori)
 - a. Psalmet 42-49 u atribuohen bijve të Korahut (përveç 43)
 - b. Mbizotëron përdorimi i titullit Elohim për Perëndinë, Elohim 164 herë në dallim nga JHVH, 30 herë
 - c. Ndoshta, në kohën e Davidit si mbret
 - 3. Libri 3 – Psalmet 73-89
 - a. Psalmet 73-83, Asafi
 - b. Psalmet 84-88, bijtë e Korahut (me përjashtim të psalmit 86)
 - c. 26 psalme i atribuohen Davidit
 - d. JHVH, si titull i Perëndisë, 44 herë; Elohim, 43 herë
 - e. Ndoshta, gjatë krizës asiriane
 - 4. Libri 4 – Psalmet 90-106
 - a. Psalmet 101, 103, i atribuohen Davidit
 - b. Psalmet 90, i atribuohet Moisiut
 - c. Të gjithë të tjerët janë anonimë
 - d. JHVH përdoret 104 herë; Elohim, 7 herë
 - e. Ndoshta, gjatë krizës babilonase
 - 5. Libri 5 – Psalmet 107-150
 - a. Psalmi 119 është akrostik i gjatë për Fjalën e Perëndisë
 - b. JHVH, 236 herë; Elohim, 7 herë
 - c. Psalmet 146-150 janë psalme lavdërimi; të gjithë fillojnë me “Lavdëroni Zotin”
 - d. Ndoshta, shpresë në bekimet e ardhshme të Perëndisë
- C. Numërimi i Psalmeve ndryshon
- 1. Dorëshkrimet e MT
 - a. Berakot 9b - Psalmet 1 dhe 2 llogariten si 1
 - b. Shabat 16 – numri i plotë i psalmeve ishte 147 për t’iu përputhur viteve të jetës së Jakobit

2. LXX
 - a. Psalmi 9 dhe 10, së bashku, përbëjnë një psalm të vetëm akrostik
 - b. Psalmi 114 dhe 115, së bashku, përbëjnë Psamlet “Halel”
 - c. Psami 116 dhe 147 ndahen në dy psalme secili
 3. Numri i Psalmeve mund të ketë lidhje me ciklin e leximit të Shkrimeve në sinagogën e hershme
- D. Disa mënyra si t’i grupojmë Psalmet:
1. sipas tematikës, ose temës kryesore
 - a. himne lavdërimi
 - (1) për Perëndinë si krijues, 8, 19, 104, 139, 148
 - (2) për Perëndinë në përgjithësi, 33, 103, 113, 117, 134-116, 145-147
 - b. himne falënderimi, 9-10, 11, 16, 30, 32, 34, 92, 116, 138
 - c. vajtime/vaje/ankesa
 - (1) kolektive, 12, 14, 44, 53, 58, 60, 74, 49, 80, 83, 85, 89, 90, 94, 106, 123, 126, 137
 - (2) individuale, 3-7, 13, 17, 22, 25-28, 31, 35, 38-43, 69-71, 86, 88, 102, 109, 120, 130, 139-143
 - d. himne mbretërie
 - (1) Perëndia si mbret, 47, 93, 96-99
 - (2) Mbreti i Izraelit ose Mesia, 2, 18, 20, 21, 45, 72, 89, 101, 110
 - e. himne për Sionin, 46, 48, 76, 84, 87, 122
 - f. himne liturgjie
 - (1) ripërtëritje besëlidhjeje, 50, 81
 - (2) bekime priftërore, 134
 - (3) për Tempullin, 15, 24, 68
 - g. himne për urtësinë, 36, 37, 49, 73, 111, 112, 127, 128, 133
 - h. himne për besimin në besnikërinë e JHVH, 11, 16, 23, 62, 63, 91, 121, 131
 - i. dënimi i perëndive të rreme dhe idhujtarisë, 82, 115
 2. sipas autorit ose folësit
 - a. himne të Davidit, që përdorin kryesisht JHVH-në si emrin e Perëndisë, Psa. 1-41
 - b. himne të Davidit, që përdorin kryesisht Elohim-in si emrin e Perëndisë, Psa. 51-72
 - c. himne nga muzikantët dhe këngëtarët levitë të Davidit
 - (1) Korahu dhe bijtë, Psa. 42-49, 84-88
 - (2) Asafi dhe bijtë, Psa. 73-83
 - d. himne nga lavdëruesit, Psa. 111-118, 140-150
 - e. himne nga shtegtarët që shkojnë në Jerusalem për adhurim në ditë festash, Psa. 120-134
 3. sipas ngjarjeve historike në historinë e Izraelit, në bazë të titujve ose përmbajtjes së psalmeve, Psa. 14, 44, 46-48, 53, 66, 68, 74, 76, 79, 80, 83, 85, 87, 108, 122, 124-126 dhe 129
- E. Psalmë që kanë lidhje me njëra-tjetrën
1. Psalmi 14 dhe 53 janë njësoj, me përjashtim të emrit të Perëndisë
 - a. Psalmi 14 ka JHVH
 - b. Psalmi 104 ka Elohim
 2. Psalmi 103 dhe 104 kanë lidhje:
 - a. e njëjta hapje dhe mbyllje
 - b. Psa. 103 ka JHVH-në si Shpëtimtar dhe Shpengues
 - c. Psa. 104 ka Elohim-in si Krijues dhe Furnizues
 3. Psami 32 dhe 51 kanë lidhje me mëkatën e Davidit me Batshebën
 4. Psalmi 57:7-11 dhe 60:5-12 kombinohen në Psa. 109
 5. Psalmi 18 përsëritet në 2 Sam. 21:1-51
- F. Pse 150 psalme në 5 libra
1. ndoshta, 150 psalmet paralelizojnë 150 ndarjet që sinagoga i bënte Ligjit për lexim publik ditën e shabatit
 2. ndoshta, pesë librat paralelizojnë pesë librat e Moisiut.

VII. FJALË MUZIKORE NË LIBRIN E PSALMEVE

- A. Fjalë muzikore në mbishkrimet, që përdoren për të përshkruar llojet e ndryshme të psalmeve
1. *MIZMOR* do të thotë “nduk”. Këto ishin psalme që duheshin kënduar dhe shoqëruar me vegla muzikore. Ka 57 të tillë.
 2. *SHIR* nënkupton këngë të çdo lloji. Ka 30 të tilla.
 3. *MASKIL* nënkupton këngë të një mjeshtërie të veçantë, ose psalme mësimdhënëse. Ka 30 të tillë.
 4. *MIKTAM* – kuptimi i kësaj fjale është i paqartë. Nga një rrënjë e mundshme fjale hebraisht, mund të ketë kuptimin “i artë”, ose “i çmuar”; nga një rrënjë akadisht, mund të ketë kuptimin “i fshehur”, ose “i pabotuar”; nga një rrënjë arabisht, mund të ketë kuptimin “shlyej”, ose “fal”. Ka 6 të tillë.
 5. *PALAL* do të thotë lutje. Përdoret për të përshkruar psalmet e DAVIDIT në librat I & II (shih Psalmi 72:20). Gjetet dhe në mbishkrimin e Psal. 17, 86, 90, 102, 142 dhe, ndoshta, 122.
- B. Fjalët muzikore që përshkruajnë ekzekutimin ose këndimin e Psalmeve:
1. *SELAH* përdoret 71 herë në 39 psalme, si dhe në Hab. 3:3, 9, 13. Kuptimi i saj është i paqartë. Ka patur disa teori:
 - a. Nga LXX, “interlud” për meditim ose efekt dramatik
 - b. Nga rrënja e fjalës hebraisht “ngre”, domethënë, ngritje ose forte
 - c. Rabinët thonë se është shprehje pohuese, si “Amen”, dhe do të thotë “përjetë”.
 2. *SHIGAION* ose *SHIGIONOT*, përdoret në Psal. 7 dhe Hab. 3. Është fjalë vaji ose kuje, që shpreh trishtim. Ka formë poetike tejet emocionale.
 3. *NEGINOT* përdoret 6 herë; dhe në Hab. 3:19. Do të thotë “vegla me tela”.
 4. *SHEMINIT* përdoret dy herë. Mund të ketë kuptimin “në oktavë”, ose “në të tetën”. Është e kundërta e Alamotit, prandaj, mundësisht ishte për zëra meshkujsh (shih 1 Kro. 15:21).
 5. *ALAMOT* përdoret 4 herë. Bëhet fjalë për zërat soprano të femrave (shih 1 Kro. 15:20).
 6. *MEKILOT* përdoret 3 herë. Do të thotë “me vegla frymore”.
 7. *GITIT* përdoret 3 herë. Do të thotë “me harpë”.
 8. Përmenden disa herë muzika me emër, Psal. 9, 22, 45, 53, 56, 57-59, 60, 62, 69, 75, 77, 80, 88

VIII. QËLLIMI I PSALMEVE

- A. Izraeli besonte se gjithë jeta ka lidhje me Perëndinë me anë të besëlidhjes. Psalmet janë mënyra sesi njeriu i shpreh Perëndisë ndjenjat më të thella për jetën.
- B. Izraeli besonte në një Perëndi të vetëm dhe personal e të dashur. Besimi nuk ishte diçka liturgjike apo kredore, por ishte personal dhe i përditshëm. Forma poetike e Psalmeve na ndihmon t’ia shprehim jetën fetare Perëndisë. Protagonisti kryesor i DHV është Perëndia!
- C. Të gjitha psalmet mund të kenë lindur si shprehje individuale besimi, por më vonë u përdorën nga gjithë komuniteti i besimit (shih Psal. 23; 139, etj.).

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

- A. Fjalë dhe/ose fraza:
1. “veçoj” (*kadosh*) 4:3 (NASB & NIV)
 2. “besoj” (*emet*) 4:5 (NASB & NIV)
 3. “bëje udhën tënde të drejtë” 5:8 (NASB & NIV)
 4. “dashamirësia” (*hesed*) 6:4 (NIV, “dashuri që nuk shteron”)
 5. “pendohem” 7:12 (NIV, “ndërroj mendje”)
 6. “biri i njeriut”, 8:4 (NASB & NIV)
 7. “shpëtim”, 9:14 (NASB & NIV)
 8. “gropa”, 9:15 (NASB & NIV)

9. “kupa”, 11:6; 75:8 (NIV, “pjesa e caktuar”)
10. “drejtësi”, 15:2 (NIV, “i drejtë”)
11. “kerubin”, 18:10 (NIV, “kerubim”)
12. “si këmbët e drerit”, 18:33 (NIV, “këmbët e drenushës”)
13. “shpengues”, 19:14 (NASB & NIV)
14. “short”, 22:18 (NASB & NIV)
15. “lugina e hijes së vdekjes”, 23:4 (NASB & NIV)
16. “në hijen e krahëve të tu”, 57:1; 91:4 (NASB & NIV)
17. “thesi”, 69:11 (NASB & NIV)
18. “libri i jetës”, 69:28; 139:16 (NASB & NIV)
19. “vende të rrëshqitshme”, 73:18 (NIV, “terren i rrështiqshëm”)
20. “brirët e të ligjve”, 75:10 (NASB & NIV)
21. “vende të larta”, 78:58 (NASB & NIV)
22. “Rahabi”, 89:10 (NASB & NIV)
23. “priti”, 118:10, 11, 12 (NASB & NIV)
24. “guri i qoshes”, 118:22 (NIV, “guri i majës”)
25. “brirët e altarit”, 118:27 (NASB & NIV)

B. Persona:


1. Zoti i ushtrive (JHVH Sabaoth) NASB, 24:10 (NIV, “Zoti i plotfuqishëm”)
2. Jeduthun, 62 hyrje (NASB & NIV)
3. Ishmaelitët, 83:6 (NASB & NIV)
4. Melkicedeku, 110:4 (NASB & NIV)

X. VENDNDODHJET NË HARTË


1. Sion, Psa.2:6
2. Bashan, 22:12
3. Kadesh-Barnea, 29:8 (NIV, “Kadesh”)
4. Mali Hermon, 42:6 (NIV, “Lartësitë e Hermonit”)
5. Shiloh, 78:60
6. Mali Tabor, 89:12
7. Baal-Peor, 106:28 (NIV, “Baali i Peorit”)

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Pse Psa. 2 konsiderohet psalm universal dhe mesianik?
2. Përshkruaj metaforat e ndryshme që përdoren për të përshkruar Perëndinë në Psa. 18:1-2.
3. Rendit dy llojet e zbulesës që gjenden në Psa. 19 dhe shpjego.
4. Çfarë përshkruan Psa. 22 në kuptimin profetik?
5. Shpjego sfondin historik të Psa. 32 & 51.
6. Për çfarë flet Psa. 38 (me fjalët e tua)?
7. Shpjego metaforën e Psa. 42:1.
8. Shpjego për çfarë flet 51:11-12.
9. Ç’do të thotë t’i druhesh Zotit? 67:7
10. Çfarë problemi të jetës trajton Psa. 73?
11. Çfarë ka të pazakontë struktura e Psa. 119? Cila është tema e përgjithshme e tij?
12. Çfarë problemi të jetës trajton Psa. 139?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR FJALËT E URTA

I. EMRI I LIBRIT

- A. Në hebraisht, titulli vjen nga shtatë vargjet e para dhe nga tema kryesore, v. 7.
- B. Në LXX, quhet “fjalët e urta të Solomonit”.
- C. Në Vullgatë, quhet “libri i fjalëve të urta”.
- D. Titulli shqip vjen nga fjala hebraisht *mashal*, që ka kuptimin “të jesh si [diçka]”. Fjalët e Urta ishin shprehje të shkurtra, mendimnxitëse, zakonisht me dy rreshta.

II. KANONIZIMI

- A. Është pjesë e ndarjes së tretë të kanonit hebre, që quhet “Shkrimet”.
- B. Talmudi, Baba Bathra 14b, thotë se rendi i librave të urtësisë ishte Psalmet, Jobi dhe Fjalët e Urta.
 - 1. Autorësinë e librit të Jobit ia atribuon Moisiut
 - 2. Psalmet ia atribuon Davidit
 - 3. Fjalët e Urta ia atribuon Hezekias
- C. Rabinët thoshin se Solomoni, që ishte i famshëm për urtësinë e vet, shkroi tre libra:
 - 1. Këngën e Këngëve, kur ishte i ri,
 - 2. Fjalët e Urta, kur ishte mesoburrë,
 - 3. Predikuesin, kur ishte i moshuar dhe i pezmatuar. Kjo traditë shprehej me anë të grupimit të këtyre tre librave së bashku në LXX.

III. GJINIA LETRARE

- A. Fjalët e Urta janë një lloj i specializuar letërsie urtësie.
- B. Ka disa lloje thëniesh të fjalëve të urta (shih Clyde, Francisco, *Introducing the Old Testament*, f. 265).
 - 1. fjalët e urta historike – këto janë thënie të famshme dhe popullore të së shkuarës, që shndërrohen në truizma të së tashmes.
 - 2. fjalët e urta metaforike – këto janë thënie me dy rreshta, që krahasojnë gjëra:
 - a. duke përdorur krahasime, “si”
 - b. duke përdorur kontrastin
 - 3. enigmat – këto janë gjëza ose pyetje ngacmuese.
 - 4. fjalët e urta si shëmbëlltyra – këto janë krahasime ose kontraste më të gjata dhe më të zhvilluara.
 - 5. fjalë të urta didaktike – këto janë të vërteta, që synojnë të stërvisin djemtë e rinj për shërbim qeveritar ose udhëheqje.
- C. Fjalët e urta përmbajnë paralelizëm, si Psalmet:
 - 1. paralelizmi sinonimik – Fja. 8:1
 - 2. paralelizmi antitetik – Fja. 28:1
 - 3. paralelizmi sintetik – Fja. 26:1

IV. AUTORËSIA

- A. Fjalët e urta tradita i ka lidhur me Solomonin, ndërsa Psalmet, me Davidin. Kjo ishte për arsye se Solomoni ishte i famshëm për urtësinë e vet (shih 1 Mbre. 3:12; 4:29-34; 10:1), si dhe për faktin se emri i Solomonit përmendet në Fja. 1:1; 10:1 dhe 25:1.

- B. Fjalët e urta janë rezultat i përpilimit redaktorial, si Psalmet. Përmenden disa autorë:
1. Solomoni – 1:1; 10:1; 25:1
 2. të urtët (të mençurit) – 22:17; 24:23
 3. Aguri – 30:1
 4. Lemueli – 31:1
- C. Procesi redaktorial i Fjalëve të Urta mund të shihet në 25:1, ku thuhet se burrat e oborrit të Hezekias mblodhën fjalët e urta të Solomonit. Ndoshta, shumë prej këtyre fjalëve të urta qarkullonin gojarisht përpara këtij momenti.
- D. Kapitujt 30 & 31 janë shkruar nga burrat e Masës. Ka patur njëfarë polemike ndër përkthyesit për këtë fjalë. Shumë versione të sotme anglisht e përkthejnë “orakull” ose “barrë”. Shoqëria e Botimit Judaik të Amerikës e përkthen si emër vendi. Kjo fjalë, *MASSA*, përdoret për një mbretëri ishmaelite në Arabinë Saudite (shih Zan. 25:14; dhe 1 Kro. 1:30).
- E. Ekziston një ngjashmëri e qartë mes “Fjalëve të të Urtëve” (22:17-24:22) dhe “Udhëzimit të Amenemopit”, që daton më 1200 para K. në Egjipt. Për një diskutim të plotë, shih John H. Walton, *Ancient Israelite Literature in Its Cultural Context*, Grand Rapids: Zondervan, 1990, f. 192-197.

V. DATA

- A. Data e këtij libri ka të njëjtin problematikë si Psalmet. Duhet patur parasysh dy data:
1. data e fjalëve të urta të ndryshme,
 2. data kur u mblodhën në një libër të vetëm kanonik.
- B. Shumë prej fjalëve të urta vijnë nga koha e Solomonit, sidomos 10:1-22:16 dhe 25:1-29:27.
- C. Ka shumë ngjashmëri mes fjalëve të Agurit në kapitullin 30 dhe teksteve të Ras Shamrës në gjuhën ugarite. Këto tekste u shkruan në shekullin 15-të para K.
- D. Libri kanonik i Fjalëve të urta, kapitujt 1-29, u përpilua gjatë kohës së Hezekias (710-687 para K.). Dy kapitujt e fundit u shtuan më vonë.

VI. KONTEKSTI HISTORIK

VII. NJËSITË LETRARE

- A. Titulli i librit, 1:1-6
- B. Shprehja e tematikës, 1:7
- C. Lavdërimi i urtësisë (personifikim), 1:8-9:18
- D. Fjalët e urta të Solomonit (çift vargësh me kuptim të kundërt), 10:1-22:16
- E. Fjalët e të urtëve (të ngjashme me urtësinë egjiptiane), 22:17-24:22
- F. Të tjera fjalë të të urtëve, 24:23-34
- G. Fjalët e urta të Solomonit (tematike), 25:1-29:27
- H. Fjalët e Agurit (si përgjigje ndaj një agnostiku), 30:1-33
- I. Fjalët e Lemuelit (nga e ëma), 31:1-9

J. Lavdërimi i gruas së perëndishme (akrostik), 31:10-31

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Ndonëse nuk shprehet shpesh, Fjalët e urta bazohen në konceptin e një Perëndie personal të monoteizmit, i cili është veprues në krijim dhe në jetën e besimtarit si individ (shih 1:7; 3:5-6; 9:10; 14:26-27; 19:23).
- B. Kjo lloj letërsie synohet si drejtpeshim ndaj (shih Jer. 18:18; Ezek. 7:26):
1. “Ligjit” (priftërinjve)
 2. “Profetëve” (profetëve)
- Nuk synon të trajtojë historinë ose kultin e Izrelit, por lumturinë, moralin dhe jetesën e suksesshme të izraelitëve si individë.
- C. Në fillim, synonte të edukonte djemtë e rinj të pasur për shërbim qeveritar, ose për udhëheqje të komuniteteit (shih 1:8-9).
- D. Janë mësimet të frymëzuara për jetesën e përditshme, praktike dhe të perëndishme. Mund të karakterizohen si “logjikë praktike hyjnore”.
- E. Duhet kujtuar se Fjalët e urta janë shprehje të përgjithshme të së vërtetës. Nuk shpjegojnë ose nuk marrin gjithmonë parasysh problemet ose rrethanat e individit.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe/ose fraza:

1. fjalë të urta (*mashal*), 1:1 (NASB & NIV)
2. urtësi (*hokmah*), 1:2 (NASB & NIV)
3. frika e Zotit, 1:7 (NASB & NIV)
4. “urtësia bërtet në rrugë”, 1:20 (NIV, “urtësia këlthet në rrugë”)
5. “naivët... tallësit... budallenjtë”, 1:22 (NIV, “të thjeshtët... tallësit... budallenjtë”)
6. gruaja e huaj, 2:16 (NIV, “kurorëshkelësja”)
7. “ajo është pemë jete”, 3:18 (NASB & NIV)
8. “neveri para Zotit”, 3:32; 17:15 (NIV, “Zoti përçmon”)
9. “pi nga cisterna jote”, 5:15 (NASB & NIV)
10. “zotim”, 6:1 (NIV, “garanci”)
11. njeriu i pavlerë (*belial*), 6:12 (NIV, “batakçiu”)
12. “Zoti më zotëroi që në fillim të udhës së tij”, 8:22 (NIV, “Zoti më shkaktoi si të parën e veprave të tij”)
13. “Sheoli dhe Abadoni rrinë të hapur para Zotit”, 15:11; 27:20 (NIV, “Vdekja dhe Shkatërrimi rrinë të hapur para Zotit”)
14. shpengimtar (*Go’el*), 23:11 (NIV, “mbrojtësi”)
15. fajde, 28:8 (NIV, “interes tejet i lartë”)
16. orakull (*massa*), 30:1; 31:1 (NASB & NIV)


B. Persona:

1. burrat e Hezekias, 25:1
2. Agur, 30:1
3. Itiel, Itiell dhe Ukal, 30:1
4. Lemuel, 31:1


X. VENDNDODHJET NË HARTË – s’ka

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Cili është dallimi mes fjalëve hebraisht “urtësi” dhe “njohuri”?
2. Pse është kaq i rëndësishëm 1:7?
3. Pse personifikohet urtësia si grua?
4. Cili ishte roli i urtësisë në krijim? (shih 3:19; 8:27)
5. Shpjego “dy udhët” (4:10-19).
6. Shpjego lutjen e 30:7-9.
7. Rendit cilësitë e gruas së perëndishme në 31:10-31.



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



HYRJE PËR PREDIKUESIN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Emri hebraisht ishte fraza “Fjalët e *Koheletit*, birit të Davidit, mbret në Jerusalem” nga 1:1. Përcaktimi shkurt ishte *Koheleti*, që përdoret për Solomonin në 1 Mbre. 8:1. Është pjesore femërore nga fjala hebraisht *Kahal*, “bashkësi”, ose “asamble”.
- B. Libri u quajt “Ecclesiastes” (në anglisht), që është formë e latinizuar nga LXX. Kjo është fjala greke, që përkthehet “ai që mbledh”, nga rrënja “thërras”.
- C. Fjala *Kohelet* mund të ketë kuptimin:
 - 1. Ai që mbledh një grup dëgjuesish, pra, mësuesi, predikuesi, debatuesi, etj.
 - 2. ndoshta, metaforë për një njeri që mbledh të vërteta, filozof, ose i urtë.

II. KANONIZIMI

- A. Predikuesi është shembull i një lloj letërsie urtësie. Është trajtim i zgjatur i një tematike, si Jobi.
- B. Është pjesë e ndarjes së tretë të kanonit hebre, që quhet “Shkrimet”.
- C. Po kështu, është pjesë e një grupi të veçantë prej pesë librash të vegjël, që quhen *Megilot*, ose “pesë pergamenat”. Secili prej tyre lexohej në një ditë të përvitshme feste. Predikuesi lexohej në festën e Kasolleve, ose Çadrave.
- D. Për shkak të natyrës radikale të këtij libri, u refuzua nga shkolla konservatore rabinike e Shamait, por mbrohej nga shkolla liberale rabinike e Hilelit. Ky debat vijoi deri në kohën e Javnes, pas rënies së Jerusalemit (70-90 pas K.).
- E. Disa nga librat kanonikë të DHV u pranuan me vështirësi:
 - 1. Predikuesi – fryma e pezmatuar, negative dhe jotradicionale
 - 2. Kënga e Këngëve – miratimi i dashurisë fizike
 - 3. Esteri – nuk përmend Perëndinë, tempullin jude, apo vendet judaike
 - 4. Ezekieli – tempulli i tij ndryshon nga ai i Mosiut
 - 5. dhe, deri në njëfarë mase, Danieli – profecitë apokaliptike të kapitujve 7-12
- F. Predikuesi, në fund, u pranua për shkak se:
 - 1. Mendohej që autor ishte Solomoni,
 - 2. Ka përmbyllje tradicionale,
 - 3. Tingëllon i vërtetë nga ana e përvojës njerëzore dhe zbulon përshtjellimin që kishte kapluar komunitetin jude pas robërisë.

III. GJINIA LETRARE

- A. Ashtu si Jobi, edhe Predikuesi duhet interpretuar në tërësi. Deri në kapitullin 12 përmban një sarkazëm të vazhdueshme.
- B. Është një vështrim qesëndisës dhe ironik i jetës pa Perëndinë. Fraza kyçe është “nën diell”, 1:3, 9, 14; 2:11, 17, 18, 19, 20, 22; 3:16; 4:1, 3, 7, 15; 5:13, 18; 6:1, 5, 12; 7:11; 8:9, 15, 17; 9:3, 6, 9, 11, 13; 10:5; 11:7; 12:2 (31 herë).

IV. AUTORËSIA

- A. Libri është anonim.

- B. Tradita judaïke thotë se ishte një nga tre librat e shkruar nga Solomoni: (Midrash Shir hashherem Rabbah I, 1, pjesa. 10)
1. Këngën e Këngëve e shkroi kur ishte i ri,
 2. Fjalët e Urta, kur ishte mesoburrë,
 3. Predikuesin, kur ishte i moshuar dhe i pezmatuar.
- C. Solomoni është, pa dyshim, kontrasti letrar i kapitujve 1-2, për shkak të urtësisë, pasurisë dhe pozitës së tij shoqërore. Por ka disa shenja që ndoshta tregojnë se ai s'është autori i vërtetë:
1. Në 1:12, "unë isha mbret i Izraelit në Jerusalem" (NIV) – në kohën e shkruar
 2. Në 1:16, "... më shumë se gjithë ata që drejtuan Jerusalem para meje" (NASB) – para Solomonit ishte vetëm Davidi
 3. Në 4:1-3, 5:8 dhe 8:9, abuzimi qeveritar diskutohet si diçka e pashpresë.
 4. Emri i Solomonit nuk shfaqet asnjëherë në libër.
- D. Për një argumentim studimor për autorësinë e Solomonit (shih *Introduction to the Old Testament*, nga C. F. Keil, vëll. 1, f. 516-529).
- E. Baba Bathra 15a thotë se Fjalët e Urta, Predikuesi dhe Kënga e Këngëve u shkruan nga burrat e Hezekias, por, qartazi, me këtë nënkupton se ata redaktuan ose mblodhën librat e urtësisë.
- F. Fjala *Kohelet* mund të jetë, ose emër i përveçëm, ose titull. Ngjan si titull për shkak se:
1. ka një shquese në 7:27 dhe 12:8,
 2. është emër femëror, që nënkupton ofiq, por përdor folje mashkullore,
 3. është fjalë e rrallë, që gjendet vetëm shtatë herë, dhe vetëm në këtë libër.
- G. Pjesa e vetme e librit që tregon shenjat e një autori ose redaktori të mëvonshëm është 12:9-14. Qartazi, ai ishte burrë i mençur, mësues urtësie.
- H. Paradokset ose kontradiktat në dukje janë shpjeguar kështu:
1. Sarkazëm, jeta pa Perëndinë ("nën diell")
 2. Urtësi tradicionale judaïke, dhe libri e sfidon këtë gjë (pra, e citon për ta kundërshtuar)
 3. Një mësues urtësie me nxënësin e tij të ri dhe entuziast, dhe një rrëfimtari (dialog)
 4. Konflikti brenda njeriut të rënë (ditar i jetës)
 5. Redaktorë të mëvonshëm, për shembull, 12:9-12 (pozitiv kundrejt *Koheletit*) dhe 12:13-14 (negativ kundrejt *Koheletit*).

V. DATA

- A. Me datën e Predikuesit lidhen dy çështje:
1. Kur u shkrua libri,
 2. Kur u vendos në formën përfundimtare kanonike.
- B. Konteksti historik duhet të jetë pas kohës së Solomonit. Ai përdoret si kontrast letrar në kapitujt 1-2.
- C. Forma përfundimtare e librit tregon për një datim të mëvonshëm:
1. forma stilistike e hebraishtes është ajo e pas robërisë, por përpara 400-300 para K.
 - a. fjalë dhe shprehje aramaisht
 - b. forma e hebraishtes
 2. ekzistojnë paralele letrare me letërsinë e urtësisë fenikase të viteve 600-400 para K.
 3. aludimet për Predikuesin gjenden në librin e Ben Sirahut, *Ekleziastiku*, që u shkrua rreth 180 para K.
 4. disa pjesë të Predikuesit janë gjetur dhe në Pergamenat e Detit të Vdekur (4!). Ato janë datuar si të shkruara në shekullin e dytë para K.

VI. NJËSITË LETRARE

- A. Është e vështirë t'i bësh përvijim këtij libri. I ngjason më tepër një ditari të jetës, sesa një veprë të strukturuar letrare. Është i ngjashëm me mësimin rabinik të quajtur "perla në gjerdan". Megjithatë, ka dhe motive përbashkëuese, ndonëse jo një tematikë të përbashkët.
- B. Ka gjasa që t'i jenë bërë shtesa redaktoriale:
 - 1. Hyrja, 1:1
 - 2. Natyra përfshirëse e 1:2 dhe 12:8 nënkupton se 1:1 dhe 12:9-14 janë shtesa
 - 3. Dy epilogë të shtuar:
 - a. 12:9-12 (në vetën e tretë)
 - b. 12:13-14 (teologjia tradicionale)
- C. Është e qartë se kapitujt 1-2 e përdorin Solomonin si kontrast letrar.
- D. Kapitulli 3 është njëp oezi e mahnitshme për përvojat e përbashkëta të jetës njerëzore.
- E. Pjesa tjetër nuk përvijohet lehtë!

VII. ÇËSHTJET TEOLOGJIKE

- A. Vetë fakti i pranisë së këtij libri në kanon duket se nënkupton që Perëndia nuk e hedh poshtë atë që e kërkon me sinqeritet, pavarësisht dyshimeve.
- B. Shtrimi i pyetjeve absolute nuk dekurajohet.
- C. Predikuesi nënkupton praninë e Perëndisë dhe u shkrua brenda rrymës së besimit të DHV.
- D. Ligësia është rezultat i njeriut, jo i Perëndisë (shih 7:29; 9:3).
- E. Udhët e Perëndisë nuk mund të njihen. Njeriu duhet të luftojë për të gjetur kuptimin e jetës!
- F. Dyshimi i pikëpamjeve ortodokse për jetën e përtejme dhe dyshimi për aftësinë e njeriut që të njohë plotësisht Perëndinë, por prapëseprapë Perëndia është i hirshëm.
- G. Bota, në gjendjen e tanishme, është e padrejtë dhe mizore, por duhet të ekzistojë diçka më tepër se kaq!
- H. Ji i kënaqur nga jeta – ajo vjen nga Perëndia. Shijoje kur dhe ku të mundesh. (2:24)
- I. Përgjigjet e thjeshtëzuara, që nuk përkojnë me përvojën e jetës, s'janë aspak përgjigje. Ne duhet të përballemi me realitetin e mungesës së kuptimit të jetës nëse s'ka Perëndi.

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Qëllimi kryesor i librit është të tregojë kotësinë e ekzistencës njerëzore nëse veçohet nga Perëndia. Është trakt për kthimin në besim të materialistëve ose intelektualëve që mbështeten te forcat e tyre. B. H. Carroll tha se, në kohën e mosbesnikërisë së tij, Predikuesi dhe Jobi ushtruan një ndikim të jashtëzakonshëm në të, pasi i shprehën kotësinë e jetës dhe e drejtuan tek Perëndia.
- B. Lumturia dhe kënaqësia gjenden në (2:24; 3:12-13, 22; 5:18-20; 8:15; 9:7-9; 12:13-14):
 - 1. besimin dhe bindjen ndaj Perëndisë,
 - 2. kënaqësitë e shtëpisë dhe familjes,

3. puna vetjake.

- C. Ky libër është agnostik për Perëndinë dhe jetën e përtëjme. Nuk u përgjigjet pyetjeve të realitetit absolut, por shtron pyetjet e realitetit të tanishëm:
1. për judenjtë, tregon gabimin e teprimeve të thjeshtëzuara që bëheshin nga teologët tradicionale (“dy udhët”).
 2. për paganët, tregon dështimin e jetës tokësore pa Perëndinë.
 3. Përgjigjet e lehta për pyetjet e jetës, zakonisht, janë të gabuara. Edhe besimi ka misterin e vet! Zbulesa nuk na zbulon gjithçka!
- D. Ky autor po përdor zbulesën e natyrshme, jo zbulesën e veçantë, për të shqyrtuar jetën. Emri i Perëndisë së besëlidhjes, JHVH, nuk përdoret në këtë libër. Si në pjesën tjetër të letërsisë së urtësisë, përdoret emri i përgjithshëm i Perëndisë, *Elohim*.
- E. Ky libër është drejtpeshim i thënieve të prera të Fjalëve të Urta, që ofrojnë sukses në jetë. Jeta, natyra, njeriu dhe Perëndia kanë misterin e tyre. Çelësi gjendet te besimi, jo te njohuria; te familja, jo te zotërimet; te Perëndia, jo te njeriu. Kënaqësitë e thjeshta të jetës—familja, puna, miqtë, ushqimi—të japin lumturi në këtë jetë. Jeta tjetër është e fshehur, por aty është Perëndia!

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe fraza:

1. “kotësi e kotësive” 1:2 (NIV, “pakuptimshmëri! Pakuptimshmëri!”)
2. “nën diell”, 1:3 (NASB & NIV)
3. “në urtësinë e shumtë gjendet dhe shumë hidhërim” 1:18 (NIV, “sepse, bashkë me urtësinë e shumtë vjen dhe trishtimi i shumtë”)
4. “e di se njëri fat i pret të dy” 2:14 (NASB & NIV)
5. “ai ka vendosur përjetësinë në zemrën e tyre” 3:11 (NASB & NIV)
6. “pa dyshim, Perëndia i ka vënë në sprovë...” 3:18 (NASB & NIV)
7. “...por më mirë se të dy këta është ai që nuk ka ekzistuar kurrë...” (4:2-3 (NIV, “më mirë se të dy këta është ai që nuk ka lindur ende”)
8. “frikësojuni Perëndisë” 5:7 (NIV, “mahnituni nga Perëndia”)
9. “ai që do paranë nuk kënaqet nga paraja” 5:10 (NASB & NIV)
10. “mos u bë i drejtë më tepër se ç’duhet, dhe mos u bë më i mençur se ç’duhet” 7:16 (NASB & NIV)
11. “kush gërmon një gropë, mund të bjerë vetë brenda” 10:8 (NASB & NIV)
12. “hidhe bukën mbi sipërfaqen e ujit, sepse pas shumë ditësh do ta gjesh” 11:1 (NASB & NIV)

B. Persona:

1. Kohelet, 1:1
2. Roja, 12:3-4 (NIV, “ruajtësit e shtëpisë”)
3. Një Bari, 12:11
4. Im bir, 12:12

X. VENDNDODHJET NË HARTË – s’ka

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Cili është qëllimi kryesor i këtij libri?
2. Pse shërben Solomoni si kontrast letrar i kapitujve 1-2?
3. Si ndryshon njeriu nga kafshët? 3:12-22
4. A mund ta njohim Perëndinë?
5. Ku gjendet lumturia?
6. Për kë u shkrua ky libër, dhe pse?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR KËNGËN E KËNGËVE

I. EMRI I LIBRIT

- A. Ky libër, si gjithë librat e tjerë të DHV, në fillim u titullua sipas fjalëve të para të librit. Në hebraisht, fjalët e para janë, “kënga e këngëve, që është e Solomonit”, që është një formë sipërore në hebraisht. Pra, kjo është më e mira e këngëve mbretërore për dashurinë.
- B. Ky libër njihet dhe me titullin “Kantiku” në Vullgatë. (*canticum canticorum*)

II. KANONIZIMI

- A. Për shkak të përmbajtjes së pazakontë, ky libër e pati të vështirë që të arrinte statusin kanonik:
1. shkolla rabinike e Shamait (konservatore) e kundërshtonte si libër
 2. shkolla rabinike e Hilelit (liberale) e pranonte si libër.
 3. Në këshillin rabinik të Javnes (90 pas K.), ky libër ende po diskutohej dhe po dyshohej për nga vlera kanonike.
 4. Nën udhëheqjen e rabinit Akiba, më në fund, libri u pranua si kanonik. Ai tha kështu për këtë libër: “sepse as gjithë bota nuk vlen sa dita kur Kënga e Këngëve iu dha Izraelit, sepse të gjitha shkrimet janë të shenjta, por Kënga e Këngëve është më e shenjta nga të gjitha”.
- B. Është i pari i një liste të specializuar librash nga pjesa e “Shkrimeve” në kanonin hebraik, që quhen *Megilot* (pesë pergamenat). Secili prej tyre lexohej në një ditë të përvitshme feste. Kënga e Këngëve lexohej në Festën e Pashkës:
1. Kënga e Këngëve – Pashkë
 2. Ruthi – Rrëshajët
 3. Predikuesi – Kasollet, ose Çadtrat
 4. Esteri – Purim
 5. Vajtimet – rënia e Jerusalemit dhe shkatërimi i tempullit të Solomonit
- C. Pjesa e “Shkrimeve” në kanonin hebre e vendos Këngën e Këngëve pas Psalmeve, Fjalëve të Urta dhe Jobi, por përpara Ruthit, Vajtimeve, Predikuesit dhe Esterit. Bibla në anglisht ndjek të njëjtin rend si LXX.

III. GJINIA LETRARE

- A. Gjinia letrare është çështja kryesore për interpretimin e librit. Gjinia letrare është kyçe për të identifikuar synimin e autorit origjinal. Ky libër është shkruar tërësisht në formë poezie.
- B. Teoritë janë:
1. Alegoria judaike – Mishna, Talmudi dhe Targumët, thonë se ky libër përshkruan historinë judaike në kuadër të dashurisë së Perëndisë për Izraelin. Izraeli është nusja e JHVH (shih Eks. 34:15-16; Lev. 17:7; 20:5-6 dhe Num. 14:33).
 2. Alegoria e krishterë – Origeni, Jeronimi, Athanasi, Augustini, Toma Akuina dhe Luteri thonë se ky libër përshkruan kishën në kuadër të dashurisë së Krishtit. Shpesh, Efe. 5:21-31 përdoret si paralel.
 3. Këngët tradicionale të martesës – ky libër ngjason shumë me poezitë e dashurisë në Siri, rreth 6000 para K., që njihen si *vasfs*. Nusja dhe dhëndri shkëmbejnë komplimente, dhe e quajnë njëri-tjetrin “mbret” dhe “mbretëreshë”. Ka dhe disa paralele nga poezitë e dashurisë egjiptiane, ku e dashura quhet “motër” (4:9-10, 12; 5:1-2). Kjo lloj letërsie, që lavdëron dashurinë besnike e të pjekur njerëzore, ishte e mirënjohur në Lindjen e Afërt të lashtë.
 4. Dramë
 - a. Ky libër është një dramë e luajtur nga aktorë të ndryshëm:
 - a. Mbreti,

- b. një vajzë fshati nga veriu,
 - c. një i dashur vendas nga veriu,
 - d. kori, ose haremi (“bijat e Jerusalemit”).
- b. Një shembull i kësaj vënieje në skenë mund të ilustruhet nga kapitulli 1:
- (1) v. 2-4b, nusja
 - (2) v.4c-e, kori (shih 2:7; 3:6-11; 5:9; 6:1, 13; 8:5, 8)
 - (3) v. 5-7, nusja
 - (4) v. 8, kori
 - (5) v. 9-10, dhëndri
 - (6) v. 11, kori
 - (7) v. 12-14, nusja
 - (8) v. 15, dhëndri
 - (9) v. 16-17, nusja
- c. teoria e të dashurit nga veriu bazohet te këto elemente:
- (1) i dashuri quhet bari, që ndjek delet.
 - (2) libri përfundon në veri, jo në Jerusalem.
 - (3) Haremi kritikohet, 6:8-9.
- d. Dorëshkrimi grek *Sinaitikus* ka tituj për çdo pjesë që lidhet me dhëndrin dhe nusen.
5. Shëmbëlltyrë – kjo teori përpiket të kombinojë të fjalëpërfjalshmen me alegoriken. Ajo merr seriozisht gëzimin e seksualitetit njerëzor dhe vlerat e monogamisë. Nga ana tjetër, ajo dikton dhe një synim tipologjik, që lidhet me Izraelin.
6. E fjalëpërfjalshmja – kjo teori thotë se Perëndia është ai që na ka dhënë aspektet e seksualitetit njerëzor. Ajo e pranon librin ashtu siç shkruhet. Kjo pikëpamje u përkrah nga Teodori i Mopsuestias, një nga mendjet e ndritura të shkollës antiokene të interpretimit.
- C. Ky libër nuk është letërsi tipike e urtësisë, por, gjithsesi, mund të ketë funksionuar në mënyrë të ngjashme, për të edukuar djemtë e rinj. Duket se përmban një aspekt moral në lidhje me monogaminë, si dhe flet për pastërtinë dhe bukurinë e seksualitetit njerëzor në kohën e duhur dhe me njeriun e duhur.

IV. AUTORËSIA

- A. Baba Bathra 15a thotë se librin e shkroi Hezekia dhe burrat e tij. Me sa duket, këtu “shkroi” do të thotë: mblodhi, ose redaktoi dhe i dha autorësinë (shih Fja. 25:1).
- B. Tradita judaike është shprehur gjithmonë se librin e shkroi Solomoni:
- 1. emri i tij shfaqet në 1:1, 5; 3:7, 9, 11; 8:11, 12
 - 2. fjala “mbret” shfaqet në 1:4, 12; 7:5.
 - 3. kuajt egjiptianë përmenden në 1:9, gjë që përputhet me mbretërimin e Solomonit (shih 1 Mbre. 10:28).
 - 4. autori përmend vendndodhje gjeografike në gjithë Palestinën, Sirinë dhe pjesën e përtej-Jordanit, madje deri poshtë në Araba. Kjo pasqyron kufijtë gjeografikë të mbretërisë së Solomonit.
 - 5. Rabinët thonë se, kur ishte i ri, Solomoni shkroi këngë dashurie (Kënga e Këngëve), kur ishte mesoburrë shkroi fjalë të urta (Fjalët e Urta), dhe kur ishte plak shkroi për kotësinë e gjithçkaje (Predikuesi).
- C. Disa arsye kundër autorësisë së Solomonit:
- 1. në hebraisht, titulli “Kënga e Këngëve”, e Solomonit” mund të ketë kuptimin:
 - a. nga Solomoni,
 - b. për Solomonin,
 - c. rreth Solomonit,
 - d. në kohën e Solomonit,
 - e. në mënyrën e Solomonit.
 - 2. libri përfundon në Izraelin verior (7:10-13), dhe jo në haremin e Jerusalemit.

3. libri duket se miraton mirësinë, natyrën e shëndetshme dhe gëzimin e seksit monogam. Kjo nuk përputhet me jetën e Solomonit.
4. Solomoni mund të jetë kontrasti letrar i Këngës së Këngëve, njësoj siç është dhe në Predikuesi 1-2 (E. J. Young, *An Introduction to the Old Testament*, f. 268).

V. DATA

- A. Ashtu si shumë libra të urtësisë në DHV, datimi këtu ka dy aspekte:
 1. Kontekstin historik fillestar,
 2. Datën dhe formën kanonike të librit.
- B. Konteksti historik:
 1. Koha e Solomonit:
 - a. fuqia e mbretit që të merrte gra të shumta,
 - b. prania e haremit si kor,
 - c. njohuria e vendeve tejet të ndryshme gjeografike (si dhe e kafshëve dhe bimëve)
 - d. Jerusalemi paralelizohet nga Tirca, që ishte kryeqyteti i Izraelit përpara Samarisë (Omri), 6:4
 2. Forma përfundimtare e librit:
 - a. forma e pjesores lidhore femërore përdoret vetëm në hebraishten e vonët (shih 1:12; 2:7)
 - b. përdorimi i fjalëve të huazuara nga aramaishtja dhe greqishtja
 - a. parajsa
 - b. kopshti
 - c. shtrati
 - d. divani
- C. Bota e sotme studimore nuk bie dakord:
 1. E. J. Young – koha e Solomonit
 2. W. F. Albright – shekulli i pestë para K.
 3. R. K. Harrison – forma e fundt iu dha përpara robërisë

VI. NJËSITË LETRARE

- A. Libri përmban disa aspekte të vështira. Nuk e dimë nëse bëhet fjalë për një tematikë ose qëllim të përbashkët, apo thjesht për një seri poezish dashurie.
- B. Vargjet e mëposhtme janë të vështira për t'u interpretuar në kuadrin e një tematike të përbashkët:
 1. 2:15
 2. 5:7
 3. 8:5b-e
 4. 8:8-9
- C. E vetmja mënyrë për ta interpretuar librin sipas një tematike të përbashkët është të supozosh një skenar dramatik me tre personazhe dhe me një kor:
 1. mbreti
 2. një vajzë fshati nga veriu
 3. i dashuri fshatar nga veriu
 4. haremi si kor
- D. Ky libër, ashtu si Esteri, nuk e përmban fare emrin e Perëndisë (8:6 përkthehet “flakë shkru mbuese” në përkthimin e Biblës së Jewish Publication Society of America).

VII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Qartazi, ky libër përbën një miratim të pastërtisë dhe bukurisë së seksualitetit njerëzor, 8:6-7. Kjo mund të duket si miratim i dukshëm, por kur kemi parasysh (1) mëkatit seksual të Davidit dhe pasojat për familjen e tij, dhe (2) idhujtarinë e Solomonit në pleqëri për shkak të grave të huaja dhe feve të tyre, kjo ishte një shprehje e domosdoshme miratimi.
- B. Shumë e kanë parë këtë libër si një analogji e DHV për Perëndinë si burrë dhe Izraelin si gruan e tij (pra, interpretimi rabinik i eksodit dhe Oseas 1-3).
- C. Vështirësia për gjetjen e gjinisë letrare dhe qëllimit qendror të bën të jesh i kujdesshëm për interpretime dogmatike.
- D. Ky libër nuk ka shenja të një tematike fetare apo kombëtare. Kjo është e pazakontë për një libër kanonik.

VIII. FJALË/PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

- A. Fjalë/fraza
 - 1. mirë (1:13; 3:6; 4:6, 14; 5:1, 5, 13 (NASB & NIV))
 - 2. “dhelpra të vogla”, 2:15 (NASB & NIV)
 - 3. “tmerret e natës”, 3:8 (NASB & NIV)
 - 4. “mbretëresha...konkubina”, 6:8, 9 (NASB & NIV)
 - 5. madërgona, 7:13 (NASB & NIV)
 - 6. vulë, 8:6 (NASB & NIV)
 - 7. ajo është një mur, 8:9 (4:12) (NASB & NIV)
- B. Persona
 - 1. “mbreti”, 1:4b, 12
 - 2. “jam e zezë, por e këndshme”, 1:5 (NIV, “E errët jam, por e këndshme”)
 - 3. “ku e kullot bagëtinë...”, 1:7 (NIV, “...çon për kullotë...”)
 - 4. “unë jam trëndafili i Sharonit, zambaku i luginave”, 2:1
 - 5. “bijat e Jerusalemit”, 2:7
 - 6. roja, 3:3; 5:7
 - 7. “O shulamite”, 6:13

IX. VENDNDODHJET NË HARTË

- 1. Engedi, 1:14
- 2. Sharon, 2:1
- 3. Liban, 4:8
- 4. Mali Hermon, 4:8
- 5. Tirca, 6:4
- 6. Gilead, 6:5 (mali Gilead, 4:1)
- 7. Damask, 7:4
- 8. Mali Karmel, 7:5


X. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

- 1. Pse është në kanon ky libër?
- 2. Cili është interpretimi mbizotërues te judenjtë? Pse?
- 3. Ç’lloj letërsie është kjo? Ç’dallim bën kjo gjë?
- 4. Pse nuk aludohet asnjëherë në libër për emrin e Perëndisë ose për historinë e Izraelit?
- 5. A ka një tematikë të përbashkët ky libër?

6. Cilat janë “bijat e Jerusalemit”?
7. Rendit vendet e ndryshme ku ndodh kjo ngjarje.



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR PROFECINË E DHIATËS SË VJETËR

I. HYRJE

A. Shënime hyrëse:

1. Komuniteti besimtar nuk bie dakord për mënyrën si interpretohet profecia. Të vërtetat e tjera janë pranuar si pozicion ortodoks gjatë shekujve, por interpretimi i profecisë, jo.
2. Profecia e DHV ka disa faza të mirëpërcaktuara:
 - a. paramonarkike:
 - a. individët e quajtur profetë
 1. Abrahami – Zan. 20:7
 2. Moisiu – Num. 12:6-8; LiP. 18:15; 34:10
 3. Aaroni – Eks. 7:1 (zëdhënës i Moisiut)
 4. Miriami – Eks. 15:20
 5. Medadi dhe Eldadi – Num. 11:24-30
 6. Debora – Gjyq. 4:4
 7. Anonim – Gjyq. 6:7-10
 8. Samueli – 1 Sam. 3:20
 - b. përmendjet e profetëve si grup – LiP. 13:1-5; 18:20-22
 - c. grupi ose gida profetike – 1 Sam. 10:5-13; 19:20; 1 Mbre. 20:35, 41; 22:6, 10-13; 2 Mbre. 2:3, 7; 4:1, 38; 5:22; 6:1, etj.
 - d. Mesia quhet profet – LiP. 18:15-18
 - b. monarkike, por jo me shkrim (ata i drejtohen mbretit):
 - (1) Gadi – 1 Sam. 22:5; 2 Sam. 24:11; 1 Kro. 29:29
 - (2) Natani – 2 Sam. 7:2; 12:25; 1 Mbre. 1:22
 - (3) Ahijahu – 1 Mbre. 11:29
 - (4) Jehu – 1 Mbre. 16:1, 7, 12
 - (5) Anonim – 1 Mbre. 18:4, 13; 20:13, 2
 - (6) Elija – 1 Mbre. 18—2 Mbre. 2
 - (7) Milkajahu – 1 Mbre. 22
 - (8) Elizeu – 2 Mbre. 2:8, 13
 - c. profetët klasikë, që shkruan libra (i drejtohen jo vetëm mbretit, por edhe kombit): Isaiiah-Malakia (me përjashtim të Danielit)

B. Fjalët biblike

1. *Ro'eh* – “shikues”, 1 Sam. 9:9. Vetë kjo fjalë tregon kalimin te fjala *Nabi*. *Ro'eh* vjen nga fjala e përgjithshme “shoh”. Ky person i kuptonte mënyrat dhe planet e Perëndisë, dhe populli shkonte tek ai për t’u siguruar për vullnetin e Perëndisë për një çështje të caktuar.
2. *Hozeh* = “shikues”, 2 Sam. 24:11. Në thelb, është sinonim i *Ro'eh*. Vjen nga një fjalë më e rrallë, “shoh”. Forma si pjesore përdoret më shpesh për të nënkuptuar profetët.
3. *Nabi'* = “profet”, nga rrënja e ngjashme e fjalës akadisht *Nabu* = “thërras” dhe arabisht *Naba'a* = “shpall”. Kjo është fjala më e përhapur në Dhiatën e Vjetër për të përshkruar një profet. Përdoret mbi 300 herë. Etimologjia e saktë është e paqartë, por “thërras” duket se është përgjigjja më e mirë deri tani. Ndoshta, kuptimi i saj vjen nga përshkrimi që i bën JHVH marrëdhënies së Moisiut me faraonin nëpërmjet Aronit (shih Eks. 4:10-16; 7:1; LiP. 5:5. Profeti është dikush që i flet popullit në emër të Perëndisë (Amosi 3:8; Jer. 1:7, 17; Ezek. 3:4).
4. Të tria këto fjalë përdoren për ofiqin e profetit në 1 Kro. 29:29; Samueli – *Ro'eh*; Natani – *Nabi'*, dhe Gadi – *Hozeh*.
5. Fraza, *ish ha-'elohim*, “burri i Perëndisë”, është përcaktim më i gjerë për zëdhënësin e Perëndisë. Përdoret rreth 76 herë në DHV në kuptimin e fjalës “profet”.
6. Fjala “profet” ka origjinë nga gjuha greke. Vjen nga fjalët: (1) pro = “përpara” ose “për”; (2) femi = “flas”.

II. PËRCAKTIMI I PROFECISË

- A. Fjala “profeci” ka fushë më të gjerë kuptimore në hebraisht sesa në shqip. Librat historikë, nga Jozueu tek Mbretërit (me përjashtim të Ruthi), quhen “profetët e hershëm” nga judenjtë. Si Abrahami (Zan. 20:7; Psa. 105:5) ashtu dhe Moisiu (LiP. 18:18) quhen profetë (si dhe Miriami, Eks. 15:20). Prandaj, ruhuni nga një përcaktim i presupozuar shqip!
- B. “Profetizmi mund të përcaktohet me të drejtë si ai botëkuptim për historinë që pranon kuptim vetëm në kuadër të preokupimit, qëllimit dhe pjesëmarrjes hyjnore”, *Interpreter’s Dictionary of the Bible*, vëll. 3, f. 896.
- C. “Profeti nuk është, as filozof, as teolog sistemaik, por ndërmjetës besëlidhjeje që i përçon popullit të Perëndisë fjalën e tij në mënyrë që t’ua formësojë të ardhmen nëpërmjet reformimit të së tashmes”, “Prophets and Prophecy,” *Encyclopedia Judaica* vëll. 13, f. 1152.

III. QËLLIMI I PROFECISË

- A. Profecia është një mënyrë sesi Perëndia i flet popullit të tij, duke i siguruar drejtim në kontekstin e tyre të momentin, si dhe shpresë në faktin se ai kontrollon jetën e tyre dhe ngjarjet në botë. Mesazhi i profetëve, në thelb, është kolektiv. Synon të qortojë, inkurajojë, nxisë besim dhe pendim, dhe ta informojë popullin e Perëndisë për të dhe për planet e tij. Kësaj i duhet shtuar se, shpesh, profecia përdoret për të zbuluar qartë faktin se Perëndia ka zgjedhur dikë si zëdhënës (LiP. 13:1-3; 18:20-22). Në fund fare, profeti absolut do të jetë Mesia.
- B. Shpesh, profeti merrte një krizë historike ose teologjike të kohës dhe e projektonte në një kontekst eskatologjik. Kjo pikëpamje e historisë në lidhje me fundin botës është unike për Izraelin dhe për mënyrën si Izraeli e kuptonte zgjedhjen hyjnore dhe premtimet e besëlidhjes.
- C. Ofiqi i profetit duket se drejtpeshon (Jer. 18:18) ose zëvendëson ofiqin e kryepriftit si mënyrë për të mësuar vullnetin e Perëndisë. Urimi dhe Thumimi tejkalohe nga një mesazh gojor nëpërmjet zëdhënësit të Perëndisë. Po kështu, ofiqi i profetit duket se u zhduk në Izrael pas Malakisë. Nuk rishfaqet më për 400 derisa lind Gjon Pagëzori. Është e paqartë sesi lidhet dhuntia e “profecisë” së Dhiatës së Re me Dhiatën e Vjetër. Profetët e Dhiatës së Re (Veprat 11:27-28; 13:1; 14:29, 32, 37; 15:32; 1 Kor. 12:10, 28-29; Efe. 4:11) nuk janë zbulues të një zbuluese të re për Shkrimin, por janë shpallës dhe parashpallës të vullnetit të Perëndisë në situata të besëlidhjes.
- D. Profecia nuk është vetëm ose kryesisht parashikuese nga natyra. Parashikimi është vetëm një mënyrë për të vërtetuar ofiqin dhe mesazhin e profetit, por duhet vënë re se “më pak se 2% e profecive në DHV janë mesianike. Më pak se 5% përshkruajnë në mënyrë të veçantë Epokën e Besëlidhjes së Re. Më pak se 1% prej tyre kanë të bëjnë me ngjarjet e ardhshme”. (Fee & Stuart, *How to Read the Bible For All Its Worth*, f. 166)
- E. Profetët përfaqësojnë Perëndinë para popullit, ndërsa priftërinjtë përfaqësojnë popullin para Perëndisë. Ky është një pohim i përgjithshëm. Ka dhe përjashtime, si Habakuku, që i shtron pyetje Perëndisë.
- F. Një arsye pse është e vështirë të kuptojmë profetët është se nuk e dimë sesi janë strukturuar librat e tyre. Nuk kanë rend kronologjik. Duken si libra tematikë, por jo gjithmonë në mënyrën siç e presim. Shpesh, duket se nuk kemi një kontekst të qartë historik, apo periudhë të caktuar, apo ndarje të qartë mes profecive. Këta libra janë të vështirë: (1) që të lexohen me një të ulur; (2) që t’i përvijojmë sipas tematikës; dhe (3) që të themi me siguri të vërtetën qendrore apo synimin e autorit për çdo profeci të dhënë.

IV. TIPARET E PROFECISË

- A. Në Dhiatën e Vjetër duket se kemi një zhvillim të konceptit të “profetit” dhe “profecisë”. Në Izraelin e lashtë, u zhvillua një grupim profetësh, të udhëhequr nga një drejtues i fortë karizmatik, si Elija ose Elizeu. Nganjëherë, fraza “bijtë e profetëve” përdorej për të përcaktuar pikërisht këtë grupim (2 Mbre. 2). Profetët karakterizoheshin nga forma të ndryshme ekstaze (1 Sam. 10:10-13; 19:18-24).
- B. Megjithatë, kjo periudhë kaloi shpejt dhe u zëvendësua nga profetët si individë. Këta ishin ata profetë (të vërtetë ose të rremë) që i bashkoheshin mbretit, dhe jetonin në pallatin mbretëror (Gadi, Natani). Po kështu, kishte dhe syresh që ishin të pavarur, nganjëherë plotësisht të palidhur me gjendjen e ndenur të shoqërisë izraelite (Amosi). Ata ishin meshkuj ose femra (2 Mbre. 22:14).
- C. Shpesh, profeti ishte zbulues i së ardhmes, e kushtëzuar nga reagimi i atypëratyshëm i njeriut. Shpesh, detyra e profetit ishte të shpaloste planin universal të Perëndisë për krijimin e tij, që nuk mund të ndikohet nga reagimi njerëzor. Ky plan universal eskatologjik është unik në profetët e Lindjes së Afërt. Parashikimi dhe besnikëria ndaj besëlidhjes janë dy pikat kyçe të mesazheve profetike (shih Fee dhe Stuart, f. 150). Kjo nënkupton se profetët kishin, pikësisht, fokus kolektiv. Zakonisht, por jo në mënyrë përjashtuese, ata i drejtohen kombit.
- D. Shumica e materialeve profetike paraqitej gojarisht. Më vonë, kombinohej me anë të tematikës, kronologjisë ose motiveve të tjera të letërsisë së Lindjes së Afërt, që tani nuk janë më të disponueshme për ne. Për shkak se ishte gojore, nuk strukturohej si prozë e shkruar. Kjo i bënte këta libra të vështirë për t’u lexuar nga fillimi në fund, dhe të vështirë për t’u kuptuar pa patur një kontekst të caktuar historik.
- E. Profetët përdorin motive të ndryshme për të përcjellur mesazhet e tyre:
1. Skena e Gjyqit – Perëndia e thërret popullin e vet në gjyq; shpesh, bëhet fjalë për një çështje gjyqësore divorci, ku JHVH refuzon gruan e vet (Izraelin) për besnikërinë e saj (Osea 4; Mikea 6).
 2. Vajtimit Funerali – metrika e veçantë e këtij lloji mesazhi dhe fjala tipike e tij “Vaj medet!” e veçon si formë të veçantë (Isaia 5; Habakuku 2).
 3. Shpalja e Bekimit të Besëlidhjes – theksohet natyra e kushtëzuar e besëlidhjes dhe shpallen pasojat (negative ose pozitive) të kësaj për të ardhmen (LiP. 27-28).

V. CILËSITË BIBLIKE PËR VËRTETIMIN E PROFETIT TË VËRTETË

- A. Ligji i Përtërirë 13:1-5 (parashikime/shenja)
- B. Ligji i Përtërirë 18:9-22 (profetët e rremë/profetët e vërtetë)
- C. Mateu 7 (mënyra e jetesës)
- D. 1 Gjonit 4:1-6 (fokusi doktrinor)
- E. Si burrat, ashtu dhe gratë, thirren dhe përcaktohen si profetë ose profetesha
1. Miriami – Eks. 15
 2. Debora – Gjyq. 4:4-6
 3. Hulda – 2 Mbre. 22:14-20; 2 Kro. 34:22-28
- F. Në kulturat përreth, profetët vërtetoheshin me anë të yshtjes. Kurse në Izrael kjo bëhej me anë të:
1. një prove teologjike – emri i JHVH
 2. një prove historike – parashikime të sakta.

VI. UDHËZIME TË DOBISHME PËR INTERPRETIMIN E PROFECISË

- A. Gjej synimin e profetit (ose redaktorit të librit) duke vërejtur kontekstin historik dhe kontekstin letrar të çdo profecie. Zakonisht, bën fjalë për shkeljen që i bën Izraeli në mënyra të ndryshme besëlidhjes së Moisiut.
- B. Lexo dhe interpreto gjithë profecinë, jo vetëm një pjesë të saj; përvijojë sipas përmbajtjes. Shih sesi lidhet ajo me profecitë e tjera në kontekst. Përpiku të përvijosh gjithë librin.
- C. Bëj interpretim të fjalëpërfjalshëm të pasazhit derisa një element i vetë tekstit të të drejtojë tek përdorimi i figurshëm; pastaj, shkruajë gjuhën e figurshme në formë proze.
- D. Analizo veprimin simbolik në kuadër të kontekstit historike dhe të pasazheve paralele. Mos harro se kjo letërsi e Lindjes së Afërt nuk është letërsi perëndimore, apo moderne.
- E. Trajtoje me kujdes profecinë parashikuese:
 - 1. A ka vlerë vetëm për kohën e autorit?
 - 2. A u përmbush më vonë në historinë e Izraelit?
 - 3. Apo bëhet fjalë për ngjarje që do të ndodhin në të ardhmen?
 - 4. A ka kjo profeci një përmbushje të kohës, apo një përmbushje në të ardhmen?
 - 5. Lejo që përgjigjet e tua të udhëhiqen nga autorët e Biblës, jo nga autorët modernë.
- F. Preokupime të veçanta:
 - 1. A ndikohet parashikimi nga përgjigja e kushtëzuar e njeriut?
 - 2. A është e qartë se kujt i drejtohet profecia (dhe pse)?
 - 3. A është e mundur, si biblikisht ashtu dhe/ose historikisht, që të kemi përmbushje të shumëfishta?
 - 4. Autorët e DHR, nën frymëzim, ishin në gjendje ta shihnin Mesinë në shumë pasazhe të DHV që s'janë të qarta për ne. Ata duket se përdorin tiplogjinë, ose lojën e fjalëve. Meqë ne s'jemi të frymëzuar, më mirë t'ua lemë atyre këtë qasje.

VII. LIBRA TË DOBISHËM

- A. *A Guide to Biblical Prophecy*, Carl E. Armerding dhe W. Ward Gasque
- B. *How to Read the Bible for All It Is Worth*, Gordon Fee dhe Douglas Stuart
- C. *My Servants the Prophets*, Edward J. Young
- D. *The Expositor's Bible Commentary*, vëll. 6 "Isaiah - Ezekiel," Zondervan
- E. *The Prophecies of Isaiah*, nga J. A. Alexander, 1976, Zondervan
- F. *Exposition of Isaiah*, H. C. Leupold, 1971, Baker
- G. *A Study Guide Commentary*, "Isaiah" nga D. David Garland, 1978, Zondervan

HYRJE PËR ISAIA

I. POHIME HYRËSE

- A. Isaia citohet më shpesh se çdo profet tjetër në DHR (mbi 411 herë). Mesazhi i tij fliste për:
1. një Perëndi
 2. një botë,
 3. një besim.
- B. Isaia ka një mesazh tejet mesianik:
1. fëmijët e veçantë, kapitujt 7-14,
 2. Këngët e Shërbëtorit, kapitujt 42:1-9; 49:1-7; 50:4-11; 55:13-53:12,
 3. Mbretëria e ardhshme mesianike (Epoka e Re), kapitujt 56-66
- C. E. J. Young, në *An Introduction to the Old Testament*, ka thënë:
1. “Libri i Isaia është konsideruar me të drejtë si profecia më madhështore në DHV”, f. 168.
 2. “Nga gjithë profetët e Izraelit, Isaia e kuptoi në mënyrën më të plotë mendjen e Perëndisë dhe planin e tij për epokat”, f. 171
 3. “Nga mprehtësia shpirtërore, atij s’ia kalon askush tjetër në DHV”, f. 172

II. EMRI I LIBRIT

- A. Ky libër ka marrë emrin e zëdhënësit të vet profetik.
- B. Ky emër do të thotë “shpëtimi i JHVH”, ose “JHVH shpëton”. Emrat hebraisht që përfundojnë me “ia” janë shkurtim i JHVH; e njëjta gjë ndodh dhe në anglisht me emrat që fillojnë me “j” [xh] dhe një zanore: për shembull, Joshua ose Joel.

III. KANONIZIMI

- A. Ky është i pari i katër pergamenave të Profetëve të Mëvonshëm:
1. Isaia
 2. Jeremia
 3. Ezekieli
 4. Të Dymbëdhjetët (profetët e vegjël)
- B. U pranua herët dhe plotësisht në shkrimet e shenjta të Izraelitëve.

IV. GJINIA LETRARE

- A. Mjeshtëritë letrare të Isaisë i tejkalojnë ato të gjithë profetëve në DHV. Lojërat e tij me fjalët dhe poezia që përdor janë madhështore dhe nxitëse. Libri është kryesisht poezi.
- B. Është e vështirë të ulesh dhe ta lexosh Isainë me një frymë. Është e vështirë ta përvijosh si libër. Kjo ndodh për shkak se Isaia ishte predikues, jo autor apo redaktor. Libri i tij regjistron mesazhe të folura me gojë. Ato lidhen së bashkuar ndonjëherë:
1. me anë të tematikës,
 2. me anë të kronologjisë,
 3. me anë të rregullave kulturore të Lindjes së Afërt, që ishin shumë të ndryshme nga tonat.

V. AUTORËSIA

- A. Pikëpamjet e judenjve për autorësinë

1. Baba Bathra 15a (Talmud) thotë se Hezekia dhe burrat e tij shkruan (pra, redaktuan, ose mblodhën) Isainë, Fjalët e Urta, Predikuesin dhe Këngën e Këngëve. Kjo nënkupton se gjithë libri vjen nga ky profet.
 2. Ben Sira, në *Ekleziastiku* 49:17-25, shkruar rreth 185 para K., tha: “Isaia, biri i Amocit” e shkroi këtë libër (1:1; 12:1; 13:1).
 3. 2 Kronikave 32:32 mbështet vegimin e Isaisë dhe paralelizmin të Mbretërit (2 Mbre. 18:19-20:19.)
 - a. nga njga familje e pasur fisnikësh në Jerusalem, ndoshta dhe kushëri i mbretit Uzia.
 - (1) Ka disa të dhëna se “jah”, që është shkurtim i JHVH, praktikohej pothuajse në mënyrë unike nga fisi mbretëror i Judës.
 - (2) Aksesi i Isaisë të mbreti mbështet lidhjen e mundshme të gjakut me të.
 - (3) Shih Talmudi, “Meg.” 10b
 - b. U martua me një profeteshë (8:3)
 - (1) biri i parë, “Shear-Jashub”, që do të thotë “një mbetje do të kthehet”
 - (2) biri i dytë, “Maher-Shalal-Hash-Baz” (8:3), që do të thotë “përshpejtoje plaçkën, nxitoje plaçkitjen”
 - c. Isaia pati një nga shërbesat më të gjata profetike nga çdo profet tjetër i DHV. Ai ishte zëdhënësi i Perëndisë në Jude nga mbretërimi i Jotamit (742-735 para K.) tek ai i Hezekias (715-687 para K.), ndoshta deri në mbretërimin e Manasit (687-642 para K.); Manasi mund të ketë qenë bashkë-mbretërues që nga viti 696 para K.
 - d. Nëse 2 Kron. 26:22 bën fjalë për Isianë, atëherë ai ishte skribi zyrtar dhe ruajtësi i kronikave zyrtare të mbretit.
 - e. Traditat thonë se e prenë me sharrë në dysh gjatë mbretërimit të Manasit.
 4. Moisi ben Samuel Ibn Gekatila, rreth 110 pas K., tha se kapitujt 1-39 janë të Isaisë, ndërsa kapitujt 40-66 u shkruan gjatë periudhës së Tempullit të Dytë (periudha perse, 538-430 para K.)
 5. Ibn Ezra (1092-1167 pas K.) ndoqi mendimin e Gekatilës dhe tha se kapitujt 40-66 nuk u shkruan nga Isaia.
- B. Mendimet e studiuesve të sotëm për autorësinë
1. Një përmbledhje e dobishme historike gjendet në R. K. Harrison, *Introduction to the Old Testament*, Eerdmans, 1969.
 2. Një diskutim i dobishëm i arsyeve teknike për idenë e dy autorëve mund të gjendet në S. R. Driver, *Introduction to the Literature of the Old Testament*, rishtypur më 1972.
 3. Nuk është gjetur asnjë dorëshkrim hebre ose grek (LXX) që të tregojë ndarjen mes kapitujve 1-39 dhe 40-66.
 - a. Në fund të kapitullit 33, në disa pergamena të Detit të Vdekur ekziston një hapësirë me dy rreshta. Kjo nënkupton një ndarje në këtë pikë, jo në kapitullin 39.
 - b. Duket se ekziston një strukturë paralele mes kapitujve 1-33 dhe 34-66. Kjo strukturë e dyfishtë, e bazuar në kohën e autorit dhe pastaj në të ardhmen, ishte diçka e njohur në profetët hebrej (shih Ezekieli, Danieli dhe Zakaria).
 - c. Studiuesit e sotëm nuk flasin njëzëri për faktin se sa autorë ka ky libër, apo se në ç’pjesë ndahet.
- C. Disa arsye për unitetin e Isaisë
1. Në të dyja pjesët e Isaisë gjenden 25 fjalë që nuk gjenden gjetiu në DHV (NIV, Hyrje për Isainë, f. 1014).
 2. Titulli “I Shenjti i Izraelit” shfaqet 13 herë në kapitujt 1-39 dhe 14 herë në kapitujt 40-66, por vetëm 6 herë në gjithë librat e tjerë të DHV.
 3. Te Gjoni 12:38,40, Jezusi citon nga Isa. 53:1 dhe 6:10, dhe ia atribuon të dyja Isaisë.
 4. Pasazhe të Isa. 40-66 i atribuohen Isaisë në Mat. 3:3; 8:17; 12:17; Luka 3:4; 4:17; Gjoni 1:23; Veprat 8:28 dhe Rom. 10:16-20.
 5. Nuk ka të dhëna dorëshkrimesh për ndarjen e librit në kapitullin 39 (MT apo dorëshkrimet e gjetura në Detin e Vdekur).

6. Nuk ka asnjë përmendje historike të një profeti të madh (deutero-Isaia) në shekullin e gjashtë. R. K. Harrison, në *Introduction to the Old Testament*, shton këto fjalë për këtë temë:
- “Argumentet nga stili letrar ishin tejet në modë në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë, por në kuadër të një njohurie shumë më të madhe që kemi nga gjuhët e lashta të Lindjes së Afërt, tani këto argumente zënë një pozicion shumë më të zbutur. Subjektiviteti i koncepteve stilistikore kishte forcë të madhe për përkrahësit e teorisë Graf-Uellhaufen për analizën letrare, të cilëve s’u dukej aspak e papërputhshme të shqyrtonin materiale që i atribuohen një autori biblik dhe, pastaj, të mohonin disa pjesë të vetë atij libri si të shkruara prej tij për shkak se forma letrare dhe fjalori i çdo kapitulli nuk rastiste të ishte identik me të tjerët. Me sa duket, këtyre hetuesve të hershëm nuk u shkante ndër mendje se koncepti për stilin e një autori të hershëm mund të krijohej vetëm si rezultat i studimit të kujdesshëm të të gjitha materialeve që i atribuohen atij, dhe se refuzimi i mëvonshëm i një pjese (apo i gjithë) të atij grupi materialesh mund të vleftësohej vetëm në bazë të një kontrolli të jashtëm e rigoroz”. f. 776

D. Disa arsye për autorësinë e shumëfishtë të Isaisë

1. Në kapitujt 40-66, emri “Isaia” nuk përmendet.
2. Kapitujt 40-66 nuk përputhen me kontekstin historik të Isaisë.
3. Duket se kan jë përzierje termash kur Isaia përmend:
 - a. pushtimin asirian, robërinë aty dhe gjykimin e Asirisë
 - b. pushtimin babilonas, robërinë aty dhe gjykimin e Babilonisë.
4. Qartazi, ka isa arsye pse mund të arrihet te teoria e autorësisë së shumëfishtë:
 - a. ndryshim i kontekstit historik
 - (1) Juda para pushtimit, 1-39
 - (2) Robëria, 40-55
 - (3) Juda pas robërisë, 56-66
 - (4) Te Isaia 1-39, Tempulli nuk do të bjerrë kurrë, ndërsa në 40-66, me sa duket ka rënë tashmë. Autori duket se është në robëri.
 - b. ndryshim i fjalëve që përshkruajnë të zgjedhurin e Perëndisë:
 - (1) fëmija mesianik
 - (2) Shërbëtori i përvuajtur
 - (3) Izraeli si:
 - (a) Grua (50:1)
 - (b) Shërbëtor i JHVH (54:17)
5. Studiuesit e sotëm konservatorë:
 - a. Thënia e E. J. Young për kapitujt 56-66 është e dosibhme: “një tjetër mundësi është se kemi të bëjmë me profeci (të dhëna nga Fryma e të mbledhura nga redaktorë) nga profetë të ndryshëm të shkollës së Isaia, të bashkuara rreth disa tematikave bazë të kësaj pjese”, f. 188
 - b. G. R. K. Harrison thotë: “unë, si autor, mendoj se Isaia, ashtu si shumica e shkrimeve të tjera profetike që kemi, përfaqëson një antologji shprehjesh profetike të dhëna në kohë të ndryshme, dhe si e tillë vepra meriton të njëjtin trajtim si ai që u jepet profecive të tjera kryesore të Dhiatës së Vjetër. Në këtë kuadër, është e rëndësishme të vërejmë se argumentet e bazuara te dallimet stilistikore ose te shprehjet letrare humbasin menjëherë vlerë sipas kësaj përqsajeje, pasi antologjia normalisht përfaqëson stilin total të autorit gjatë periudhave të ndryshme të veprimtarisë së tij krijuese. Arsyeja e përshkrimit të kësaj vepre si antologji në kuptimin më të mirë të kësaj fjale gjendet në vargun hryës të profecisë, që përbën titullin e veprës, dhe që flet në mënyrë të veçantë për materialet e zbulesës që Isaia, biri i Amocit, kishte marrë në vegime në lidhje me Judën dhe Jerusalem në kohën e Uziahut, Jotamit, Ahazit dhe Hezekias. Ashtu si në çdo antologji tjetër, është shumë e qartë se ky libër përmban vetëm një përzgjedhje të thënieve dhe predikimeve të disponueshme profetike, dhe ka shumë gjasa që Isaia të ketë shkruar shumë më tepër materiale nga ç’kanë mbijetuar në këtë libër. Natyra e profecië së tij si antologji vihe më tej në dukje nga prania e mbishkrimeve në Isa. 2:1 dhe 13:1, që mund të kenë përfaqësuar, ose treguar, praninë e koleksioneve të mëparshme me shprehje profetike”. f. 780
6. Stili letrar i kapitujve 40-66 ndryshon nga ai i kapitujve 1-39.

- E. Komete përmbledhëse për autorësinë
1. Studiuesit e perëndishëm vazhdojnë të mos bien dakord sesi u formua libri i Isaisë në formën e tanishmë (shih pergamenat e Detit të Vdekur dhe MT). Theksi kryesor duhet vendosur në frymëzimin dhe besueshmërinë e këtij libri kur na zbulon karakterin dhe qëllimet e JHVH.
 2. Duhet të refuzojmë çdo presupozim që mohon zbuluesën besnike të Perëndisë përmes Isaisë. Kjo përfshin dhe refuzimin *a priori* të profecisë parashikuese, apo uljen e DHV në nivelin e një rreftim historik që është vetëm njerëzor dhe përfaqëson kohën e vet.

VI. DATA

- A. Isaia bën pjesë në profetët e shekullit të tetë
1. Jona, Amosi dhe Osa në veri, gjatë mbretërimit të Jeroboamit II (786-640 para K.)
 2. Isaia dhe Mikea në jug
- B. Ai u lind më 760 para K. dhe u thirr në ofiqin profetik rreth 742 para K. në vitin e vdekjes së Uaizahut (6:1). Uziahuh quhet dhe Azaria (783-742 para K.).
- C. Isaia pati një shërbesë të gjatë, që nga vitet përmbyllëse të Uziahut (783-742 para K.) deri në kohën e Jotamit (742-735 para K.), Ahazit (735-715 para K.), Hezekias (715-687 para K.) dhe, ndoshta, Manasit (687-642 para K.).
- D. R. K. Harrison shprehet se ky libër është një antologji me shkrimet dhe predikimet e këtij profeti gjatë shumë viteve dhe mbretërve të ndryshëm të Judesë. Më në fund, u mbledh dhe u redaktua pas vdekjes së këtij profetit, rreth 630 para K.

VII. KONTEKSTI HISTORIK

- A. Profetët e shekullit të tetë
1. Materiali biblik gjendet në:
 - a. 2 Mbre. 14:3-17:6
 - b. 2 Kron. 25-28
 - c. Amos
 - d. Jona
 - e. Osea
 - f. Isaia
 - g. Mikea
 2. Përmbledhja më e thjeshtë e gjendjes idhujtare të popullit të Perëndisë gjendet në Osea:
 - a. 2:16, “nuk do të më quani më Baali”
 - b. 4:12-13, “... bijat luajnë prostitutën...”
 - c. 4:17, “Efraimi u është bashkuar idhujve; lëre të shkojë”
 - d. 13:2 “burrat puthin viçat!” (ritual)
 3. Konteksti shoqëror
 - a. Ishte kohë begatie ekonomike dhe zgjerimi ushtarak për Izraelin dhe për Judan. Megjithatë, ky begatim ishte i dobishëm vetëm për klasën e të pasurve. Të varfrit shfrytëzoheshin dhe dhunoheshin. Duket se “paraja dhe pushka” ishin bërë idhuj shtesë!
 - b. Qëndrueshmëria shoqërore dhe ekonomike e Izraelit dhe Judës lidhet më disa shkaqe:
 - (1) Mbretërimet e gjata dhe të begata të Jeroboamit II (786-746 para K.) në veri dhe të Uziahut (783-742 para K.) në jug.
 - (2) Disfata e Sirisë nga asirianët e udhëhequr nga Ada-Nirari III më 802 para K.
 - (3) Mungesa e konflikteve mes Izraelit dhe Judës.
 - (4) Taksimi dhe shfrytëzimi i rrugëve tregtare ver-jug përmes “urës” tokësore të Palestinës çuan në rritje të shpejtë ekonomike, madje dhe në teprim për klasën e pasur.

- c. “Copat e vazove të Samarisë”, që datojnë gjatë mbretërimit të Jeroboamit II duket se tregojnë për një organizim administrativ si ai i Solomonit. Kjo duekt se vërtetohet humnerën gjithnjë e më të madhe mes të kamurve dhe të skamurve.
- d. Pandershmeria e të pasurve përshkruhet qartë nga Amosi, që quhet “profeti i drejtësisë”. Korrupsioni i gjyqësorit dhe falsifikimi i peshave tregtare janë dy shembuj të qartë të abuzimit, që, me sa duket, ishte i përhapur edhe në Izrael, edhe në Judë.
4. Konteksti fetar
- a. Ishte një periudhë aktiviteti të madh fetar, por e një besimi shumë të pakët. Kultet e pjellorisë kananite ishin përzier me fenë e Izraelit. Populli ishte idhujtar, por besimin e tyre e quanin JHVH-izëm. Prirja e popullit të Perëndisë drejt aleancave politike i kishte shtyrë në adhurimin dhe ritualet pagane.
- b. Idhujtaria e Izraelit shprehet qartë në 2 Mbre. 17:7-18.
- (1) Në v. 8, ata ndiqnin ritualet e adhurimit të kananitëve.
- (a) Adhurimi i pjellorisë (shih Lev. 18:22-23)
- i) vendet e larta, v. 9, 10, 11
- ii) shtyllat e shenjta (Baaali), v. 10, 16
- iii) Asherimët, v. 16; ishin simbole druri të bashkëshortes femër të Baalit. Ishin ose drurë të gdhendur, ose pemë të gjalla.
- (b) Shortaria, v. 17. Ishte dënuar nga Lev. 19-20 dhe LiP. 18.
- (2) Në v. 16, ata vijuan adhurimin e dy viçave të artë, që simbolizojnë JHVH, dhe që ishin ngritur në Dan dhe Betel nga Jeroboami I (1 Mbre. 12:28-29).
- (3) Në v. 16, ata adhurorin perënditë yjore të Babilonisë: diellin, hënën, yjet dhe yjësitë.
- (4) Në v. 18, ata adhurorin perëndinë e zjarrit dhe pjellorisë fenikase, Molekun, duke flijuar bijtë e tyre (shih Lev. 18:21; 20:2-5). Ky ritual quhet “*molek*”. Nuk ishte emri i perëndisë.
- c. Baalizmi (shih W. F. Albright, *Archaeology and the Religion of Israel*, f. 82 e më tej)
- (1) Burimi ynë më i mirë arkeologjik është “Epika e Baalit në Ugarit”.
- (a) E pasqyron Baalin si një perëndi që vdes dhe ringjallet në mënyrë stinore. Ai u mposht nga Moti dhe u detyrua të jetonte në botën e nëndheshme. Gjithë jeta në tokë pushoi. Por, me ndihmën e perëndeshës femër *Anat*, ai ngrihet dhe e mposht Motin çdo pranverë. Baali ishte një perëndi pjellorie, që adhurohej me anë të magjive imituese.
- (b) Njihej edhe me emrin *Hadad*.
- (2) *El* është perëndia kryesor i panteonit kananit, por popullariteti i Baalit bëri që të zëvendësohej.
- (3) Izraeli u ndikua më së tepërmi nga baalizmi tirian përmes Jezebelës, që ishte e bija e mbretit të Tirit. Ajo u zgjodh nga Omri për të birin e tij, Ahabin.
- (4) Në Izrael, Baali adhurohej në vendet e larta. Simbolizohej nga një gur i ngritur në këmbë. Bashkëshortja e tij ishte Asherahu, e simbolizuar nga një hu i gdhendur, që simbolizonte pemën e jetës.
- d. Përmenden disa burime dhe lloje idhujtarie.
- (1) viçat e artë në Betel dhe Dan, të ngritur nga Jeroboami I për të adhuroar JHVH.
- (2) Adhurimi i perëndisë dhe perëndeshës së pjellorisë tiriane në vendet e larta.
- (3) Idhujtaria e domosdoshme që përfshihet në aleancat politike të kohës.
5. Përmbledhje e shkurtër e pushtimeve të Asirisë dhe Babilonisë gjatë shekullit të tetë, që ndikuan dhe në situatën e Palestinës:
- a. Katër profetët e shekullit të tetë vepruan gjatë ngritjes së perandorisë së Asirisë në Tigër-Euftrat. Perëndia e përdori këtë komb mizor për të gjykuar popullin e vet, veçanërisht Izraelin.
- (1) Ngjarja ishte formimi i aleancës politike dhe ushtarake të trans-Jordanit, e njohur si “Lidhja siro-eframite” (735 para K.). Siria dhe Izraeli u përpoqën ta detyronin Judën që të bashkohej me ta kundër Asirisë. Mirëpo Ahazi i dërgoi letër Asirisë për ndihmë. Mbreti i parë i fuqishëm asirian, që kishte mendësi perandorake, Tiglath-Pileseri III (745-727 para K.), iu përgjigj kësaj sfide ushtarake dhe pushtoi Sirinë.

- (2) Më vonë, mbreti kukull i Asirisë, Hoshea (732-722 para K), në Izrael, ngriti krye dhe i kërkoi ndihmë Egjiptit. Shalmaneseri V (727-722 para K.) e pushtoi sërisht Izraelin. Ai vdiq përpara se Izraeli të nënshtrohej, por pasardhësi i tij, Sargoni II (722-705 para K.), e pushtoi kryeqytetin e Izraelit, Samarinë, më 722 para K. Asiria deportoi mbi 27,000 izraelitë me këtë rast, ashtu si Tiglath-Pileseri kishte çuar në robëri mijëra të tjerë më herët në 732 para K.
- b. Pas vdekjes së Ahazit (735-715 para K.), u formua një tejtër koalicion ushtarak mes vendeve të trans-Jordanit dhe Egjiptit kundër Asirisë (714-711 para K.). Njihej si “Kryengritja e Ashdodit”. Shumë qytete judease u shkatërruan kur Asiria i pushtoi sërisht. Në fillim, Hezekia e mbështeste koalicionin, por më vonë u tërhoq prej tij.
- c. Sidoqoftë, sërisht një tjetër koalicion u përpoq të përfitonte nga vdekja e mbretit të fuqishëm të Asirisë, Sargonit II, më 705 para K., së bashku me shumë kryengritje të tjera që ndodhën në mbarë perandorinë asiriane.
- (1) Hezekia mori plotësisht pjesë në këtë kryengritje. Në kuadër të kësaj sfide, Senakeribi (705-681 para K.) pushtoi Palestinën (701 para K.) dhe fushoi pranë qytetit të Jerusalemit (2 Mbre. 18-19; Isa. 36-39), por ushtria e tij u shkatërrua në mënyrë të mrekullueshme nga Perëndia.
- (2) Ka njëfarë diskutimi mes studiuesve se sa herë e pushtoi Senakeribi Palestinën. (Shembull: John Bright flet për një pushtim më 701 para K. dhe një tjetër të mundshëm më 688 para K., shih f. 270).
- (3) Hezekia shpëtoi nga zaptimi asirian, por për shkak të ekspozimit krenar të thesareve të Judës që ai bëri para delegacionit babilonas, Isaia parashkoi rënien e Judës në dorë të Babilonisë (39:1-8). Jerusalemi ra në dorë të Nebukadnecarit më 587-586 para K.
- d. Isaia paratha dhe rikthimin e popullit të Perëndisë nën Kirin II, sundimtari medo-pers (41:2-4; 44:28; 45:1; 56:11). Niniva ra më 612 para K. në dorë të Babilonisë, por qyteti i Babilonisë ra më 539 para K. në dorë të ushtrisë së Kirit. Më 538 para K., Kiri nxori një dekret, që lejonte gjithë popujt e çuar në robëri, përfshi dhe judenjtë, që të ktheheshin në vendlindje. Madje, u siguroi dhe fonde nga thesari i tij për rindërtimin e tempujve kombëtarë.
- B. Një vështrim i shkurtër historik i fuqive të mëdha në Mesopotami (duke përdorur data të marra kryesisht nga *A History of Israel*, shkruar nga John Bright, f. 462 e më tej):
1. Perandoria asiriane (Zan. 10:11):
- a. feja dhe kultura u ndikuan së tepërmi nga perandoria sumere/babilonase.
- b. listë e mundshme e sundimtarëve, me datat e përafërta:
- (1) 1354-1318 Ashur-Ubalit I:
 (a) Pushtoi qytetin hitit të Karkemishit.
 (b) Nisi zhdukjen e ndikimit hitit dhe lejoi zhvillimin e Asirisë.
- (2) 1297-1266 Ada Nirari (mbret i fuqishëm)
- (3) 1265-1235 Shalmaneser I (mbret i fuqishëm)
- (4) 1234-1197 Tukulti-Ninurta I
 - Pushtimi i parë i perandorisë babilonase në jug.
- (5) 1118-1078 Tiglath-Pileser I
 - Asiria bëhet fuqi e madhe në Mesopotami.
- (6) 1012-972 Ashur-Rabi II
- (7) 972-967 Ashur-Resh-Isui II
- (8) 966-934 Tiglath-Pileser II
- (9) 934-912 Ashur-Dan II
- (10) 912-890 Adad-Nirari II
- (11) 890-884 Tukulti-Ninurta II
- (12) 890-859 Ashur-Nasir-Apal II
- (13) 859-824 Shalmaneser III.
 Beteja e Karkarit më 853
- (14) 824-811 Shamashi-Adad V

- (15) 811-783 Adad-Nirari III
 (16) 781-772 Shalmaneser IV
 (17) 772-754 Ashur-Dan III
 (18) 754-745 Ashur-Nirari V
 (19) 745-727 Tiglath-Pileser III:
- (a) I quajtur sipas emrit të tij të fronit babilonas, Pul, në 2 Mbre. 15:19.
 - (b) Mbret shumë i fuqishëm
 - (c) Filloi politikën e deportimit të popujve të pushtuar.
 - (d) Më 735 para K. u bë formimi i “Lidhjes siro-efraimite”, që ishte përpjekje për të bashkuar të gjitha burimet e disponueshme ushtarake të kombeve të trans-Jordanit, që nga Eufrati në Egjipt, me qëllim që të neutralizonin forcën ushtarake në rritje të Asirisë. Mbreti Ahaz i Judës nuk pranon të bashkohet me Lidhjen, kështu që pushtohet nga Izraeli dhe Siria. Ai i shkruan Tiglath-Pileserit III për ndihmë kundër kështillës së Isaisë (shih Isa. 7-12).
 - (e) Më 732 Tiglath-Pileseri III pushton Sirinë dhe Izraelin dhe vendos një mbret vasal në fronin e Izraelit: Hoshean (732-722 para K.). Mijëra judenj çohen në robëri në Medi (shih 2 Mbre. 15-16).
- (20) 727-722 Shalmaneser V.
 -Hoshea lidh aleancë me Egjiptin dhe pushtohet nga Asiria (shih 2 Mbre. 17).
- (21) 722-705 Sargon II:
- (a) Pas një rrethimi trevjeçar, të nisur nga Shalmaneseri V, gjenerali dhe pasuesi i tij Sargoni II pushton kryeqytetin e Izraelit, Samarinë. Mbi 27,000 izraelitë deportohen në Medi.
 - (b) Pushtohet dhe perandoria hitite.
 - (c) Më 714-711, një tjetër koalicion i kombeve të trans-Jordanit dhe Egjiptit ngrënë krye kundër Asirisë. Ky koalicion njihet si “Kryengritja e Ashdodit”. Edhe Hezekia i Judës u përfshi në fillim me ta. Asiria i pushtoi dhe shkatërroi disa qytete filistinase.
- (22) 705-681 Senakeribi:
- (a) Më 705, një tjetër koalicion i kombeve të trans-Jordanit me Egjiptin ngritën krye pas vdekjes së babait të tij, Sargonit II. Hezekia e mbështeti plotësisht këtë kryengritje. Senakeribi i pushtoi më 701. Kryengritja u shtyp, por Jerusalemi u kursye për shkak të një veprimi hyjnor (shih Isa. 36-39; 2 Mbre. 18-19.)
 - (b) Senakeribi shtypi dhe kryengritjet në Elam dhe Babiloni.
- (23) 681-669 Esarhadoni:
- (a) Sundimtari i parë asirian që sulmoi dhe pushtoi Egjiptin.
 - (b) Kishte simpati të madhe për Babiloninë, dhe ia rindërtoi kryeqytetin.
- (24) 669-663 Ashurbanipali:
- (a) I quajtur dhe Osnapar, në Ezra 4:10
 - (b) Vëllai i tij, Shamash-shum-ukin u bë mbret i Babilonisë. Kjo solli disa vite paqeje mes Asirisë dhe Babilonisë, por pati një nënrrymë pavarësie, e cila shpërtheu më 652, e udhëhequr nga i vëllai.
 - (c) Rënia e Tebës, 663
 - (d) Disfata e Elamit, 653, 645
- (25) 633-629 Ashur-Etil-Ilani.
 (26) 629-612 Sin-Shar-Ishkun.
 (27) 612-609 Ashur-Ubalit II:
- U kurorëzua mbret në mërgim në Haran pas rënies së Ashurit më 614 dhe Ninives më 612.
2. Perandoria neobabilonase:
- a. 703-? Merodak-Baladan:
 - Nisi një sërë kryengritjesh kundër sundimit asirian.
 - b. 652 Shamash-Shum-Ukin:
 (1) Biri i Esarhadonit dhe vëllai i Ashurbanipalit.
 (2) Nisi kryengritjen kundër Asirisë, por u mposht.

- c. 626-605 Nabopolasar:
- (1) Ishte monarku i parë i perandorisë neo-babilonase.
 - (2) Sulmoi Asirinë nga jugu, ndërsa Kiaksari i Medisë e sulmoi nga verilindja.
 - (3) Kryeqyteti i vjetër asirian, Ashuri, ra më 614, kurse kryeqyteti i ri e i fuqishëm, Niniva, ra më 612.
 - (4) Pjesa e mbetur e ushtrisë asiriane u tërhoq në Haran. Madje, caktuan dhe një mbret.
 - (5) Më 608, faraoni Neko II (shih 2 Mbre. 23:29) marshoi në veri për të ndihmuar pjesën e mbetur të ushtrisë asiriane me qëllim që të formonte një zonë sigurie kundër fuqisë në rritje të Babilonisë. Josia, mbreti i perëndishëm i Judës (shih 2 Mbre. 23), iu kundërvu kalimit të ushtrisë egjiptiane përmes Palestinës. Në Megido u zhvillua një përleshje e shkurtër. Josia u plagos dhe vdiq (2 Mbre. 23:29-30). I biri, Jehoahazi, u bë mbret. Faraoni Neko II mbërriti tepër vonë për të ndaluar shkatërrimin e forcave asiriane në Haran. U përlesh me forcat babilonase, të komenduara nga princi i kurorës, Nebukadnecari II, dhe pësoi disfatë të rëndë më 605 në Karkemish, në Eufrat.
Gjatë kthimit në Egjipt, Neko ndaloi në Jerusalem dhe plaçkiti qytetin. E zëvendësoi dhe e deportoi Jehoahazin pas vetëm 3 muajsh.. Në fron vendosi një tjetër bir të Josias, Jehoiakimin (shih 2 Mbre. 23:31-35).
 - (6) Nebukadnecari II e ndoqi ushtrinë egjiptiane në jug përmes Palestinës, por i dërguan fjalë për vdekjen e të atit dhe u kthye në Babiloni.
Më vonë, në të njëjtin vit, u kthye në Palestinë. La Jehoiakimin në fronin e Judës, por çoi në robëri disa mijëra njerëz të parisë dhe disa anëtarë të familjes mbretërore. Danieli dhe miqtë e tij ishin pjesë e këtij deportimi.
- d. 605-562 Nebukadnecari II:
- (1) Nga 597-538, Babilonia e kishte plotësisht nën kontroll Palestinën.
 - (2) Më 597, u krye një tjetër deportim nga Jerusalem për shkak të aleancës së Jehoiakimit me Egjiptin (2 Mbre. 24). Ai vdiq përpara mbërritjes së Nebukadnecarit II. Biri i tij, Jehoiakini, u bë mbret për vetëm 3 muaj dhe, pastaj, e çuan në robëri në Babiloni. Dhjetë mijë shtetas, bashkë me Ezekielin, u rivendosën pranë qytetit të Babilonisë, përbri Kanalit të Kebarit.
 - (3) Më 586, pas flirtimit të vazhdueshëm me Egjiptin, qyteti i Jerusalem u shkatërrua plotësisht (2 Mbre. 25) dhe u krye një deportim tjetër masiv. Zedekia, që zëvendësoi Jehoiakinin, udeportua dhe guvernator u caktua Gedaliahu.
 - (4) Gedaliahu u vra nga forcat ushtarake kryengritëse të judenjve. Këto forca u arratisën në Egjipt dhe e detyruan Jeremian të shkonte me ta. Nebukadnecari i pushtoi për herë të katërt (605, 596, 586, 582) dhe deportoi gjithë judenjtë e mbetur që arriti të gjente.
- e. 562-560 Evil-Merodak, i njohur dhe si Amel-Marduk
- Liroi Jehoiakimin nga burgu, por e detyroi të qëndronte në Babiloni (shih 2 Mbre. 25:27-30; Jer. 52:31).
- f. 560-556 Neriglisar.
-Ishte gjenerali i Nebukadnecarit, që shkatërroi Jerusalem.
- g. 556-? Labaski-Marduk.
-Ishte biri i Neriglisarit, por u vra pas vetëm nëntë muaj.
- h. 556-539 Nabonidi:
- (1) Nabonidi nuk kishte lidhje gjaku me familjen mbretërore, kështu që u martua me një bijë të Nebukadnecarit II.
 - (2) Shumicën e kohës e kaloi duke ndërtuar një tempull për perëndinë e hënës “Sin”, në Tema. Ishte biri i kryepriфтëreshës së kësaj perëndeshe. Kjo shkaktoi armiqsinë e priфтërinjve të Mardukut, kryeperëndisë së Babilonisë.
 - (3) Shumicën e kaloi në përpjekje për të shtypur kryengritjet dhe për të stabilizuar mbretërinë.
 - (4) U zhvendos në Tema dhe ia la në dorë punët e shtetit të birit, Belshacarit, në kryeqytetin e Babilonisë (shih Dan. 5).
- i. ?-539 Belshacar (bashkëmbret)

- Qyteti i Babilonisë ra shumë shpejt në dorë të ushtrisë medo-perse nën Gobriasin e Gutiumit, të cilët ia ndryshuan rrjedhën ujit të Eufratit dhe hynë në qytet pa rezistencë. Priftërinjtë dhe populli i qytetit i trajtuan persët si çlirues dhe si rimëkëmbësit e Mardukut. Gobriasi u bë guvernator i Babilonisë nga Kiri II. Ose Kiri II, ose Gobriasi, është “Dari med” i Dan. 5:31 dhe 6:1. Dar do të thotë “Mbretërori”.
- 3. Perandoria medo-perse: vështrim i përgjithshëm i ngritjes së Kirit II (Isa. 44:28; 45:1-7):
 - a. 625-585 Kiaksari ishte mbreti i Medisë, që ndihmoi Babilonin të mposhte Asirinë.
 - b. 585-550 Astiagu ishte mbreti i Medisë. Krisi ishte nipi i tij me anë të Mandanit.
 - c. 550-530 Kiri II i Anshamit ishte një mbret vasal, që ngriti krye.
 - (1) Nabonidi, mbreti babilonas, e mbështeti Kirin.
 - (2) Kiri II rrëzoi nga fronti Astiagun.
 - (3) Me qëllim që të rikthente ekuilibrin e pushtetit, Nabonidi bëri aleancë me:
 - (a) Egjiptin
 - (b) Kroesin, mbretin e Lidias (Azia e vogël)
 - d. 547- Kiri II marshoi kundër Sardit (kryeqyteti i Lidias)
 - e. 2 nëntor, 539, Gobriasi i Gutiumit, bashkë me ushtrinë e Kirit, e pushtoi Babiloninë pa rezistencë. Gobriasi u bë guvernator i Babilonisë.
 - f. 539- në tetor, Kiri II “i madh” hyri personalisht si çlirues. Politika e tij zemërgjerë ndaj grup-kombeve zmbropsi vitet e deportimit si politikë kombëtare.
 - g. 538- judenjtë dhe të tjerët u lejuan që të ktheheshin në vendlindje dhe të rindërtonin tempujt vendas.
 - h. 530- biri i Kirit, Kambisi II, pasoi të atin në fron.
 - i. 530-522 mbretërimi i Kambisit II.
 - I shtoi perandorisë medo-perse dhe Egjiptin më 525.
 - Mund të ketë kryer vetëvrasja.
 - j. 522-486 në pushtet erdhi Dari I.
 - (1) Nuk ishte nga familija mbretërore, por ishte gjeneral ushtarak.
 - (2) E organizoi perandorinë perse duke përdorur planet e Kirit për satrapët (shih Ezra 1-6; Hagai; Zakaria).
 - (3) Nxorri monedhat e veta, si Lidia.
 - k. 486-465 mbretërimi i Kserksit I:
 - (1) Shtypi kryengritjen egjiptiane.
 - (2) Donte të pushtonte Greqinë dhe të përmbushte ëndrrën perse, por pësoi disfatë në betejën e Termopileve më 480 dhe në Salaminë më 479.
 - (3) Burri i Esterit, që quhet Ahasur në Bibël, u vra më 465.
 - l. 465-424 mbretërimi i Artakserksit I (shih Ezra 7-10; Nehemia; Malakia):
 - (1) Grekët viajuan të përparonin derisa u përballën me luftrat civile të Peloponezit.
 - (2) Greqia ndahet (Athinase – Peloponeziane).
 - (3) Luftrat civile greke zgjatën rreth 20 vjet.
 - (4) Gjatë kësaj periudhe, komuniteti jude u forcua.
 - m. 423-404 mbretërimi i Darit II.
 - n. 404-358 mbretërimi i Artakserksit III.
 - o. 338-336 mbretërimi i Arsit.
 - p. 336-331 mbretërimi i Darit III.
- 4. Vështrim i përgjithshëm i Egjiptit:
 - a. Hiksot (mbretërit barinj – sundimtarë semitë) – 1720/10-1550 para K.
 - b. Dinastia e 18-të (1570-1310 para K.)
 - (1) 1570-1546 Amosis
 - (2) 1546-1525 Amenofisi I (Amenhotepi I)
 - (3) 1525-1494 Tutmozi I
 - (4) ? Tutmozi II
 - (5) ? Hatshepsuti
 - (6) 1490-1435 Tutmozi III
 - (7) 1435-141 Amenofisi II

- (8) 1414-1406 Tutmozi IV
- (9) 1406-1370 Amenofisi III
- (10) 1370-1353 Amenofisi IV (Akhenaten)
- (11) ? Smenkhare
- (12) ? Tutankhamun
- (13) ? Aj
- (14) 1340-1310 Haermhabi
- c. Dinastia e 19-të (1310-1200 para K.):
 - (1) ? Ramzesi I
 - (2) 1309-1290 Seti I
 - (3) 1290-1244 Ramesisi (Ramzesi II)
 - (4) 1224-1216 Marniptah (Merneptah)
 - (5) ? Amenmesi
 - (6) ? Seti II
 - (7) ? Sipta
 - (8) ? Tevosreti
- d. Dinastia e 20-të (1180-1065 para K.):
 - (1) 1175-114 Ramzesi III
 - (2) 1144-1065 Ramzesi IV – XI
- e. Dinastia e 21-të (1065-935 para K.):
 - (1) ? Smendi
 - (2) ? Herihori
- f. Dinastia e 22-të (935-725 para K. – libiane):
 - (1) 935-914 Shishaku (Shoshenku I, ose Shoshengu I)
 - (2) 914-874 Osorkoni I
 - (3) ? Osorkoni II
 - (4) ? Shoshenku II
- g. Dinastia e 23-të (759-715 para K. – Libiane)
- h. Dinastia e 24-të (725-709 para K.)
- i. Dinastia e 25-të (716/15-663 para K. – etiopiane/nubiane):
 - (1) 710/09-696/95 Shabako (Shabaku)
 - (2) 696/95-685/84 Shebetko (Shebitku)
 - (3) 690/89, 685/84-664 Tirhaka (Taharka)
 - (4) ? Tantamuni
- j. Dinastia e 26-të (663-525 para K. – Saitike):
 - (1) 663-609 Psametiku I (Psamtiku)
 - (2) 609-593 Neko II (Neko)
 - (3) 593-588 Psametiku II (Psamtiku)
 - (4) 588-569 Apriesi (Hofra)
 - (5) 569-525 Amasi
 - (6) ? Psametiku III (Psamtiku)
- k. Dinastia e 27-të (525-401 para K. – perse):
 - (1) 530-522 Kambisi II (biri i Kirit II)
 - (2) 522-486 Dari I
 - (3) 486-465 Kserksi I
 - (4) 465-424 Artakserksi I
 - (5) 423-404 Dari II

* për një kronologji ndryshe, shih *Zondervan's Pictorial Bible Encyclopedia*, vëll. 2, f. 231.

- 5. Vështrim i përgjithshëm i Greqisë:
 - a. 359-336 Filipi i Maqedonisë:
 - (1) Ndërtoi Greqinë
 - (2) U vra më 336.

- b. 336-323 Aleksandri II “i Madh” (biri i Filipit):
- (1) I dha dërmën Darit II, mbretit pers, në betejën e Isit.
 - (2) Vdiq më 323 në Babiloni nga ethet në moshën 33/32 vjeçare.
 - (3) Gjeneralët e Aleksandrit e ndanë kështu perandorinë e tij pas vdekjes:
 - (a) Kasandri – Maqedoninë dhe Greqinë
 - (b) Lisimiku – Trakën
 - (c) Seleuku I – Sirinë dhe Babiloninë
 - (d) Ptolemi – Egjiptin dhe Palestinën
 - (e) Antigoni – Azinë e Vogël (nuk zgjati shumë)
- c. Seleukët kundër ptolemëve për kontrollin e Palestinës
- (1) Siri (sundimtarët seleukë):
 - (a) 312-280 Seleuku I
 - (b) 280-261 Antioku I Soster
 - (c) 261-246 Antioku II Teus
 - (d) 246-226 Seleuku II Kalinikus
 - (e) 226-223 Seleuku III Keraunus
 - (f) 223-187 Antioku III i Madh
 - (g) 187-175 Seleuku Iv Filopator
 - (h) 175-163 Antioku IV Epifan
 - (i) 163-162 Antioku V
 - (j) 162-150 Demetri I
 - (2) Egjipt (sundimtarët ptolemej):
 - (a) 327-285 Ptolemi I Soter
 - (b) 285-246 Ptolemi II Filadelfus
 - (c) 246-221 Ptolemi III Evergjet
 - (d) 221-203 Ptolemi IV Filopator
 - (e) 203-181 Ptolemi V Epifan
 - (f) 181-146 Ptolemi VI Filometor
 - (3) Vështrim i shkurtër:
 - (a) 301- Palestina nën sundimin ptolem për vite me radhë
 - (b) 175-163 Antioku IV Epifan, sundimtari i tetët seleuk, donte t’i helenizonte judenjtë, edhe forcërisht nëse ishte e nevojshme:
 - i) Ndërtoi gjimnaze (vende ku stërviteshin të rinjtë)
 - ii) Ndërtoi altarë paganë për Zeusin Olimpik në tempull

VIII. NJËSITË LETRARE

A. Përvijim i shkurtër

1. Kapitujt 1-39 – profeti dhe koha e tij
2. Kapitujt 40-66 (ose, mundësisht, 40-55 dhe 56-60) – epoka e re

B. Kapitujt 1-39, konteksti historik i kohës së Isaisë (para robërisë)

1. Kapitujt 1-6, nën mbretërit Uzia dhe Jotam
2. Kapitujt 7-14, nën mbretin Ahaz
3. Mbretërit 15-39, nën mbretin Hezekia (kapitujt 36-39 janë paralel me 2 Mbre. 18:13-20:19)

C. Kapitujt 40-66, periudha e robërisë dhe pas robërisë janë tipologji të mbretërisë së ardhshme.

1. Ashtu si kapitujt 1-39 reflektojnë predikimin e Isaisë dhe janë, qartazi, prezantime gojore, kapitujt 40-55 reflektojnë një kontekst të ri. Gjykimi i Perëndisë ka ardhur dhe, tani, tema kryesore është rimëkëmbja. Ekzistojnë dhe disa shenja stilistike që këta kapituj janë më shumë të shkruar, sesa gojorë.
2. Kapitujt 1-39 trajtojnë qartazi kërcënimin asirian, si dhe kërcënimin asirian në mënyrë tipologjike, në veçanti në kapitujt 13-14, 21 dhe 39. Kapitujt 40-55 trajtojnë periudhën perse dhe rimëkëmbjen e popullit të Perëndisë në Vendin e Premtuar.

3. Kapitujt e mëvonshëm të Isaisë, 56-66, janë eskatologjikë; përdorin metafora nga Lindja e Aftërt e lashtë që parahijezojnë adhurimin monoteist të JHVH-së në mbarë botën.

D. Vështirësia e përvijimit të Isaisë

1. Shumica e studiuesve modernë e ndajnë librin në të paktën dy pjesë: kapitujt 1-39 dhe 40-66. R. K. Harrison: kap. 1-33 dhe 34-66, për shkak të një ndarjeje në tekstin e Pergamenave të Detit të Vdekur. Kjo ndarje e qartë në këta Pergamena mes kapitullit 33 dhe 34 ka çuar në mendimin se Isaia u mblodh nga dishepujt e tij në dy vëllime. W. H. Brownlee ka propozuar se këta dy vëllime pasqyrojnë njëri-tjetrin nga ana strukturore:

Vëllimi 1:

Kapitujt 1-5 shkatërrimi dhe rimëkëmbja
 Kapitujt 6-8 material biografik
 Kapitujt 9-12 vepruesit e bekimit dhe gjykimit hyjnor
 Kapitujt 13-23 orakuj kundër fuqive të huaja
 Kapitujt 24-27 shpengimi botëror dhe çlirimi i Izraelit
 Kapitujt 28-31 predikime etike
 Kapitujt 32-33 rimëkëmbja e kombit

Vëllimi 2:

kapitujt 34-35
 kapitujt 36-40
 kapitujt 41-45
 kapitujt 46-48
 kapitujt 49-55
 kapitujt 56-59
 kapitujt 60-66

2. Disa përvijime përqendrohen në kontekstin historik, ndërsa disa të tjera, në përmbajtjen mesianike

	NIV	Leupoldi
kap. 7-12	“profecitë me rastin e kërcënimit arameas dhe izrealit ndaj Judës”	“Libri i Imanuelit”
kap. 28-33	“Gjashtë goditjet: pesë ndaj Izraelit jobesnik dhe një ndaj Asirisë”	“Libri i Sionit” (guri i qoshes)

3. Disa shembuj paqartësie për njësitë letrare (kap. 1-12)

- a. Përvijimi i kapitujve 1-12 nga E. Y. Young, f. 211-214:

- (1) 1:1-12:6 Profeci në lidhje me Judën dhe Jerusalemin
 (a) 1:1-31 gjyqi i madh
 (b) 2:1-4:6 mbretërimi dhe gjykimi që i bën Mesia popullit
 (c) 3:5-30 paudhësitë e mëdha të Judës
 (d) 6:1-13 vegimi që pati Isaia për Zotin
 (e) 7:1-12:6 profecitë e shprehura gjatë mbretërimit të Ahazit

- b. Përvijimi i kapitujve 1-12 nga R. K. Harrison, f. 764:

- (1) Profecitë për shkatërrimin dhe rimëkëmbjen e Judës, kap. 1-5
 (2) Thirrja e Isaisë; materiali biografik, kap. 6-8
 (3) Perandoritë botërore të kohës dhe rolet e tyre, kap. 9-12

- c. Përvijimi i kapitujve 1-12 nga NIV Study Bible, f. 1016

- (1) kapitujt 1-6
 (a) Hyrje: akuzat kundër Judës për shkeljen e Besëlidhjes, kap. 1
 (b) Disiplina e ardhme dhe lavdia e Judës dhe Jerusalemit, kap. 2-4
 (i) Bekimet e ardhshme të Jerusalemit (2:1-5)
 (ii) Disiplinimi i Judës nga Zoti (2:6-4:1)
 (iii) Rimëkëmbja e Sionit (4:2-6)
 (c) Gjykimi dhe çuarja e kombit në robëri (kap. 5)
 (d) Detyra e veçantë e Isaisë (kap. 6)
 (2) Kapitujt 7-12
 (a) Ahazi paralajmërohte që të mos i druhet aleancës aramease dhe izraelite (kap. 7)
 (b) Biri i Isaisë dhe biri i Davidit (8:1-9:7)
 (c) Gjykimi kundër Izraelit (9:8-10:4)
 (d) Perandoria asiriane dhe mbretëria davidike (10:5-12:6)
 (i) Shkatërrimi i Asirisë (10:5-34)
 (ii) Vendosja e mbretit davidik dhe mbretërisë së tij (kap. 11)
 (iii) Këngë gëzimi për shkak të çliirmit (kap. 12)

- d. Përvijimi i kapitujve 1-12 nga H. C. Leupold, f. 38-40:
- (1) Profecitë Judën dhe Jerusalemin (kap. 1-12)
- (a) Hyrje: mesazhi tipik i Isaisë (kap. 1)
- (i) Titull, v. 1
 - (ii) Gjykimi hyjnor, v. 2-4
 - (iii) Gjendja e jashtme e rrënuar e kombit, v. 5-9
 - (iv) Lloji i atëhershëm i adhurimit, i paefektshëm si ilaç, v. 10-15
 - (v) Thirrje për pendim, v. 16-20
 - (vi) Shenja të shprishjeve në Jerusalem, v. 21-33
 - (vii) Izraeli shpengohet nga gjykimi, v. 24-31
- (b) Nga gjykimi të përmbushja e premtimeve të hirshme të Perëndisë, kap. 2-6
- i e ardhmja e lavdishme e Sionit në epokën mesianike, 2:2-5
 - ii e tashmja e turpshme e Sionit, 2:6-4:1
 - a) Përshkrim i vlerave të rreme të kohës, v. 6-9
 - b) Tregim i gjykimit të tmerrshëm në të ardhmen, v. 10-11
 - c) Çfarë do t'u bëjë Dita e Zotit gjithë vlerave të rreme, v. 12-17
 - d) Fati i tmerrshëm i idhujve, v. 18-21
 - e) Dënimi i krerëve të papërgjegjshëm nga Zoti, 2:22-3:15
 - i) Gjendja e anarkisë kur Zoti do t'u heqë çdo mbështetje, 3:1-12
 - ii) Faji i drejtuesve, që sollën gjithë këtë fatkeqësi mbi krye, 3:13-15
 - f) Dënimi që u bën Zoti grave mendjelehta të Jerusalemit, 3:16-4:1
 - g) Sioni pastrohet, 4:2-6
 - h) Gjykimi i popullit fajtor të Perëndisë, kap. 5
 - i) Shëmbëlltira e vreshtit, v. 1-7
 - ii) Rrushi i hidhur që prodhon Izraeli, v. 8-23
 - iii) Gjykimi i ardhshëm që do të vijë me anë të asirianëve, v. 24-30
 - i) Gjykimi i Izraelit në thirtjen e parë të profetit, kap. 6
 - i) vegimi i profetit, v. 1-3
 - ii) reagimi i profetit ndaj vegimit, v. 4-5
 - iii) shpëlarja e tij, v. 6-7
 - iv) autorizimi i tij, v. 8-9a
 - v) mesazhi i tij, v. 9b-13
- (c) Libri i Imanuelit (kapitujt 7-12)
- i. Shenja e Imanuelit, kap. 7
 - a) Ngjarja në Pellgun e Sipërm, v. 1-9
 - b) Ç'ndodhi pas asaj ngjarjeje, Fjala në lidhje me Imanuelin, v. 10-17
 - c) Ngjarjet e mëtejshme, shkatërrimi i profetizuar i vendit, v. 18-25
 - ii. Kohët e vështira (734-732 para K.) dhe si të përballen më to, kap. 8
 - a) Plaçkitja e Damaskut dhe Sirisë, v. 1-4
 - b) Pushtimi i Judës nga Asiria, v. 5-8
 - c) Siguria që mund të ofrojë Imanueli, v. 9-10
 - d) Kujt dhe çfarë gjëje t'i firkësohemi, v. 11-15
 - e) Pritja e duruar me besim, v. 16-18
 - f) Sllogani i duhur për kohën, v. 19-22
 - iii. Fëmija me katër emra, 9:1-7
 - a) Përmbledhje, v. 1
 - b) Lumturia e madhe, v. 2-3
 - c) Çfarë hiqet? V. 4-5
 - d) Autori i lumturisë së madhe, v. 6-7
 - iv. "Dora e tij është ende e shtrirë", 9:8-10:4
 - a) për shkak të krenarisë së pashejntë do të pësojnë disfatë nga armiqtë, v. 8-12
 - b) për shkak të mospendimi të vazhdueshëm, krerët e Judës do të shkatërrohen, v. 13-17
 - c) për shkak të mbizotërimit të ligësisë do të ketë luftë civile, v. 18-21

- d) për shkak të padrejtësive shoqërore, do të ketë një ditë gjykimi, 10:1-4
- v. Mjerë Asiria, 10:5-34
 - a) Asiria kryeneçe e ka keqkuptuar detyrën e veçantë që i dha Perëndia, v. 5-11
 - b) Gjykimi i vonuar do të godasë këtë pushtues krenar, v. 12-14
 - c) Për shkak të arrogancës së vet, Asiria do të digjet si zjarri kur bie në pyll, v. 15-19
 - d) Pas shkatërrimit që vjen nga gjykimi i Perëndisë, pjesa e mbetur e Izraelit do t'i kthehet atij, v. 20-23
 - e) Sioni do të çlirohet kur Asiria të bjerë, v. 24-27
 - f) Përparimi strategjik asirian, që pothuajse pushtoi Sionin, përshkruhet si buletin nga fronti i luftës, v. 28-32
 - g) Jahve do ta presë pyllin kryelartë asirian, v. 33-34
 - h) Mesia, nga pasardhja e Davidit, dhe vepra e tij madhështore e shpëtimit, kap. 11
 - i) Pajimet e Mesisë, v. 1-3a
 - ii) Mënyra si do ta kryejë punën e vet, v. 3b-5
 - iii) Transformimi që do të kryhet edhe në natyrë, v. 6-9
 - iv) Përshkrimi i veprës së tij në lidhje me ato që do të bëjë për Izraelin, v. 10-16
 - i) Lavdërim për ditën madhështore që do të vijë, kap. 12
 - i) Vendosmëria e Izraelit për të ofruar këtë lavdërim, v. 1-2
 - ii) Përshkrim përmbledhës i bekimeve të asaj dite, v. 3
 - iii) Nxitje për ofrimin e këtij lavdërimi, v. 4-6

IX. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Isaia e urdhëron Judën që të jetë besnik ndaj besëlidhjes së Davidit (2 Sam. 7), por kthehet dhe tek qëllimi fillestar i besëlidhjes së Abrahamit (Zan. 12:1-3), ku Perëndia zgjodhi Izraelin për të zgjedhur botën. Sa dallim duhet të ketë bërë ky mbretërim mbarëbotëror i JHVH! Perëndia, jo vetëm që do të rimëkëmbë Izraelin, por edhe do t'ia zgjerojë ndikimin në gjithë botën!
- B. Isaia paratha në mënyrë të veçantë lëvizjet e ngjarjeve botërore të kohës së vet dhe në të ardhmen, që do të çojnë në rikthimin e mbretërimit davidik nëpërmjet Mesisë së Perëndisë (kështu thotë dhe Mikea). Kjo mbretëri është e shenjtë dhe mbarëbotërore (si dhe te Mikea). Të dyja këto janë aspekte të Perëndisë monoteist, të shenjtë dhe shpengues të Isaisë.
- C. Isaia tregon qartë kotësinë e mbështetjes së popullit të Perëndisë në burimet e rëna dhe njerëzore të kësaj bote. Çlirimi do të vijë vetëm nga JHVH!
- D. Isaia zbulon tre tipare tejet të fuqishme të planit shpengues të Perëndisë:
 - 1. Mesia i ardhshëm
 - 2. Mesia si Shërbëtor i Përvuajtur
 - 3. Mbretërimi mbarëbotëror i Mesisë

X. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

- A. Fjalë dhe fraza
 - 1. “dëgjoni, o qiej, dhe dëgjo, o tokë” 1:2 (NASB & NIV)
 - 2. “si kasollja e rojtarit në një fushë me kunguj...”, 1:8 (NIV, “si kasolle në një fushë me shalqinj”)
 - 3. “ç’vlerë kanë flijimet tuaja të shumta për mua?...”, 1:10-15 (NIV, “numri i madh i flijimeve tuaja”)
 - 4. “Ejani, le të arsyetojmë së bashku...”, 1:18 (NASB & NIV)
 - 5. “në ditët e fundit...”, 2:2 (NASB & NIV)
 - 6. “të gjitha kombet do të derdhen aty...”, 2:2-4 (NASB & NIV)

7. “unazë hunde”, 3:21 (NASB & NIV)
8. “një re”, 4:5 (NASB & NIV)
9. “kush do të shkojë për ne?” 6:8 (NASB & NIV)
10. “një e virgjër”, 7:14 (NIV, “virgjëresha”)
11. “në kohën kur të jetë aq i madh sa të dijë të refuzojë të keqen dhe të zgjedhë të mirën”, 7:15, 16 (NASB & NIV)
12. “një gur për të goditur dhe një gur për t’u penguar”, 8:14 (28:16) (NASB & NIV)
13. “mediumët dhe magjistarët që pëshpërisin dhe murmurisin”, 8:19 (NASB & NIV)
14. “Asiria, shkopi i zemërimit tim”, 10:5 (NASB & NIV)
15. “vetëm një pakicë brenda tyre do të kthehet...”, 10:22 (NASB & NIV)
16. “një filiz do të dalë nga rrënja e Jeseut”, 11:1, 10 (NIV, “... nga trungu”)
17. “dhi të egra”, 13:21; 34:14 (NIV, “krijesa të shkretëtirës”)
18. “mali i asamblesë në cepat e veriut”, 14:13 (NIV, “Mali i Asamblesë, në majat më të larta të malit të shenjtë”)
19. “një altar për Zotin në mes të vendit të Egjiptit”, 19:19 (NIV, “... në zemër të Egjiptit”)
20. Ariel, 29:1-2,7 (NASB & NIV)
21. “do t’i shkatërrojë plotësisht”, 34:2 (NIV, “do t’i shkatërrojë krejt”)
22. “gremçi në hundën tuaj”, 37:29 (NASB & NIV)
23. “i ke hedhur gjithë mëkatet e mia pas shpine”, 38:17 (NASB & NIV)
24. “Fjala e Zotit tonë qëndron përjetë”, 40:8 (NASB & NIV)
25. “Ai që rri ulur mbi kubënë e tokës”, 40:22 (NIV, “ai që rri në fron mbi qarkun e tokës”)
26. “Unë, Zoti, jam i pari dhe i fundit. Unë jam ai”, 41:4; 44:6 (NASB & NIV)
27. “Nuk do t’jua kujtoj më mëkatet”, 43:25 (NASB & NIV)
28. “A ka Perëndi tjetër veç meje, a ka Shkëmb tjetër”, 44:8; 45:5 (NIV, “A ka Perëndi tjetër veç meje? Jo, s’ka Shkëmb tjetër; nuk njoh askënd”)
29. “Ai që formon dritën dhe krijon errësirën, që shkakton ekzistencën dhe krijon fatkeqësinë” 45:7 (NIV, “unë formoj dritën dhe krijoj errësirën, sjell begatinë dhe krijoj fatkeqësinë”)
30. “kthehuni tek unë, dhe shpëtohuni, gjithë cepat e tokës...”, 45:22 (NASB & NIV)
31. “para meje çdo gju do të përkulet, dhe çdo gjuhë do të më betohet për besnikëri”, 45:23 (NASB & NIV)
32. “për hirin tim, për hirin tim, do të veproj...”, 48:11 (NASB & NIV)
33. “A mund ta harrojë gruaja fëmijën e vet në gji... edhe sikur këta të harrojnë, unë s’do të të harroj”, 49:15 (NASB & NIV)
34. “kupa e zemërimit të tij”, 51:17 (NIV, “kupa e tërbimit të tij”)
35. “I goditur nga Perëndia dhe i munduar...”, 53:4 (NASB & NIV)
36. “... Zoti u kënaq që ta shtypte, duke i dhënë mundime”, 53:10 (NIV, “mirëpo, vullneti i Zotit ishte që ta shtypte dhe ta bënte të vuante”)
37. “Sepse ju do të keni vetë Zotin si dritë të përjetshme”, 60:19-20 (NASB & NIV)

B. Persona


1. “I Shenjti i Izraelit”, 1:4; 41:8-9; 42:1, 19; 43:10
2. “bija e Sionit”, 1:8
3. “Zoti i ushtrive”, 1:9 (NIV, “Zoti i Plotfuqishëm”)
4. “Dega e Zotit”, 4:2
5. Serafimët 6:2 (NIV, “serafët”)
6. Shear-jashub, 7:3
7. Imanuel, 7:14
8. Maher-shalal-hash-baz, 8:3
9. “I plotfuqishmi” (El Shadai), 13:6
10. “O ylli i mëngjesit, biri i agimit”, 14:12
11. “njëri nga lindje”, 41:2, 25 (44:28; 45:1)
12. “Shërbëtori im”, 41:8, 9; 42:1, 19; 43:10; 52:13
13. Bel... Nebo, 46:1
14. Rojtarët, 52:8

XI. VENDNDODHJET NË HARTË


1. Tarshish, 2:16 (NIV, “anijet tregtare”)
2. Fisi i Efraimit, 7:2
3. Mali i Sionit, 8:18
4. Fisi i Zebulunit, 9:1
5. Galile, 9:1
6. Karkemish, 10:9
7. Sela, 16:1; 42:11
8. Zoan, 19:13
9. Memfis, 19:13
10. Negev 21:1 (NIV, “NEGEV”)
11. Tema 21:14
12. Tir 23:1
13. Sidon 23:2
14. Araba 35:1 (NIV, “shkretëtira”)
15. Mali i Karmelit 35:2
16. Sharon 35:2
17. Ararat 37:38
18. Tubal 66:19
19. Javan 66:19 (NIV, Greqi)

XII. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT


1. Pse po e sjell Perëndia popullin e vet në gjyq? Çfarë kanë bërë? (kap. 1)
2. A është kundër flijimeve Perëndia? (1:10-15)
3. Shpjego pse 5:1-7 është kaq e fuqishme dhe emocionuese?
4. Pse thirrja e Isaisë përmendet jo më parë se kapitulli 6?
5. Pse nuk e përdor Isaia fjalën “virgjëreshë” në 7:14?
6. Rendit vendet në kapitujt 7-12 ku një fëmijë përdoret për të përshkruar epokën e re.
7. Shpjego tre titujt e fiseve veriore, që përdoren në 9:8-9.
8. Pse rënia e Babilonisë përmendet në kapitullin 13, kur Isaia po diskuton për Asirinë në kapitullin 10?
9. Ç’lidhje kanë me Satanin Isa. 14 dhe Ezek. 28?
10. Shpjego kontekstin historik të kapitujve 36-39.
11. A po nënkupton 40:1-2 se populli i Perëndisë është në robëri? Nëse po, ç’lidhje ka kjo me autorësinë?
12. Si mund të lidhet Shërbëtori i 42:1 me Jezusin, por jo v. 19?
13. Si lidhet 52:13-53:12 me Jezusin? Po me Izraelin?
14. Cili është konteksti gjeografik i kapitujve 56-66?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



HYRJE PËR JEREMIAN

I. EMRI I LIBRIT

A. U quajt sipas profetit Jeremia.

B. Emri i tij do të thotë:

1. “JHVH flak [diçka]”
2. “JHVH themelon”

II. KANONIZIMI

A. Ishte pjesë e Profetëve në kanonin hebre.

B. Në literaturën rabinike, shpesh, konsiderohej si i pari i profetëve (shih Mat. 27:9).

III. GJINIA LETRARE

A. Ky libër përbëhet nga disa gjini letrare:

1. Poezia klasike hebraike (orakujt e Jeremias)
2. Proza hebraike (shkruar nga Baruku në vetën e tretë)
3. Përmbledhje të predikimeve të Jeremias, shpesh, në prozë (sërish, nga Baruku)
4. Ankesa autobiografike që i bëhen Perëndisë në formë poetike (rrëfimi i Jeremias)

B. Qartazi, Jeremia përfshin profeci gojore dhe me shkrim. Po kështu, nga kapitulli 36 mësojmë se u desh që disa profeci të ridiktoheshin/rikopjoheshin.

IV. AUTORËSIA

A. Qartazi, kapitullin 52 nuk e shkroi Jeremia, pasi vargjet 31-34 tregojnë për ngjarje që ndodhën në Babiloni. Jeremian e çuan forcërisht në Egjipt disa njësite ushtarake me kryengritës judenj pas vdekjes së Gedaliahut, guvernatorit babilonas.

B. Autorë/redaktorë të mundshëm:

1. Jeremia
2. Baruku – skribi i tij
3. Një redaktor i mëvonshëm (Ezra, ose burrat e Sinagogës së Madhe)

C. Mësojmë më shumë për Jeremian se për çdo profet tjetër:

1. Ishte nga pasardhja (e mërguar) priftërore e Abiatarit, 1 Mbre. 2:26-27.
2. U rrit pranë Jerusalemit në Anatot.
3. U thirr nga Perëndia kur ishte djalë i ri, 1:2; 25:3 (627 para K.)
4. U ndikua nga veprat e Oseas dhe Ligjit të Përtërirë.
5. Bashkëkohës i:
 - a. Danielit
 - b. Ezekielit
 - c. Habakukut
 - d. Sofonisë
 - e. Nahumit
6. Pesë vjet pas thirrjes së tij, në tempull u gjet “Libri i Ligjit” gjatë reformës së Josias. Është e habitshme që marrëdhënia e tyre nuk përmendet kurrë në Shkrim. Kur u gjet Libri i Ligjit, mbreti u konsultua me një profeteshë të quajtur Hulda (2 Mbre. 22:14-20), jo me Jeremian.
7. Ndjenjat e tij mund të shihen qartë në rrëfimet ose ankesat që bën:
 - a. 11:18-12:6

- b. 15:10-21
 - c. 17:14-18
 - d. 18:18-23
 - e. 20:7-18
8. U çua forcërisht në Egjipt, ku e vranë refugjatët judenj, 43:6.

V. DATA

- A. Jeremia lindi në Anatot rreth 640 para K.
- B. Libri i Jeremias datohet më 1:2 dhe mbulon kohën nga viti i trembëdhjetë i Josias deri në kohën e Gedaliahut, 627 para K. – 587 para K. Sa gjatë jetoi Jeremia në Egjipt me refugjatët e tjerë është e paqartë.
- C. Copat e qeramikës, të gjetura në Lakish, përshkruajnë rrethimin e qyteti më 587 para K. Forma e tekstit hebraik në këto qeramike është e ngjashme me atë të Jeremias.
- D. Mesazhet e Jeremias përqendrohen në ngjarjet që ndodhën që nga rënia e Samarisë (722 para K.) deri në rënien e Jerusalemit (586 para K.).

VI. KONTEKSTI HISTORIK

- A. 686 para K. – Manasi (686-641 para K.) bëhet mbret i Judës. Ishte mbreti më i lig i Judës.
- B. 664 para K. – perandoria egjiptiane fuqizohet nën Psametikon (664-610 para K.).
- C. 648 para K. – lindja e Josias.
- D. 642 para K. – Amoni, mbreti i Judës, vritet nga shërbëtorët e vet (2 Mbre. 21:19-26).
- E. 640 para K. – vdes sundimtari i fundit i aftë asirian, Ashurbanipali.
- F. 640 para K. – Josia bëhet mbret në moshën 8 vjeçare (2 Mbre. 22:1).
- G. 628 para K. – Josia nis reformën (2 Kro. 34:3 e më tej; 2 Mbre. 23).
- H. 626 para K. – thirrja e Jeremias (Jer. 1:2).
- I. 626 para K. – Nabopolasari (626-605 para K.) bëhet mbret i neo-Babilonisë.
- J. 621 para K. – punëtorët që po ripararin tempullin gjejnë librin e Ligjit (2 Kro. 34:8 e më tej; 2 Mbre. 22)
- K. 614 para K. – kryeqyteti rajonal i Asirisë, Ashuri, bie në dorë të neo-babilonasve.
- L. 612 para K. – Niniva, kryeqyteti i Asirisë shkatërrohet nga neo-babilonasit dhe medët.
- M. 609 para K. – Josia vritet në Megido, ku doli të përballej me faraonin Neko II (610-594 para K.), i cili po përpiqej të ndihmonte pjesën e mbetur të ushtrisë asiriane, që kishte marrë arratinë (2 Kro. 35:20-24; 2 Mbre. 23:28-30).
 - Jehoahazi II (609 para K.), biri i Josias, u bë mbret në vend të të atit, por vetëm për tre muaj. Faraoni Neko e deportoi në Egjipt.
 - Jehoiakimi (609-598 para K.) u vu në fron nga faraoni Neko. Qëndroi në fronin e Judës edhe kur erdhi Nebukadnecari II më 605 para K. Më vonë, bëri kryengritje duke formuar një aleancë me Egjiptin. Biri i tij, Jehoiakini, u vu mbret pas tij vetëm për tre muaj; pastaj, Nebukadnecari e zëvendësoi me Sedekinë më 597 para K.
- N. 605 para K. – Neo-Babilonia mposht egjiptasit dhe pjesën e mbetur të ushtrisë asiriane në Karkemish.
- O. 605 para K. – Nebukadnecari II kalon nëpër Palestinë dhe kërkon haraç (merr me vete dhe Danielin, si pjesë e grupit të të deportuarve të parë). Pati katër pushtime që prekën Judën dhe Jerusalemin: 605, 597, 586 dhe 582 para K.
- P. 601 para K. – Nebukadnecari II humb betejën për pushtimin e Egjiptit (situatë bllokimi).

VII. NJËSITË LETRARE

- A. Struktura e librit është tematike, jo kronologjike. Ndoshta, është përmbledhje e mesazheve/rrotullave të ndryshme të Jeremias, 1-25, 30-33 dhe 46-51.

- B. LXX dhe MT ndryshojnë së tepërmi. Pothuajse 3000 fjalë të MT mungojnë në LXX. Po kështu, rendi i kombeve në kapitujt 46-51 është i ndryshëm; edhe vendosja e tyre në libër, pas kapitullit 25, është e ndryshme. Të dyja këto tradita tekstuale gjenden në Pergamenat e Detit të Vdekur.
- C. Përvijim i mundshëm (në thelb, ndjekim Harrisonin dhe Young):
1. Kapitulli 1 – thirrja dhe pajisja e Jeremias.
 2. Kapitujt 2-25 – mëkati i Judës që nga vitet e hershme të shërbesës së Jeremias.
 3. Kapitujt 26-29; 34-35 – jeta personal e profetit.
 - a. Mesazhi i JHVH për reagimin e Sedekias dhe Hananias, 26-29.
 - b. Rehabitet, 34-35
 - c. Ngjarjet historike që nga mbretërimi i Jehoiakimit, Sedekias, deri te Gedalia dhe Egjipti, 36-45
 4. Kapitujt 30-33 – premtimi i rimëkëmbjes së popullit të Perëndisë:
 - a. Fizikisht
 - b. Shpirtërisht
 5. Kapitujt 46-51 – profecitë kundër kombeve përreth (si dhe 25:12-38):
 - a. Egjipti – 46 (Isa. 19; Ezek. 29-32)
 - b. Filistia – 47 (Amos 1:6-8; Isa. 14:29-32; Ezek. 25:15-17)
 - c. Moabi – 48 (Amos 2:1-3; Isa. 15-16; Ezek. 25:8-11)
 - d. Amoni – 49:1-6 (Amos 1:13-15; Ezek. 25:1-7)
 - e. Edomi – 49:7-22 (Amos 1:11-12; Isa. 21:11-12; Ezek. 25:12-14; Abdia)
 - f. Siria – 49:23-27 (Amos 1:3-5; Isa. 17:1-3)
 - g. Arabia – 49:28-33
 - h. Elami – 49:34-38
 - i. Babilonia – 50-51 (Isa. 13:1-14; Hab. 2:6-17)
 6. Kapitulli 52 – Rënia e Jerusalemit (shih 2 Mbre. 24:18-25:30)
- D. Është interesante të vërejmë se, në kapitujt 1-25, mesazhet e Jeremias prezantohen me frazën “fjala e JHVH erdhi tek unë”, ndërsa në kapitujt 26-51, prezantohen me “fjala e JHVH erdhi tek Jeremia”.
- E. Grafiku i Profecive të Jeremias sipas mbretit të kohës:

E. J. Young:

R. K. Harrison:

1. nën Josian (640 para K. -)
1:1-19; 2:1-3:5; 3:6; 6:30; 7:1-10:25; 11:1-13:27; 14:1-15:21; 16:1-17:27; 18:1-20:18

2. nën Jehoahazin (609 para K.)

3. nën Jehoiakimin (609 para K.)
25; 26; 27; 35; 36; 45; 46-49

11:1-13:14; 14:1-15:21; 16:1-17:27;
22; 23; 25; 26; 35; 36; 45; 46-48

4. nën Jehoiakinin (598-596 para K.)

31:15-27

5. Sedekia (597 para K.)
21:1-22:30; 23; 24; 27; 28; 29; 30-31; 32; 34;
37; 38; 39

21:1-22:30; 24:1-10; 27; 28; 29; 30-31;
32; 33; 34; 37; 38; 39; 49; 50:1-51:64

6. nën Gedaliahun
40; 41; 42; 43-44:30; 50-52

40:1-42:22; 43:1-44:30

7.

Shtojcë historike

VIII. TEMAT KRYESORE

- A. Koha e gjykimit është tani, pasi Juda nuk pranon të pendohet! Jeremia thekson mëkatin, gjykimin dhe, pastaj, rimëkëmbjen; 1:4-10.
- B. Feja liturgjike ose ritualiste, pa besimin personal si mënyrë jetese, është shkatërrimtare! (kap. 7; Isa. 29:13).
- C. Juda e kishte humbur në mënyrë të dëshperueshme rrugën e vet për shkak të ritualeve, idhujtarisë dhe mëkatis! E kishte shkëlur besëlidhjen me Perëndinë, që simbolizohet si kontratë martesë (shih 2:1-3:5).
- D. Pendimi dhe besimi personal janë baza e besëlidhjes së re të Perëndisë (31:31-34), jo besimi familjar (31:29; Ezek. 18).
- E. Besëlidhja e Re është e përhershme (31:35-37) pasi nuk kushtëzohet nga veprat e njeriut, por nga hiri dhe fuqia e Perëndisë (Ezek. 36:26-27).

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT (NASB)

A. Fjalë dhe/ose fraza:

1. profet, 1:5 (NASB & NIV)
2. pemë bajame, 1:11 (NASB & NIV)
3. veriu, 1:13 (NASB & NIV)
4. ngjishni ijët, 1:17 (NIV, “përgatituni!”)
5. certifikata e divorcit, 3:8 (NIV, “vërtetimi i divorcit”)
6. “kreu kurorëshkelje me gurë dhe drurë”, 3:9 (NASB & NIV)
7. “prepuçet e zemrës”, 4:4 (NIV, “rrethprisni zemrën”)
8. “balsami i Gileadit”, 8:22 (NASB & NIV)
9. “qethin flokët mbi tëmthat”, (:26 (NIV, “në vende të largëta”)
10. “si Zoti jeton”, 12:16 (NASB & NIV)
11. “shkatërruesi në mesditë”, 15:8 (NIV, “në mesditë, do të sjell një shkatërrues”)
12. “e gjithë ushtria qiellore”, 19:13 (NIV, “gjithë ushtritë yjore”)
13. shkatërroj plotësisht, 25:9 (NIV, “shkatërroj tërësisht”)
14. “enët e shtëpisë së Zotit”, 27:16 (NIV, “sendet...”)
15. “koha e mundimit të Jakobit”, 30:7 (NIV, “një kohë mundimi për Jakobin”)
16. besëlidhja e re, 31:31 (NASB & NIV)
17. “e prenë viçin më dysh dhe kaluan mes copave”, 34:18 (NIV, “viçin e prenë më dysh dhe, pastaj, kaluan përmes copave të tij”)

B. Persona


- | | |
|--|--------------------------------------|
| 1. Josia, 1:2,3 | 10. Ebed-Melek, 38:7 |
| 2. Jehoiakimi, 1:3 | 11. Gedalia, 39:14 & 40-41 |
| 3. Baal, 2:8 | 12. Faraoni Neko, 46:2 (NIV, “Neko”) |
| 4. Manasi, 15:4 | 13. Kemosh, 48:7, 13, 46 |
| 5. Nebukadnecari, 21:2, 7 | 14. Ben-Hadad, 49:27 |
| 6. Hanania, 28:1 | 15. Bel, 50:2; 51:44 |
| 7. Baruku, 32:12, 13, 16 | 16. Marduk, 50:2 |
| 8. Moleku, 32:35 | |
| 9. Rekabitët, 35:1 (NIV, “familja rekabite”) | |

X. VENDNDODHJET NË HARTË


1. Anatot, 1:1
2. Kitim
3. Memfis
4. Shilo, 7:12
5. Lugina e bijve të Hinomit, 7:31
6. Sodomi dhe Gomora, 23:14
7. Tiri, 25:22
8. Lakish, 34:7
9. Micpa, 40:6
10. Gibeon, 41:12
11. Betlehem, 41:17
12. Karkemish, 46:2
13. Betel, 48:13
14. Hacor, 49:28
15. Elam,49:3

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Pse është kaq e vështirë të përvijosh Jeremian?
2. Për sa kohë predikoi Jeremia?
3. Shpjego dy vegimet e 1:11-16.
4. Pse paraqitet kapitulli si rast ligjor? (shih 4-8, 9, 29)
5. Pse paraqitet si rast divorci ky kapitull?
6. Rendit katër kushtet që kërkon Perëndia për shfaqjen e pendesës në 4:1-2.
7. Ç'lidhje kanë kapitujt 7 dhe 26 me njëri-tjetrin?
8. A e dënoi Jeremia sistemin e fljimeve në kapitullin 7?
9. Pse po përpiqeshin burrat e vendlindjes së Jeremias që ta vrisnin? (kapitujt 11-12)
10. Pse janë kaq të rëndësishëm pasazhet e 12:14-17 dhe 16:19-21?
11. Shpjego ç'lidhje kanë me njëri-tjetrin mëkatet kolektive dhe ato individuale në 16:10-13.
12. Ç'lidhje ka 17:10 me Gal. 6:7?
13. Përshkruaj mënyrat e ndryshme sesi Jeremia e përdor metaforën e poçarit në kapitujt 18 dhe 19.



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR VAJTIMET

I. EMRI I LIBRIT

- A. Në hebraisht (MT), titulli është fjala e parë e librit, pra, “Ah, si” [‘*ekhah*] (shih 1:1; 2:1; 4:1). Kjo është fjalë e zakonshme në funerale.
- B. Në Septuagintë (LXX), u titullua “vajtimet”, nga rrënja e fjalës greke “qaj me zë të lartë”.
- C. Talmudi e quajti, “vajtimet”.
- D. Vullgata e titullon: “përbën vajtimet e profetit Jeremia”.

II. KANONIZIMI

- A. Gjetet në listën e specializuar të librave, në pjesën e Shkrimeve të kanonit hebraik që quhet *Megilot* (pesë pergamenat). Secili prej tyre lexohej në një ditë të përvitshme festash:
 - 1. Kënga e Këngëve – Pashka
 - 2. Ruthi – Rrëshajët
 - 3. Predikuesi – Kasollet, ose Çadrat
 - 4. Esteri – Purim
 - 5. Vajtimet – rënia e Jerusalemit dhe shkatërimi i tempullit të Solomonit
- B. Pjesa e “Shkrimeve” në kanonin hebraik e vendos Këngën e Këngëve pas Psalmeve, Fjalëve të Urta dhe Jobit, por përpara Ruthit, Vajtimeve, Predikuesit dhe Esterit. Bibla anglisht ndjek rendin e LXX.
- C. Vajtimet lexohet në datën 9 Ab (mes-korriku) në përkujtim të shkatërrimit të tempullit të Solomonit nga ushtria e Nebukadnecarit II më 586 para K. Në judaizmin e mëvonshëm, përkujtonte dhe rënien e Jerusalemit nga gjenerali romak Titi, më 70 pas K.

III. GJINIA LETRARE

- A. Secili nga pesë kapitujt përbën një këngë të veçantë vaji/funerali. Këto lloj poezish ishin të përhapura në Lindjen e Afërt të lashtë, që nga koha e Sumerit. Për Izraelin, ato shprehin dhimbje për kushtet e momentit, por edhe shpresë për të ardhmen.
- B. Katër poezitë e para janë akrostikë. Secili rresht fillon me shkronjën e radhës së alfabetit hebraisht. Kjo mund të ketë qenë mënyrë simbolike për të shprehur hidhërimin e plotë.
- C. Poezia hebraike bazohet në paralelizmin e mendimit, jo në rimë.
 - 1. Çelësi letrar është rreshti, jo fjalët.
 - 2. Paralelizmi, zakonisht, përbëhet nga dy ose tre rreshta.
 - A. paralelizmi sinonimik – rreshtat shprehin të njëjtin mendim me fjalë të ndryshme
 - 1. Psa. 3:1; 8:40; 83:14; 103:3
 - 2. Fja. 20:1
 - 3. Vaj. 1:2, 3
 - 4. Isa. 1:3
 - 5. Amos 5:24
 - B. paralelizmi antitetik – rreshtat shprehin mendime të kundërta me anë të përdorimit të kontrastit, ose duke shprehur anën pozitive dhe atë negative të një gjëje të caktuar.
 - 1. Psa. 1:6; 90:6
 - 2. Fja. 1:29; 10:1, 12; 15:1; 19:4
 - C. paralelizmi sintetik – rreshtat zhvillojnë mendimin
 - 1. Psa. 1:1-2; 19:7-9

2. Vaj. 1:4

IV. AUTORËSIA

- A. Vetë libri nuk na e jep autorin. Është e qartë se u shkrua nga një dëshmitar okular i rrethimit dhe rënies së Jerusalemit më 586 para K.
- B. Baba Bathra 15a dhe Targumët e Jer. 1:1 thonë se autor i librit ishte Jeremia.
- C. Septuaginta e nis librin me fjalët: “dhe ndodhi që, pasi Izraeli shkoi në robëri dhe Jerusalemi u shkatërrua, Jeremia u ul duke vajtuar dhe kompozoi këtë vajtim për Jerusalemin dhe tha...” Septuaginta e vendos këtë libër pas Jeremias.
- D. Vullgata e nis librin me fjalët: “përbën vjatin e profetit Jeremia”.
- E. Peshita (një përkthim siriak i shekullit 5 pas K.) e titullon: “Libri i Vajtimeve të Profetit Jeremia).
- F. Prova për autorësinë:
 - 1. e shkroi Jeremia:
 - A. Jeremia mendohet se është autori për shkak të 2 Kro. 35:25. Por vini re se këtu bëhet fjalë për një vajtim për Josian, jo Jerusalemin.
 - B. Shumë pasazhe të Jeremia flasin për vajtimin e tij për situatën e kohës, 7:29; 8:21; 9:1, 10, 20 (shih Vaj. 3:48-51).
 - C. Kanë ngjashmëri fjalori.
 - D. “Unë” i 3:1 mund të bëjë fjalë për Jeremian.
 - E. Qartazi, autori ishte dëshmitar okular i rënies së Jerusalemit.
 - 2. nuk e shkroi Jeremia:
 - a. Jeremia thotë se Perëndia e dërgoi Babiloninë për gjykim, por 3:59-66 duket se ndryshon.
 - b. Jeremia nuk do të kishte thënë se mesazhet profetike kanë shterur, 2:9c.
 - c. Jereami nuk do të kishte përkrahur ndihmën e Egjiptit, 4:17.
 - d. Jeremia nuk do të shpresonte te Sedekia, 4:20.
 - e. Këto poezi akrostike janë tejet të strukturuar, gjë që ndryshon së tepërmi nga stili spontan i Jeremisë.
 - f. Stili i strukturuar i secilës prej 5 poezive është i ndryshëm. Disa kanë rreshta të gjatë, disa, të shkurtër. Numri i rreshtave që nis me të njëjtën shkronjë ndryshon. Metaforat ndryshojnë nga njëra poezi te tjetra. E gjithë kjo tregon se u shkruan nga më tepër se një autor.

V. DATA DHE KONTEKSTI HISTORIK (dhe pjesa VI.)

- A. Situata historike është rënia e Jerusalemit në dorë të ushtrisë Babilonasë më 586 para K.
- B. Për kontekstin historik, lexo 2 Mbre. 25:8-12 dhe Jer. 52.
- C. Disa mendojnë se libri bën fjalë për ata judenj që mbetën në Jude dhe kujtonin përvit rënien e Jerusalemit, Jer. 41:4-5.

VII. NJËSITË LETRARE

- A. Jerusalemi personifikohet, nga gruaja të skllavi, kapitulli 1
- B. Privilegji mbart përgjegjësi, zemërimi i besëlidhjes së JHVH, kapitulli 2.
- C. Trishtimi individualizohet, kapitulli 3.

D. Privilegji mbart përgjegjësi, populli i besëlidhjes mëkaton, kapitulli 4

E. Besimi dhe shpresa në Perëndinë e Besëlidhjes, kapitulli 5.

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

A. Këto poezi shprehin hidhërimin dhe ndjenjën e pështjellimit që ndiente populli i Perëndisë nga:

1. humbja e Jerusalemit,
2. shkatërrimi i tempullit,
3. anulimi që i bëri JHVH besëlidhjes së Moisiut. Këto gjëra u ndien shumë rëndë për shkak të premtimeve të Perëndisë në:
(a) 2 Sam. 7:10-16
(b) Isa. 37:30-35

B. Këto poezi theksojnë:

1. Sovranitetin e Perëndisë,
2. Drejtësinë e Perëndisë,
3. Gjykimin e Perëndisë,
4. Premtimet e Perëndisë për ripërtëritje.

C. Juda shkatërron për shkak se theu besëlidhjen e Moisiut (LiP. 27-28). Disfata e Babilonisë nuk ishte për shkak të dobësisë së JHVH, por për shkak të mëkatit të popullit të tij. JHVH do të sjellë fitore me forcën e tij në të ardhmen (3:22-23, 25).

D. Premtimet e Perëndisë janë edhe të kushtëzuara, edhe të pakushtëzuara. Koncepti i besëlidhjes kërkon përgjigjen e duhur ndaj Perëndisë.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjala dhe/ose fraza

1. “të gjithë të dashurit e saj” 1:2, 19 (NASB & NIV)
2. “bija e virgjër e Judës” 1:15 (NASB & NIV)
3. “stoli i këmbëve të tij” 2:1 (NASB & NIV)
4. “Zoti është bërë armik” 2:5 (NIV, “Zoti është si armik”)
5. “duartrokisni... puthni... tundni kokat” 2:15 (NIV, “duartrokisni... talluni... tundni”)
6. “ngrini duart drejt tij”, 2:19; 3:41 (NASB & NIV)
7. “a duhet gratë të hanë fëmijët e tyre” 2:20; 4:10 (NASB & NIV)

B. Persona


1. “unë jam njeriu” 3:1

X. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Shpjego strukturën letrare të Vajtimev.
2. Si na ndihmon ky libër i Biblës për t’u përballur me vuajtjen dhe pështjellimin?
3. Kujt ia atribuon librin shkakun e dëbimit? (1:5, 18)
4. Si lidhet vargu 2:17 me LiP. 27-28?
5. Pse është kaq i rëndësishëm 3:19-38?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR EZEKIELIN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Emërtohet sipas zëdhënësit kryesor të tij: profeti Ezekieli.
- B. Emri i tij do të thotë “Perëndia forcon”, ose “Perëndia forcoftë”.

II. KANONIZIMI

- A. Ky libër ka hasur në njëfarë vështirësie për t’u pranuar në kanonin hebre:
 - 1. Tempulli dhe procedurat e Ezekielit ndryshojnë nga ato të Moisiut.
 - 2. Terminologjia e gjallë e vegimeve, sidomos në kapitujt 1, 8 & 10.
- B. Rabini Hanania ben Hezekia i shkollës rabinike të Shamait thuhet se përdori 300 qypa me vaj për të pajtuar Ezekielin me Moisiun (shih Shabb. 14b; Menahut 45a; Hagiga 13a).
- C. Tradita judaike thotë se, kur Elija të kthehet para Mesisë, do të zgjidhë problemet mes Ezekielit dhe Moisiut.

III. GJINIA LETRARE

- A. Ky libër përmban shumë gjini letrare:
 - 1. profeci (kap. 37)
 - 2. apokaliptika (kap. 1, 8-10, 38-39, 40-48)
 - 3. poezi
 - 4. prozë
 - 5. shëmbëlltyra dramatike (kap. 4-7, 12)
 - 6. tipologji (kap. 16)
- B. Si të interpretohen kapitujt 40-48
 - 1. Shënime hyrëse
 - a. Konteksti letrar i kapitujve 40-48 është premtimi i rimëkëmbjes, që përmendet në kapitujt 33-39.
 - b. Kjo pjesë përbën një model të hollësishtëm arkitekturor të tempullit eskatologjik, ashtu si Eks. 25-27 është model i tabernakullit.
 - c. Përvijim i shkurtër:
 - 1. Kapitujt 40-43 – rikthehet tempulli
 - 2. Kapitujt 44-46 – rikthehen ritualet
 - 3. Kapitujt 47-48 – rishpërndahet vendi
 - d. Kjo profeci përdor besëlidhjen e lashtë të Perëndisë me Abrahamin dhe farën e tij për të përshkruar rimëkëmbjen e popullit të Perëndisë në fund të epokës.
 - e. Historikisht, këta kapituj duhet të kenë të bëjnë me kthimin nga robëria (43:2). Mirëpo ky libër është qartazi eskatologjik në disa mënyra, pasi nuk përputhet me periudhën pas kthimit nga robëria.
 - 2. Disa interpretime të mundshme:
 - a. Nuk u synua kurrë që të përmbushej në mënyrë të fjalëpërfjalshme;
 - b. Është profeci e kushtëzuar, të cilët judenjtë nuk iu përgjigjën në mënyrën e duhur;
 - c. U përmbush pjesërisht me kthimin nga robëria nën udhëheqjen e Zerubabelit dhe Jozueut;
 - d. U përmbush në tempullin e Herodit;
 - e. Gjithmonë, synimi ishte të merrej në mënyrë simbolike (shih, *Prophecy Interpreted*, nga John Milton);
 - f. Do të përmbushet në tempullin eskatologjik.
 - 3. Probleme për interpretimin e këtyre kapitujve:

- a. Nuk kemi asnjë kontekst të veçantë historik për kapitujt 38-39 dhe 40-48. Për shkak se s'kemi kontekst historik, qoftë brenda kapitujve, qoftë në histori, shumica e interpretuesve e marrin si eskatologjik;
 - b. Dhiata e Re:
 - (1) duket se përjashton një sistem flijimi në fund të epokës në Heb 9 dhe 10;
 - (2) duket se i përfshin johebrenjtë, ndërsa Ezek. 40-48 është shumë nacionalist.
 - c. Jezusi duket se i anashkaloi judenjtë si instrument të shpengimit hyjnor në shëmbëlltyrën e vreshtarëve të këqinj (shih Mat.21:33-46; Mk. 12:1-12; Luka 20:9-19);
 - d. Ndonëse besoj se Perëndia do ta përdorë Izraelin kombëtar në fund të epokës (shih Rom. 9-11), mendoj se Izraeli shpirtëror është kisha (shih Rom. 2:28-29; Gal. 3:1 e më tej; 6:16; Efe. 2-3).
- C. Ezekieli e kompozoi shumicën e mesazheve me shkrim. Ato nuk u dhanë gojarisht si në rastin e Isaisë dhe Jeremisë. Janë tejet të strukturuar.

IV. AUTORËSIA

- A. Autorësia e librit nuk ka qenë kurrë në dyshim. Gjithë libri, me përjashtim të 1:2-3, është shkruar në vetën e parë njëjës (autobiografi).
- B. Tradita judaike, Baba Bathra 15a, thotë: “burrat e Sinagogës së Madhe shkruan Ezekielin dhe të Dymbëdhjetët”. Siç kemi parë, fjala “shkruan” do të thotë “redaktuan, ose përpiluan”.
- C. *Lashtësitë e judenjve* 10:5-1, e shkruar nga Jozefusi, thotë se Ezekieli shkroi dy libra. Ndoshta, kjo bën fjalë për strukturën karakteristike të shumë profetëve të Biblës hebraisht, pasi librat e tyre mund të ndahen lehtësisht në dy gjysma. Në pjesën e parë, konteksti historik është koha e tij. Në pjesën e dytë të librit, konteksti është e ardhmja (shih Isa. 1-39 & 40-66; Dan. 1-6 & 7-12; Zak. 1-8 & 9-14 dhe Ezek. 1-32 & 33-48). Kjo mund të jetë arsyeja pse Jeronimi shprehu dyshime për unitetin e Ezekielit. Po kështu, është arsyeja pse Jozefusi mendonte se Ezekieli shkroi dy libra.
- D. Gjithçka që dimë për Ezekielin vjen nga ky libër. Ai nuk përmendet askund tjetër në DHV:
 - 1. ishte prift i pasardhjes së Cadokut, 1:3,
 - 2. ishte i martuar, por s'kishte fëmijë, 24:16-18,
 - 3. u mor rob kur ishte 25 vjeç, më 597 para K, nga Nebukadnecari II, së bashku me mbretin Jehoiakin, 1:1; 1 Mbre. 24:14-16.
 - 4. U çua në robëri në një koloni judenjsh jo larg nga Babilonia, përbri një kanali ujitës të krijuar nga njerëzit, Kebar, 1:1, 3, që quhej Tel-Abib, 3:15,
 - 5. Predikoi për të paktën 25 vjet, 1:1-2; 29:17,
 - 6. Ishte profet i fortë, por edhe i dhembshur, 9:8; 11:13.

V. DATA

- A. Lindi rreth 623 para K. në Jerusalem.
- B. Ezekeli është një nga profetët e shekullit të shtatë: Jeremia, Danieli, Nahumi, Habakuku dhe Sofonia.
- C. Gjatë periudhës së ngritjes së fuqisë neo-babilonasë nën Nabopolasarin dhe princin e kurorës Nebukadnecarin II, Perëndia foli përmes këtyre profetëve në vende të ndryshme:
 - 1. Danieli u mor rob nga Nebukadnecari më 605 para K. U çua në pallatin mbretëror të Babilonisë, Dan. 1:1.
 - 2. Ezekieli u mor rob nga Nebukadnecari më 597 para K., së bashku me 10,000 zejtarë dhe me mbretin Jehoiakin, 2 Mbre. 24:14-16.
 - 3. Jeremia qëndroi në Jerusalem derisa vdiq Gedaliahu.

D. Ezekieli i daton profecitë e tij. Këto data tregojnë se libri nuk është përpiluar në radhë kronologjike:

		Dita	Muaji	Viti i robërimit të Jehoiakinit
1.	një vegim, 1:1	5	4	13
2.	një vegim, 1:2	5	4	5
3.	një vegim, 8:1	5	6	6
4.	pyetjet e pleqve, 20:1	10	5	7
5.	Fillon rrethimi i Jerusalemit, 24:1	10	10	9
6.	Orakulli kundër Tirit, 26:1	1	?	11
7.	Orakulli kundër Egjiptit, 29:1	12	10	10
8.	Orakulli kundër Egjiptit, 29:17	1	1	27
9.	Orakulli kundër Egjiptit, 30:20	7	1	11
10.	Orakulli kundër Egjiptit, 31:1	1	3	11
11.	Orakulli kundër Egjiptit, 32:1	1	12	12
12.	Orakulli kundër Egjiptit, 32:17	15	(12)	12
13.	Rënia e Jerusalemit, 33:21	5	10	12
14.	një vegim për Jerusalemin e ri, 40:1	10	1	25

E. Kështu, shërbesa e Ezekelit nisi rreth vitit 592 para K. dhe vazhdoi deri më 570 para K., ndoshta dhe më vonë.

VI. KONTEKSTI HISTORIK

VII. NJËSITË LETRARE

A. Profecitë e Ezekielit mund të ndahen në dy mesazhe rrënjësisht të ndryshme:

1. përpara rënies së Jerusalemit më 586 para K., predikimet e tij karakterizohen nga thirrja për pendim për shkak të gjykimit të ardhshëm të Perëndisë. (1-32)
2. pas rënies së Jerusalemit, predikimet e tij përqendrohen te shpresa, rimëkëmbja dhe falja. (33-48)

B. Përvijim i shkurtër

1. Thirrja e tij për shërbesë, 1-3.
2. Gjendja e mëkatshme e popullit të besëlidhjes dhe rënia e Jerusalemit, 4-24.
3. Gjykimi i Perëndisë për kombet përreth, 25-32
4. Premtimi i Perëndisë për rimëkëmbjen e popullit të vet, qytetit dhe tempullit, 33-37.
5. Pushtimi apokaliptik nga veriu, 38-39.
6. Një vegim i tempullit të rindërtuar, 40-48.

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

A. Judenjtë po vuanin për shkak të mëkatit të tyre, jo për shkak të dobësisë së JHVH.

- B. Besimi i besëlidhjes përmban një aspekt kolektiv dhe një aspekt individual. Besëlidhja e Re. E përmendur në Jer. 31:31-34, në thelb është individuale; kjo vlen dhe për kapitujt 18 dhe 33. Ajo garantohej dhe nga veprimi i Perëndisë (shih kapitujt 36-37). Ky është i njëjti drejtpeshim i sovranitetit të Perëndisë me përgjegjësitë e individit ndaj besëlidhjes, që gjenden në Dhiatën e Re.
- C. Perëndia është besnik ndaj farës së Abrahamit dhe Davidit. Besëlidhja do të ripërtërihet, kapitujt 37, 40-48. Robëria ishte akt dashurie!
- D. Problemet e judenjve nuk përfundojnë, kapitujt 38-39 (shih Dan. 7-12). Ekziston një betejë e vazhdueshme mes popullit të Perëndisë dhe njerëzimit të rënë e të tunduar (Psa. 2).

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe/ose fraza

1. Shekel, 4:10
2. Guri i Tarshishit, 10:9 (NIV, “krizolit”)
3. “gërmo një vrimë në mur në sytë e tyre dhe kalo mes tij”, 12:5
4. Shirita magjie, 13:18 (NIV, “hajmali magjie”)
5. “bëni për vete një zemër të re dhe një frymë të re”, 18:31 (NIV, “merrni një zemër të re dhe një shpirt të ri”)
6. “kaloj përmes zjarrit”, 20:26 dhe 31
7. *Bamah*, 20:29
8. “kaloj nën shkopin”, 20:37
9. Idhujt e shtëpisë, 21:21 (NIV, “idhujt”)
10. “ata do të të heqin hundën dhe veshët”, 23:25
11. “ishe në Eden, në kopshtin e Perëndisë”, 28:13
12. Gjerësia e një dore,
13. E vazhdueshme, 46:15 (NIV, “mëngjes për mëngjes, si ofertë e vazhdueshme”)

B. Persona

1. “Katër qenie të gjalla” 1:5 (NIV, “katër krijesa të gjalla”)
2. Biri i njeriut, 2:1
3. Tamuzi, 8:14
4. Kerubinët, 10:6
5. Danieli, 14:14, 20
6. Ohola dhe Oholiba, 23:4
7. Bijtë Cadokut, 40:46

X. VENDNDODHJET NË HARTË

1. Lumi Kebar, 1:1 (NIV, “Lumi i Kebarit”)
2. Vendi i kaleasve, 1:3 (NIV, “vendi i babilonasve”)
3. Tiri, 26:2
4. Javan, 27:13 (NIV, “Greqi”)
5. Tubal, 27:13
6. Meshek, 27:13
7. Coan, 30:14


XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Çfarë pa Ezekieli në kapitullin 1? Pse ishte e pazakontë në Babiloni?
2. Çfarë përfaqëson pergamenin e kapitullit 2?
3. Çfarë përfaqësojnë veprimet simbolike të kapitujve 4 dhe 5?
4. Pse është kaq tronditës kapitulli 8? A ishte real, apo simbolik?
5. Ç’lidhje kanë me njëri-tjetrin kapitujt 1 dhe 11?

6. Pse është kaq i pazakontë kapitulli 18 për Dhiatën e Vjetër?
7. Ç'lidhje ka Satani me mbretin e Tirit (28)? Pse përbën kapitulli 28 një përshkrim të Satanit?
8. Ç'lidhje kanë kapitujt 36-39 me kohën e Ezekielit?
9. Çlidhje ka 18:30-32 me 36:26-27?
10. A është tempulli i Ezekielit simbolik apo i fjalëpërfjalshëm?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



HYRJE PËR DANIELIN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Mban emrin e zëdhënësit dhe profetit kryesor të librit.
- B. Emri i tij do të thotë “Perëndia është gjykatësi im”.

II. KANONIZIMI

- A. Danieli bën pjesë në pjesën e tretë dhe të fundit të kanonit hebre, “Shkrimet”.
- B. Kjo ndodh për shkak se:
 - 1. Judenjët e konsideronin burrë shteti, jo profet.
 - 2. Libri reflekton një datë të mëvonshme kompozimi (redaktimi).
 - 3. Përmban disa pjesë në aramaisht (2:4b-7:28), si Ezra.

III. GJINIA LETRARE

- A. Ashtu si shumë profetë të tjerë hebrej, libri përbën një kombinim gjinish letrare:
 - 1. Kapitujt 1-6 janë rrëfime historike, të shkruara në vetën e tretë. Pasqyrojnë jetën dhe kohën e Danielit.
 - 2. Kapitujt 7-12 janë ngjarje të ardhshme, shpesh të shprehura me simbolikë apokaliptike në vetën e parë (shih 7:1, 9; 8:1; 9:2)
- B. Ky motiv i veçantë, ku historikja pasohet nga e ardhmja, gjendet dhe në:
 - 1. Isaia, 1-39 dhe 40-66
 - 2. Ezekieli 1-32; 33:48
 - 3. Zakaria 1-8 & 9-14.
- C. Letërsia apokaliptike është një gjini letrare unike për judenjët. Përdorej në kohë vështirësie të madhe për t’u theksuar besnikëve faktin se historinë e ka në dorë Perëndia dhe për t’u kujtuar atyre premtimet e çlirimit dhe bekimit të ardhshëm.
- D. Karakterizohet nga përdorimi i një terminologjie tejet simbolike:
 - 1. ngjyra,
 - 2. kafshë,
 - 3. numra,
 - 4. vegime/ëndrra,
 - 5. ndërmjetësim engjëjsh,
 - 6. fjalë të fshehta të koduara,
 - 7. dualizmi i thekët – mes të mirës dhe së keqes.

IV. AUTORËSIA

- A. Libri nuk e shpreh autorin. Kapitujt 1-6 janë shkruar në vetën e tretë, ndërsa 7-12 janë në vetën e parë, 7:1, 9; 8:1; 9:1.
- B. Tradita judaike, Baba Bathra 15a, thotë: “Danielin e shkruan burrat e Sinagogës së Madhe”. Kjo do të thotë se e redaktuan, ose e kopjuan. Kjo mund të jetë arsyeja për disa tipare të vonëta të hebraishtes së përdorur në libër.
- C. Arsyet e mëposhtme janë dhënë si mbështetje për një datim të hershëm, ose të vonët:
 - 1. Datimi herët (shek. 7-6 para K.):

- a. Libri pretendon se përbëhet nga vegimet e Danielit, 7:2, 4, e më tej, 28; 8:1, 15; 9:1-2; 10:2 e më tej; 12:4-8.
 - b. Jezusi përmend autorësinë e Danielit, Mat. 24:15.
 - c. Prania e fjalëve perse dhe greke nuk tregon një datim të vonët, pasi në kohën e Danielit këto vende kishin kontakte tregtare.
 - d. Teologjia e jetës së përtejme mund të shihet edhe te Jobi dhe në disa Psalme. Teologjia e zhvilluar e engjëjve mund të shihet dhe te Zakaria.
 - e. Danieli përputhet me botëkuptimin tonë të tanishëm arkeologjik për oborret mbretërore babilonase dhe pers.
2. Datimi i vonët (shekulli i dytë para K.):
- a. Vendosja e librit në kanonit hebraik.
 - b. Prania e fjalëve perse dhe greke.
 - c. Teologjia e zhvilluar e jetës së përtejme dhe engjëjve.
 - d. Natyra specifike e parashikimeve, sidomos në kapitullin 11, që flet për betejën e seleukëve dhe ptolemejve për kontrollin mbi Palestinën.
 - e. Ngjashmëria e Danielit me librat e tjerë apokaliptikë të periudhës makabease.
 - f. Një sërë “gabimesh” të supozuara në libër:
 - (1) Përdorimi i fjalës “kaldeas”.
 - (2) Danieli si kaldeas (i mençur).
 - (3) Belshacari quhet “mbreti i Babilonisë”.
 - (4) Nebukadnecari quhet babai i Belshacarit.
 - (5) Përmendja e “Darit medas”.
 - (6) Përdorimi i fjalës administrative perse, *satrap*.

D. Uniteti i librit të Danielit mund të shihet në:

1. Marrëdhënien mes kapitujve 2, 7 & 8.

<u>Kap. 2</u>	<u>kap. 7</u>	<u>kap. 8</u>
Floriri (Babilonia)	luani	
Argjendi	ariu	dashi (Persia)
Bronzi	leopardi	cjapi (Greqia)
Hekuri/argjila	bisha	

2. Pjesa aramaisht është në 2:4b-7:28.

E. Bibla identifikon këto perandori:

1. Floriri i kapitullit 2 është Babilonia, 2:38.
2. Dashi i kapitullit 8 është Persia, 8:20.
3. Cjapi i kapitullit 8 është Greqia, 8:21.
4. Prandaj, mbretëria e katërt duhet të jetë Roma. Kjo është mbretëria kur do të vijë mesia (2:34-35, 44; 8:25).

F. Çfarë dimë për Danielin si person:

1. u çua në robëri më 605 para K., 1:1.
2. vinte nga një familje e rëndësishme dhe e pasur në Jerusalem, 1:3.
3. i zgjuar, 1:4.
4. dhunti të veçantë për interpretimin e ëndrrave dhe dhunti njohurie, 5:12, 14.
5. shërbëtor besnik i:
 - a. Perëndisë, 6:5.
 - b. mbretit, 6:4.

G. Danieli i librit të Danielit nuk është Danieli që përmendet në Ezek. 14:14, 20 dhe 28:3. Këta dy emra shqiptohen ndryshe në hebraisht.

V. DATA

- A. Danieli çohet në robëri nga Nebukadnecari II më 605 para K. (shih 1:1).
- B. Danieli është interpretuesi i ëndrrave dhe këshilltar i mbretërve të Babilonisë dhe Persisë deri në kohën e Kirit II “të madh” (shih 1:21; 6:28; 10:1).
- C. Disa studiues, që s’e pranojnë profecinë parashikuese, shqetësohen nga saktësia e detajeve historike të Danielit 11. Prandaj, këtë libër e datojnë në kohën pak pas profecisë së fundit të shkoqur, që flet për Antiokun IV Epifan (175-164 para K.).
- D. Meqë në libër përdoret shpesh përemri në vetën e parë njëjës (shih 7:1, 9; 8:1; 9:1), kjo nënkupton se autori i libri që mban të njëjtin emër është vetë Danieli, dhe kjo gjë do tadatonte si libër brenda periudhës së jetës së tij.

VI. NJËSITË LETRARE

- A. Përvijim i shkurtër
 - 1. Jeta e Danielit, 1-6
 - 2. Vegimet e Danielit, 7-12
- B. Përvijimi sipas përmbajtjes
 - 1. Danieli në oborrin e Nebukadnecarit, kapitulli 1.
 - 2. Ëndrra e Nebukadnecarit dhe interpretimi, kapitulli 2.
 - 3. Statuja e artë e Nebukadnecarit dhe tre miqtë e Danielit, kapitulli 3.
 - 4. Ëndrra e dytë e Nebukadnecarit dhe interpretimi i saj, kapitulli 4.
 - 5. Gostia e Belshacarit dhe rënia e qytetit të Babilonisë, kapitulli 5.
 - 6. Dari medas dhe Danieli në gropën e luanëve, kapitulli 6.
 - 7. Vegimi i katër bishave, kapitulli 7.
 - 8. Vegimi i kapitullit 7 shpjegohet dhe zgjerohet, kapitulli 8.
 - 9. Preokupimi i Danielit për rimëkëmbjen e Jerusaleit, por i tregohen problemet e ardhshme të judenjve, kapitulli 9.
 - 10. Hyrje e mesazhit të kapitujve 11-12, kapitulli 10.
 - 11. Beteja e ardhshme mes seleukëve dhe ptomejve për Palestinën, kapitujt 11-12.

VII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Perëndia kishte/ka në dorë historinë; soni në të dhe qëndrojnë besnikë në kohë të vështira.
- B. Vuajtjet e popullit të Perëndisë (judenjve) nuk kishin/kanë përfunduar.
- C. Perëndia do të vendosë një mbretëri të përhershme përmes Mesisë.
- D. Do të ketë ringjallje të drejtëve dhe të padrejtëve.

VIII. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA, QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

- A. Fjalë dhe/ose fraza
 - 1. “gjuha e kaldeasve” (kuneiforme), 1:4 (NIV, “gjuha dhe letërsia e babilonasve”)
 - 2. “i katërti është si bir perëndish”, 3:25 (NASB & NIV)
 - 3. *Mene, Mene, Tekel Upharsin*, 5:25 (NIV, “... *parsin*”)
 - 4. “katër erërat e qiellit”, 7:2 (NASB & NIV)
 - 5. “katër bisha të mëdha po dilnin nga deti”, 7:3 (NASB & NIV)

6. “librat u hapën”, 7:10 (NASB & NIV)
7. “një kohë, kohë dhe gjysmë kohe”, 7:25 (NASB & NIV)
8. Shtatëdhjetë javë, 9:24 (NIV, “shtatëdhjetë shtata”)
9. “populli i Princit”, 9:26 (NIV, “populli i sundimtarit”)
10. “krah i neverisë”, 9:27 (NIV, “në krah të tmepullit, ai do të vendosë një neveri”)
11. “neveria e shkatërrimit”, 11:31 (NIV, “neveria që shkakton shkatërrim”)

B. Persona

1. Jehoiakimi, 1:1
2. Kaldeasit, 2:2 (NIV, “astrologët”)
3. Belteshacari, 2:26
4. Rojtarët engjëj, 4:13 (NIV, “lajmëtarët”)
5. Belshacari, 5:1
6. Dari medas, 5:31-6:1
7. Briri i vogël, 7:8
8. I Lashti i Ditëve, 7:9
9. Biri i njeriut, 7:13
10. Biri i vogël, 8:9
11. Gaberieli, 8:16
12. Mikaeli, 10:13
13. “princi i jugut”, 11:5 (NIV, “mbreti i Jugut”)
14. “mbreti i veriut”, 11:6 (NIV, “mbreti i Veriut”)

IX. VENDNDODHJET NË HARTË


1. Shinari, 1:2 (NIV, “Babilonia”)
2. Media, 8:20
3. Suza, 8:2
4. Elami, 8:2
5. Greqia, 8:21

X. PYETJE PËRMBAJTEJE PËR STUDENTËT

1. Në cilat tre mënyra përdoret fjala “kaldeas”?
2. Si lidhen me njëri-tjetrin vegimet e kapitujve 2, 7 dhe 8?
3. Cilët janë “librat” e përmendur në 7:10 dhe 12:1?
4. Pse është kaq i vështirë interpretimi i 9:24-27?
5. Për cilat dy kombe flet kapitulli 11?
6. Te Danieli përmenden dy brirë të vegjël (7:8 dhe 8:9); kë përfaqësojnë?
7. Ku përmendet në libër tema e ringjalljes së përgjithshme të të vdekurve?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR OSEAN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Mban emrin e profetit në fjalë.
- B. Emri i tij do të thotë “shpëtim”. Kështu quhej në fillim Jozueu, Num. 13:16. Është i njëjti eër si Hoshea (2 Mbre. 17:1).
- C. Osea si person:
 - 1. biri i Beerit (1:1)
 - 2. qytetar i Izraelit (7:5), por s’ dihet për ç’ qytet bëhet fjalë.
 - 3. Amosi foli për nevojën për drejtësi shoqërore, ndërsa Osea foli për nevojën për besnikëri ndaj besëlidhjes.
 - 4. Ai është thirrur:
 - (a) “Jeremia i Izraelit”
 - (b) “apostulli Gjon i DHV”
 - (c) “ungjilltari i parë i Izraelit” ë

II. KANONIZIMI

- A. Ky libër është pjesë e “profetëve të mëvonshëm” (*Ekleziastiku* 49:10)
- B. Është i pari i të Dymbëdhjetëve, një grupim që u bëhej profetëve “të Vegjël” (Baba Bathra 14b)
 - 1. ashtu si Isaia, Jeremia dhe Ezekieli, këta dymbëdhjetë profetë ishin shkruar brenda një pergameni të vetëm.
 - 2. përfaqësojnë 12 fiset, ose përbën numrin simbolik të organizimit.
 - 3. pasqyron pikëpamjen tradicionale për kronologjinë e librit.
- C. Rendi i “të Dymbëdhjetëve”, ose i Profetëve të Vegjël, është lidhur nga shumë studiues me njëfarë rendi kronologjik. Mirëpo kjo pikëpamje ka disa probleme:
 - 1. Gjashtë librat e parë janë në rend të ndryshëm në MT dhe LXX.

<u>MT</u>	<u>LXX</u>
Osea	Osea
Joeli	Amosi
Amosi	Mikea
Abdia	Joeli
Jona	Abdia
Mikea	Jona
 - 2. Të dhënat e brendshme e vendosin Amosin përpara Oseas nga ana kronologjike.
 - 3. Datimi i Joelit është tejet i debatueshëm. Unë e vendos ndër profetët e hershëm pas kthimit nga robëria, së bashku me Abdian.
- D. Teksti i Osea është, ndoshta, më i vështiri nga gjithë librat e tjerë të DHV.
 - 1. Një pjesë e kësaj ndodh për shkak të natyrës emocionale të librit.
 - 2. Pjesërisht, kjo ka ndodhur edhe për shkak të kopjimit të skribëve. MT dhe LXX ndryshojnë nga njëri-tjetri.
 - 3. Pjesërisht, kjo ka ndodhur edhe për shkak të ndryshimeve në hebraishten e folur mes Judës dhe Izraelit.

III. GJINIA LETRARE

- A. Kjo është një narrativë historike e jetës dhe periudhës së një profeti izraelit të shekullit të tetë (sidomos kapitujt 1-3).

- B. Jeta e tij përdoret në mënyrë analoge për të demonstruar dashurinë e Perëndisë:
 1. Perëndia si dashurues i ri dhe besnik (1-3)
 2. Perëndia si prind i dashur (11)
 3. Këto metafora bazoheshin në ngatërrimin që i bënte Izraelit Baalit si “burrë” dhe “zot”.
- C. Është shkruar në formë poezi të bukur, të fuqishme dhe emocionale, por me pjesë të palidhura me njëra-tjetrën (kapitujt 4-14)

IV. AUTORËSIA

- A. Konsensusi ka qenë gjithmonë Osea, ndonëse dimë shumë pak për të.
- B. Baba Bathra 15a thotë se “të Dymbëdhjetët” u shkruan nga burrat e Sinagogës së Madhe. Kjo duhet marrë në kuptimin e përpilimit, ose redaktimit.
- C. Disa kanë vënë në pikëpyetje:
 1. Përmendjet e Judës, 1:1; 4:15; 5:5, 10, 12-14; 6:4, 11; 8:14; 11:12,
 2. Pasazhet e begatisë dhe çliimit të ardhshëm,
 3. Martesa e Oseas përshkruhet në vetën e tretë në kapitujt 1-2, por në vetën e dytë në kapitullin 3.
- D. Përgjigje për këto kundërshtime:
 1. Të gjithë profetët e shohin si të gabuar ndarjen e Izraelit nga Juda. Juda shihet gjithmonë si trashëgimtari i përligjur i premtimeve të besëlidhjes së Abrahamit dhe Davidit.
 2. Profeti kombinon orakujt e gjykimit me ato të premtimit. Ato shkojnë dorë për dorë si një mesazh i bashkuar hyjnor.
 3. Osea mund të jetë një grup predikimesh.

V. DATA

- A. Osea është një profet i shekullit të tetë para K.
 1. Isaia dhe Mikea në Judë
 2. Jona, Amosi dhe Osea në Izrael
- B. Osea pasoi shërbesën e Amosit, madje pati dhe mbivendosje kohore mes tyre
- C. Datimi i predikimit të tij duhet vendosur në periudhën e mbretërve të përmendur në 1:1:
 1. Uziahu (i Judës)
 2. Jotami (i Judës)
 3. Ahazi (i Judës)
 4. Ezekia (i Judës)
 5. Jeroboami II (i Izraelit)
- D. Disa sugjerime studiuesish:
 1. Keil, 790-725 para K.
 - a. 1:4, filloi përpara rënies së dinastisë së Jehut
 - b. 10:14, i pranishëm në pushtimin e Shalmaneserit V
 2. Francisco, 750-735 para K.
 - a. Pak më vonë se Amosi
 - b. Në ditët e fundit të Jeroboamit II
 - c. Jo më vonë se 735 para K., kur Asiria pushtoi zonën e Gileadit
 3. Harrison, përpara 722 para K.
 - a. Jeroboami II vdes më 753 para K.
 - b. Menahemi i paguan haraç Tiglath-Pileserit III (8:9) rreth 739 para K.

- c. Ngjarjet e Luftës Siro-Eframite më 735-734 para K. përmenden në 5:8-6:6 (si dhe në Isa. 7-14).
- d. Koha e Osea shpjegon përmendjen e Egjiptit në 7:11; 9:6 dhe 12:2.
- 4. La Sor, Hubbard dhe Bush, 753 – deri pas 722 para K.
 - a. Nisi përpara vdekjes së Jeroboamit II, 753 para K.
 - b. Zgjati deri në mbretërimin e Ezekias
 - (1) Bashkë-regjent nga viti 723 para K.
 - (2) Mbret nga viti 715 para K.
 - c. Predikoi gjatë mbretërimit të Tiglath-Pileserit III, 745-727 para K.

VI. KONTEKSTI HISTORIK

Shih “Sfondi historik i profetëve të shekullit të tetë” në fillim të Isaias.

VII. NJËSITË LETRARE

A. (Marrë nga *Introduction to the Old Testament*, nga Clyde Francisco, f. 150-163)

- 1. Hyrje, 1:1
- 2. Kriza familjare e Oseas, 1:2-3:5
- 3. Polemika e Perëndisë me Izraelin, 4:1-10:15
- 4. Babai dhe biri i tij plangprishës, 11:1-12
- 5. Ç’kuptim ka emri (Jakob në dallim nga Izraeli) 12:1-15
- 6. Vdekja e një kombi, 13:1-16
- 7. Alternativa e gjykimit 14:1-9

B. (Marrë nga *Introduction to the Old Testament*, E. J. Young, f. 252-254)

- 1. Marrëdhëniet e Perëndisë me popullin e tij, 1:1-3:5
- 2. Ligjëratat të ndryshme të profetit, 4:1-14:9
 - a. Faji i fiseve të veriut, 4-8
 - b. Ndëshkimi i fiseve të veriut, 9:1-11:11
 - c. Bekimet e ardhshme për një popull të papenduar, 11:12-14:9

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. JHVH është Perëndia personal. Mëkati është kundër Perëndisë personal, nuk është thjesht shkelje e disa rregullave të besëlidhjes (Amosi)
- B. Besimi biblik mund të karakterizohet më së miri duke përdorur metafora marrëdhëniesh familjare:
 - 1. bashkëshorti (Perëndia) – gruaja (Izraeli)
 - 2. prindi (Perëndia) – fëmija (Izraeli)
- C. JHVH ka zgjedhur të lidhet me njeriun e rënë nëpërmjet premtimeve, flijimit dhe besëlidhjes. Këto kërkojnë besim personal dhe bindje ndaj besëlidhjes.
- D. Mosbindja ndaj besëlidhjes çon në gjykim. Gjykimi ka gjithmonë si qëllim rimëkëmbjen. Disiplina është vepër dashurie prindërore (Heb. 12:5 e më tej). Bekimet e ardhshme të Izraelit kushtëzohen nga bindja e tij e tanishme.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjala dhe/ose fraza:

- 1. kurvëri, 1:2 (NIV, “grua kurorëshkelëse”)
- 2. debatohet, 2:2 (NIV, “qortohet”)
- 3. kekë me stafidhe, 3:1 (NIV, “i shenjti...”)

4. homer, 3:2 (NASB & NIV)
5. shtylla e shenjtë, 3:4 (NIV, “gurët e shenjtë”)
6. *terafimët*, 3:4 (NIV, “idhull”)
7. “nuk e njohin Zotin”, 5:4 (NIV, “nuk e pranojnë ZOTIN”)
8. “lëvizin kurifin”, 5:10 (NIV, “gurët e kufirit”)
9. “Efraimi përzihet me kombet”, 7:8 (NASB & NIV)
10. “viçi yt, o Samari” 8:5 (NIV, “idhulli yt viç, o Samari”)
11. “mbill erën, korr furtunën”, 8:7 (NASB & NIV)
12. “buka e vajtuesit”, 9:4 (NASB & NIV)
13. “e mësova Efraimin të ecte”, 11:3 (NASB & NIV)
14. Dashamirësia [*hesed*] 4:1; 6:6; 10:12; 12:6 (NIV, “pa besnikëri”)

B. Persona:


1. Uzia, 1:1
2. Ahaz, 1:1
3. Hezekia, 1:1
4. Jeroboami, biri i Joashit (II), 1:1
5. Gomer, 1:3
6. Jezreel, 1:4
7. Lo-ruhama, 1:6
8. Lo-ammi, 1:9
9. Baali, 2:16 (NIV, “burri im”)
10. Mbreti Jareb, 5:13; 10:6 (NIV, “mbreti i madh”)

X. VENDNDODHJET NË HARTË


1. Lugina e Akorit, 2:15 (Joz. 7:26)
2. Gilgal, 4:15
3. Bet-aven, 4:15 (Betel)
4. Micpa, 5:1
5. Mali Tabor, 5:1
6. Gilbea, 5:8
7. Rama, 5:8
8. Adam, 6:7
9. Gilead, 6:8
10. Baal-pero, 9:10
11. Liban, 14:6-7

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. A u martua Osea me një prostitutë?
2. Si është besëlidhja e Perëndisë me Izraelin: e kushtëzuar, apo e pakushtëzuar?
3. Ç’lidhje ka Baali dhe Gomeri me JHVH dhe Izraelin?
4. Pse mendohet që 6:1-3 bën fjalë për një pendim thjesht sipërfaqësor?
5. Për kë bën fjalë përemri “ata” në 7:4-6 dhe 8:4?
6. A është 8:13 në kundërshtim me 11:5?
7. A do të dëbohet Izraeli në Egjipt, apo në Asiri? Shpjego 11:5 në krahasim me 7:10; 8:13 dhe 9:3.
8. Pse aleancat politike dënohen nga të gjithë profetët e DHV?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJJE PËR JOELIN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Mban emrin e profetit në fjalë.
- B. Emri i tij është kombinim i dy emrave të Perëndisë:
 - 1. JHVH – emri i Perëndisë së besëlidhjes.
 - a. Çdo emër hebre që fillonte me shkronjën “J” dhe me një zanore, zakonisht, ishte shkurtim i fjalës JHVH.
 - b. Çdo emër hebre që mbaronte me “jah” ishte, gjithashtu, shkurtim i emrit JHVH (p.sh., Elijah).
 - 2. El – emri i përgjithshëm i Perëndisë.
 - 3. Midis këtyre dy emrave hebraisht duhet nënkuptuar një folje: JHVH (është) El.
- C. Ishte emër shumë i përhapur hebre. Përmenden trembëdhjetë persona me këtë emër në librat historikë.

II. KANONIZIMI

- A. Ky libër bën pjesë në atë nëndarje të kanonit hebre që quhej “Profetët”.
- B. Ishte pjesë e një rrotulle të quajtur “Të Dymbëdhjetët”. Këta njihen si “profetët e vegjël” për shkak të gjatësisë së shkrimeve të tyre.

III. GJINIA LETRARE

- A. Është gjysma në prozë dhe gjysma në formë poezie klasike hebraike.
- B. Joeli duket se aludon për një sërë profetësh të tjerë:
 - 1. Joeli 1:15 c – Amos 4:9; Isa. 13:6
 - 2. Joeli 2:3 – Isa 51:3 ose Ezek 36:35
 - 3. Joeli 2:10 – Isa. 13:10
 - 4. Joeli 3:10 – Isa. 2:4; Mikea 4:3
 - 5. Joeli 3:16 – Amosi 1:2
 - 6. Joeli 3:18 – Amosi 9:13
- C. Metaforat e Joelit për fundint e kohës shprehen me anë të fjalës apokaliptike “Dita e Zotit”.
- D. Teoritë sesi duhet interpretuar fatkeqësia e karkalecëve, 1:4; 2:25.
 - 1. simbolike/alegorike
 - a. Targumi jude për 2:25
 - 1) Popuj
 - 2) Gjuhë
 - 3) Sundimtarë
 - 4) Mbretëri
 - b. Shënim në anë të faqes në disa dorëshkrimet të LXX të shekullit të gjashtë
 - 1) Egjiptianë
 - 2) Babilonas
 - 3) Asirianë
 - 4) Grekë
 - 5) Romakë
 - c. Komentuesit e krishterë (shekulli i 18-të)
 - 1) Asirianë
 - 2) Kaldeas

- 3) Maqedonas
 - 4) Romakë
2. e shkuar historike
 - a. profeti përdor kohën e shkuar të foljes hebraisht
 - b. kjo ishte teknikë tipike profetike, që i merrte ngjarjet në jetën e profetit dhe i projektonte në një kontekst të ardhshëm. E ardhmja e Izraelit varej nga zgjedhjet që bënte në bazë të besimit dhe pendimit në të tashmen
 3. e ardhme historike
 - a. do të ndodhë një pushtim i vërtetë për shkak të mëkateve të Izraelit
 - b. karkalecat përdoren për shkak të metaforave ushtarake që përdoren për t'i përshkruar:
 - 1) duken si kuaj
 - 2) bëjnë zhurmë si karrocet e luftës
 - 3) marshojnë në mënyrë të rregullt
 - c. Joeli ndoshta lidhet dhe me Zbulesën 9:3-11
 4. Apokaliptike
 - a. përmendja e “Ditës së Zotit” sinjalizon për këtë lloj gjinie letrare
 - b. përdorimi i ngjyrave dhe kafshëve është diçka tipike për këtë gjini

IV. AUTORËSIA

- A. Nuk dihet asgjë tjetër veç emrit të profetit dhe emrit të babait të tij: Joeli, biri i Petuelit, 1:1.
- B. Ka patur dy tradita për këtë profet:
 1. nga fisi i Rubenit (pseudo-Epifani)
 2. nga Juda, për shkak se e njihte rutinën e tempullit të Jerusalemit

V. DATA

- A. Nuk ka një mënyrë sesi ta datojmë saktësisht librin (G. Campbell Morgan tha se ishte një nga profetët më të vjetër, ose më të rinj):
 1. nga të dhënat e brendshme janë sugjeruar dy datime:
 - a. një datë pas robërisë:
 - 1) duhet lidhur me pushtimin e kërcënuar të Judës nëpërmjet metaforës së fatkeqësisë së karkalecave.
 - 2) 3:2 nënkupton se Izraeli është çuar tashmë në robëri. Emri “Izrael” tani përdoret për Judën, 2:27; 3:1-2, 16.
 - 3) 3:6 flet për tregtinë greke të skllëvërve, që nënkupton një datë pas robërisë.
 - 4) 3:1, 17 nënkupton se Juda është çuar tashmë në robëri dhe rrezikon të pushtohet sërish nëse vazhdon mëkatin.
 - 5) nuk përmendet mbreti, gjë që nënkupton një kontekst pas robërisë. Joeli ia drejtoi mesazhin e tij pleqësisë dhe priftërinjve.
 - 6) Pushtuesit quhen “veriorë”, që nënkupton një pushtim mesopotamas (Asiria, Babilonia, Persia), 2:20.
 - 7) Adhurimi i Baalit, karakteristik për periudhën para robërisë, nuk përmendet.
 - b. Një datë para robërisë:
 - 1) duket se përmendet tempulli, 1:9, 13-14; 2:17.
 - 2) Armiqtë e përmendur në 3:4, 6, 8 (Feniki, Filisti, Edom, Sabeasti) ishin para robërisë, jo gjatë robërisë.
 2. nga të dhënat e jashtme:
 - a. pozicionimi i këtij libri në kanonin hebre nënkupton një datim para robërisë.
 - b. Megjithatë, mund të jetë vendosur ngjitur me Amosin edhe për shkak se të dy flasin për “Ditën e JHVH”, si dhe për pushtimet e karkalecëve si simbole gjykimi. Po kështu, kjo ditë nënkupton dhe një vizitë bekimi, jo vetëm gjykimi. Kjo përputhet me kontekstin pas robërisë.

3. Unë mendoj se datimi pak kohë pas robërisë përputhet më mirë me të dhënat.

B. Teoritë për datimin në bazë të pushtimit të Palestinës:

1. gjatë mbretërimit të Joashit (837-800 para K.)
2. gjatë mbretërimit të Uzias (783-742 para K.)
3. gjatë mbretërimit të Sedekisë (598-586 para K.)
4. gjatë kohës së Zerubabelit (598 para K.)
5. gjatë kohës së Malakisë (430 para K.)
6. një pushtim i ardhshëm eskatologjik i popullit të Perëndisë

C. Ekziston një lidhje letrare mes:

1. Joeli 2:32 dhe Abdia 17. Të dy janë shkruar pak kohë pas robërisë.
2. Joeli 3:16 dhe Amosi 1:2. Joeli citon shumë profetë; ndoshta, citon dhe Amosin.

D. Gjon Kalvini tha me të drejtë për datimin e Joelit: “Meqë s’jemi të sigurt, është më mirë që ta lemë të papërcaktuar kohën kur mësoi ai; dhe, siç do të shohim, kjo s’ka rëndësi të madhe. Mosnjohja e kohës së Oseas do të kishte qenë humbje e madhe për lexuesit, sepse përmban shumë pjesë që nuk mund të shpjegohen pa njohur historinë e kohës; por, sa për Joelin, kjo s’është e nevojshme, pasi vlera e doktrinës së tij është e qartë, ndonëse periudha e tij mund të jetë e mjegullt dhe e paqartë”.

VI. KONTEKSTI HISTORIK – Revista *National Geographic* e dhjetorit 1915 (XXVIII, Nr. 6) përmend një pushtim të Palestinës nga karkalecat. Ky artikull është shumë i dobishëm për të kuptuar aludimet e profetit Joel.

VII. NJËSITË LETRARE

A. Vegimi i fatkeqësisë së rëndë të pushtimit të karkalecave simbolizon një ushtri pushtuesish, 1:1-2:27

B. Dita e Zotit do të jetë bekim, jo mallkim, për popullin e penduar të Perëndisë (2:28-3:21; tek Sofonia është e kundërta.)

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

A. Profeti i sheh ngjarjet e kohës së tij si parahijezi i ngjarjeve të ardhshme.

B. Joeli bën thirrje për një ditë kombëtare pendimi, 1:13-14; 2:12-17.

C. Nëse populli i Perëndisë pendohet, Perëndia do të sjellë një ditë të re begatie fizike dhe shpirtërore (LiP. 27-28).

D. Perëndia do t’i gjykojë kombet përreth! 3:1-17

E. Kjo ditë e re ripërtëritjeje shpirtërore (shih 2:28-29) do të prekë:

1. burrat dhe gratë
2. të rinjtë dhe pleqtë,
3. skllëvërit dhe të lirët. (shih Veprat 2; Gal. 3:28)

F. “Dita e Zotit” është frazë tipike për Amosin, Joelin dhe Sofonian. Mënyra si reagojmë ndaj Perëndisë tani përcakotn nëse kjo do të jetë ditë gjykimi, apo bekimi.

G. Karakteri i Perëndisë përshkruhet te 2:13 (shih Eks. 34:6; Psa. 103:8-13 dhe Neh. 9:17).

H. Derdhja e Frymës (2:28-32) pasqyron Epokën e Besëlidhjes së Re (shih Jer. 31:31-34 dhe Ezek. 36:26-27).

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe/ose fraza:

1. “degët e tyre janë zbardhur”, 1:7 (NASB & NIV)
2. “dita e Zotit është afër”, 1:15 (NASB & NIV)
3. “fryjini borisë në Sion”, 2:1, 15 (NASB & NIV)
4. “shqyeni zemrën, jo rrobat”, 2:13 (NASB & NIV)
5. Dashmirësi (*hesed*), 2:13 (NIV, “i mbushur me dashuri”)
6. “Do ta derdh Frymën time mbi gjithë njerëzimin”, 2:28 (Veprat 2:16 e më tej) (NIV, “...mbi gjithë njerëzit”)
7. “kushdo që i bën thirrje emrit të Zotit do të çlirohet”, 2:32 (Veprat 2:21; Rom. 10:13) (NIV, “kushdo që i bën thirrje emrit të Zotit do të shpëtohet”)
8. “ata do të hedhin short për popullin tim”, 3:3 (NASB & NIV)
9. “farkëtojini shpatat në plugje...” 3:10 (NASB & NIV)

B. Persona:


1. I Plotfuqishmi (*El Shaddai*), 1:15
2. Sabeasit, 3:8

X. VENDNDODHJET NË HARTË


1. Tiri, 3:4
2. Sidoni, 3:4
3. Filistia
4. Javani (Greqia)
5. Edomi, 3:19
6. Sioni, 2:1
7. Lugina e Shitimit, 3:18 (NIV, “...e Akacieve”)

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. A janë karkalecat e 1:4 lloje të ndryshme karkalecash, apo faza të ndryshme të ciklit të jetës së karkalecit?
2. Pse u thuhet priftërinjve që të vajtojnë?
3. Përcakto emrin e Perëndisë, që përdoret në 1:15.
4. Cilat dy vargje të kapitullit 2 përdoren në DHR? Kush i përdor, dhe pse?
5. A është i fjalëpërfjalshëm apo i figurshëm vargu 1:5 dhe pse?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR AMOSIN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Mban emrin e profetit në fjalë.
- B. Amos do të thotë:
 1. “jam barrë”
 2. “mbart një barrë”
 3. “vazhdoj”
 4. Një traditë rabinike thotë se ishte një titull që u jepej atyre që i kundërviheshin mesazhit të tij, duke nënkuptuar se ai nuk fliste qartë, ose ndoshta kishte pengesë në të folur.
- C. Kjo është e vetmja herë kur ky emër shfaqet në Dhiatën e Vjetër.

II. KANONIZIMI

- A. Ky libër është pjesë e “Profetëve të Mëvonshëm”.
- B. Është një nga “të Dymbëdhjetët”, një listë e Profetëve “të Vegjël”.
- C. Vendosej i treti në profetët e vegjël sipas MT, ndërsa LXX e rendit të dytin.

III. GJINIA LETRARE

- A. Ky është i pari i profetëve shkruar.
- B. Gjinia letrare është profetizmi klasik hebre. Ky është shembull i poezisë dhe metaforës së shkëlqyer hebraike.

IV. AUTORËSIA

- A. Tradita judaike ka pohuar gjithmonë se autor është Amosi i Tekoas.
- B. Amosi si person:
 1. Ishte judeas nga Tekoa, që ndodhej rreth 8 kilometra në juglindje të Betlehemit.
 2. Nuk ishte profet, as pjesë e një familjeje apo grupimi profetik (shih 7:14). Në fillim, profetët jetonin së bashku në formë komuniteti. Më vonë, disa u identifikuan me pallatin mbretëror.
 3. Me sa duket, ishte bari “delesh të vogla” (shih 1:1). Fjala që përdoret për ta përshkruar është e rrallë, por përdoret për ata që kishin në pronësi dhen (shih 2 Mbre. 3:4).
 4. Ai ishte: (1) pronar pemësh frutore; ose (2) “krasitësh pemësh sikamori” (shih 7:14). Kjo, ndoshta, e bënte që të lëvizte përvit në vende të ndryshme. Këto pemë quhen “mana-fiq”. Fryti i ngjason shumë atij të fikut. Duhet që çdo fryt të shpohet në mënyrë që të piqet si duhet. Ishte një prodhim tejet i rëndësishëm për popujt e lindjes së afërt. Davidi, madje, caktoi një mbikëqyrës të veçantë për këtë punë (shih 1 Kro. 27:28).
 5. Tradita judaike thotë se Amosi ishte tregtar në gjendje të mirë. Kjo është tejet e ndryshme nga pikëpamja e sotme se ishte një fshatar i varfër. Për shkak të nivelit të shkëlqyer të poezisë së tij dhe ekspertizës letrare, tradita judaike duhet të ketë të drejtë! Nga 2 Samueli 14:2 e më tej, dimë se Tekoa, me sa duket, njihej për qytetarët e saj të mençur. Ai ishte profeti i parë në Izrael që i shkroi mesazhet profetike. Vini re përemrat në vetën e parë njëjës në 5:1; 7:1-9; 8:1 dhe 9:1.
 6. I predikoi mbretërisë veriore të Izraelit. E dimë me siguri se Beteli ishte një vend predikimi, por, ndoshta, duhet të ketë patur dhe shumë vende të tjera gjeografike në Izrael.
- C. Problemi i autorësisë është i koklavitur pasi:
 1. Libri nënkupton se Amosi ishte punëtor i varfër ferme.
 2. Stili dhe poezia janë të shkëlqyera, gjë që nënkupton një njeri të mirëarsimuar.

3. Thuhet se predikimet e tij bëheshin gojraisht, por janë tejet të strukturuar dhe të drejtpeshuara, gjë që nënkupton literaturë të shkruar.
4. Shumë mendojnë se Amosi u ndihmua nga një redaktor ose skrib.

V. DATA

- A. Është pak a shumë e lehtë që këtë profeci ta datojmë rreth vitit 750 para K., shto ose hiq 10 vjet.
- B. Vargu i parë i Amosit përbën përpjekjen më të gjatë dhe më qartë datuese në gjithë librat e DHV:
 1. Uziahu mbretëroi më 783-742 para K. (Bright)
 2. Jeroboami II mbretëroi më 786-746 para K. (Bright)
 3. Tërmeti i përmendur përdoret si një përpjekje tjetër për datimin e librit (shih 1:1; 8:8; 9:1, 5). Jozefusi e lidhi me 2 Kro. 26:16-21, kur Uziahu ofroi një fljirim. Studimet arkeologjike në Hacor sugjerojnë vitin 760 para K. (Yadin, 1964).
- C. Në 5:8 dhe 8:9 përmendet një eklips. Ky mund të jetë i njëjti që përmendet dhe në dokumentet asiriane; mendohet se ndodhi më 15 qershor 763 para K.; megjithatë, pati dhe një tjetër eklips të plotë më 9 shkurt 784 para K.
- D. Ky libër datohet dhe nga takimi i Amosit me Amaciahun, priftin kryesor në Betel nën autoritetin e Jeroboamit II (shih 7:10-17).

VI. KONTEKSTI HISTORIK

- A. Materiale biblike paralele gjenden në:
 1. 2 Mbre. 14:3-17:6
 2. 2 Kronikave 25-28
 3. Osea
 4. Isaia
 5. Mikea
- B. Përmbledhja më e thjeshtë e gjendjes së idhujtarisë ndër popullin e Perëndisë mund të gjendet te Osea:
 1. 2:16, “nuk do të më quajnë më ‘Baali’”
 2. 4:12-13, “...bijat sillen si prostituta...”
 3. 4:17, “Efraimi u bashkohet idhujve; lëreni rehat”
 4. 13:2, “burrat puthin vëçat!” (ritual)
- C. Konteksti shoqëror
 1. Ishte një periudhë lulëzimi ekonomik dhe zgjerimi ushtarak, si për Izraelin, ashtu dhe për Judën. Megjithatë, ky lulëzim ishte i dobishëm vetëm për klasën e pasur. Të varfrit shfrytëzoheshin dhe keqtrajtoheshin. Duket se “paraja dhe arma” ishin kthyer në idhuj shtesë!
 2. Qëndrueshmëria dhe lulëzimi shoqëror në Izrael dhe Judë lidhen më disa shkaqe:
 - a. Mbretërimet e gjata dhe të begata të Jeroboamit II (786-746 para K.) në veri, dhe Uziahut (783-742 para K.) në jug.
 - b. Rënia e përkohshme e fuqisë së Egjiptit dhe Mesopotamisë.
 - c. Disfata e asirianëve në Siri nga Adad-Nirari III më 802 para K.
 - d. Mungesa e konflikteve mes Izraelit dhe Judës.
 - e. Taksimi dhe shfrytëzimi i rrugëve tregtare nga veriu në jug, që kalonin përmes urës tokësore të Palestinës, sollën rritje të shpejtë ekonomike, madje dhe teprim pasurie për të kamurit.
 3. “Copat e poçave të Samarisë”, që datohen rreth kohës së mbretërimit të Jeroboamit II duket se tregojnë një organizim administrativ shumë të ngjashëm me atë të Solomonit. Kjo duket se vërteton humnerën gjithnjë e më të madhe mes të pasurve dhe të varfërve.

4. Pandershmëria e të pasurve pasqyrohet qartë te Amosi, i cili quhet “profeti i drejtësisë shoqërore”. Korrupsioni i gjyqësorit dhe falsifikimi i peshave të tregut janë dy shembuj të qartë abuzimi që, me sa duket, ishin të përhapura në Izrael dhe Judë.

D. Konteksti fetar

1. Ishte një kohë e mbushur me veprimtari fetare së jashtmi, por që nuk karakterizohet nga besimi i vërtetë. Kultet e pjellorisë së Kanaanit ishin përzier me fenë e Izraelit. Populli ishte idhujtar, por besimin e vet e quante “Jahvizëm”. Pririja e popullit të Perëndisë për aleanca politike e kishte shtyrë në rituale dhe adhurim pagan.
2. Idhujtari e Izraelit shprehet qartë në 2 Mbretërve 17:7-18.
 - a. v. 8; ndiqnin ritualet e adhurimit të kananitëve.
 - 1) Adhurimi i pjellorisë
 1. Vendet e larta, v. 9, 10, 11
 2. Shtyllat e shenjta (Baali), v. 10, 16
 3. Asherim, v. 16; këto ishin simbole të drunjtat të partneres femër të Baalit. Ishin ose hunj të gdhendur, ose pemë të gjalla.
 - 2) Orakujt, v. 17. Kjo diskutohet me hollësi në Lev. 19-20 dhe LiP. 18.
 - b. v. 16, ata vijuan me adhurimin e dy viçave të artë, që simbolizojnë JHVH, të ngritur në Dan dhe Betel nga Jeroboami I (1 mbre. 12:28-29).
 - c. v. 16, ata adhuronin perënditë yjore të Babilonisë: diellin, hënën, yjet dhe yjësitë.
 - d. v. 18, adhuronin dhe perëndinë e zjarrit dhe pjellorisë të fenikasve, Molekun (shih Lev. 18:21; 20:2-5).
3. Baalizmi (shih W. F. Albright, *Archeology and the Religion of Israel*, f. 82 e më tej).
 - a. Burimi ynë më i mirë është “Epika ugarite e Baalit”.
 - 1) E pasqyron Baalin si perëndi stinore, që vdes dhe ringjallet çdo vit. Ai u mposht nga Moti dhe u burgos në botën e nëndheshme. Gjithë jeta në tokë përfundoi. Por, me ndihmën e perëndeshës femër, ai ngrihet dhe e mposht Motin çdo pranverë. Ai është perëndi pjellorie dhe adhurohet me anë të magjive imituese.
 - 2) Njihej dhe me emrin Hadad.
 - b. Eli është perëndia kryesor i panteonit kananit, por popullariteti i Baalit ia zuri vendin.
 - c. Izraeli u ndikua më tepër nga baalizmi i Tirit nëpërmjet jezebelës, që ishte bija e mbretit të Tirit. Omri e zgjodhi Jezebelin për ta martuar me birin e tij, Ahabin.
 - d. Në Izrael, Baali adhurohet në vendet e larta lokale. Ai simbolizohet me anë të një guri të ngritur në këmbë. Bashkëshortja e tij është Asherahu, e simbolizuar me anë të një huri të gdhendur që simbolizonte pemën e jetës.
4. Përmenden një sërë burimesh dhe lloj idhujtari.
 - a. Viçat e artë të Betelit dhe Danit, të ngritur nga Jeroboami I për të adhuruar JHVH.
 - b. Adhurimi i perëndisë dhe perëndeshës së pjellorisë së Tirit në vendet e larta lokale.
 - c. Idhujtaria e pashmangshme në aleancat politike të kohës.

E. Konteksti politik në veri

- I. Jeroboami II ishte mbreti i fundit i fuqishëm në Izrael. Ishte i katërti në brezninë e Jehut dhe i fundit që u paratha se të do të mbretëronte (shih 2 Mbre. 10:30). Pati një mbretërim të gjatë dhe të suksesshëm politikisht (786-746 para K.).
- II. Pas vdekjes së Jeroboamit II pati gjashtë mbretër brenda një periudhe njëzetepesëvjeçare.
 - a) Zakaria (2 Mbre. 15:8-12). U vra brenda gjashtë muajsh.
 - b) Shalumi (2 Mbre. 15:13-15). U vra brenda muajit të parë.
 - c) Menahemi (2 Mbre. 15:16-22). Mbretëroi dhjetë vjet, por i pagoi haraç të rëndë Tiglath-Pileserit III.
 - d) Pekahiani (2 Mbre. 15:23-26). Mbretëroi dy vite dhe e ranë.
 - e) Pekahu (2 Mbre. 15:27-21). Mbretëroi pesë vjet dhe e vranë. Humbi një sërë qytetesh, që ranë në dorë të Asirisë.
 - f) Hoshea (2 Mbre. 15:30, 17:1-16). Mbretëroi nëntë vjet dhe u syrgjynos në Asiri më 722 pas rënies së Samarisë.

- III. Përmbledhje e shkurtër e pushtimeve të Asirisë dhe Babilonisë gjatë shekullit të tetë, që prekën dhe Palestinën:
- a) Katër profetët e shekullit të tetë vepruan gjatë ngritjes së perandorisë të Tigër-Eufratit, pra, Asirisë. Perëndia e përdori këtë komb mizor për të gjykuar popullin e tij, në veçanti Izraelin. Ngjarja e veçantë në këtë rast ishte formimi i një aleanca politike dhe ushtarake të trans-Jordanit, e njohur si “Lidhja siro-efraimite” (735 para K.). Siria dhe Izraeli u përpoqën që ta detyronin Judën të bashkohej me ta kundër Asirisë. Mirëpo Ahazi i dërgoi letër Asirisë për ndihmë. Mbreti i parë i fuqishëm asirian, që kishte plane perandorie, Tiglath-Pileseri III (745-727 para K.), iu përgjigj sfidës ushtarake dhe e pushtoi Sirinë. Më vonë, mbreti kukull i Asirisë, Hoshea (732-722 para K.), në Izrael, ngriti krye dhe i kërkoi ndihmë Egjiptit. Shalmaneseri V (727-722 para K.) e pushtoi sërish Izraelin. Ai vdiq para se Izraeli të nënshtrohej, por pasardhësi i tij, Sargoni II (722-705 para K.), e pushtoi kryeqytetin e Izraelit, Samarinë, më 722 para K. Asiria deportoi më shumë se 27,000 izraelitë me këtë rast, ndërsa Tiglath-Pileseri më herët kishte çuar në robëri mijëra të tjerë më 732 para K.
 - b) Pas vdekjes së Ahazit (735-715 para K.), u formua një tjetër koalicion ushtarak nga vendet e trans-Jordanit me Egjiptin kundër Asirisë (714-711 para K.). Ajo njihet si “Kryengritja e Ashdodit”. Shumë qytete judease u shkatërruan kur Asiria i pushtoi sërish. Në fillim, Hezekia e mbështeti këtë koalicion, por më vonë u tërhoq.
 - c) Gjithsesi, sërish, një tjetër koalicion u përpoq të përfitonte nga vdekja e mbretit të fuqishëm të Asirisë, Sargoni II, më 705 para K., bashkë me shumë kryengritje të tjera që ndodhën në mbarë perandorinë asiriane. Hezekia mori pjesë plotësisht në këtë kryengritje. Për shkak të kësaj sfide, Senakeribi (705-681 para K.) pushtoi (më 701 para K.) Palestinën dhe fushoi pranë qytetit të Jerusalemit (2 Mbre. 18-19; Isa. 36-39), por ushtria e tij u shkatërrua në mënyrë të mbinatyrshme nga Perëndia. Ka disa debate mes studiuesve se sa herë e pushtoi Senakeribi Palestinën (shembull: John Bright thotë se një pushtim ndodhi më 701 para K., dhe një tjetër i mundshëm më 688 para K., shih faqja 270). Hezekia i shpëtoi pushtimit të plotë asirian, por për shkak se ekspozoi me krenari thesaret e Judës në sytë e delegacionit babilonas, Isaia paratha rënien e Judës në dorë të Babilonisë (39:1-8). Jerusalemi ra në dorë të Nebukadnecarit më 587-586 para K.
 - d) Isaia paratha dhe rimëkëmbjen e popullit të Perëndisë nën Kirin II, sundimtarin medopers (41:2-4; 44:28; 45:1; 56:11). Niniva ra më 612 para K. në dorë të Babilonisë, por qyteti i Babilonisë ra më 539 para K. në dorë të ushtrisë së Kirit. Më 538 para K., Kiri lëshoi një dekret sipas së cilit të gjithë popujt e mërguar, përfshi dhe judenjtë, mund të ktheheshin në vendlindje. Madje, u siguroi dhe fonde nga thesari i vet për rindërtimin e tempujve kombëtarë.

VII. NJËSITË LETRARE

- A. Akuzat kundër kombeve, 1:1-2:3 (ndoshta deri në 2:16)
 1. Siria (Damasku), 1:3-5
 2. Filistia (Gaza), 1:6-8
 3. Fenikia (Tiri), 1:9-10
 4. Edomi, 1:11-12
 5. Amoni, 1:13-15
 6. Moabi, 2:1-3
- B. Akuzat e veçanta kundër popullit të Perëndisë, 2:4-6:14
 1. Juda 2:4-5
 2. Izraeli 2:6-6:14 (konteksti i gjykimit të Izraelit deri në 6:14)
- C. Vegimet e gjykimit, 7:1-9:10
 1. Karkalecat, 7:1-3
 2. Zjarri, 7:4-6

3. Plumbçja, 7:7-17
4. Frytet e verës, 8:1-14
5. Shkatërrimi i shenjtërores, 9:1-10

D. Shpresa mesianike, 9:11-15

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Amosi flet për zemërimin e Perëndisë për shkak të shkeljes së besëlidhjes së Moisiut nga Izraeli. Duhet të kemi parasysh këtu marrëdhënien mes përgjegjësisë kolektive dhe besimit individual në Dhiatën e Vjetër. Kemi një problem shoqëror mëkati si Izraeli atëherë, por, shpesh, në mendjen tonë ekzistojnë dy standarde:
 1. Jeta dhe besimi ynë privat si individë;
 2. Jeta jonë kolektive, shoqërore dhe publike.
- B. Sovraniteti i Perëndisë mbi gjithë tokën është sfondi për gjykimin që JHVH do t'u bëjë kombeve jashtë besëlidhjes së Izraelit. Kjo është baza e botëkuptimit monoteist të Izraelit.
- C. Kapitulli 2:9-12, gjykimi i Izraelit nga Perëndia, duhet parë në kontekstin e veprave të tij të hirshme në histori. Zgjedhja e Izraelit dhe besëlidhja e Perëndisë me të përcakton skenën për gjykimin e tij të rëndë. Duhet patur parasysh se “atij që i jepet shumë, shumë do t'i kërkohet” (shih Luka 12:48).
- D. Kapitulli 5 e lidh besimin me jetën në mënyrë të pandashme! Amosi demaskon shfrytëzimin e të varfërve nga të pasurit.
- E. Izraeli ka besuar në mënyrë të rreme te:
 1. feja e vet (shih 4:4-5; 5:21-23)
 2. begatia e vet ekonomike (shih 6:1 e më tej)
 3. fuqia e vet ushtarake (shih 2:14-16; 6:1b, 13).
- F. Edhe në mes të mosbesnikërisë së Izraelit, ka shpresë në besëlidhjen dhe Mesinë e Perëndisë, 9:8b-15.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe/ose Fraza

1. “tërmeti”, 1:1 (NASB & NIV)
2. kështjellat, 1:7 (NIV, “fortesat”)
3. skeptri, 1:8 (NASB & NIV)
4. “dogji kockat e mbretërve të Edomit...”, 2:1 (NASB & NIV)
5. “nevojtarin për një palë sandale”, 2:6; 8:6 (NASB & NIV)
6. “brirët e altarit”, 3:14 (NASB & NIV)
7. “shtëpitë e fildishta”, 3:15 (NIV, “shtëpitë e zbukuruara me fildish”)
8. “Unë i urrej, i refuzoj festat tuaja”, 5:21 (NASB & NIV)
9. Pjesa e dhjamur, 5:22 (NIV, “ofertat e zgjedhura të bashkësisë”)
10. Plumbçja, 7:7 (NASB & NIV)
11. “faji i Samarisë”, 8:14 (NIV, “turpi i Samarisë”)

B. Persona

1. Naziritët, 2:12
2. Lopët e Bashanit, 4:1
3. Vajtuesit profesionistë, 5:16 (NIV, “vajtuesit”)
4. *Sikut*, 5:26 (NIV, “tyrbe”)
5. *Kijun*, 5:26 (NIV, “pedestal”)


6. Amaciahu, 7:10
7. Jeroboami II, 7:10
8. Shikuesi, 7:12

X. VENDNDODHJET NË HARTË


1. Tekoa, 1:1
2. Karmeli, 1:2
3. Gileadi, 1:3
4. Gaza, 1:6
5. Ashdodi, 1:8
6. Ashkeloni, 1:8
7. Ekroni, 1:8
8. Temani, 1:12
9. Bocra, 1:12
10. Raba, 1:14
11. Beteli, 4:4
12. Gilgali, 4:4
13. Sodomi, 4:11
14. Beersheba, 5:5
15. Hamati, 6:14
16. Dani, 8:14

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. A ishte Amosi fshatar i varfër, apo tregtar i pasur?
2. A jemi përgjegjës vetëm për mëkatet individuale, apo dhe për mëkatet kolektive si shoqëri?
3. Cili është theksi i 3:2-8?
4. Pse dënohen Beteli dhe Gilgali? Pse dënohet veprimtaria fetare e 4:4-5?
5. Pse i refuzoi Perëndia flijimet e Izraelit?
6. Pse është kaq e vështirë të interpretohet pasazhi 5:25-26?
7. A po e dënonte Amosi sistemin flijues?
8. A e ndryshon mendjen Perëndia?
9. Ç'lidhje ka pendimi me faljen? (kapitulli 7)
10. A është gjykimi i Perëndisë eskatologjik, apo i kohshëm?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR ABDIAN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Mban emrin e profetit në fjalë.
- B. Ky emër do të thotë “shërbëtor i JHVH”
- C. Ishte emër i përhapur hebre (shih 1 Mbre. 18:3; 2 Kro. 3:12; 7:3; 8:38; 9:16,44; 12:9; 27:19; 2 Kro. 17:7; 34:12; Ezra 8:9; Neh. 10:5; 12:25)

II. KANONIZIMI

- A. Ky libër është pjesë e profetëve të mëvonshëm (*Ekleziastiku* 49:10)
- B. Bën pjesë të të “Dymbëdhjetët”, një grupim i profetëve “të vegjël” (Baba Bathra 14b)
 - 1. Ashtu si Isaia, Jeremia dhe Ezekieli, gjithë këta profetë futen në një rrotull të vetëm pergameni
 - 2. Përfaqësojnë dymbëdhjetë fiset për nga numri simbolik i organizimit
 - 3. Pasqyrojnë pikëpamjen tradicionale për kronologjinë e këtyre librave
- C. Rendi i “të Dymbëdhjetëve”, ose i “Profetëve të Vegjël”, është lidhur nga shumë studiues me një radhë kronologjike. Megjithatë, kjo pikëpamje ka problemet e veta:
 - 1. Gjashtë librat e parë ndryshojnë nga radha në MT dhe në LXX.

<u>MT</u>	<u>LXX</u>
Osea	Osea
Joel	Amos
Amos	Mikea
Abdia	Joel
Jona	Abdia
Mikea	Jona
 - 2. Të dhënat e brendshme e vendosin Amosin kronologjikisht përpara Oseas
 - 3. Datimi i Joelit është tejet i debatueshëm. Unë e rendis si profet të hershëm pas robërisë, së bashku me Abdian

III. GJINIA LETRARE – poezi klasike profetike e hebrenjve

IV. AUTORËSIA

- A. Asgjë nuk dihet për këtë profet
- B. Disa teori:
 - 1. Sanhedrin 39b (Talmudi) thotë se ai ishte shërbëtori i mbretit Ahab të 1 Mbre. 18:3-16
 - 2. Pseudo-Epifani (kisha e hershme), në librin “Jetët e Profetëve”¹ thotë se ishte zyrtar i lartë ushtarak i mbretit Ahazia (842 para K.) të 2 Mbre. 1:12 e më tej.
 - 3. Gjon Kalvini tha se Abdia ishte dëshmitar okular i shkatërrimit të Jerusalemit (586 para K. nga Nebukadnecari II i Babilonisë)
- C. Ky emër mund të jetë titull.

V. DATA

- A. Ky libër, nga ana gjuhësore, ka ngjashmëri me Jeremian 49:7-12 (Abd. v. 1-9) dhe Joelin 2:32 (Abdia v. 10):
 - 1. E. J. Young i vendos në këtë rend: Abdia, Jeremia

2. R. K. Harrison i vendos në këtë rend: Jeremia, Abdia (450 para K.) dhe Joeli (400 para K.). Kjo e vendos këtë libër në periudhën e hershme pas robërisë.
 3. Keil i vendos në këtë rend: Abdia, Joeli, Jeremia
- B. Është e qartë se ky libër lidhet me një pushtim të Judës dhe me ngacmimet e Jerusalemit nga Edomi. Disa data të mundshme janë:
1. Jerusalemi u pushtua nga Shishaku, faraoni i Egjiptit në vitin e pestë të Rehoboamit, 922-915 para K. (shih 1 Mbre. 14:25-28; 2 Kro. 12:2-10).
 2. Jerusalemi u pushtua nga lidhja e arabëve me filistinët gjatë mbretërimit të Jehoramit, 849, 842 para K. (shih 2 Mbre. 8:20 e më tej; 2 Kro. 21:16-17; 22:1).
 3. Jerusalemi u pushtua nga sirianët gjatë mbretërimit të Joashit, 837-800 para K. (shih 2 Kro. 24:23-24).
 4. Jerusalemi u pushtua nga Izraeli (Jehoashi) pas disfatës së Edomit në mbretërimin e Amaciahut (shih 2 Mbre. 14:7-14, 842 para K.)
 5. Juda u sulmua nga edomitët (shih 2 Kro. 28:17; 19:8-9; 2 Mbre. 16:1-20).
 6. Jerusalemi u pushtua nga Nebukadnecari disa herë, 605, 597, 586, 582 para K.:
 - a. 605 para K. mbretërimi i Jehoiakimit (shih Dan. 1:1-2)
 - b. 596 para K. mbretërimi i Jehoiakinit (shih 2 Mbre. 24:8-17; 2 Kro. 36:9-10; Ezek.)
 - c. 586 para K. mbretërimi i Cedekisë (shih 2 Mbre. 24:18-25:21; 2 Kro. 36:11-21; Vajtimet; Psalmet 137:7)
 - d. 586 para K. guvernatori babilonas Gedaliah (shih 2 Mbre. 25:22-26)
- C. Studiuesit kanë përkrahur dy datime:
1. një datim i hershëm në mbretërimin e Jehoramit (849-842 para K.):
 - a. për shkak të pozicionit të librit në listën e “të Dymbëdhjetëve”:
 - (1) grupimi i shekullit të tetë: Amos, Osea, Mikea, (Joeli?) dhe Abdia
 - (2) grupimi i shekullit të shtatë: Nahumi, Habakuku dhe Sofonia
 - (3) grupimi pas robërisë: Hagai, Zakaria dhe Malakia
 - b. Abdia nuk e përmend shkatërrimin e tempullit
 - c. Kombet e përmendura janë para robërisë, jo pas saj
 - d. Mëkatet janë të ngjashme me ato që renditen nga profetët e shekullit të tetë
 - e. S’ka fjalë, idioma apo shprehje aramaike
 2. një datim i vonët, që lidhet me pushtimin e Jerusalemit nga Nebukadnecari II
 - a. vgj. 11-14 duket se përputhen me rënien e Jerusalemit më 586 para K.
 - b. Edomi mori pjesë në këtë pushtim
 - (1) U gëzua nga rënia e Judës
 1. Psa. 137:7
 2. Vaj. 2:15-17; 4:21
 3. Ezek. 36:2-6
 4. 1 Esdra 4:45, 50
 - (2) Ndhmoi në rënien e Judës:
 - (a) Ezek. 25:12-14
 - (b) Ezek. 35:1-5

VI. KONTEKSTI HISTORIK

- A. Edomi, objekt i profecisë, v. 1-9, 18, 21
1. Edomi është kombi në lindje të Detit të Vdekur, që rodhi nga Esau, vëllai i Jakobit (shih Zan. 25-29; 32-33). Edom do të thotë “i kuq”, ndërsa Esau do të thotë “leshatak” (shih Zan. 25:25, 30).
 2. Izraeli u urdhërua që ta respektonte Edomin (shih LiP. 23:7).
 3. Izraeli dhe Edomi kishin probleme të vazhdueshme:
 - a. Num. 20:14-21
 - b. Gjyq. 11:16-17
 - c. 1 Sam. 14:47-48

- d. 2 Sam. 8:14
 - e. 1 Mbre. 11:14-25
 - f. 2 Mbre. 14:22; 16:5-6
 - g. 2 Kro. 20:10-30; 21:8 e më tej
 - h. Amos 1:6, 9
4. Profeci të tjera kundër Edomit:
- a. Isa. 34:5 e më tej; 63:1 e më tej
 - b. Jer. 49:7-22
 - c. Vaj. 4:21-22
 - d. Ezek. 26:12 e më tej; 35:1 e më tej; 36:2-6
 - e. Amosi 1:11-12
5. Edomi u dënua për shkak të:
- a. krenarisë, v. 3-4
 - (1) në sigurinë gjeografike
 - (2) në aleancat politike dhe fuqinë ushtarake
 - (3) në pasurinë tregtare
 - (4) në urtësinë tradicionale
 - b. shkeljeve ndaj Judës, kushëririt të saj, v. 10-14
 - (1) u gëzua kur ra Jerusalemi (Vaj. 2:15-17; 4:21)
 - (2) s'pranoi ta ndihmonte (v. 15)
 - (3) mbështeti aktivisht armikun (v. 14)
 - (4) mori pronën e Judës (Jer. 13:19)
 - c. refuzimit dhe përçmimit kundrejt JHVH (v. 16)
- B. Edomi është simbol i gjithë kombeve që u ngritën kundër Perëndisë dhe popullit të tij, v. 15-21 (shih Psa. 2).
- C. Përmbushje të mundshme historike të profecisë:
- 1. Shkatërrimi i Edomit nga neo-Babilonia rreth 5 vjet pas rënies së Jerusalemit, 580 para K.
 - 2. Shpërngulja e Edomit nga Petra për shkak të arabëve nabateas rreth 550-449 para K. (shih Mal. 1:2-5). Edomi nuk përmendet në listën e Nehemias për kombet armiq që e rrethonin, por zëvendësohet nga fiset arabe. Edomi u zhvendos në Negev.
 - 3. Disfata e Edomit nga gjenerali i Aleksandrit, Antigoni, më 312 para K. (e regjistruar në Diodorus Sekulus)
 - 4. Disfata e Edomit në Negev nga Juda Makabeu rreth 175 para K. (shih 1 Mak. 5:3, 15; 2 Mak. 10:15; Jozefus, *Lashtësitë e judenjve* 12:8:1; 13:9:1)
 - 5. Edomi u detyrua të pranonte judaizmin nga Gjon Hirikani më 125 para K. Në atë kohë, quheshin idumeas.
 - 6. Gjenerali romak, Titi, e shkatërroi plotësisht ndikimin idumeas më 70 pas K.

VII. NJËSITË LETRARE

Përvijim i shkurtër, i marrë nga seria e *The New International Commentary*, “Joel, Abdia, Jona dhe Mikea”, nga Allen, f. 142

- A. Shkatërrimi i Edomit (2-9)
- 1. Përmbysja e Edomit (2-4)
 - 2. Rrënimi i plotë i Edomit (5, 6)
 - 3. Mashtrimi i aleatëve të Edomit (7)
 - 4. Edomi humb urtësinë dhe luftëtarët e vet (8, 9)
- B. Keqbërja e Edomit (10-14, 15b)
- 1. Sjellja jovëllazërore e Edomit (10, 11)
 - 2. Tallja e Edomit (12)
 - 3. Shkeljet e Edomit (13)

4. Bashkëpunimi i Edomit dhe shpagimi që po vjen (14, 15b)

C. Edomi në Ditën e Jahves (15a, 16-21)

1. Dita e Jahves (15a, 16)
2. Roli i mbetjes (17, 21)
3. Zjarri judeas dhe kashta edomite (18)
4. Toka rifitohet (19, 20)

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Armiqtë e Perëndisë dhe të popullit të Perëndisë do të ndëshkohen. Edomi është tipologji e një kombi kryengritës dhe mosbesues (shih v. 15)
- B. Perëndia do ta përlëvdojë popullin e vet sipas premtimeve të besëlidhjes së tij. Shenjtëria është synimi i JHVH për popullin e tij.
- C. Situata historike do të përmbysset. Edomi do të shkatërrohet; populli i Perëndisë do të bekohet.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe/ose fraza

1. “ti ndërton lart si shqiponja” 1:4 (NIV, “e bën follenë mes yjeve”)
2. “për shkak të dhunës ndaj vëllait tënd, Jakobit...” 1:10 (NASB & NIV)
3. “hedh short për Jerusalemin” 1:11 (NASB & NIV)
4. “Dita e Zotit është afër” 1:15 (NASB & NIV)

B. Persona

1. Esau, 1:8

X. VENDNDODHJET NË HARTË

1. Edomi, 1:1
2. Temani, 1:9
3. Mali Sion, 1:17
4. Negevi, 1:19, 20 (ose “Negebi”)
5. Shefelahu, 1:19 (NIV, “kodrat e ulëta”)
6. Gileadi, 1:19

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Cila është tematika qendrore e librit të Abdias?
2. Pse u gjykua kaq rëndë Edomi?
3. Pse përdoret Edomi si simbol për gjithë kombet?
4. A citohet apo aludohet Abdia në DHR?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



HYRJE PËR JONËN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Mban emrin e profetit në fjalë.
- B. Emri i tij do të thotë “pëllumb”. Ishte simboli i kombit të Izraelit:
1. Përdoret në mënyrë pozitive nga psalmisti, Psa. 68:13; 74:19;
 2. Përdoret në mënyrë negative nga Osea, 7:11,
 3. Përdoret si metaforë dashamirësie në Këngën e Këngëve, 2:14; 5:2; 6:9.

II. KANONIZIMI

- A. Ky libër është pjesë e “profetëve të mëvonshëm” (*Ekleziastiku* 49:10)
- B. Libri i parë i të Dymbëdhjetëve, një grupim i profetëve të vegjël (Baba Bathra 14b)
1. Ashtu si Isaia, Jeremia apo Ezekieli, edhe këta futen në një rrotull të vetme.
 2. Përfaqësojnë dymbëdhejtë fiset, ose është numri simbolik i organizimit.
 3. Pasqyrojnë pikëpamjen tradicionale për kronologjinë e librave.
- C. Rendi i “të Dymbëdhjetëve”, ose i Profetëve të Vegjël, është lidhur nga shumë studiues me një radhë kronologjike. Mirëpo kjo pikëpamje ka probleme:
1. Gjashhtë librat e parë ndryshojnë në LXX dhe në MT.
- | | |
|-----------|------------|
| <u>MT</u> | <u>LXX</u> |
| Osea | Osea |
| Joeli | Amosi |
| Amosi | Mikea |
| Abdia | Joeli |
| Jona | Abdia |
| Mikea | Jona |
2. Të dhënat e brendshme e vendosin Amosin kronologjikisht më herët se Osean.
 3. Datimi i Joelit është tejet i debatueshëm. Unë e rendis si profet të hershëm pas robërisë, së bashku me Abdian.

III. GJINIA LETRARE

- A. Ndryshon nga pjesa tjetër e profetëve të vegjël. Është prozë, me përjashtim të 2:2-9.
- B. Gjinia letrare e Jonës është shumë e debatueshme. Shumë studiues ndiejnë siklet nga aspektet e mrekullueshme, profetizuese dhe teologjike të librit. Disa e shohin si:
1. Alegori
 2. Shëmbëlltyrë (që përdor humor)
 3. Tipologji
- C. Emri i Jonës është i rrallë në hebraisht; i tillë është dhe emri i të atit. Një burrë, ose baba, me këtë emër përmendet dhe në 2 Mbre. 14:25. Ai jetoi gjatë mbretërimit të Jeroboamit II (783-743 para K.). Jezusi e përmend Jonën si njeri që jetoi vërtet, Mat. 12:39-40; 16:4; dhe Luka 11:29.
- D. Ka gjasa që Jona, ashtu si Jobi, të jetë shkruar dhe/ose zgjeruar nga një njeri i urtë për të përçuar një të vërtetë teologjike. Shumica e librave profetikë përmbajnë mesazhet e profetit në fjalë, kurse te Jona i vetmi mesazh profetik përbëhet nga pesë fjalë në 3:4.

IV. AUTORËSIA

- A. Autori është vetë profeti. Ai prezantohet në 1:1, njësoj si profetët e tjerë të vegjël.
- B. Jona dhe i ati, Amitai, janë emra të rrallë në hebraisht; të dy shfaqen në 2 Mbre. 14:25. Ai ishte profet i Jeroboamit II nga Gath-heferi, pranë Nazareti.
- C. Ka mundësi që një njeri i mençur hebre të ketë marrë jetën e një personi historik, si Jobi, dhe ta ketë zgjeruar për të paraqitur një të vërtetë teologjike. Ndoshta, Jona u thirr nga mbreti i Izraelit për t'u mbrojtur pse i predikoi armikut të Izraelit. Jona ishte një profet/skrib i veriut të Izraelit, dhe rrinte te mbreti. Kjo mund të shpjegojë faktin pse është kaq antagonist në libër. Një njeri i mençur mund ta ketë dëgjuar mbrojtjen e Jonës, mund të ketë kuptuar rrjedhojat për mbarë botën, dhe ta ketë hedhur me shkrim përjetimin e Jonës (John Harris, ETBU, 1998).

V. DATA

- A. Nëse autori është Jona i 2 Mbre. 14:25, atëherë duhet mbrojtur një datë para rënies së Ninivës më 612 para K. gjatë mbretërimit të Jeroboamit II (783-743 para K.).
- B. Shpesh, thuhet se Jona u shkrua vonë, por kjo zakonisht bazohet në këto pika:
 - 1. refuzimi i profecisë parashikuese,
 - 2. refuzimi i elementeve të mbinatyreshme të librit si diçka historike,
 - 3. supozimi se Jona kundërshton krenarinë kombëtare dhe natyrën përjashtuese të Izraelit pas kthimit nga robëria.

VI. KONTEKSTI HISTORIK – Ka dy data në historinë e Asirisë që mund të kenë qenë rasti kur ndodhi pendesa e Ninivës.

- 1. prirja drejt monoteizmit gjatë mbretërimit të Adad-Nirarir III (810-783 para K.)
- 2. murtaja e rëndë në Asiri gjatë mbretërimit të Asurdanit III (771-754 para K.).

VII. NJËSITË LETRARE

- A. Ndarjet e kapitujve tregojnë përshkallëzimin e ngjarjeve
- B. Përvijim i shkurtër
 - 1. Kapitulli 1 – vullneti i Perëndisë kundërshtohet dhe zëvendësohet nga vullneti i Jonës. Perëndia fiton!
 - 2. Kapitulli 2 – Jona pendohet (poezi e shkruar në kohën e shkuar; pasqyron adhurimin në tempullin e Jerusalemit)
 - 3. Kapitulli 3 – pranohet vullneti i Perëndisë. Niniva pendohet.
 - 4. Kapitulli 4 – karakteri i Perëndisë na zbulohet në dallim nga qëndrimi dhe veprimet e Jonës.

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Në këtë libër, paganët janë fetarë, ndërsa profeti është rebel
 - 1. Marinarët
 - 2. Ninivasit
- B. Dashuria e Perëndisë për kombet shihet qartë në 3:10 dhe 4:11. Perëndia nuk do vetëm njerëzit, por edhe kafshët, 4:11
- C. Asirianët e urryer dhe mizorë pranohen nga JHVH për shkak të pendimit dhe besimit në të, 3:5-9. Nuk u kërkohet që të bëhen judenj.

- D. Jona simbolizon thirrjen e Perëndisë që Izraeli të jetë një mbretëri priftërinjsh për botën (shih Zan. 12:3; Eks. 19:4-6). Izraeli u bë nacionalist, përjashtues dhe krenar, në vend që të bëhej ungjillizues dhe shpengues.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe/ose fraza

1. “Zoti caktoi një peshk të madh” 1:17 (NIV, “...siguroi një peshk të madh”)
2. Sheol, 2:2 (NIV, “varri”)
3. Gropa, 2:6 (NASB & NIV)
4. “Perëndia ndjeu keqardhje”, 3:10 (NIV, “pati dhembshuri”)
5. “dashamirësi” *hesed*, 4:2 (NIV, “mbushullues në dashuri”)
6. “Zoti caktoi një bimë, 4:6 ... një krimb, 4:7, ... një erë, 4:8 (NIV, “siguroi”)
7. “njerëz që nuk dallojnë dot dorën e djathtë nga e majta”, 4:11 (NASB & NIV)
8. “si dhe kafshë”, 4:11 (NIV, “dhe shumë gjedhë”)

B. Persona


1. Amitai, 1:1
2. “Perëndia i qiellit”, 1:9

X. VENDNDODHJET NË HARTË


1. Niniva, 1:2
2. Tarshish, 1:3
3. Jopa, 1:3

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. A ishte personazh historik Jona?
2. Pse nuk donte të shkonte në Ninivë Jona?
3. A është peshku i madh problemi kryesor interpretues i librit? Pse, ose pse jo?
4. Përshkruaj natyrën e Perëndisë. (1:9; 4:2)
5. Kush është personazhi kryesor: Jona, apo Perëndia? Pse?
6. Ç’mesazh ka ky libër për Izraelin? Si ngjason Jona me Izraelin?
7. Si e përdor Jezusi këtë libër? (shih Mat. 12:38-45)



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR MIKEAN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Mban emrin e profetit në fjalë.
- B. Emri i tij është formë e shkurtuar e emrit Mikajah (Gjyq. 17:1, 4; 1 Mbre. 22:13), që do të thotë: “kush është si JHVH?”

II. KANONIZIMI

- A. Ky libër është pjesë e “profetëve të mëvonshëm” (*Eklesiastiku* 49:10).
- B. Është i pari i “Të Dymbëdhjetëve”, një grupim i profetëve të vegjël (Baba Bathra 14b).
 - 1. Ashtu si Isaia, Jeremia dhe Esteri, ata futen në një rrotull të vetme.
 - 2. Përfaqësojnë dymbëdhjetë fiset, ose numrin simbolik të organizimit.
 - 3. Pasqyrojnë pikëpamjen tradicionale të librit nga ana kronologjike.
- C. Rendi i “të Dymbëdhjetëve”, ose i Profetëve të Vegjël, është lidhur nga shumë studiues me një radhë kronologjike. Mirëpo kjo pikëpamje ka probleme:
 - 1. Gjashtë librat e parë ndryshojnë në LXX dhe në MT.

<u>MT</u>	<u>LXX</u>
Osea	Osea
Joeli	Amosi
Amosi	Mikea
Abdia	Joeli
Jona	Abdia
Mikea	Jona
 - 2. Të dhënat e brendshme e vendosin Amosin kronologjikisht më herët se Osean.
 - 3. Datimi i Joelit është tejte i debatueshëm. Unë e rendis si profet të hershëm pas robërisë, së bashku me Abdian.

III. GJINIA LETRARE

- A. Ndonëse i ngjason Amosit nga teologjia, nuk i ngjason nga stili. Megjithëse Mikea nuk është shkruar me formën e bukur dhe të zhvilluar poetike të Amosit, përmban shprehje të forta të së vërtetës.
- B. Karakterizohet nga mesazhe gjykimi dhe rimëkëmbjeje, që vendosen përbri njëra-tjetres pa kalime graduale. E vërteta pikturohet me dy ngjyra, bardhezi!
- C. Profeti jep mesazhe të fuqishme, të ndjera dhe të mençura nga Perëndia i Besëlidhjes!
- D. Mikea është profet i parashikimeve:
 - 1. Rënia e Samarisë në dorë të Asirisë, 1:5-7; 6:9-16
 - 2. Rënia e Jerusalemit në dorë të Babilonisë, 1:9-16; 3:12; 4:10-12; 6:9-16
 - 3. Kthimi i popullit të dëbuar jude, 2:12-13; 5:5b-9; 7:7-20
 - 4. Vendlindja e Mesisë, 5:2, dhe mbretëria e tij mbarëbotërore, 5:4
 - 5. Besimi i ardhshëm i kombeve pagane, 4:1-5

IV. AUTORËSIA

- A. Sipas traditës, profeti Mikea nga Moresheth-gathi konsiderohet si autori i gjithë kësaj profecie.

- B. Studiuesit e sotëm janë përpjekur ta ndajnë librin e Mikeas sipas disa autorësh, siç kanë bërë dhe me shkrimet e Moisiut. Mirëpo ekzistojnë të dhëna të brendshme që ky libër përbën një njësi të vetme:
1. Disa kapituj nisin me fjalën hebraisht “dëgjoni” (*shema*, shih LiP. 6:4), 1:2; 3:1; 6:1.
 2. Metaforat “barinj/dele” përdoren në gjithë librin, 2:12; 3:2-3; 4:6; 5:1 e më tej; 7:14.
 3. Gjithë libri përmban aludime nga fjalët e disa profetëve të tjerë të shekullit të tetë (shih 4:1-3 dhe krahasoje me Isa. 1:2-4).
- C. Në shumë mënyra, Mikea ngjason me Amosin nga ana e personalitetit dhe mesazhit. Qytetet e tyre të vendlindjes janë vetëm 30 kilometra larg njëri-tjetrit. Ata ishin të dy burra fshati, të papërfshirë në betejat politike për pushtet në oborret mbretërore, si në rastin e Isaisë.

V. DATA

- A. Kapitulli 1, vargu 1, shpreh kohëzgjatjen dhe periudhën e shërbesës së Mikeas: “në ditët e Jotanit, Ahazit dhe Hezekias”.
- B. Jeremia 26:18 thotë se Mikea profetizoi gjatë mbretërimit të Hezekias.
- C. Meqë 1:1 i drejtohet jo vetëm Jerusalemit, por edhe Samarisë, dhe meqë 6:1-6 tregon për një skenë në oborrin mbretëror që parathotë rënien e Izraelit, Mikea duhet të ketë profetizuar para rënies së Samarisë më 722 para K.
- D. Shërbesa e tij vijoi përtej rënies së Samarisë. Ky libër duket se përmbledh mesazhe të Mikeas gjatë gjithë shërbesës së tij.

VI. KONTEKSTI HISTORIK

- A. Mikea është profet i shekullit të tetë; ai shërbeu në mbretërinë e jugut në kohën e Isaisë.
- B. Ishte një kohë begatie dhe zgjerimi ushtarak. Kishte shumë veprimtari fetare, por asokohe mbizotëronte kulti i pjellorisë kanaanite, që përdorte emrin e JHVH.
- C. Perandoria e Asirisë, që sa vinte e forcohej nën udhëheqjen dinamike të Tiglath-Pileserit III, po bëhej gati të sulmonte.
- D. Për një përmbledhje të plotë e të hollësishme historike, shih pjesën për Isainë.

VII. NJËSITË LETRARE

- A. Ky libër karakterizohet nga ndryshime të menjëhershme: 2:5, 12; 3:1; 6:6-8; 7:14-15. Autori kalon nga gjykimi në orakujt e shpëtimit, krahaso 2:10-11 me 2:12-13.
- B. Përvijimi bazë
1. Gjykimi i ardhshëm mbi popullin e Perëndisë, 1:1-16
 - a. Dëbimi i veriut, 1:5-7
 - b. Dëbimi i jugut, 1:9-16 (3:12)
 2. Ndëshkimi dhe rimëkëmbja e popullit të Perëndisë, 2:1-13
 - a. Mëkatet shoqërore të pasanikëve, 1-11
 - b. Shpresa e ardhshme, 12-13
 3. Dënimi i udhëheqësve të popullit të Perëndisë, 3:1-12
 - a. Krerët e qeverisë, 1-4, 9, 11
 - b. Profetët, 5-7 (profeti i vërtetë, v. 8), 11
 - c. Prifti, 11
 - d. Pasojat, 12 (4:10)

4. Lavdia e ardhshme e rimëkëmbur e popullit të Perëndisë, 4-5
 - a. Ftesa mbarëbotërore për gjithë kombet, 4:1-5
 - b. Ftesa për ulokët, të përjashtuarit dhe të dobtit, 4:6-8
 - c. Komuniteti i bseimtarëve sulmohet por del fitimtar, 4:9-13
 - d. Ardhja e Mesisë, 5:1-5a
 - e. Fitorja e ardhshme kundër Asirisë, 5:5b-9
 - f. Gjykimi i tanishëm i popullit të Perëndisë, 5:1, 10-15
5. Perëndia sjell para gjyqit popullin e tij, 6
 - a. Profeti flet në emër të Perëndisë, 1-5
 - b. Populli i Perëndisë përgjigjet, 6-7
 - c. Profeti përgjigjet në emër të Perëndisë, 8
 - d. Gjykimi i Perëndisë bie mbi qytetin e popullit të tij: ose Jerusalemi dhe/ose Samaria, 9-16
6. Dënimi i Perëndisë dhe bekimi i premtuar për popullin e Perëndisë, vazhdimi, 7
 - a. Mëkatet e vazhdueshme shoqërore të popullit të Perëndisë, 1-6
 - b. Udhëheqësi i ardhshëm i popullit të Perëndisë do të jetë si Perëndia, 14-20

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Mikea, ashtu si Amosi, dënon mëkatet shoqërore të pasanikëve dhe të pushtetshmëve.
- B. Mikea, ashtu si Osea, dënon femohimin e profetëve dhe priftërinjve (3:11).
- C. Mikea paratha rënien dhe dëbimin e Izraelit dhe Judës për shkak të idhujtarisë dhe mosbesnikërisë ndaj besëlidhjes.
- D. Perëndia është i drejtë. Populli i tij do të ndëshkohet. Por Perëndia është edhe i hirshëm dhe besnik ndaj besëlidhjes së tij; populli i tij (mbetja) do të shpengohet dhe rimëkëmbet.
- E. Perëndia do që populli i tij të pasqyrojë karakterin e tij, 6:8, jo të kryejë rituale pa besim (6:6-7).
- F. Izraeli, Juda dhe johebrentjë besimtarë do të bekohen nga ardhja e Mesisë, që do të lindë në Betlehem (5:2). Ky udhëheqës i ri do të jetë si JHVH (7:18-20).

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

- A. Fjalë dhe/ose fraza
 1. “malet do të shkrihen”, 1:4 (NASB & NIV)
 2. “plaga e saj është e pashërueshme”, 1:9 (NASB & NIV)
 3. Bejte, 2:4 (NASB & NIV)
 4. “kush ha mishin e popullit tim” 3:3 (NASB & NIV)
 5. Yshtje, 3:6 (NASB & NIV)
 6. “Sioni do të plugohet si fushë” 3:12 (NASB & NIV)
 7. “popujt... kombet do të vijnë...” 4:1-2 (NASB & NIV)
 8. “do t’i farkëtojnë shpatat në plugje” 4:3 (NASB & NIV)
 9. “daljet e tij janë prej qyshkur, që nga ditët e përjetësisë”, 5:2 (NIV, “origjina e të cilit është prej qemoti, që nga kohët e lashta”)
 10. “a do ta paraqes... frytin e trupit tim për mëkatën e shpirtit tim?” 6:7 (NASB & NIV)
 11. Pesha mashtruese 6:11 (NIV, “pesha të rreme”)
 12. “mëkatet e tyre do t’i hedh në thellësinë e detit” 7:19 (NIV, “do t’i flakë gjithë shkeljet tona në thellësitë e detit”)
- B. Persona
 1. Nimrod, 5:6
 2. Balak, 6:5

3. Balaam, 6:5
4. Omri, 6:16

X. VENDNDODHJET NË HARTË


1. Samari, 1:5
2. Jerusalem, 1:5
3. Lakish, 1:13
4. Moresheth-gat, 1:14
5. Mali Sion, 4:7
6. Betlehem Efrata, 5:2
7. Vendi i Nimrodit, 5:6
8. Shitim, 6:5
9. Gilgal, 6:5
10. Bashan
11. Gilead

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Rendit ritet e vajtimin në 1:8-16.
2. Të tria format profetike (orakulli i premtimit, skena e gjykatës, dhe vajtimi/vaji) gjejnë shprehje në librin e Mikeas. Jep shembuj.
3. Ku ngjason Mikea me Amosin?
4. Pse citohet Mikea në Jeremia 26:18?
5. Kujt i drejtohet 5:10-15?
6. Rendit gjërat që do të bëjë Perëndia për popullin e vet në 7:18-20.



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR NAHUMIN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Mban emrin e profetit me të njëjtin emër.
- B. Emri i tij do të thotë “ngushëllim”, ose “dhembshuri” (shih Isa. 57:18).

II. KANONIZIMI

- A. Ky libër është pjesë e Profetëve të Vegjël për shkak të gjatësisë së shkrimeve të tyre.
- B. Ata quhen “të Dymbëdhjetët”. Ndoshta, u vendosën së bashku për shkak se mund të shkruheshin brenda një rrotulle të vetme.
- C. Futen te pjesa e dytë e kanonit hebre, që quhet “Profetët”.
- D. Judenjtë donin që numri i librave në kanonin e tyre të përputhej me numrin e bashkëtingëlloreve të alfabetit, prandaj, disa libra i kombinuan me njëri-tjetrin.

III. GJINIA LETRARE

- A. Është profetizëm hebre klasik (në formë poezie). Është një nga poezitë më të fuqishme në DHV.
- B. Nahumi është unik dhe artistik për nga zgjedhja e fjalëve dhe shprehjeve. Ai dhe Isaia konsiderohen si poetët më të mëdhenj të Profetëve. Ekziston një lidhje letrare mes tyre:
 - 1. Nahumi 1:4 dhe Isaia 33:19.
 - 2. Nahumi 1:15 dhe Isaia 52:7.
- C. Nahumi 1:2-8 është psalm akrostik. Psalmi hapës është unik ndër profetët e vegjël.

IV. AUTORËSIA

- A. Pak dihet për këtë profet. Ky është i vetmi rast kur emri i tij shfaqet në DHV.
- B. Quhet Elkoshi, që është ndoshta emri i ndonjë vendi. Ka patur disa teori:
 - 1. Jeronimi dhe Euzebi e vendosin në Galile, në qytetin e Elkoshit.
 - 2. Të tjerë mendojnë se bëhet fjalë për Kapernaumin, “shtëpia e Nahumit”, por nuk ka të dhëna që e mbështesin këtë gjë.
 - 3. Pseudo-Epifani e vendos në Judën jugore, *Jetët e profetëve XVII*, në qytetin e Elkoshit pranë shtëpisë së Mikeas.
 - 4. Një traditë arabe e shekullit të 16-të e vendos në Irak (fëmija i prindërve të çuar në robëri). Qyteti i Elkoshit është 30 km në veri të Ninivesë.

V. DATA

- A. Duhet të jetë shkruar para rënies së Ninivesë, 612 para K.
- B. U shkrua para rënies së Tebës (No-amon) në duar të Ashurbanipalit më 663 para K. (shih 3:8 e më tej) sepse ajo përdoret si shembull i një qyteti të mbrojtur nga uji, por që u pushtua gjithsesi.

- C. Mund të jetë shkruar pak kohë pas vdekjes së Ashurbanipalit më 627 para K. Ai ishte mbreti i fundit i fortë i Asirisë dhe, rreth vitit 626 para K., Neo-Babilonia fitoi pavarësinë nën udhëheqjen e Nabopolasarit.

VI. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E HISTORISË SË ASIRISË DHE PALESTINËS

- A. Nahumi flet për rënien e Asirisë, që kishte si kryeqytet Niniven. Perëndia e përdori këtë komb mizor si mjet të gjykimit hyjnor ndaj Izraelit (shih Isa. 10:5).
- B. Ngjarja e parë e regjistruar ndodhi në mbretërimin e Jehut (842-812 para K.). Më 841 para K., mbreti asirian, Shalmaneseri III (858-824 para K.), e detyroi t'i jepte haraç.
- C. Kjo vazhdoi edhe nën Adad-nirarin III (810-782 para K.). Damasku u pushtua dhe Joashi u detyrua t'i paguante haraç.
- D. Pushtimi dhe dëbimi i parë masiv ndodhi gjatë mbretërimit të Menahemit (752-732 para K.) nën drejtimin e Tiglath-pileserit III (745-727 para K.) më 732 para K. Me sa duket, ai e zëvendësoi Pekën (740-732 para K.) me Hosean (732-722 para K.) (shih 2 Mbre. 15:29; 1 Kron. 5:6; 2 Kron. 30:6, 10; Isa. 9:1. Ky nënshttrim i Palestinës ndikoi edhe te Juda, pasi edhe Ahazi (735-715 para K.) paguante haraç.
- E. Hosea u përpoq të lidhte aleancë mes Izraelit dhe Egjiptit, ndaj u pushtua nga Shalmaneseri V (727-722 para K.). Kryeqyteti i tij, Samaria, ra pas një pushtimi trevjeçar në dorë të Sargonit II (721-705 para K.). Izraeli u çua në robëri në Mede (shih 2 Mbre. 17:3-20; 18:20-21; Isa. 7:8; 8:4; 10:11; 36:20; Os. 9:3; 10:6, 14; 11:5). Sargoni II e pushtoi Judën dhe e detyroi t'i paguante haraç më 720 para K. dhe 712 para K.
- F. Në Judë, Hezekia (728-687 para K.) mori pushtetin pas Ahazit. Në fillim, i pagoi haraç Sargonit II. Më vonë, nuk pranoi t'i jepte haraç Asirisë (shih 2 Mbre. 18). Juda u pushtua nga Senakeribi (704-681 para K.) më 701 para K., por u detyrua të tërhiqej për shkak të një murtaje të shkaktuar nga engjëlli i Zotit, që vrau 185,000 ushtarë asirianë (shih Isa. 10:16; 36:1-37:38; 2 Mbre. 18:13-19:37; 2 Kron. 32:1-31).
- G. Më vonë, Manasi u detyrua t'i nënshtrohej Esarhadonit (681-669 para K.) (shih 2 Kron. 33:1-11).
- H. Biri i Esarhadonit, Ashurbanipali (638-633 para K.) ishte mbreti i fundit i fortë i Asirisë. Pas vdekjes së tij, gjatë një periudhe rënieje të shpejtë:
1. Nabopolasari (625-605 para K.) ngriti një neo-Babiloni të pavarur.
 2. Psametihu I (664-609 para K.) i riktheu pavarësinë Egjiptit.
 3. Josia (640-609 para K.) i riktheu pavarësinë Judës.
 4. Kiaksaksi (625-585 para K.) ngriti një Media të pavarur.
- I. Ninive, kryeqyteti i Asirisë, ra më 612 para K. në dorë të Nabopolasarit dhe Kiaksaksit. Ashuri, kryeqyteti i mëparshëm, pati rënë më 614 para K.
- J. Ninive zinte një hapësirë prej 7.5 km katrorë dhe kishte 12 km mure të përforcuara.

VII. NJËSITË LETRARE

- A. Hyrje, 1:1
- B. Një psalm për ashpërsinë dhe hirin e JHVH, 1:2-8 (akrostik i pjesshëm).
- C. Realiteti i karakterit të Perëndisë, gjykim për Niniven, çlirim për Judën, 1:9-2:2.

D. Një rrëfim i gjallë poetik i pushtimit dhe rënies së Ninives, qytetit të madh, 2:3-3:19.

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Fokusi i librit është shkatërrimi i Ninives, kryeqyteti i perandorisë mizore asiriane. Senakeribi e shpalli kryeqytet rreth vitit 700 para K. Ndodhej në bregun lindor të lumit Tigër dhe ishte i fortifikuar më së miri.
- B. Qyteti u shkatërrua plotësisht nga babilonasit dhe medasit më 612 para K.; e njëjta gjë i pati ndodhur Ashurit më herët në 614 para K. Ata përdorën murin që kalonte përreth mureve. Ia ndryshuan rrjedhën lumit duke e futur në disa rezervuare dhe, pastaj, e lëshuan në të njëjtën kohë. Forca e ujit shkatërroi një pjesë të madhe të murit, 2:6.
- C. Perëndia i pati përdorur asirianët mizorë për të gjykuar popullin e tij (Isa. 10:5), por, tani, erdhi radha e gjykimit të asirianëve. Njeriu korr atë që mbjell, Gal. 6:7.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe/ose fraza

- 1. Orakull, 1:1 (NASB & NIV)
- 2. Vegim, 1:1 (NASB & NIV)
- 3. “Zoti është i ngadaltë në zemërim”, 1:3 (NASB & NIV)
- 4. “fortesë”, 1:7 (NIV, “strehim”)
- 5. Korracë, 2:5 (NIV, “mburojë”)
- 6. “portat e lumit hapen, dhe pallati shkërmoqet”, 2:6 (NIV, “portat e lumit shpërthehen dhe pallati rrëzohet”)
- 7. “vini fustanet mbi fytyrë”, 3:5 (NASB & NIV)
- 8. “fëmijët e tij të vegjël bëhen copë-copë në krye të çdo rruge”, 3:10 (NASB & NIV)

B. Persona

- 1. Belial, 1:15 (NIV, “të ligjtë”)
- 2. ZOTI i ushtrive, 2:13 (NIV, “Zoti i plotfuqishëm”)

X. VENDNDODHJET NË HARTË

- 1. Bashan, 1:4
- 2. Karmel, 1:4
- 3. Liban, 1:4
- 4. No-amon (Teba), 3:8
- 5. Ninive, 1:1

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

- 1. Cili është qëllimi qendror i librit?
- 2. Ç’lidhje ka 1:3 me vargun 7?
- 3. Ç’lidhje ka Jona me Nahumin?
- 4. Pse konsiderohet poet i madh Nahumi?
- 5. Ç’lidhje ka 2:6 me rënien historike të Ninives?

6. Pse përmendet një qytet egjiptian në 3:8-10?
7. Rendit urdhrat ironikë të pasazhit 3:14-15.



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR HABAKUKUN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Mban emrin e profetit me të njëjtin emër.
- B. Në Septuagintë, quhet “Hambakum”, që është fjalë asiriane dhe do të thotë “perime”.

II. KANONIZIMI

- A. Ky libër është pjesë e “profetëve të mëvonshëm” (*Ekleziastiku* 49:10).
- B. Është një nga “të Dymbëdhjetët”, një grupim i profetëve të vegjël (Baba Bathra 14b)
 - 1. Ashtu si Isa., Jer., dhe Ezekeli, këta libra futen në një rrotull të vetme.
 - 2. Përfaqësojnë dymbëdhjetë fiset, ose është numri simbolik i organizimit.
 - 3. Pasqyron pikëpamjen tradicionale për kronologjinë e librave.
- C. Rendi i “të Dymbëdhjetëve”, ose Profetëve të Vegjël, është lidhur nga shumë studiues me një rrjedhë kronologjike. Është e qartë se Nahumi, Habakuku dhe Sofonia përbëjnë një njësi.

III. GJINIA LETRARE – është tejet e pazakontë që profeti t’i flasë Perëndisë në emër të popullit. Kapitulli i parë është një diatribë, ose mjet komunikimi i së vërtetës me anë të një dialogu të hamendësuar.

IV. AUTORI

- A. Ky profet flet me JHVH-në për Judën. Të gjithë profetët e tjerë i flasin popullit në emër të Perëndisë.
- B. Ky profet bën pjesë në të njëjtën periudhë të përgjithshme si Danieli, Jeremia, Ezekieli, Nahumi dhe Sofonia. Këta i quajmë Profetët e Shekullit të Tetë.
- C. Ka gjasa që të ketë qenë muzikant i lidhur me Korin e Tempullit, pasi:
 - 1. 3:1 ka fjalën *Shigionot*. Shënimi i NASB e quan “një formë poetike tejet emocionale”. Është një fjalë muzikore me kuptim të panjohur, ndoshta do të thotë “pauzë”, ose “kreshendo”.
 - 2. Përdoret një tjetër fjalë e mundshme muzikore, *Sela*, në 3:3, 9, 13.
 - 3. Përdoroet fraza e 3:19, “për drejtorin e muzikës, për veglat me tela”.

V. DATA (Ekzistojnë dy teori kryesore)

- A. Mbretërimi i Manasit (687-642 para K.). Zakonisht, kjo lidhet me vendin e Habakukut në kanon dhe me ngritjen e kaldeasve, perandorisë neo-babilonase (shih Hab. 1:5).
- B. Mbretërimi i Jehoiakimit (609-598 para K.). Kjo e vendos këtë libër në periudhën kur faraoni Neko II plaçkiti qytetin dhe, më vonë, Nebukadnecari pushtoi gjithë rajonin pas shpartallimit të pjesës së mbetur të ushtrisë asiriane dhe asaj egjiptiane në Karkemish më 605 para K.
- C. Pseudo-Epifani, në *Jetët e profetëve*, thotë se Habakukut ishte nga fisi i Simeonit. U largua para se të vinte Nebukadnecari II më 586 para K., dhe u kthye pas rënies së qytetit, ku vdiq dy vjet pas kthimit nga robëria. Megjithatë, ky burim është i vonët dhe jo i besueshëm.

VI. KONTEKSTI HISTORIK

VII. NJËSITË LETRARE

- A. Libri ndahet në dy pjesë kryesore:

1. kapitujt 1 & 2 – dialog mes profetit dhe Perëndisë
2. kapitulli 3 – poezi lavdërimi për zotërimin e historisë nga Perëndia.

B. Dialogu mes Perëndisë dhe profetit, 1:2-2:20

1. Ankesa e Habakukut për ngadalësinë e Perëndisë në ndëshkim, 1:2-4
2. Përgjigjja e Perëndisë, 1:5-11
3. Problemi moral i Habakukut nga përgjigjja e Perëndisë, 1:12-2:1
4. Përgjigjja e dytë e Perëndisë, 2:2-5
 - a. Plani i Perëndisë është i sigurt, shkruaje, 2:20
 - 1) bekimi për besimin, 2:4, 14, 20
 - 2) gjykimi mbi ligësinë, 2:5, 6-20
 - b. Populli i Perëndisë është përgjegjës për besnikërinë ndaj besëlidhjes, 2:4-5 (3:16-19)
 - c. Perëndia do ta ndëshkojë agresionin dhe paperëndishmërinë pagane, 2:6-20 (5 “mjerët”)
 - 1) 2:6-8, agresioni i dhunshëm
 - 2) 2:9-11, agresioni i dhunshëm
 - 3) 2:12-14, agresioni i dhunshëm
 - 4) 2:15-17, agresioni i dhunshëm
 - 5) 2:18-20, idhujtaria

C. Pasm Bekimi për veprat besnike të Perëndisë, i cili ka sjellë çlirim në të kaluarën dhe jep shpresë çlirimi në të ardhmen, 3:1-19

1. Veprat e kaluara të çlirimit të Perëndisë, të shprehura në formë tejet poetike, duke përdorur metafora (3:1-15) nga:
 - a. Eksodi
 - b. Krijimi
 - c. Pushtimi
2. Besimi i profetit dhe durimi i tij për të pritur çlirimin e Perëndisë, ndonëse nuk ka shenja të jashtme të këtij çlirimi (2:4; 3:16-19)

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Ky është univers moral. Mëkati do të gjykohej. Edhe populli i zgjedhur i Perëndisë është përgjegjës për veprimet e tij (Gal. 6:7).
- B. Edhe në këtë botë të rënë, kontrollin e ngjarjeve e ka ende Perëndia. Ai e përdor ligësinë për qëllimet e tij, por edhe kjo ligësi do të gjykohej!
- C. Është e pranueshme t’i bësh pyetje Perëndisë. Mirëpo, shpesh, ajo që e kënaq besimtarin nuk janë përgjigjet logjike, por prania e Perëndisë.
- D. Ky libër është burimi i motivit të famshëm teologjik të Palit, “shfajësimi me anë të besimit” (shih 2:4). Ligësia, në fund, do të vetëshkatërrohet. Populli i Perëndisë duhet të ushtrojë besim në mes të ditëve të liga! Besimi nuk duhet lidhur me situatat e tanishme, 3:17-19.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe/ose fraza

1. “drejtësia dhe autoriteti i tyre burojnë nga vetja e tyre”, 1:7 (shih 1:11c) (NIV, “ata janë ligj për veten dhe përkrahin nderin personal”)
2. “O Zot, Perëndia im, i Shenjti im”, 1:12 (NASB & NIV)
3. “O Shkëmb”, 1:12 (NASB & NIV)
4. “ofrojnë fljime për rrjetën e tyre”, v. 15-17 (NIV, “ai i flijon rrjetës së vet”)
5. “por i drejti do të jetojë me anë të besimit të tij”, 2:4 (NASB & NIV)
6. Sheol, 2:5 (NIV, “varri”)

7. Bejte, 2:6 (NIV, “bejte”)
8. “kupa është në dorën e djathtë të Zotit”, 2:16 (NASB & NIV)
9. Shigionot, 3:1 (NASB & NIV)
10. Sela, 3:3, 9, 13 (NASB & NIV)
11. I vajosuri yt, 3:13 (NIV, “i vajosuri yt”)
12. “Ai m’i ka bërë këmbët si ato të drerit”, 3:19 (NIV, “ai m’i bën këmbët si ato të drerit”)

B. Persona – asnjë

X. VENDNDODHJET NË HARTË


1. Kaldea, 1:6 (NIV, “babilonasit”)
2. Teman, 3:3
3. Mali Paran, 3:3
4. Midian, 3:7

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Ku ndryshon së tepërmi ky libër nga profetët e tjerë të vegjël?
2. Përvijo dialogun mes Perëndisë dhe profetit në kapitujt 1-2.
3. Pse mendohet që Habakuku ishte muzikant?
4. Shpjego simbolikën e 1:16-17.
5. Ç’kuptim ka 2:4 në kontekst? Si e përdor Pali në Rom. 1:17 dhe Gal. 3:11?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



HYRJE PËR SOFONIAN

I. EMRI I LIBRIT

A. Mban emrin e profetit me të njëjtin emër.

B. Emri i tij do të thotë:

1. “JHVH ka fshehur”, ose
2. “JHVH vështron”

II. KANONIZIMI

A. Ky libër bën pjesë në “profetët e mëvonshëm” (*Ekleziastiku* 49:10).

B. Është pjesë e “të Dymbëdhjetëve”, një grupim i profetëve të vegjël (Baba Bathra 14b):

1. Ashtu si Isa., Jer. Dhe Ezekieli, bëjnë pjesë në një rrotull të vetme.
2. Përfaqësojnë dymbëdhjetë fiset, ose është numri simbolik i organizimit.
3. Reflektojnë pikëpamjen tradicionale për kronologjinë e librave.

C. Rendi i “të Dymbëdhjetëve”, ose i Profetëve të Vegjël, është lidhur nga shumë studiues me rrjedhën kronologjike. Është e qartë se Nahumi, Habakuku dhe Sofonia përbëjnë një njësi të vetme.

III. GJINIA LETRARE

A. Kjo ishte profeci (poezi) klasike hebraike, që përqendrohej në tematikat e mëkatit, gjykimit dhe rimëkëmbjes.

B. 3:14-20 mund të jetë himn i lashtë.

IV. AUTORËSIA

A. Ky libër ka një gjenealogji tejet të gjatë: “... biri i Kushit, biri i Gedaliahut, biri i Amariahut, biri i Hezekias”, 1:1.

1. Kjo nënkupton se ai vinte nga pasardhja mbretërore e Judës. Nëse Hezekia i përmendur është mbreti i Judës (715-687 para K.), atëherë ky duket se ishte qëllimi i kësaj gjenealogjie të zgjatur.
2. Ndoshta, kjo kronologji e gjatë jepet për të provuar se Sofonia ishte jude, pasi kjo mund të vihej në dyshim nga emri i atit të tij, *Kushi* (dmth., etiopas).

B. Shumë besojnë se ishte kushëri i Josias dhe, ndoshta, ishte edukuar nga të njëjtit mësues të këtij mbreti të perëndishëm.

C. Tre të tjerë në DHV kanë të njëjtin emër: 1 Kro. 6:36-38; Jer. 21:1; 2 Mbre. 25:18-21; 29:25; 37:3; 52:24-27; Zak. 6:10, 14.

V. DATA

A. Sofonia foli gjatë jetës së mbretit Josia (640-609 para K.).

B. Për shkak të tensionve të brendshme në Judë, që përshkruhen në këtë libër, 1:4-6, 8-9, 12; 3:1-3, me sa duket lexuesit e tij ishin judeasit para kryerjes së reformave të Josias (621 para K.).

VI. KONTEKSTI HISTORIK

- A. Disa e shohin instrumentin hyjnor të pushtimit në formën e hordhive skithe (NIV, Francisco Way, 626 para K.), që kishte pushtuar më herët Asirinë. Herodoti (1:103-106) thotë se skithasit pushtuan Palestinën dhe depërtuan deri në Egjipt, por aty u zmbarsën nga faraoni Psametiku I (663-609 para K.) i cili u dha haraç.
- B. Ndonëse pushtimi skithas është i mundshëm, me gjasë ishte Babilonia ajo që pushtoi Judën. Shumica e studiuesve mendojnë se pushtuesit ishin babilonasit.

VII. NJËSITË LETRARE (marrë nga *Introduction to the Old Testament*, nga R. K. Harrison, f. 939-940)

- A. Dita e ZOTIT, 1:1-2:3
 - 1. Kërcënimi i shkatërrimit që u drejtohet adhuruesve të Baalit, 1:2-6.
 - 2. Rrjedhjet e Ditës së ZOTIT, 1:7-13.
 - 3. Gjykimi vijues, 1:14-18.
 - 4. Mjeti i shmangjes së gjykimit, 2:1-3.
- B. Gjykimet kundër kombeve të huaja, 2:4-15
 - 1. Filistia, 2:4-7
 - 2. Moabi dhe Amoni, 2:8-11
 - 3. Egjipti, 2:12
 - 4. Asiria, 2:13-15
- C. Mjerimi dhe bekimi, 3:1-20
 - 1. Kërcënimi me ndëshkim i Jerusalemit, 3:1-7
 - 2. Siguria e bekimit për mbetjen besnike, 3:8-20

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Ky profet paralajmëron pushtimin e ardhshëm të Judës. Arsyeja për këtë akt gjykimi ishte idhujtaria mbizotëruese në Jerusalem, që kishte nisur nga Manasi. Sofonia përdor konceptin e “Ditës së ZOTIT”. Shpesh, profetët e përdornin një krizë të kohës si shenjë të ngjarjeve të ardhshme në fund të epokës.
- B. Ka një thirrje për pendim në 2:3. Shpresa e vetme e Judës ishte në dashurinë e Mesisë (3:17) dhe në praninë e tij (3:15 & 17)!
- C. Po kështu, është e qartë se Perëndia e përdori Asirinë për të ndëshkuar Izraelin, por tani, edhe kjo perandori e Gjysmëhënës Pjellore do të gjykohet bashkë me Judën!

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

- A. Fjalë dhe/ose fraza
 - 1. “priftërinjtë idhujtarë”, 1:4 (NASB & NIV)
 - 2. “ushtria e qiejve”, 1:5 (NIV, “ushtritë yjore”)
 - 3. “dita e Zotit është afër”, 1:7 (NASB & NIV)
 - 4. “gjithë ata që kërcëjnë mbi prag”, 1:9 (NIV, “gjithë ata që shmangin shkeljen e pragut”)
 - 5. “Llaçi”, 1:11 (NIV, “lagjja e tregut”)
 - 6. “dhe tufat do të shtrihen në mes të saj, gjithë bishat që qarkullojnë në tufa”, 2:14 (NASB & NIV)
 - 7. “kushdo që kalon aty pari do të vërshëllejë dhe do të tundë kokën me përçmim”, 2:15 (NIV, “gjithë ata që kalojnë aty pari tallen dhe tundin grushtin”)
 - 8. “mali im i shenjtë”, 3:11 (NIV, “kodra ime e shenjtë”)
- B. Persona
 - 1. Kushi, 1:1

2. Milkomi, 1:5 (NIV, “moleku”)
3. Keretitët, 2:5 (NIV, “keretit”)

X. VENDNDODHJET NË HARTË


1. Gaza, 2:4
2. Ashkeloni, 2:4
3. Ashdodi, 2:4
4. Ekroni, 2:4
5. Sodomi dhe Gomora, 2:9
6. Etiopia, 2:12 (NIV, “kushitët”)

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Pse Sofonia përmban gjenealogjinë më të gjatë nga gjithë profetët e DHV?
2. Pse profecia e gjykimit që jep Sofonia është më e rëndë se përmytja e Noeut?
3. Përcakto dhe shpjego konceptin e “Ditës së ZOTIT”.
4. Pse Juda ishte edhe më mëkatar dhe fajtor se Izraeli?
5. A përmban vargu 3:9 një element universal që lidhet me johebrenjtë? Pse?
6. Si na e tregon vargu 3:17 zemrën e Perëndisë?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR HAGAIN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Mban emrin e profetit me të njëjtin emër.
- B. Emri i tij do të thotë “Festë”. Shkronja *jod*, ose “i”, në fund të emrit mund të jetë shkurtesë e fjalës JHVH; në këtë rast, kuptimi do të ishte “festë e JHVH” (shih 1 Kro. 6:30), ose mund të jetë përemri “im”, që sërish do t’i referohej JHVH.

II. KANONIZIMI

- A. Ky libër është pjesë e “profetëve të mëvonshëm” (*Ekleziastiku* 49:10).
- B. Është pjesë e “të Dymbëdhjetëve”, një grupim i profetëve të vegjël (Baba Bathra 14b):
 - 1. Ashtu si Isa., Jer. Dhe Ezekieli, bëjnë pjesë në një rrotull të vetme.
 - 2. Përfaqësojnë dymbëdhjetë fiset, ose është numri simbolik i organizimit.
 - 3. Reflekojnë pikëpamjen tradicionale për kronologjinë e librave.
- C. Rendi i “të Dymbëdhjetëve”, ose i Profetëve të Vegjël, është lidhur nga shumë studiues me rrjedhën kronologjike. Është e qartë se Hagai dhe Zakaria duhen lidhur me njëri-tjetrin nga ana kronologjike.

III. GJINIA LETRARE

- A. Kjo është një seri prej katër ose pesë predikimesh (1:13).
- B. Kjo nuk është poezi.

IV. AUTORËSIA

- A. Hagai përmendet në Ezra 5:1; 6:14; dhe Zakaria 8:9, ku lidhet me Zakarian. Ndoshta, ishte një nga të kthyerit prej robërisë.
- B. Ai përmendet dhe në 1 *Ezra* 6:1; 7:3; 2 *Ezra* 10; edhe *Ekleziastiku* 49:11 është citim nga Hagai 2:23.
- C. Jeronimi thoshte se Hagai ishte prift, por ky është keqkuptim, që vjen nga 2:10-19.
- D. Ewald dhe Pusey thonë se 2:3; nënkupton se Hagai kishte parë tempullin e Solomonit, gjë që nënkupton se ishte 70 ose 80 vjeç.
- E. Kirili i Aleksandrisë përmend një mendim të përgjithshëm të kohës se Hagai ishte engjell. Kjo vjen nga keqkuptimi i fjalës hebraisht “lajmëtar” në 1:13.
- F. LXX u atribuon disa Psalme Hagait dhe Zakarias: 112, 126, 127, 137, 146-149.
- G. Të katërta predikimet e Hagait shkruhen në vetën e tretë, gjë që nënkupton:
 - 1. një teknikë të zakonshme letrare,
 - 2. një kopjues, ose redaktor.

V. DATA

- A. Hagai ishte profet i kohës pas robërisë, së bashku me Zakarian, bashkëkohësin e tij.

- B. Ky libër datohet nga dita e parë e muajit të gjashtë (1:1) deri në ditën e njëzetekatërt të muajit të nëntë (2:10, 20) të vitit të dytë të Darit I Histap (521-486 para K.). Kështu, data i bie të ketë qenë 520 para K., katër vjet para se të përfundonte tempulli i dytë më 516 para K., dhe përmbush profecinë e Jeremias në lidhje me shtatëdhjetë vitet e robërisë, që nisën më 586 para K.

VI. KRONOLOGJIA E PERIUDHËS (marrë nga *The Minor Prophets*, nga Dr. Teho Laetsch, botuar nga Concordia, f. 385.)

Viti i mbretërimit të Darit	Viti (para K.)	Muaji	Dita	Pasazhi	Përmbajtja
2	520	6 Shtator/tetor	1	Hag. 1:1-11	Hagai nxit popullin të punojë
			24	Hag. 1:12-15	Populli nis punën e ndërtimit
		7 Tetor/nëntor	1	Hag. 2:1-9	Lavdia e mëvonshme e tempullit të Perëndisë
		8 Nëntor/dhjetor	?	Zak. 1:1-6	Zakaria nis të profetizojë
		9 Dhjetor/janar	24	Hag. 2:10-19	Perëndia fillon t'i bekojë
				Hag. 2:20-23	Mbretërimi i Mesisë vendoset pas përmbysjes së fuqive botërore
	519	11 Shkurt/mars	24	Zak. 1:7-6:8	Vegimet e natës së Zakarisë
				Zak. 6:9-15	Kurorëzimi i Jozueut, parahijezim i priftërisë së Mesisë
4	518	9 Dhjetor/janar	4	Zak. 7, 8	Nxitje për pendim; premtim për bekim
6	516	12 Mars/prill	3	Ezra 6:15	Përkushtimi i tempullit
		?		Zak. 9-14	Pas përkushtimit të tempullit

VII. NJËSITË LETRARE - libri përvijohet sipas predikimeve të profetit.

- Predikimi, 1:1-11, rindërtoni tempullin!
- Krerët dhe populli përgjigjen, 1:12-15
- Predikimi i dytë, 2:1-9, madhësia e tempullit nuk është problem!
- Predikimi i tretë, 2:10-19, bekimet e Perëndisë do të vijnë nëse populli bindet dhe rindërton tempullin.
- Predikimi i katërt, 2:20-23, mbretërimi mbarëbotëror i Mesisë parahijezohet te personi i Zerubabelit.

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- Libri përqendrohet te rindërtimi i tempullit të dytë, që ishte lënë mënjanë para disa vitesh:
 - Shih Ezra 5:16 (viti i parë – nën Sheshbacarin)
 - Ezra 3:8-13 (viti i dytë – nën Zerubabelin)
- Premtimet e Perëndisë për bekime të atypëratyshme fizike dhe bekimet e ardhshme mesianike lidhen me rindërtimin e tempullit (rimëkëmbja e Besëlidhjes së Moisiut)
- Rëndësi nuk ka madhësia dhe madhështia e tempullit, por prania e tij. Prania e Perëndisë, që simbolizohet nga tempulli, ishte lavdia e vërtetë!

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjala dhe/ose fraza:

1. “shtëpitë tuaja të mbuluara mirë”, 1:4 (NASB & NIV)
2. “shqyrtoni sjelljen tuaj”, 1:5, 7 (NIV, “mendoni me kujdes për...”)
3. “Do t’i shkund të gjitha kombet”, 2:7 (NASB & NIV)
4. “lavdia e mëvonshme e kësaj shtëpie do të jetë më e madhe se ajo e mëparshmja”, 2:9 (NASB & NIV)
5. “Zerubabel... do të të bëj si unazë vule”, 2:23 (NASB & NIV)

B. Persona

1. Dari I, 1:1
2. Zerubabeli, 1:1
3. Jozueu, 1:1
4. “ZOTI i ushtrive”, 1:2 (NIV, “ZOTI i Plotfuqishëm”)

X. VENDNDODHJET NË HARTË – Nuk ka.

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Cila është tematika qendrore e librit?
2. Pse judenjtë e kthyer nga robëria po kalonin kaq kohë të vështira në Judë?
3. Cilat pjesë të kapitullit 2 janë mesianike? Pse?
4. Shpjego 2:3.
5. Shpjego 2:10-19.
6. Pse thuhet gjëra kaq madhështore për Zerubabelin, kur historia përmend shumë pak prej arritjeve të tij? (2:20-23)



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR ZAKARINË

I. EMRI I LIBRIT

- A. Mban emrin e profetit me të njëjtin emër.
- B. Emri i tij do të thotë “JHVH kujton”, ose “i kujtuar nga JHVH”, ose “JHVH ka kujtuar”. Emri i tij nënkupton se JHVH ishte ende me judenjtë dhe e kishte ripërtërirë besëlidhjen me ta.

II. KANONIZIMI

- A. Ky libër është pjesë e “profetëve të mëvonshëm” (*Ekleziastiku* 49:10).
- B. Është pjesë e “të Dymbëdhjetëve”, një grupim i profetëve të vegjël (Baba Bathra 14b):
 - 1. Ashtu si Isa., Jer. Dhe Ezekieli, bëjnë pjesë në një rrotull të vetme.
 - 2. Përfaqësojnë dymbëdhjetë fiset, ose është numri simbolik i organizimit.
 - 3. Reflektojnë pikëpamjen tradicionale për kronologjinë e librave.
- C. Rendi i “të Dymbëdhjetëve”, ose i Profetëve të Vegjël, është lidhur nga shumë studiues me rrjedhën kronologjike. Është e qartë se Hagai dhe Zakaria përbëjnë një dyshe historike.

III. GJINIA LETRARE

- A. Ky libër është shembull i letërsisë apokaliptike:
 - 1. Kapitujt 1-8 përbëjnë, në thelb, prozë.
 - 2. Kapitujt 9-14 përbëjnë, në thelb, poezi.
- B. Kjo gjini ishte unike për judenjtë. Shpesh, përdorej në kohë të mbushura me tension për të shprehur bindjen se Perëndia e ka në dorë historinë dhe se do të sjellë çlirimin e popullit të vet.
- C. Karakterizohet nga:
 - 1. ndjesia e fortë për sovranitetin mbarëbotëror të Perëndisë,
 - 2. beteja mes së mirës dhe së ligës në këtë epokë,
 - 3. përdorimi i fjalëve të fshehta e të koduara,
 - 4. përdorimi i ngjyrave,
 - 5. përdorimi i numrave,
 - 6. përdorimi i kafshëve, madje, ndonjëherë, edhe i kafshëve/njerëz,
 - 7. Perëndia e përçon zbulesën e vet me anë të ëndrrave ose vegimeve, zakonisht me ndërmjetësimin e engjëjve.
 - 8. Përqendrohet, pikësisht, tek e ardhmja.
- D. Disa shembuj të tjerë janë:
 - 1. Dhiata e Vjetër
 - a. Danieli 7-12
 - b. Ezekieli 37-48 (?)
 - 2. Dhiata e Re
 - a. Mateu 24, Marku 13, Luka 21, 2 Thes. 2
 - b. Zbulesa
 - 3. Jokanonike
 - a. I Enokut
 - b. IV Ezrës (Esdra)
 - c. II Barukut

- E. Jeronimi e quajti Zakarian librin më të vështirë të Dhiatës së Vjetër. Megjithatë, ai përmendet shpesh në Dhiatën e Re:
1. Kapitujt 1-8 në librin e Zbulesës.
 2. Kapitujt 9-14 në ungjijtë.
- F. Këto vegime janë të vështira për t'u interpretuar, por nëse kemi parasysh kontekstin historik, ato duhet të bëjnë fjalë për rindërtimin e tempullit në Jerusalem pas kthimit nga robëria. Përqendrohen tek dita e re e faljes dhe e ardhjes së Mesisë.

IV. AUTORI

- A. Zakaria ishte emër shumë i përhapur hebre. Shqiptohej në dy mënyra: Zekeria, ose Zakaria. Në DHV ka 27 persona që u shqiptohet emri me “e” dhe 2 të tjerë që u shqiptohet me “a”.
- B. Kapitulli 1:1 thotë se Zakaria ishte profet (shih Ezra 5:1; 6:14; Neh. 12:4, 16). Është e paqartë psse Berekiahu përmendet në 1:1, por nuk përmendet në Ezra 5:1 dhe 6:14. Kjo do ta bënte Zakarian profet të hershëm pas robërisë, njësoj si Hagai dhe Malakia (dhe, ndoshta, si Abdia me Joelin).
- C. Shumë studiues të sotëm e mohojnë unitetin e kapitujve të Zakarias. Kjo ndodh për shkak se kapitujt 1-8 ndryshojnë shumë nga kapitujt 9-14. Në kapitujt 1-8, profeti përmendet me emër dhe jepen data historike. Konteksti është qartazi i një kohe pas kthimit nga robëria. Kjo pjesë aludohet shpesh nga Gjoni në librin e Zbulesës. Nga ana tjetër, kapitujt 9-14 janë pa datë. Nuk përmendet asnjë profet në to. Konteksti historik është eskatologjik. Kjo pjesë aludohet shpesh në ungjijtë.
- Në Mat. 27:9, Jezusi i atribuon Jeremisë një citim që është marrë nga Zakaria 11:12-13. Ky ishte fillimi i prirjes që autorësia e kapitujt 9-14 të mos i atribuohet Zakarias. Nga ana tjetër, edhe Rrotullat e Detit të Vdekur e shfaqin Zakarian si një njësi të vetme. Ka një sërë elementesh të brendshme të librit që tregojnë se përbën një njësi të vetme:
1. përdorimi i numrit “dy” – 4:3; 5:9; 6:1; 11:7; 13:8,
 2. përdorimi i thirroses – 2:7, 10; 3:2, 8; 4:7; 9:9, 13; 11:1-2; 13:7,
 3. përdorimi i frazës “nga vajtja dhe nga ardhja”, që është unike për Zakarian – 7:14; 9:8,
 4. përdorimi i përsëritur i frazës “thotë Zoti” – përdoret 16 herë,
 5. forma *kal* e “banoj” – 2:8; 7:7; 12:6; 14:10.
- (Këto janë marrë nga R. K. Harrison, *Introduction to the Old Testament*, f. 954. Për një diskutim të mëtejshëm për unitetin e librit shih E. J. Young, *Introduction to the Old Testament*, f. 280.)
- D. Fakti se Zakaria përbëhet nga një pjesë historike dhe nga një pjesë për të ardhmen nuk duhet të na habisë. Këtë model e kemi parë dhe më herët:
1. Isaia 1-39 dhe 40-66
 2. Ezekieli 1-29 dhe 30-48
 3. Danieli 1-6 dhe 7-12
- E. Një hyrje e re për DHV, e shkruar nga Andrew Hill dhe John Walton, në faqen 421 i përvijon të dyja këto pjesë si një sërë kiazmath. Kjo teknikë koherente letrare jep të dhëna të mëtejshme për një autor të vetëm.

V. DATA

- A. Zakaria 1:1 thotë se profeti e nisi shërbesën e vet në vitin e dytë të muajit të tetë të mbretërimit të Darit I (522-486 para K.). Shumica e studiuesve mendojnëse ky ishte Dari I Histropi, i cili e mori në dorë mbretërinë e Persisë pas vdekjes së Kambisit II (530-522), birit të Kirit II, më 522 para Krishtit. Dari ishte gjeneral në ushtrinë perse.
- B. Në këtë mënyrë, data i bie të ketë qenë 519 ose 520 para K. (dy muaj pas Hagait). Zakaria predikoi për rreth dy vjet (shih 1:1, 7; 7:1).

VI. KONTEKSTI HISTORIK

VII. NJËSITË LETRARE (e marrë nga *Introduction to the Old Testament*, R. K. Harrison, f. 950).

A. Profecitë e datuara, kapitujt 1-8

1. Hyrje dhe thirrje për pendim, 1:1-6.
2. Tetë vegime që lidhen me rindërtimin e tempullit të Jerusalemit, 1:7-6:15
 - a. Katër kalorësit: premtimi për rimëkëmbjen hyjnore, 1:7-17
 - b. Katër brirët shkatërrues dhe katër kovaçët, 1:18-21 (2:1-4 në tekstin hebraisht)
 - c. Madhështia e pamasë e Jerusalemit, 2:1-13 (2:5-17 në heb.)
 - d. Pastrimi i Jozueut, një orakull; për të, 3:1-10
 - e. Shandani me shtatë degë, 4:1-14
 - f. Rrotulla e madhe fluturuese, 5:1-4
 - g. Gruaja në një efa çohet në Babiloni, 5:5-11
 - h. Katër karroca me kuaj që përshkojnë tokën, 6:1-8
3. Pjesa historike: Jozueu simbolizon Mesinë, 6:9-15.
4. Pyetje e Zakarias në lidhje me agjërimin, 7:1-8:23.

B. Profecitë pa datë, 9-14

1. Gjykimi i armiqve të kombit; ardhja e princit të paqes, 9:1-17
2. Mbledhja në tufën e zgjedhur nga Udhëheqësi hyjnor, 10:1-12
3. Barinjte e mirë dhe ata të marrë; vuajtja e tufës, 11:1-17
4. Orakujt eskatologjikë, 12:1-13:6
5. Gjykimi pastrues i mbretërisë hyjnore, 13:7-14:21

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

A. Synimi kryesor i librit është inkurajimi i judenjve të kthyer për të rindërtuar tempullin. Kjo nisi me Sheshbacarin, Ezra 1:8; 5:16, por nuk ishte vazhduar më si punë gjatë kohës së Zerubabelit. Tempulli ishte anashkaluar për shumë vite. Hagai thotë se kjo ndodh për shkak të plogështisë së popullit, ndërsa Ezra lë të nënkuptohet se ndodhi për shkak të manovrave politike të provincave përreth, sidomos Samarisë.

B. Ky libër është shumë mesianik. Shumë nga profecitë për jetën e Jezusit jepen në kapitujt 9-14:

1. mbreti është i përlur dhe rri hipur mbi një kërriq, 9:9.
2. shitet për tridhjetë shekela argjendi, çmimi i një skllavi; si vend varrimi përdoret fusha e poçarit, 11:13,
3. theksohet se është pasardhës i Davidit, 12:4-9,
4. “ata do të më shohin mua, të cilin e tejshpuan...” 12:10.

C. Dashuria dhe mbretërimi i përbotshëm i Perëndisë shihet në 2:11; 8:20-23; 14:9, 16. Por në kapitujt 9-14 theksohet kryengritja e përbotshme e gjithë popujve, 12:3 & 14:2 (Psa. 2).

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe/ose fraza

1. Kthehuni, 1:3 (NASB & NIV)
2. “jam jashtëzakonisht xheloz për Jerusalemin dhe Sionin”, 1:14 (NASB & NIV)
3. “një litër matës do të shtrihet mbi Jerusalemin”, 1:16 (NASB & NIV)
4. Katër brirët, 1:18-21 (NASB & NIV)
5. “Do të jem si mur zjarri rreth saj”, 2:5 (NIV, “unë vetë do t’i jem si mur zjarri përreth”)
6. “molla e syrit tim”, 2:8 (NASB & NIV)
7. “Jozueu ishte veshur me rroba të ndotura”, 3:3 (NASB & NIV)

8. Rrotulla fluturuese, 5:1 (NASB & NIV)
9. Terafirmët, 10:2 (NIV, “idhujt”)
10. Dy shkopinjtë: “Hir dhe Bashkim”, 11:7, 14 (NASB & NIV)
11. “Do ta bejë Jerusalemin një kupë... një gur të rëndë”, 12:2-3 (NIV, “shkëmb të patundur”)
12. “nga Jerusalemi do të rrjedhin ujëra të freskëta”, 14:8 (NASB & NIV)

B. Persona që duhen përcaktuar shkurtimisht

1. Berekiahu, 1:1, 7
2. Engjëlli i Zotit, 1:11; 3:1
3. Satani, 3:1-2
4. Dega, 3:8; 6:12
5. “dy të vajosurit”, 4:14
6. Hadadrimoni, 12:11 (NIV, “Hadad Rimoni”)

X. VENDNDODHJET NË HARTË

1. Sioni, 1:14
2. Shinari, 5:11 (NIV, “Babilonia”)
3. Beteli
4. Hamati, 9:2
5. Pllajat e Megidos, 12:11
6. Mali i Ullinjve, 14:4

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Ku qëndron lidhja mes Zakarias dhe Hagait?
2. Ç’lidhje kanë vegimet e 1:7-6:8 me njëri-tjetrin?
3. Rendit titujt e Mesisë në këtë libër.
4. Kush përfaqësohet nga dy pemët e ullirit në kapitullin 4?
5. Sa ditë agjërimi renditen në kapitujt 7-8?
6. Rendit profecitë e kapitujve 9-14 që lidhen me jetën e Krishtit.



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES

HYRJE PËR MALAKIAN

I. EMRI I LIBRIT

- A. Mban emrin e profetit me të njëjtin emër.
- B. Emri i tij do të thotë “lajmëtari im”.
 1. Mund të jetë titull, “lajmëtari im”, 3:1.
 2. Mund të jetë “engjëlli im”.
 3. Mund të jetë emër i përveçëm.

II. KANONIZIMI

- A. Ky libër është pjesë e “profetëve të mëvonshëm” (*Ekleziastiku* 49:10).
- B. Është pjesë e “të Dymbëdhjetëve”, një grupim i profetëve të vegjël (Baba Bathra 14b):
 1. Ashtu si Isa., Jer. Dhe Ezekieli, bëjnë pjesë në një rrotull të vetme.
 2. Përfaqësojnë dymbëdhjetë fiset, ose është numri simbolik i organizimit.
 3. Reflekojnë pikëpamjen tradicionale për kronologjinë e librave.
- C. Rendi i “të Dymbëdhjetëve”, ose i Profetëve të Vegjël, është lidhur nga shumë studiues me rrjedhën kronologjike. Është e qartë se Malakia ishte profeti i fundit i vogël.

III. GJINIA LETRARE

- A. Përdor diatribën për të përçuar të vërtetën. Ky është një format i llojit “pyetje-përgjigje”. E vërteta prezantohet dhe, pastaj, një kundërshtues i hamendësuar shtron një pyetje, ose bën një koment, dhe folësi i përgjigjet.
- B. Malakia është quajtur “Sokrati hebre”.
- C. Si Pali, ashtu dhe Jakobi, e përdorën këtë metodë për të paraqitur të vërtetën.
- D. Kjo strukturë mund të shihet në fjalët “Por ju thoni...”, 1:2, 6, 7 (dy herë), 12, 13; 2:14, 17 (dy herë); 3:7, 8, 13, 14.
- E. Nuk është poezi hebraike.

IV. AUTORËSIA

- A. Fjala hebraisht “*malaki*”, që përdoret në 1:1, do të thotë “engjell”, ose “lajmëtar”.
 1. Shumica e marrin si emër të përveçëm.
 2. LXX e konsideron si titull (shih 3:1).
 3. Origeni mendonte se bëhej fjalë për një engjell.
- B. Talmudi (Mekila 15a) thotë se këtë libër e shkroi Mordekai.
- C. Targumi aramaisht i Jonatanit thotë se ky ishte titull i Ezrës. Ky interpretim ndidet dhe nga Jeronimi, Rashi dhe Kalvini.
- D. Jozefusi, në *Lashtësitë e judenjve* 11:4-5, i përmend të gjithë profetët e pas-robërisë me emër, me përjashtim të Malakisë.

- E. Emri i tij nuk shfaqet në asnjë citim që i bëhet në DHR këtij libri.
- F. *II Esdra* i rendit profetët e pas robërisë në këtë rend: Hagai, Zakaria dhe Malakia.
- G. Meqë asnjë libër tjetër profetik nuk është anonim, Malakia duhet të ketë qenë emër i përveçëm. Mos harroni, gjithsesi, se autorësia e këtij libri nuk ndikon aspak në frymëzimin e tij hyjnor.

V. DATA

- A. Ka ngjashmëri të madhe mes sfondit historik të Nehemias dhe atij të Malakisë:
 1. tensioni për të dhjetat, Mal. 3:8; Neh. 10:32-39.
 2. të varfrit shtypen, Mal. 3:5; Neh. 5:1-5,
 3. martesat e përziera, Mal. 2:10, 11; Neh. 13:1-3, 23-24 (Ezra 9:1-2).
- B. Mundësia më e mirë mbetet periudha mes 450-430 para K., pas kthimit të Nehemias në oborrin e Artakserksit I, Neh. 13:6.

VI. MARRËDHËNIA HISTORIKE MES HEBRENJVE DHE EDOMIT, 1:2-5

- A. U ishte thënë t'i respektonin si kushërinj:
 1. Numrat 20:14
 2. Ligji i Përtërirë 2:4-6
- B. Kishin shumë përplasje me ta:
 1. Numrat 20:14-21
 2. Gjyqtarët 11:16 e më tej
 3. 1 Samuelit 14:47-48
- C. Profecitë kundër tyre:
 1. Numrat 24:18
 2. Isaia 34:5 e më tej; 63:1 e më tej
 3. Jeremia 49:7 e më tej
 4. Vajtiemt 4:21-22
 5. Ezekieli 26:12 e më tej; 35:13 e më tej; 36:2-6
 6. Amosi 1:11-12

VII. NJËSITË LETRARE

- A. Përvijimi i Malakisë bëhet sipas gjashtë debeteve, ose diatribave, të tij. Malakia flet në emër të Perëndisë, populli i përgjigjet, pastaj Malakia flet sërish në emër të Perëndisë.
- B. Përvijimi
 1. Dashuria e Perëndisë për judenjtë e kthyer, 1:2-5
 2. Dënimi hyjnor i priftërinjve, 1:6-2:9
 3. Dënimi hyjnor i divorcit dhe martesave të përziera nga ana fetare, 2:10-16
 4. Dënimi hyjnor për qëndrimin e tyre të gabuar (Ku është drejtësia e Perëndisë?), 2:17-3:6
 5. Dënimi hyjnor për mbështetjen që ata i bënin tempullit, 3:7-12
 6. Dënimi hyjnor për qëndrimin e tyre të gabuar (Është e kot t'i shërbesh Perëndisë!), 3:13-4:3
 7. Një paralajmërim dhe premtim i fundit, 4:4-6

VIII. TË VËRTETAT KRYESORE

- A. Malakia rendit mëkatet e plogështisë dhe zhgënjimit të judenjtë e kthyer.

B. Ky libër përmban disa pohime mbarëbotërore. Perëndia do ta përdorë Izraelin për të ungjillizuar botën, 1:5, 11, 14; 3:12.

C. Populli i Perëndisë po fyen karakterin e Zotit:

1. 2:17 – Perëndia nuk vepron me drejtësi.
2. 3:6 – karakteri i pandryshuar i Perëndisë është e vetmja arsye pse Izraeli ekziston ende.
3. 3:14 – është e kotë t'i shërbejmë Perëndisë.

D. Ky libër përmban shpresën mesianike, 3:1; 4:5.

IX. FJALË DHE/OSE FRAZA DHE PERSONA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

A. Fjalë dhe/ose fraza

1. Orakull, 1:1 (NASB & NIV)
2. “por ju thoni...” 1:2 (NIV, “Por ju pyesni...”)
3. “ju paraqisni ulokët dhe të sëmuret”, 1:8 (NIV, “kafshë të çala, ose të sëmura”)
4. “ju i merrni erë me përçmim”, 1:13 (NIV, “ju mblidhni hundën me përçmim”)
5. “qortoni pasardhjen”, 2:3 (NIV, “qortoni pasardhësit tuaj”)
6. “është martuar me të bijën e një perëndie të huaj”, 2:11 (NASB & NIV)
7. “Zoti, që ju kërkoni, do të vijë papritmas në tempullin e tij”, 3:1 (NASB & NIV)
8. “libri i kujtimeve”, 3:16 (NIV, “rrotulla e kujtesës”)
9. “dielli i drejtësisë do të ngrihet me shërim në krahët e tij”, 4:2 (NASB & NIV)

B. Persona

1. Esau, 1:2-3
2. Jakobi, 1:2
3. Levi, 2:4
4. Magjistarët, 3:5
5. I huaj, 3:5
6. Profeti Elija, 4:5

X. VENDNDODHJET NË HARTË


1. Edom, 1:4
2. Judë, 2:11
3. Izrael, 2:11
4. Horeb, 4:4

XI. PYETJE PËRMBAJTJEJE PËR STUDENTËT

1. Si është strukturuar Malakia?
2. Pse përmendet Esau në 1:2?
3. Si e tregojnë prifti dhe populli mungesën e respektit për JHVH?
4. Ku e ka fillesën në Shkrim mallkimi i përmendur në 2:2 dhe 3:9? Për çfarë bëhet fjalë?
5. Pse thotë Perëndia se e urren divorcin? 2:16
6. Si do të vinte Mesia papritmas në tempull?
7. Pse është shumë i rëndësishëm 3:6?
8. A premton Perëndia begati nëse japim të dhjetat?
9. A erdhi Elija para Jezusit?



**ANCIENT
NEAR EAST**



PALESTINE



0 10 20 30 40
SCALE IN MILES